- Udhëzim Administrativ MMPH - Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor;
- Udhëzim Administrativ Nr. 05/2014 për Përgjegjësit e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor si dhe Parimet dhe Procedurat për Pjesëmarrjen e Publikut në Planifikim Hapësinor.

Bazuar në kërkesat ligjore, ky Plan Zhvillimor Komunal është në përputhje me Planin Hapësinor të Kosovës, i cili përcakton makro-kornizën zhvillimore për Komunën e Ferizajt. Plani Zhvillimor i Ferizajt është përgatitur nën udhëheqjen e koordinatorit, Drejtorisë për Urbanizëm dhe drejtorive të tjera përkatëse komunale. Për këtë qëllim janë mbajtur një varg seminaresh, ku janë diskutuar propozimet e planifikimit me ekipin ndër-disiplinor. Veç kësaj, ekspertët lokalë kanë pasur konsultime edhe me ekspertët vendorë dhe rajonalë. Në mënyrë që të krijohet planifikim dhe zhvillim i qëndrueshëm, Komuna ka angazhuar ndërmarrjen projektuese "INSI" në cilësinë e konsulentit të jashtëm për të përkrahur punonjësit e komunës gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

Ky Plan bazohet në njohuritë e ekspertëve të disiplinave të ndryshme shkencore, të cilat janë përfshirë gjatë hartimit të këtij Plani. Plani Zhvillimor Komunal siguron zhvillimit hapësinor dhe këshilla të mëtutjeshme për çështjet themelore të planifikimit. Pas aprovimit të tij nga komuna, Plani Zhvillimor Komunal do të luajë një rol vendimtar në tërheqjen dhe orientimin e investimeve publike, private, publiko-private dhe komerciale, si dhe do të shërbejë si bazë për hartimin e kushteve zhvillimore dhe ndërtimore të Hartës Zonale të Komunës.

Sfida më e madhe gjatë përgatitjes së këtij Plani janë dallimet në emërtimet të disa zonave kadastrave në mes të Ligjit Nr. 03/L-041 Për Kufijtë Administrativ Të Komunave dhe të dhënave zyrtare të regjistrit zyrtar të Agjencionit Kadastral të Kosovës, të cilat Drejtoria komunale e Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër është obliguar që të shfrytëzoj. Kështu ky plan është bazuar në të emërtimet dhe kufijtë e Agjencionit Kadastral të Kosovës, të cilat janë të dhënat zyrtare të zonave kadastrale në Republikën dhe kur ato azhurnohen sipas Ligjit Nr. 03/L-041 Për Kufijtë Administrativ Të Komunave, Komuna gjithashtu do të azhurnojë emërtimet e zonave kadastrale



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Vendimet e Kuvendit të Komunës

Vendimi i Kuvendit të Komunës për hartimin e PZHK-së



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.08
Data: 29.01.2016

Ne bazë të Ligjit Hapësinor 04/L-174 i datës 31.7.2013 neni 11, 15, dhe dispozitave të tjera të të njëjtit ligj, në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.11/2015 të datës 11.11.2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për Hartimin, Zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, si dhe në bazë të nenit 58, alineja 1.e Ligjit për Qeverisjen Lokale 03/L-040 si dhe në bazë të statutit të komunës 01.Nr.50 të datës 28.6.2013, Kuvendi Komunal i Ferizajt në seancën e vet të rregullt të mbajtur më 29.01.2016 mori:

VENDIM PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË HARTIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL

I

Me këtë vendim fillohet procesi i hartimit të Planit Zhvillimor Komunal i cili përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik të komunës.

II

Pjesë e këtij vendimi është Programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit dhe hartimit të këtij Plani ashtu siç parashihet në nenin 11 pika 1.3

III

Për realizimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës .

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në veb faqen e komunës.



Kryesuesi i KK-së

Faruk Guri



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Vendimi i Kuvendit të Komunës për miratimin dhe zbatimin

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS DHË PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA		
Datëse / Mënyrë: Date / Denar: 25.9.2018		
Nr. Dëgje / Orig. / red.	Nr. Prot. / Di. Prot.	Nr. Faqeve. / Br. Strana.
01	147	2
Ferizaj - Uroševac		



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr.147
Datë: 25.09.2017

Në bazë të nenit 12, neni 17, pika b, të Ligjit NR. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen lokale (gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës e nr.28,qershor)nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1 dhe neni 10,paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, neni 15, dhe neni 26 i Ligjit NR. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dt.23.08.2013,si dhe Udhëzimit Administrativ MMPH- NR. 11/2015 Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal , neni 50,te Statutit te Komunës 01.NR-50 dt.28.6.2013 .Kuvendi Komunal ne seancën e vet te rregullt te mbajtur me dt.21.09.2017 muar:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL 2017-2025 I KOMUNËS SË FERIZAJT PËR PERIUHDHËN TETË VJEÇARE.

I

Me këtë vendim miratohet Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt , për periudhën tetë (8) vjeçare .

II

1. Plani Zhvillimor Komunal i Komunës së Ferizajt i cekur në pikën I përbëhet nga pjesa tekstuale dhe pjesa grafike.
2. Pjesa tekstuale e planit përmban :Profilin e zhvillimit hapësinor dhe analizën e gjendjes, vizionin, parimet dhe caqet, kornizën e zhvillimit hapësinor, strategjitë dhe dispozitat për zbatim dhe monitorim.
3. Pjesa grafike e planit përmban të dhënat hartografike dhe pjesët tjera grafike ku përshkruhet gjendja në hapësirë dhe ndërhyrjet në të.
4. Prezantimet hartografike të digjitalizuara të planit paraqesin tërësinë e zgjidhjeve të planifikuara.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Vendimi për pëlqimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Permanentni Sekretara / Office of the General Secretary

Në bazë të nenit 28.paragrafi 1, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr.03/L-025, nenit 13 të Ligjit për Vlerësim Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230 dhe nenit 90. të LPA (Nr.02/L-28), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, bie këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e Drejtorisë të Mjedisit dhe Urbanizmit - Komuna e Ferizajt për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Ferizajt.

A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka shqyrtuar kërkesën, dokumentacionin dhe Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Ferizajt, Raportin e Shqyrtimit Publik te dorëzuar nga Drejtoria e Mjedisit dhe Urbanizmit - Komuna e Ferizajt, për Pëlqim Mjedisor për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal, të Komunës së Ferizajt, vlerëson që:

Drejtorisë së Mjedisit dhe Urbanizmit - Komuna së Ferizajt, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i jep **Pëlqimi Mjedisor** për Raportin e Vlerësimit

Faqe 2 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave " Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë
Telefon: + 381 38-200-32-307
<http://www.ks-gov.net/mmph>, E-mail: zsp.mmph@ks-gov.net





Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Vendimi i miratimit të PZHK-së nga MMPH



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit/ Department Prostornog Planiranja,
Izgradnje i Stanovanja/ Department of Spatial Planning, Construction and Housing

Në bazë të neni 9, paragrafi 2, nenparagrafi 2.3.; neni 11, paragrafi 1, nenparagrafi 1.9.; neni 15.; neni 20. dhe neni 26. të Ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor dhe neni 90 të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, sjellë:

VENDIM

Për dhënien e Pëlqimit për miratim të Plani Zhvillimor Komunal 2017- 2025 i Komunës së Ferizajt

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas verifikimit të përputhshmërisë së projekt-Plani Zhvillimor Komunal 2017-2025 i Komunës së Ferizajt, me "Planin Hapësinor të Kosovës-Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+", jep pëlqim për miratim në Planin Zhvillimor Komunal 2017 – 2025 i Komunës së Ferizajt.



Vendimi për hapjen e shqyrtimit publik



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01.Nr. 25
Data: 09.03.2017

Në bazë të neni 12 paragrafi, 2 pika d, neni 17, pika b dhe neni 40 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale, neni 11, paragrafi 1, nenparagrafi 1.12 dhe neni 20 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.05/2014 për Përgjegjësitë e Autoriteteve të Planifikimit Hapësinor, si dhe Parimet dhe Procedurat për pjesëmarrjen e publikut në Planifikimin Hapësinor, neni 4.paragrafi 3 pika 3.1 neni 7 paragrafi 2, dhe 3, neni 8, 10, 12 dhe 14, si dhe në bazë të neni 50, 69, dhe 70. të Statutit të Komunës së Ferizajt 01 nr. 50 të datës 28.06.2013 dhe sipas Rekomandimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të datës 21.02.2017, për rishqyrtimin e vendimit 01 nr.16 të datës 31.01.2017, Kuvendit i Komunës së Ferizajt në seancën e vet të mbajtur më datën 09.03.2017 nxjerrë këtë:

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN PUBLIK TË PROJEKT PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT PËR PERIUHDHËN 2017-2025

Neni 1.

1.1 Me këtë vendim shpallet në shqyrtim publik Projekt-Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt 2017-2025.

Neni 2

2.1 Hapja zyrtare e shqyrtimit publik dhe prezantimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt 2017-2025 bëhet në sallën e Kuvendit Komunal më dt. 27.03.2017.

2.2 Ekspozimi i Projekt-Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt 2017-2025 bëhet nga data 25.03.2017 në hollin e Kuvendit Komunal.

2.3 Për të promovuar gjithë përfshirjen dhe transparencën, Komuna do të organizojë tubime nëpër vendbanime të ndryshme për çka qytetarët do të njohohen 8 dite përpara takimit, ashtu siç parashihet me ligj.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

1. Korniza strategjike

Gjatë përgatitjes së kornizës strategjike, Komuna është mbështetur në dokumentet vijuese strategjike:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Raporti i Gjellbër, Prishtinë, 2015
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Lista e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme 2016, Prishtinë, 2016
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Plani Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+, Prishtinë, Qershor, 2010
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, Prishtinë, 2013
- Qeveria e Republikës së Kosovës - Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (skzh), Prishtinë, Janar, 2016
- Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Strategjia e Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Prishtinë, Strategjia për Konsolidimin e Tokës 2010 – 2020, Prishtinë 2010, Strategjia për Zhvillimin e Pylltarisë 2010 – 2020, Prishtinë 2009.
- Ministria e Ekonomisë, Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017 – 2016, Prishtinë mars 2017, Strategjia e Ngrohjes e Republikës së Kosovës 2011 – 2018, Prishtinë Gusht 2011.
- Ministria e Financave, Strategjia për Zhvillimin e Partneriteteve Publikeprivate për Republikën e Kosovës, Prishtinë 2014.
- Ministria e Punëve të Brendshme, Strategjia Zhvillimore e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, Prishtinë 2016, Plani Zhvillimor Strategjik për Policinë, Prishtinë 2016
- Ministria e Infrastruktura, Strategjia Sektoriale dhe Transportit Multimodal 2015-2025 dhe Plan i Veprimit 5 vjeçar, Prishtinë Gusht 2015.
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike për Kosovën, Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+, Prishtinë Qeshorë 2010.
- Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2016-2026, Prishtinë 2016
- Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, Prishtinë Korrik 2016, Strategjia e Sigurimit të Cilësisë për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, Prishtinë 2016.
- Ministria e Diasporës, Strategjia për Diasporën dhe Mërgatën 2013-2018, Prishtinë korrik 2013
- Ministria e Shëndësisë, Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë, Prishtinë Nëntor 2016.
- Ministria e Mirqenjes Sociale, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, Prishtinë 2014.
- WYG International, Feasibility Study for Ferizaj Wastewater Treatment Plant - Volume 1 – Main Report, Ferizaj, 2014
- Komuna e Ferizajt, Dokument planifikimi-Transporti dhe Mobiliteti, Ferizaj 2011
- Komuna e Ferizajt, Komponentë e PZHK/PZHU-së, Vlerësimi i Rreziqeve dhe Menaxhimi i Fatkeqësive (VRMF), Ferizaj, 2011
- Komuna e Ferizajt, Programi Trevjeçar e Banimi 2014 – 2016, Ferizaj, 2013
- Komuna e Ferizajt, Qyteti i Perspektivës dhe i Dijes – Draft-Strategjia e zhvillimit ekonomik për Komunën e Ferizajt 2014 – 2019, Ferizaj, 2014

Korniza strategjike mbështetet në përmirësimin e sektorëve vijues:

▪ Bujqësia

Bujqësia është sektori që përben prioritet në ekonominë e Komunës dhe rruga për zbatimin e këtij plani në këtë degë është përmbajtësore për të ardhmen andej aktivitete e poshtë renditura janë esenciale.

▪ Industria

Bazuar në traditën dhe resurset natyrore lokale, Komuna synon që të zhvillojë industrinë përpunuese dhe të eksploatimit të resurseve natyrore.

▪ Ndërtimtaria

Hapja e vendeve të reja të punës, përmes fuqizimit i sektorit të ndërtimtarisë.

▪ Tregtia



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Vazhdimi i traditës and trendit aktual të Komunës si port i mallrave i Kosovës dhe fuqizimi i tyre me infrastrukturë adekuate.

▪ Turizmi

Bazuar në trashëgiminë natyrore dhe kulturore që shtrihet përbrenda territorit të Komunës, synohet Promovimi i Ferizajt si qytet i turizmit kulturor, natyror dhe rekreacional.

▪ Transporti

Përmirësimi i infrastrukturës së transportit dhe tansportit publik për të lehtësuar lëvizshmërinë e banorëve.

▪ Ngrohja qendrore termale

Në mënyrë që të mbrohet mjedisi dhe natyra, Komuna është e përkushtuar që të krijojë rrjetin e ngrohjes qendrore termale.

▪ Furnizim i qëndrueshëm me ujë të pijshëm

Në mënyrë që të mbrohet mirëqenia e banorëve, Komuna synon që të i ofrojë banorëve furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm.

▪ Furnizim i qëndrueshëm me ujë të pijshëm

Në mënyrë që të mbrohet mirëqenia e banorëve, Komuna synon që të i ofrojë banorëve furnizimit të vazhdueshëm me ujë të pijshëm.

▪ Arsimi

Zgjerimi i vëllimit, përmbajtjeve si dhe rritja e cilësisë së infrastrukturës të sistemit të arsimit në të gjitha nivelet në harmoni me konceptin e zhvillimit policentrik.

▪ Shëndetësia

Ofrimi i përmbajtjeve shëndetësore në vendbanime në përputhshmëri me funksionin e tyre si dhe hierarkinë

▪ Kultura

Ofrimi i kushteve dhe përmbajtjeve për ruajtje, konservim dhe përdorim në vazhdimësi të qëndrueshme të trashëgimisë kulturore

▪ Sporti dhe rekreimi

Ofrimi i përmbajtjeve sportive dhe rekreative për secilën zonë urbane dhe nënqendër sekondare.

▪ Banimi

Në mënyrë që strehimi të jetë financiarisht i arritshëm dhe i përshtatshëm, Komuna synon ngritjen e sasisë dhe cilësisë së banimit.

▪ Vendbanimet

Në mënyrë që zvogëlohen ngarkesat e trafikut dhe shpenzimet e banorëve të zonave rurale, zhvillimi e ardhshëm i Komunës do të bëhet sipas konceptit e zhvillimit hapësinor policentrik.

1.1. Strategjitë sektoriale

1.1.1. Strategjitë afatshkurta

- Zgjerimi dhe avancimi i njohurive dhe praktikave në fushën e bujqësisë

1.1.2. Strategjitë afatmesme

- Komuna duhet së bashku me Agjensionin e Pyjeve të fillojnë projektet në zonat e parapara me Planë për pyllëzim, ripyllëzim, kalim nga shkurret në pyje të rregullta dhe mirëmbajtje.
- Aktivizimi i eksploatimit të pasurive nëntokësore në pjesën veriore të Komunës.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve.
- Modernizimi i hekurudhës ekzistuese.
- Zgjerimi i rrugëve kryesore.
- Ngritja e kapaciteteve prodhuese dhe riparimi i rrjetit ekzistues të ujësjellësit.

1.1.3. Strategjitë afatgjata

- Sa më shumë sipërfaqe e tokës bujqësore dhe mundësi (të mbrohet dhe zhvillohet) në funksion të zhvillimit ekonomik.
- Shtimi i fondit blegtoral, si dhe përmirësimi i racave të kafshëve me raca me potencial të lartë të prodhimit sidomos për mish dhe qumësht.
- Rritja dhe fuqizimi i Zonave Zhvillimore të Bujqësisë.
- Përcaktimi i zonave ndërtimore me kushte të volitshme zhvillimore dhe ndërtimore.
- Zgjerimi i zonave industriale dhe komerciale.
- Ndërtimi i terminalit të mallrave të importuara në Gurrëz.
- Zhvillimi i Neredimës dhe Jezercit si kompleks turistik-rekreativ.
- Përmirësimi i transportit publik Komunal.
- Ndërtimi i rrjetit e ngrohjes qendrore termale.
- Krijim i infrastrukturës për secilën lagje urbane dhe nënqendër sekondare.
- Kompletimi i infrastrukturës publike arsimore me sipërfaqe 7m²/nxënës.

1.2. Udhëzimet, përgjegjësitë dhe kërkesat e “Planit Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+”

“Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” është dokument i planifikimit hapësinor, i përgatitur nga niveli i qeverisjes qendrore për të siguruar zhvillim të baraspeshuar dhe të qëndrueshëm për regjionet dhe komunat e Republikës së Kosovës. Të gjitha komunat janë të detyruara të i përmbahen zhvillimeve të planifikuara në “Planin Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” për territoret e tyre. “Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” është i bazuar mbi vizionin për të ardhmen:


“Kosova vend sovran i integruar në Bashkësinë Evropiane me zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik, infrastrukturë dhe teknologji moderne, me mundësi arsimimi për të gjithë, fuqi punëtore të kualifikuar, një vend që ka respekt për mjedisin, trashëgimin natyrore dhe kulturore për tërë territorin e vet dhe vendet fqinje, me një shoqëri të hapur që e promovon llojllojshmërinë dhe shkëmbimin e ideve, duke respektuar të drejtat e të gjithëve”.¹

Pjesa qendrore e “Planit Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” bazohet në:

- Zhvillimi i rrjetit të fuqishëm urban për zhvillim ekonomik;
- Zhvillimi dhe ruajtja e burimeve natyrore; dhe
- Zhvillimi i lidhjeve strategjike.

“Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” përcakton veçoritë karakteristike dhe zhvillimet e planifikuara të regjioneve kryesore në Kosovë.

¹ MMPH, *Plani Hapësinor të Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+*, Prishtinë, Qershor, 2010



Harta 1 Plani Hapësinor të Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+”


“Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” ka përcaktuar regionin e Ferizajt si “Urat e Kosovës- Hapësirë e Verdhë” me këto përparësi dhe mundësi të zhvillimit:

- Qyteti i Ferizajt me pozitë qendrore në korridorin e zhvillimit në jug të Kosovës – pikës kufitare në Han të Elezit-vend tregtimi me Maqedoni e më tej Shqipëri dhe Greqi;
- Traditë dhe trendi aktual i fuqishëm për tregti;
- Baza e KFOR-it si përparësi, me vullnet për ndihmë Kosovës në zhvillimin ekonomik,
- Tradicionalisht hapësirë ku bashkëjetojnë, punojnë, me shkallë të lartë të tolerancës, grupe të ndryshme etnike;
- Hapësirë e cila në nuk është afektuar shumë nga pasojat e luftës së fundit, krahasuar me viset tjera në Kosovë;
- Mundësi për ndërtim të transportit efikas publik, për shkak të motorizimit ende jo të lartë,
- Trendi i ndërtimeve (banimit individual, kolektiv, afarist) dëshmi e potencialit investiv privat,
- Mundësi për orientimin e kapitalit privat drejt investimeve të rëndësishme sipas planeve zhvillimore;
- Toka kualitative, e përshtatshme për zhvillim të bujqësisë, industrisë përpunuese e shërbëse, agrobiznes;
- Prezenca e resurseve natyrore, rekreative, shëruese, të ujërave termal, mundësi për zhvillim të turizmit malor, rekreativ e shëruese; dhe
- Mundësia e shfrytëzimit të atraksionit natyror të bifurkacionit të lumit të Neredimes si resurs turistik.

Për këtë zonë është paraparë zhvillimi i shërbimeve tregtare, agro-industriale dhe turistike. Komuna e Kaçanikut, Novobërdës, Vitisë, Kamenicës dhe Shtërpçës gjithashtu janë të përfshira në këtë zonë. Sipas Planit Hapësinor, “Urat e Kosovës - Hapësirë e Verdhë” kanë këto veçori:

- Tokë bujqësore të kualitetit të lartë;
- Resurse të ujërave minerale;

- Hapësira të lira të gjelbra;
- Aktivitete ekonomike tregtare, industriale dhe turistike - malore, transitore dhe shëndetësore.



Harta 2 Strategjia e zhvillimit hapësinor – Hapësira e verdhë, “Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+”

Ky vizion parasheh një rol të rëndësishëm për rajonin si një lidhje ndërmjet Kosovës dhe vendeve fqinje. Brenda rrjetit të qyteteve dhe fshatrave janë zhvilluar aktivitete ekonomike, janë tërhequr investimet, dhe është siguruar hapësirë e përshtatshme për sektorin privat, duke e bërë rajonin konkurrent në tregtinë e brendshme dhe të jashtme dhe duke e përmirësuar kualitetin e jetës për të gjithë qytetarët e njëherësh duke i përmbushur kriteret për zhvillim të qëndrueshëm. Firma të vogla dhe të mëdha (FVM) janë duke e siguruar kontributin më të madh të zhvillimit ekonomik.

Synimet kryesore për rajonin e Ferizajt janë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve që siguron qasje të lehtë dhe kushte për jetë dhe punë atraktive në qytete të mëdha të Gjiçanit, Ferizajt, si dhe nëpër fshatra të vogla;
- Mbështetja e ekonomisë së qëndrueshme të urbanizmit lokal;
- Konkurrencë në tregun e brendshëm dhe të jashtëm;

- Zhvillimi i infrastrukturës (transport rrugor, hekurudhor, ajror, teknologjia e informimit dhe komunikimit TIK) për të krijuar lidhje të përshtatshme ndër-urbane me pjesë të tjera të Kosovës dhe jashtë vendit.

Bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, Parku Nacional Malet e Sharrit dhe bifurkacioni i Lumit Neredime, janë zona me interes të veçantë për tërë Kosovën.

Për Komunën e Ferizajt, Plani Hapësinor i Kosovës ka përcaktuar zonat dhe monumentet vijuese të mbrojtura natyrore:

- Bifurkacioni i lumit Neredime, Ferizaj – Rezervat special natyror, fenomen i vetmi në Evropë dhe i dyti në botë.
- Arneni në Neredime, Ferizaj – ish monument natyror me karakter botanik.



Harta 3 Lokacioni i zonave të mbrojtura natyrore, PHK



Harta 4 Lokacioni i zonës së veçantë të mbrojtur, PHK

Për Komunën e Ferizajt, Plani Hapësinor ka përcaktuar zonat vijuese të veçanta të mbrojtura:

- Manastiri i Uroshit të Shenjtë, Neredime, Ferizaj.

“Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” ka identifikuar dukuritë negative, siç janë zhvillimet në konflikt me mbrojtjen e tokës. Në mesin e propozimeve të tjera është edhe ndërtimi i vijës hekurudhore Ferizajt–Bujanoc, përmes Gjilanit.

1.3. Informata për procesin e planifikimit

1.3.1. Takimet, konsultimet dhe shqyrtimet publike

Gjatë përgatitjes së planit zhvillimor komunal, komuna ka zhvilluar takime, konsultime, dhe shqyrtime publike, në mënyrë që qytetaret, organizatat joqeveritare, ndërmarrjet publike, institucione dhe organizatat tjera të njoftohen mbi zhvillimin e këtij dokumenti të rëndësishëm strategjik. Qëllimi i këtyre takimeve gjithashtu ka qenë që përpos përmbushjeve të detyrimeve ligjore, drejtorit komunale të njoftohen për së afërmi mbi sfidat, aspirata dhe vështirësitë e zhvillimit hapësinor brenda vendbanimeve të tyre dhe shërbimeve të cilat komuna aktualisht i ofron.

Për të njoftuar dhe nxitur pjesëmarrje sa më të gjerë nga banoret e komunës sonë, fillimisht komuna para se të fillojë përgatitjen e këtij dokumenti ka zhvilluar gjithsej 9 takime njoftuese, ku:

- 6 takime njoftuese janë zhvilluar me banoret e zonave rurale dhe; dhe
- 3 takime njoftuese me banoret e lagjeve urbane.
- Po ashtu komuna ka zhvilluar 4 takime me ndërmarrjet publike si dhe 3 takime me bashkësit fetare dhe Forcat e Sigurisë së Kosovës.
- Krahas këtyre zhvillimeve komuna ka zhvilluar:
 - 3 prezantime publike të profilit të komunës,
 - 1 prezantim të prezantimit të gjendjes
 - 1 punëtor të përbashkët me ndërmarrjet publike, OJQ-të dhe koordinatortë drejtorive përkatëse komunale për caktimin e vizionit dhe kornizës së zhvillimit hapësinor;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- 1 shqyrtim publik i kornizës së zhvillimit hapësinorë; dhe
- Shqyrtimi publik 30 ditësh i tërë përmbajtjes së planit zhvillimor komunal
- Në vijim janë të paraqitura të dhënat rreth takimeve, konsultimeve dhe shqyrtimeve publike që komuna ka ndërmarre gjate hartimit të planit zhvillimor komunal.

1.3.1.1. Takimet, konsultimet dhe shqyrtimeve publike

Takimi me banorët e fshatrave: Greme, Doganaj, Komogllave, Gurez(Gërlicë), Softaj, Pojate, Sazli, Dardani, Zllatar, Mirosale, Bibaj, Fshati Vjetër, Varosh, Nikadin etj.

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
08.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Greme	30
09.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Komogllavë	25
10.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Softaj	33
13.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Dardani	32
14.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Bibaj	27
15.09.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të fshatit për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën e fshatit Varosh	23

Takimi me banorët e lagjeve urbane : zona 8, 7 dhe pjesërisht zona 1; zona 4, 5, 6 dhe pjesërisht zona 1; zona 2, 3 dhe një pjesë e zonës 1.

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
05.10.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të zonës për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën fillore "Astrit Bytyqi" - Ferizaj	19
06.10.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të zonës për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën fillore "Ahmet Hoxha" – Ferizaj	21
07.10.2016	Njoftimi për procesin e Hartimit të PZHK-se dhe kontributi i tyre në proces me vërejtjet dhe propozimet e tyre si dhe formimi i një komisioni të zonës për mbledhjen e propozimeve të qytetarëve.	Ne shkollën fillore "Ganimete Terbeshi" - Ferizaj	11



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

1.3.1.2. Konsultimet

Takimi me ndërmarrjet publike: KRUK "Bifurkacioni", Ndërmarrja për grumbullimin e mbeturinave "Pastërtia", KEDS, KOSTT, PTK etj.

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
17.06.2016	Marrja e shënimeve rreth Infrastrukturës nëntokësore për ujësjellës dhe kanalizim	KRUK "Bifurkacioni"	9
03.10.2016	Gjetja e mundësive që bashkërisht ti gjejnë informatat dhe të dhënat e fushave tematike përkatëse (Bifurkacioni dhe Pastërtia)	KRUK "Bifurkacioni"	13
05.10.2016	Gjetja e mundësive që bashkërisht ti gjejnë informatat dhe të dhënat e fushave tematike përkatëse (KOSTT dhe KEDS)	Salla e kuvendit të komunës	8
18.11.2016	Prezantimi i vizionit të Hekurudhës, Projekteve të Energjisë elektrike dhe të Telekomunikimit-rrjetit kabllor	Salla e kuvendit të komunës	23

Takimi me ndërmarrjet publike: BIK, FSK

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
24.08.2016	Takim konsultativ rreth ofrimit të të dhënave të objekteve fetare - myslimane.	BIK – Dega Ferizaj	3
05.12.2016	Diskutim rreth problemeve dhe nevojave të BIK-ut për hapësira për varreza dhe Xhami të reja.	BIK – dega Ferizaj	7
06.12.2016	Diskutim rreth problemeve dhe nevojave të FSK-s për hapësira të reja për nevojat e Ushtrisë së ardhshme.	FSK-s - KDS në zyrën e gjeneralit.	6

1.3.1.3. Shqyrtimet publike

Shqyrtimi publik i Profililit

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
24.06.2016	Njoftim rreth fillimit të procesit të Hartimit të PZHK-se	Salla e kuvendit të komunës	54
16.08.2016	Prezantimi i ecurisë së procesit të Hartimit të PZHK-se si dhe marrja e vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të qytetarëve e në veçanti të bashkatdhetarëve.	Salla e kuvendit të komunës	33
18.10.2016	Prezantimi i Profililit Komunal - Diskutimi I të dhënave të gjetura për fushat tematike veç e veç	Salla e kuvendit të komunës	31

Shqyrtimi publik i vlerësimit të gjendjes

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
25.10.2016	Diskutimi i të dhënave të gjetura për fushat tematike veç e veç	Salla e kuvendit të komunës	49

Shqyrtimi publik i Kornizës së Zhvillimit Hapësinor

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
27.10.2016 deri me 30.10.2016	Punëtori pune(workshop) në Durrës-Shqipëri. Analiza dhe vizionimi i Ferizajt	Durrës	41
18.11.2016	Prezantimi i vizionit të Hekurudhës, Projekteve të Energjisë elektrike dhe të Telekomunikimit-rrjetit kabllor	Salla e kuvendit të komunës	23
12.12.2016	Prezantimi i Draftit të PZHK-s qytetarëve	Salla e kuvendit të komunës	52
19.01.2017	Prezantimi i Draftit të PZHK-s në MMPH	Salla e MMPH - Prishtine	17

Shqyrtimi publik 30 ditësh I draft PZHK-së 25.03.2017 – 25.04.2017

Data	Qëllimi i takimit	Vendtakimi	Nr. i pjesëmarrësve
------	-------------------	------------	---------------------



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

25.03.2017	Hapja solemne e Shqyrtimit publik te PZHK ne sallën e kuvendit ne ora 10.00.	Salla e kuvendit te komunës	Nuk po mund ta gjej listën e nënshkrimeve
------------	--	-----------------------------	---

1.3.2. Trajtimi i kërkesave të qytetarëve

Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti komuna në fazat e ndryshme ka pranuar kërkesa nga banoret e viseve të ndryshme të komunës, të cilat janë marrë parasysh dhe janë përfshirë në këtë dokument. Përcaktimi i kufijve ndërtimorë të fshatrave janë zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë me banoret e fshatrave, të cilët kanë gëzuar mundësin që vet ti përcaktojnë kufijtë ndërtimor.

Gjatë kohës së shqyrtimit publik të PZHK 2017-2025 nga data 25.03.2017 deri me 26.04.2017 janë gjithsejtë 114 kërkesa, ankesa, vërejtje, sugjerime dhe lëvdata, ku në mesin e tyre kanë qenë edhe 7 peticione, por kërkesa nga qytetarët ka pas dhe para afatit të shqyrtimit publik ku të gjitha janë trajtuar nga komisioni apo grupi punues i përberë nga Drejtorja e Urbanizmit, si bartëse e procesit dhe koordinatoret e sektorëve (drejtorive) tjerë komunal.

Të gjitha kërkesat dhe peticionet e parashtruara gjatë shqyrtimit publik janë vlerësuar nga komisioni i caktuar për shqyrtimin e tyre dhe i cili ka dhënë përgjigjet secilit koment sugjerim apo vërejtje të pranuar e që është përfshirë në raportin e shqyrtimit publik që është bashkangjitur këtij dokumenti në Shtojcën 1 – Raporti i Shqyrtimit Publik.

1.3.3. Mundësitë, qëllimet dhe objektivat e Komunës

Gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal dhe zbatimit të Planit Zhvillimor paraparak janë identifikuar sfidat vijuese:

1. ZHVILLIMI EKONOMIK DHE SHKALLA E LARTË E PAPUNËSISË

- 1.1. Qasja cilësore, fuqizimi dhe shfrytëzimi nga Komuna e Ferizajt i pozitës të saj qendrore në Kosovë, për lëvizshmëri efikase të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve;
- 1.2. Rigjenerimi dhe zhvillimi i ekonomisë së ngecur, bazuar në fushat dhe parametrat e përgjithshëm për rritjen e mundshme ekonomike me theks në ri-aktivizimin e kapaciteteve ekzistuese dhe zgjerimin e tyre si dhe fuqizimin e zhvillimeve ekonomike private;
- 1.3. Sfidat e zhvillimit të turizmit kulturor, historik dhe përmbajtjeve tjera turistike në funksion të zhvillimit të ekonomisë;
- 1.4. Shpërndarja hapësinore e veprimtarive ekonomike varësisht nga popullsia, potencialet, infrastruktura si dhe mundësia e punësimit më të gjerë;
- 1.5. Mbrojtja dhe zhvillimi i zonave dhe i kapaciteteve për të shfrytëzuar resurset lokale dhe potencialet për zhvillim të qëndrueshëm në të gjitha fushat sidomos të bujqësisë, blegtorisë dhe pylltarisë;
- 1.6. Krijimi i mundësive dhe ofertave për investime nga brenda dhe jashtë vendit në të gjitha fushat sidomos investitorëve që në projektet e tyre parashohin një numër të konsiderueshëm të punësuarish;
- 1.7. Energjia dhe të gjitha burimet energjetike janë sfidë e nivelit të Kosovës por që duhet të trajtohen edhe në nivel të komunave energjia e ripërtërishme, hidroenergja, energjia solare dhe disa tjera janë sfida në funksion të zhvillimit ekonomik.

2. SHFRYTËZIMI I HAPËSIRËS

- 2.1. Destinimi dhe ridestinimi themelor si dhe bilanci i sipërfaqeve (bujqësi, pylltari, industri, turizëm, banim etj) është një sfidë, për shkak të zhvillimeve të pakontrolluara të ndërtimeve;
- 2.2. Shpërndarja hapësinore dhe organizimi i banimit në vendbanimet duhet trajtuar si sfidë pasi që ekziston shpërndarje hapësinore me organizim jo adekuat të banimit dhe banim shumë të shkapërdërdhur në kuadër të zonave kadastrale;
- 2.3. Kemi një numër të konsiderueshëm të ndërtimeve që janë bërë në tokë bujqësore (humbje e pakthyeshme e tokës shumë të kualitative bujqësore të komunës së Ferizajt) dhe përgjatë korridorit të rrugëve;
- 2.4. Integrimi i hapësirës për zhvillim ekonomik dhe sigurimi që do të mundësojnë qëndrueshmërinë e qëllimeve ekonomike, duke u përkushtuar edhe për ruajtjen e vlerave të shquara hapësinore dhe të vendbanimeve;
- 2.5. Sigurimi i hapësirës për shfrytëzime publike, që do të përparojnë qytetin jo vetëm nga vet funksioni, por edhe duke krijuar një hapësirë publike të vlefshme dhe të paramenduar në zonën urbane dhe fshatra;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- 2.6. Sigurimi i hapësirave për zhvillimin e sportit dhe rekreacionit - për banorët e komplet komunës së Ferizajt;
- 2.7. Parandalimi i krijimit të zonave të reja me ndërtime pa leje në zonat e rrezikuara nga kërcënimet natyrore dhe mjedisore;
- 2.8. Identifikimi, përkufizimi si dhe propozimet për mbrojtje dhe zhvillim të zonave me vlera ekonomike, kulturore, natyrore, historike, zonën e mbrojtur me pakon e Ahtisar-it, si dhe të pasuritë nëntokësore dhe tjera sipërfaqësore.

3. MJEDISI

- 3.1. Sfidë e madhe në fushën e mjedisit është të planifikohet dhe zhvillohet një mjedis i shëndoshë, i sigurt, tërheqës, ku njerëzit duan të jetojnë dhe të rrinë;
- 3.2. Krijimi i Sistemeve të pandërprera të rrjedhave sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit. avancimi i cilësisë së mirë të ujit dhe mirëmbajtjes së sasive ujore gjithkund, filtrimi natyror deri ku është e mundur si dhe trajtimi i ujërave sipërfaqësore si elemente atraktive e pejsazhe në vendbanimet e Ferizajt është sfidë tjetër në fushën e mjedisit;
- 3.3. Vazhdimi i mbrojtjes së ajrit të pastër me ndotje minimale si dhe nivel të tolerueshëm të zhurmës sidomos në zonat e ndjeshme (sidomos afër rrugëve, gurëthyesve, ndotja nga Obiliqi, nga shfrytëzimi i lëndëve të para etj);
- 3.4. Sigurimi i dheut të pastër, kontaminim minimal, mos trazim i karakteristikave e gjeomorfologjike dhe zënie minimale e tokës për ndërtim;
- 3.5. Sigurimi i ekosistemeve të plota pa ndërprerë rrjedhat dhe ciklet e mbyllura;
- 3.6. Përcaktimi i vendeve për deponi të përkohshme dhe përhershme për mbeturina ndërtimore, industriale dhe farmaceutike, menaxhimi me mbeturina komunale, vëllimi minimal i mbeturinave dhe ri përdorimi dhe riciklimi i tyre është njëra ndër sfidat më të mëdha mjedisore;
- 3.7. Sigurimi i një transporti kreativ, racional, efikas dhe miqësor ndaj mjedisit.

4. INFRASTRUKTURA

- 4.1. Kompletimi me infrastrukturë për trajtimin e ujërave të përdorura duke pas parasysh konfiguracionin e terrenit, numrin e banorëve dhe konceptin regjional për këtë lloj trajtimi të promovuar nga MMPH-ja, atë hidroekonomike, hekurudhore (Transporti i xehes dhe udhëtareve), për grumbullim dhe trajtim të mbeturinave, rrjeti funksional të gaz-përçuesit janë sfida të mëdha për komunën e Ferizajt në fushën e infrastrukturës;
- 4.2. Infrastruktura tjetër (infrastruktura e komunikacionit, telekomunikimi, rrjeti energjetik, ajo e furnizimit me ujë, infrastruktura e kanalizimit, për rregullimin e regjimit të ujërave, mbrojtje të ujërave nga ndotja) ose nuk mbulon tërë territorin e komunës si dhe në vendbanimet e mëdha, ashtu edhe në atë rurale ose është e dobët si në aspektin kualitativ, edhe në atë kuantitativ;
- 4.3. Si sfidë jashtëzakonisht e madhe është shpërndarja hapësinore e infrastrukturës duke u bazuar në parimet dhe standardet që synon Kosova;
- 4.4. Mbrojtja e zonave dhe korridoreve për zhvillimet e planifikuara dhe planifikimi i korridoreve të reja në harmoni me nevojat për zhvillimin e ardhshëm;
- 4.5. Kompletimi i infrastrukturës sociale (shkollore, sportive, shëndetësore, kulturore etj).

5. TRASHËGIMIA

- 5.1. Identifikimi, incizimi, përkufizimi, mbrojtja dhe zhvillimi i lokaliteteve arkeologjike ishte pjesë edhe e planit të mëshëm por përkufizimi adekuat dhe trajtimi më cilësor vazhdon të mbetet sfidë e madhe e trashëgimisë sidomos kur merret parasysh historiku i Ferizajt dhe potencialet e kësaj fushe;
- 5.2. Krijimi i masave të qëndrueshme për mbrojtjen, konservimin dhe rivitalizimin e strukturave dhe hapësirave të trashëgimisë kulturore historike, natyrore dhe historike;
- 5.3. Ri-përkufizimi i identitetit të komunës së Ferizajt duke zhvilluar projektin e Bifurkacionit të Neredimës dhe fuqizimi i Vizionit të komunës për këtë mrekulli të rrallë natyrore;
- 5.4. Kompletimi me infrastrukturë në strukturat dhe hapësirat arkeologjike, kulturore - historike duke marrë parasysh shfrytëzimin e këtyre vlerave dhe mbrojtjen e tyre për brezat e ardhshëm është prapë një sfidë;
- 5.5. Rritja e vetëdijes mbi vlerat e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore; dhe
- 5.6. Gjenerimi i mjeteve nga vlerat e trashëgimisë është sfidë e cila duhet trajtohet dhe planifikohet në detaje në të ardhmen në funksion të zhvillimit të turizmit kulturor dhe komplementare edhe me turizmin rural.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

6. NIVELI I SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE DHE SOCIALE, KULTURORE, ETJ

- 6.1. Ofrimi i një vargu sa më të gjerë dhe cilësorë të shërbimeve paraqet sfidë në këtë fushë;
- 6.2. Sigurimi i qasjes në objekte dhe shërbime e të gjithë popullatës duke e reformuar atë sipas modelit të bazuar në nevojat e ndryshme të grupeve të ndryshme të popullatës;
- 6.3. Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe sociale në harmoni me standardet Evropiane në vendbanimet e mëdha e sidomos në atë rurale do trajtohet si një sfidë e veçantë;
- 6.4. Ofrimi i mundësisë si dhe krijimi i kushteve për sektorin privat do të krijonte një alternativë të shëndoshë të shkollimit, shëndetësisë dhe funksioneve tjera.

7. VARFËRIA

- 7.1. Trajtimi i shkallës së varfërisë dhe sidomos asaj të skajshme është sfidë e madhe për ekipin që harton këtë dokument;
- 7.2. Rritja e shkallës së varfërisë për shkak të tranzicionit, kufizimeve dhe politikave rurale, krizës globale etj;
- 7.3. Mos funksionimi adekuat i mekanizmave për përkrahje sociale në nivel të shtetit por edhe të komunës dhe reduktimi i ndihmave nga Organizatat Jo qeveritare; dhe
- 7.4. Zbutja e varfërisë.

2. Profili i Komunës

Komuna e Ferizajt shtrihet në pjesën jugore- lindore të Kosovës dhe qyteti është qendër rajonale për komunat rrethuese. Një ndër faktorët më të rëndësishëm të zhvillimit të qytetit të Ferizajt është ndërtimi i vijës hekurudhore në vitin 1873 dhe stacionit hekurudhorë, duke e shndërruar një vendbanim të vogël në qytet. Në vitin 1903, gazetari anglez ka përshkruar Ferizajn si:

“Një hekurudhë strategjike, e cila si duket nga mallrat bart vetëm topa dhe nga udhëtarët vetëm ushtarë ose robër të luftës, përshkon një grykë të ngushtë prej Shkupit deri në stacionin e fshatit të vogël të Ferizajt, një vend i cili u bë i njohur para disa viteve për shkak të kryengritjes së tij kundër nënprefektit turk, i cili u dëbua me vesh të prerë. Në Ferizaj fillon Shqipëria...”²



Foto 1 Pamje e hekurudhës

2.1. Zhvillimi i Komunës ndër shekuj

Vendbanimet në lokalitetet e Ferizajt datojnë që nga periudhat e hershme historike. Dëshmia për këtë janë gërmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të Komunës, sidomos ato në lindje dhe në perëndim. Më karakteristike janë gërmadhat e kalave në Jezerc, në Murakaj (Surqinë) etj. Edhe në disa vendbanime fushore ka gjurme të lokaliteteve të vjetra, sidomos në Ilirias (Zaskok), Varosh, etj.³

Pushtimi i romakëve shkaktoi shumë pasoja politike dhe ekonomike. Pasojë në këtë drejtim pësuan sidomos vendbanimet e fortifikuara, si dhe fortifikatat mbrojtëse të popullatës iliro-dardane. Pas shkatërrimit të tyre filloi krijimi i vendbanimeve të reja në rrafshina, municipiume e të tjera, kryesisht nëpër vendet pranë udhëve kryesore të asaj kohe.⁴

Pas sundimit romak, përkatësisht bizantin, pastaj edhe bullgar, tokat arbërore në fund të shekullit XII u pushtuan definitivisht nga shteti i Rashkës dhe kështu u krijua pushteti i tyre administrativ. Kjo pjesë e Kosovës, më vonë, e sidomos në shekullin XIV, bëhet qendër me rëndësi të madhe politike, ekonomike dhe kulturore për shtetin serb të mesjetës së hershme, ku dalloheshin Neredimja, Surqina dhe Pjeterqi, që nga banorët e fshatit Jezerc, e quanin gjytet, ku gjendeshin pallatet dhe sarajet luksoze të Nemanjidëve.⁵

Pas Betejës së Kosovës në 1389, osmanlinjtë pushtuan Shkupin në 1392, duke vendos kufijtë ushtarak në perëndim. Osmanët i mbajtën territoret e Vuk Brankoviqit, në pronat e të cilit ka qenë e përfshirë edhe treva e Ferizajt të

² Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës - Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

³ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës - Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

⁴ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

⁵ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

sotëm, si në kohën e pushtimit të përkohshëm të despotit (1439-1444), ashtu edhe pas përtëritjes së saj (15.VIII.1444). Domethënë, në këto vende mbeten nënpunësit dhe ushtarët osmanë. Duhet theksuar se në Kosovë, rreth vitit 1862, janë vendosur disa familje Qerkeze, të dëbuar nga atdheu i tyre Qerkestani në Kaukaz. Sipas disa shënimeve në Kosovë janë vendosur rreth 40.000 banorë Qerkezë. Në territorin e komunës së Ferizajt, Qerkezët ishin vendosur në fshatrat Prelez i Muhaxhirëve, Talinoc i Muhaxhirëve, Sazli, Pojatishte, Ferizaj etj.⁶

Me ripushtimin e Kosovës, në vjeshtën e vitit 1918 dhe vendosjen e pushtetit serbo-malazias me funksion të aparatit të veçantë administrativo-politik, administrata shtetërore e ushtarake, krahas organizimit të operacioneve ndëshkimore të dhunës, terrorit, vrasjeve, dënimeve të mëdha etj. Shqiptarët ishin të detyruar të punonin tani te kolonizuesit me mëditje shumë të ultë, ose tokën e vet përgjysmë. Sipas shënimeve statistikore të kohës, në territorin e Rrethit të Neredimes deri në vitin 1938 janë vendosur 374 familje me 1750 banorë (1055 serbe, 692 kroate dhe 5 sllovene).⁷

Në territorin e komunës së Ferizaj kolonët serb ishin vendosur në këto fshatra: Bibaj, Babushan, Rrezar (Cernillë), Ferizaj, Gaçkë, Gurrëz (Gërlica), Greme, Koshare, Lloshkobare, Mirash, Mirosale, Muhofc, Nikadim, Neredime të Poshtme, Dardan (Tankosiq), Trim (Tërn), Varosh, Murakaj (Surqinë), Talinoc i Jerlive, Talinoc i Muhaxhirëve, Sojeve, Fshat i Vjetër, Papaz, Pojatë (Pojatishte), Prelez i Jerlive, Prelez i Muhaxhireve, Rrahisht (Rahavice), Sazli, Rakaj, Micsokol (Slivove), Softaj dhe Ilirian (Zaskok). Sipas shënimeve statistikore të kohës, në territorin e Rrethit të Neredimes deri në vitin 1938 janë vendosur 374 familje me 1750 banorë (1055 serbe, 692 kroate dhe 5 sllovene). Sa i përket ndërtimit të shtëpive në territorin e Drejtoratit Agrar të Ferizajt deri me 10.07.1935, për Rrethin e Neredimes, në 7 komuna, 35 fshatra dhe 19 koloni ishin ndërtuar 332 shtëpi.⁸

Pas pushtimit të Mbretërisë jugosllave, me 6 prill të vitit 1941, nga Koalicioni Hitlerian, territori i Kosovës u copëtua e u nda në tri zona pushtuese: në zonën gjermane, italiane dhe bullgare. Në baze të marrëveshjes ndërmjet armatës gjermane dhe italiane me 14 prill 1941, territori i Ferizajt dhe i rrethinës së saj i takon zonës pushtuese italiane. Struktura organizative e pushtetit civil italian ishte vendosur sipas të njëjtit shembull që ishte vendosur edhe në Shqipëri. Në krye të nënprefekturës ishte nënprefekti, i cili me aparatit e tij kontrollonte tërë administratën, gjyqet, ekonominë, arsimin dhe kulturën. Nënprefektura e Ferizajt, me 100.000 banorë, ishte në kuadër të Prefekturës së Prishtinës. Nënprefekt i Ferizajt ishte Halim Shuku.

Në ndërkohe, në vitet 1944-45, kinse me qëllim të plotësimit të njërive ushtarake partizane jugosllave, u mobilizuan shumë shqiptarë në frontet e ndryshme në Bosnje, Vojvodinë, Kroaci, Slloveni. Qëllimi i vërtetë ishte zbrazja e Kosovës nga të rinjtë dhe krijimi i mundësisë që të veprohej sa me lehtë ndaj popullatës së pafajshme. Shumë të rinj nga treva e komunës së Ferizajt u mobilizuan në brigadat kosovare. Disa prej tyre, pësuan nga sëmundja e tifos. Ndërsa, sa i përket mobilizimit të shqiptareve për në Tivar të Malit të Zi, 2214 banorë të trevës së Ferizajt ishin mobilizuar në eshalonin e parë, të cilët, me 22 mars 1945, arrijnë në Prizren, ku iu bashkëngjiten edhe ata të territorit të Prizrenit dhe pastaj vazhduan rrugën për në Shkodër. Në eshalonët e tjera ishin mobilizuar shqiptarët e trevave të tjera. Gjate rrugës kishin filluar keqtrajtimit, vrasjet dhe pushkatimet e të mobilizuarve.⁹

Në vitin 1969, Kushtetutës e Jugosllavisë pësoi ndryshime të amendamenteve, ndërsa në vitin 1974, Kosova fitoi Kushtetutën e vet, qyteti i Ferizajt dhe fshatrat e saj fituan një fizionomi të re të zhvillimit dhe të ndërtimit. Shumë banorë nga fshatrat e ndryshme, sidomos ato nga viset malore u vendosen në Ferizaj. Për nga numri i banorëve, Ferizaj u bë qyteti i tretë në Kosovë. Mirëpo, ajo vendosje ishte e pakontrolluar, pa ndonjë plan urbanistik, në

⁶ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

⁷ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

⁸ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

⁹ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

mënyre stihike, e cila më vonë u pasqyrua në infrastrukturën e qytetit, sidomos në gjendjen e rrugëve, shumë të ngushta, pa trotuare, pa ndonjë rend dhe plan.¹⁰

Prej 28 Shkurtit 1998 deri me 10 Qershor 1999, në Komunën e Ferizajt ishin 45 fshatra me 101.280 banorë, prej të cilëve 31 fshatra janë të dëmtuara. Dëmet në shtroj-mbulojë-veshmbathje dhe pajisjet në banjo kapin shumën prej 10.352.600 DM. Gjatë kësaj periudhe, në Ferizaj janë vrarë 154 persona, 18 persona janë të zhdukur, 74 të plagosur, 90 shtëpi të granatuara, 1.267 shtëpi të djegura, nga të cilat 689 shtëpi të kategorisë së parë; 495 shtëpi të kategorisë së dytë; 94 shtëpi të kategorisë së tretë. Ndërsa janë djegur e shkatërruar 765 kulme me një vlerë financiare prej 60.182.585 DM.¹¹

Gjendja aktuale

Sipërfaqja km ²	Numri i banorëve 2011	Dendësia (ba/km ²)	Lartësia mesatare mbidetare
344.64	108,610	315.14	500m

Tabela 1 Karakteristikat hapësinore të Komunës

Zhvillimi i qytetit

Krahasuar me qytetet tjera, Ferizaj është njëra prej qendrave urbane më të reja të Kosovës. Si fshat, ai është formuar në periudhën otomane, përgjatë rrugës kryesore rajonale veri-jug. Pas vitit 1874, ai u zhvillua në një qytet përgjatë vijës hekurudhore Mitrovicë – Shkup. Kjo vijë hekurudhore kishte rëndësi të shumë të madhe për transportin e udhëtarëve dhe të mallrave.

Emri Ferizaj rrjedh nga z. Feriz Shashivari, i cili e menaxhonte një han në fshat. Në këtë zonë ekzistojnë vendbanime qysh nga kohët e lashta, të cilat janë dëshmuar nga disa gërmime të bëra në territorin e komunës. Hapat e parë të formimit të qytetit janë vitet pas 1900-shit. Në këtë periudhë fillojnë të zhvillohen disa veprimtari, si ato zejtare dhe tregtare. Veprimtari dominuese në qytet ishte tregtia. Në vitin 1900, prej 400 shtëpive sa kishte gjithsej Ferizaj, 200 ishin dyqane tregtare dhe zejtare.

Gjatë periudhës së Mbretërisë Jugosllave, qyteti i Ferizajt vazhdon të zhvillohet. Nga ajo kohë ende ka disa objekte të mbetura, si Shtëpia e Kulturës “Hivzi Sulejmani”, e ndërtuar në vitin 1924, dhe Libraria e Qytetit, e ndërtuar në vitin 1928. Në vitin 1941 qyteti kishte vetëm 5,000 banorë. E vetmja ndërmarrje nga kjo periudhë është Fabrika e tjegullave. Ndërmarrjet dhe fabrikat e tjera ekzistuese janë formuar pas Luftës së Dytë Botërore. Më vonë, Ferizaj zhvillohet në një ndër qendrat më të mëdha industriale dhe tregtare të Kosovës.

¹⁰ DDr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004

¹¹ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.2. Pozita gjeografike


Kosova gjendet në qendër të Evropës Juglindore dhe ka një sipërfaqe prej 10,887 km². Kosova kufizohet me Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë dhe Malin e Zi. Kosova është territor i përbërë prej fushave të gjëra dhe maleve të larta. Rrethohet nga malet-Alpet Shqiptare, më lartësi mbidetare deri 2,700 metra. Megjithatë, malet nuk e izolojnë Kosovën. Lumenjtë kanë formuar lugina të thella, duke i kapërcyer barrierat natyrore dhe duke i formuar lidhjet natyrore me rajonet përreth. Në mes të Kosovës janë dy fusha të mëdha, Rrafshi i Dukagjinit dhe Fusha e Kosovës, të cilat janë të ndara në mes veti me Malet e Drenicës. Në lindje, Fushës së Kosovës i bashkohet Anamorava.

Ferizaj shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës. Paraqet një udhëkryq të rëndësishëm, sepse nëpër Ferizaj kalojnë të gjitha rrugët e rëndësishme që e përshkojnë Kosovën nga veriu në jug dhe nga lindja në perëndim. Këto rrugë pastaj vazhdojnë edhe në shtetet fqinje dhe në rajon.

Perimetri i Ferizajit	Shtimja	Shtërpcë	Suharekë	Lipjan	Kaçanik	Gjilan	Viti
112,5 km	27.07 km	17,79 km	8.47 km	16.37 km	19.34 km	5.13 km	18.33 km

Tabela 2 Gjatësia e vijës kufitare me Komunitat fqinje

Komuna e Ferizajt ka pozitë të përshtatshme gjeografike për zhvillim ekonomik dhe në lindje kufizohet me komunën e Gjilanit dhe të Vitisë, nga të cilat qendra ka distancën rrugore prej 32, përkatësisht 21 km. Në jug kufizohet me komunën e Kaçanikut (16 km), në jugperëndim me Shtërpcën (32 km), në perëndim me Prizrenin (60 km) e Therandën (42 km) dhe në veri me Shtimen (13 km) e Lipjanin(17 km). Distanca e Ferizajt nga kryeqendra e Kosovës, Prishtina, është 36 km, kurse nga Shkupi 48 km. Lidhjet ajrore për Ferizajn realizohen përmes aeroportit të Prishtinës që është në largësi prej 33 km. Distanca rrugore Ferizaj- Tiranë është 350 km, kurse me portin e Durrësit 384 km.



Harta 5 Pozita Gjeografike e Komunës së Ferizajt



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.3. Demografia


Komuna e Ferizajt ka 344.64 km², ka gjithsejtë 44 fshatra, në të cilat jetojnë gjysma e popullatës së kësaj komune. fshatrat më mëdha janë Dardania, Gremja, Komogllava, në të cilat jetojnë mbi 6.000 banorë. Komuna e Ferizajt sipas regjistrimit të fundit të popullsisë ka 108 610 banorë.¹² Gjersa sipas vjetarit të fundit 2016, në Komunë aktualisht jetojnë 101,174 banorë, prej tyre gjysma jetojnë në qytet dhe gjysma në fshatra.¹³ Nga komunitetet tjera jetojnë rreth 3700 banorë, kryesisht Ashkalinjë, Romë, Goranë, Mysliman, Serbë, në të cilat përbëjnë rreth 2,06 % të popullatës.

	Fshatra	Lagje urbane
Numri i vendbanimeve	45	8
Sipërfaqja (ha)	2300.92	1837.1
Numri i banorëve	65,982	42,628
Dendësia (ba/ha)	28.68	23.20

Tabela 3 Karakteristikat e vendbanimeve të Komunës

Përpos 45 fshatrave dhe 8 lagjeve urbane, Komuna ka 6 identifikuar Vendbanime Joformale, pesë në zonën urbane dhe një në zonën rurale.¹⁴

Sipas analizës të numrit të banorëve të Ferizajt, brenda periudhës 1948 – 2011, numri i banorëve të Ferizajt gati është trefishuar, duke u rritur me 78,175 banorë shtesë. Sipas të dhënave ekzistuese, numri i banorëve në Komunë është rritur për 1,150 në vit, që nuk përkon rritjen graduale të banorëve. Ky supozim për projektme të ardhme nuk mund të merret parasysh, sepse në Komunën e Ferizajt para vitit 1999 kanë jetuar pjesëtar të komuniteteve tjera, të cilët kanë lëshuar Kosovën dhe përbënin 10% të numrit të përgjithshëm të banorëve. Përpos, komuniteteve tjera të cilët kanë lëshuar Kosovën pas vitit 1999, shumë shqiptar kanë qenë të detyruar të lëshojnë vendlindjen gjatë viteve këtë 1991 – 1999, që parashikohet të përbëjë 20% të numrit të përgjithshëm të banorëve të Komunës. Për këtë arsye, regjistri i popullsisë shënon një rënie të thellë për periudhën 1991 – 2011.¹⁵ Kështu që, prognozoreale i rritjes së numrit të banorëve në Komunë, brenda periudhës 1948 – 2011, është 93,810 banorë shtesë apo 1,380 banorë shtesë në vit.



Grafika 1 Zhvillimi i numrit të banorëve nga viti 1948 – 2011

Sipas analizës të numrit të banorëve të Ferizajt, brenda periudhës 1948 – 2011:

- Nga viti 1948 – 1953 popullsia është shtuar për 13% apo 2.53% në vit;

¹²Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia Sipas Gjinisë, Etnicitetit Dhe Vendbanimit, Prishtinë, 2013

¹³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2016

¹⁴

¹⁵ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Nga viti 1953 – 1961 popullsia është shtuar për 21% apo, 2.43% në vit;
- Nga viti 1961 – 1971 popullsia është shtuar për 41% apo 3.25% në vit;
- Nga viti 1971 – 1981 popullsia është shtuar për 42% apo 3.56% në vit;
- Nga viti 1981 – 1991 popullsia është shtuar për 25% apo 2.25% në vit; gjersa
- Nga viti 1991 – 2011 popullsia është shtuar për 4% apo 0.19% në vit.
- Sipas analizës së sipërme, gjatë periudhës 1948 – 2011 numri i banorëve në Komunë ka shënuar rritje për 225%.

Viti	Shtimi i banorëve	Shtimi vjetor
2011	4%	0.19%
1991	25%	2.25%
1981	42%	3.56%
1971	41%	3.52%
1961	21%	2.43%
1953	13%	2.53%
1948	/	




Tabela 4 Përqindjet e rritjes së numrit të banorëve gjatë periudhës 1948 – 2011


Siç mundet të vërehet nga statistikat për 68 vitet e fundit, regjistrimi i popullsisë shënon rënie të dukshme gjatë periudhës 1991 – 2011. Mirëpo, ky supozim për projektme të ardhme nuk mund të merret parasysh, sepse në Komunën e Ferizajt para vitit 1999 kanë jetuar pjesëtar të komuniteteve tjera, të cilët kanë lëshuar Kosovën dhe përbënin 10% të numrit të përgjithshëm të banorëve. Kështu që, prognoza reale e rritjes së numrit të banorëve në Komunë, brenda periudhës 1948 – 2011, është 93,810 banorë shtesë apo 1,380 banorë shtesë në vit.

2.3.1. Popullsia sipas zonave urbane dhe rurale

Përqendrimi i banorëve sipas zonave rurale dhe urbane është paraqitur në tabelën vijuese:

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Zonë Urbane	6,685	8,165	11,665	22,239	37,723	45,645	42,628
Zona Rurale	23,750	26,326	30,140	36,820	46,046	58,973	65,982

Tabela 5 Numri i banorëve për vitin 1948, 1953, 1961, 1971, 1981, 1991 dhe 2011



Grafika 2 Numri i banorëve gjatë 50 viteve të fundit


Sipas analizës së 68 viteve të fundit, vërehet rënie e numrit të banorëve në zonën urbane prej -3,017 banorë gjatë periudhës 1991 - 2011, gjersa në zonat rurale vërehet rritje e numrit banorëve për +7,009 banorë.¹⁶

¹⁶ Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës 9, Ferizaj, Shtimja dhe Shtërpce, Prishtinë, 2004



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt



Grafika 3 Raporti i numrit të banorëve gjatë 68 viteve të fundit për zonë rurale dhe urbane

Sipas analizës së 68 viteve të fundit, vërehet rënie e numrit të banorëve në zonën urbane prej -6.31% gjatë periudhës 1991 - 2011, gjersa në zonat rurale vërehet rritje e numrit banorëve për 11.89%.


2.3.2. Popullsia sipas moshës dhe gjinisë

Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë në vitin 2011, rezulton se përbërja e banorëve sipas grupmohave shënon rënie të konsiderueshme prej -11.21% në grupmoshat 0-4 vjeçare dhe -7.90% në grupmoshat 5-9 vjeçare.

Grupmosha	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Bilanci(+/- banorë)	Bilanci (+/- %)
0-4 vjeçare	4952	4579	9,531	-1068	-11.21%
5-9 vjeçare	5440	5159	10,599	-837	-7.90%
10-14 vjeçare	5887	5549	11,436	451	3.94%
15-19 vjeçare	5696	5289	10,985	1135	10.33%
20-24 vjeçare	5126	4724	9,850	1194	12.12%
25-29 vjeçare	4461	4195	8,656	501	5.79%
30-34 vjeçare	4,024	4,131	8,155	232	2.84%
35-39 vjeçare	3,848	4,075	7,923	1096	13.83%
40-44 vjeçare	3,304	3,523	6,827	832	12.19%
45-49 vjeçare	2,927	3,068	5,995	1168	19.48%
50-54 vjeçare	2,434	2,393	4,827	846	17.53%
55-59 vjeçare	1,975	2,006	3,981	693	17.41%
60-64 vjeçare	1,640	1,648	3,288	486	14.78%
65-69 vjeçare	1,368	1,434	2,802	1034	36.90%
70-74 vjeçare	903	865	1,768	653	36.93%
75-79 vjeçare	494	621	1,115	243	21.79%
80+ vjeçare	362	510	872	-	-
Gjithsej	54841	53769	108,610		

Tabela 6 Përbërja e banorëve sipas grupmohave katër vjeçare

Rënia mesatare prej -9.55% për grupmoshën 0 – 8 vjeçare, dëshmon se numri i banorëve është në rënie e sipër gjatë periudhës së viteve 2002 – 2011.



Grafika 4 Diagrami i përbërjes së banorëve sipas grupmohave katër vjeçare



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë në vitin 2011 rezulton se raporti gjinor është pothuajse i barabartë në Komunën e Ferizajt, e përbërë nga 50.49% meshkuj dhe 49.51% femra.

Meshkuj	Femra
54,841	53,769
50.49%	49.51%

Tabela 7 Numri dhe përqindja e banorëve në bazë gjinore në vitin 2011

Tabela e sipërme pasqyron një tregues se përbërja gjinore e popullsisë është mirë e baraspeshuar dhe nuk paraqet ndonjë faktor të rëndësishëm të migrimit drejtë apo jashtë Komunës. Sipas regjistrimit zyrtar të popullsisë në vitin 2011, rezulton se përbërja e banorëve sipas grupmoshave në baza gjinore nuk ka ndonjë ndryshim madhor që paralajmëron ndonjë shqetësim në aspektin e planifikimit hapësinor.

Grupmosha	Meshkuj	Femra	%Meshkuj	% Femra
0-4 vjeçare	4952	4579	48.04%	51.96%
5-9 vjeçare	5440	5159	48.67%	51.33%
10-14 vjeçare	5887	5549	48.52%	51.48%
15-19 vjeçare	5696	5289	48.15%	51.85%
20-24 vjeçare	5126	4724	47.96%	52.04%
25-29 vjeçare	4461	4195	48.46%	51.54%
30-34 vjeçare	4,024	4,131	50.66%	49.34%
35-39 vjeçare	3,848	4,075	51.43%	48.57%
40-44 vjeçare	3,304	3,523	51.60%	48.40%
45-49 vjeçare	2,927	3,068	51.18%	48.82%
50-54 vjeçare	2,434	2,393	49.58%	50.42%
55-59 vjeçare	1,975	2,006	50.39%	49.61%
60-64 vjeçare	1,640	1,648	50.12%	49.88%
65-69 vjeçare	1,368	1,434	51.18%	48.82%
70-74 vjeçare	903	865	48.93%	51.07%
75-79 vjeçare	494	621	55.70%	44.30%
80+ vjeçare	362	510	58.49%	41.51%
Gjithsej	54841	53769		

Tabela 8 Përbërja e banorëve sipas grupmoshave katër vjeçare

2011	2012	2013	2014	2015	2016
108.610	109.899	111.141	111.842	107,985	101.174


Tabela 9 Numri i banorëve të Komunës gjatë gjashtë viteve të fundit

Nga grafikoni, vërehet një shtim i vogël të numrit të banorëve meshkuj, mirëpo kjo nuk paraqet ndonjë kërcënim për raportin e balancuar gjinor. Sipas, vjetarit statistikor në Komunën e Ferizajt aktualisht banojnë 101, 174.¹⁷

¹⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 5 Diagrami i përbërjes së banorëve sipas grupmoshave katër vjeçare


2.3.3. Popullsia sipas përkatësisë etnike

Sa i përket përkatësisë etnike, në Komunën e Ferizajt dominon etnia shqiptare që përbën 95.90% të numrit të përgjithshëm të banorëve.

Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferoj të mos përgjigje	Të dhënat nuk janë në dispozicion
104,152	32	55	83	204	3,629	24	64	102	45	220
95.90%	0.03%	0.05%	0.08%	0.19%	3.34%	0.02%	0.06%	0.09%	0.04%	0.20%

Tabela 10 Numri i banorëve sipas përkatësisë etnike, bazuar në regjistrimin zyrtar të vitit 2011

Komuniteti i dytë më i madh është komuniteti Ashkali të cilët përbëjnë 3.34% banorë dhe Romë të cilët gati 1% të banorëve.¹⁸



Grafika 6 Diagrami i përbërjes së banorëve sipas përkatësisë etnike

2.3.4. Popullsia sipas përkatësisë religjioze

Sa i përket përkatësisë religjioze, në Komunën e Ferizajt dominon përkatësia religjioze myslimane që përbën 98.63% të numrit të përgjithshëm të banorëve. Komuniteti i dytë më i madh religjioz është ai katolik që përbën 0.38% të banorëve.¹⁹

Islam	Ortodoks	Katolik	Tjetër	Nuk i përket asnjë feje	Preferon të mos përgjigjet	Nuk është në dispozicion
107,121	45	413	64	41	612	314

¹⁸Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia Sipas Gjinisë, Etnicitetit Dhe Vendbanimit, Prishtinë, 2013

¹⁹Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia Sipas Gjinisë, Etnicitetit Dhe Vendbanimit, Prishtinë, 2013




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

98.63%	0.04%	0.38%	0.06%	0.04%	0.56%	0.29%
--------	-------	-------	-------	-------	-------	-------

Tabela 11 Numri i banorëve sipas përkatësisë religjioze, bazuar në regjistrimin zyrtar të vitit 2011



Grafika 7 Diagrami i përbërjes së banorëve sipas përkatësisë religjioze

2.3.5. Ekonomitë familjare

Bazuar në regjistrim zyrtar të vitit 2011, në Komunë është gjithsej 18,359 ekonomi familjare, me mesatarisht 5.9 anëtar për familje dhe mesatare prej 13m² hapësirë banimi për kokë banori.


	Ekonomi familjare	Banesa të shfrytëzueshme nga banorë të zakonshëm	Mesatarja e numrit të personave për ekonomi shtëpiake	Mesatarja e hapësirës në m ² e shfrytëzuar për kokë banori
Urban	7,784	7,653	5.5	14.1
Rural	10,575	10,452	6.2	12.4
Gjithsej	18,359	18,105	5.9	13.0

Tabela 12 Ekonomitë familjare, numri i banesave, nukleusi familjar dhe hapësira mesatare banimi

Sipas regjistrit, 57.60% të ekonomive familjare jetojnë në zonë rurale, që dallon nga shumë Komuna tjera, ku pas luftës banorët kanë migruar drejtë zonës urbane. Gjersa, numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjar është 5.9 anëtar për familje, përkatësisht 6.2 anëtar në zonë rurale dhe 5.5 anëtar në zonë urbane.

	Numri i ekonomive familjare	Përqindja e ekonomive familjare
Urban	7,784	42.40%
Rural	10,575	57.60%

Tabela 13 Përqindja e ekonomive familjare sipas vendbanimit rural apo urban



Grafika 8 Raporti i ekonomive familjare në mes të zonës rurale dhe urbane

2.3.6. Lëvizjet natyrore

2.3.6.1. Migrimi ndërkombëtar

Për dallim nga Komunat tjera, pak Ferizajas migruar jashtë vendit. Me -6.5% migruer ndërkombëtar, sa i përket bilancit të migrimit ndërkombëtar, Komuna e Ferizajt qëndron në vendin e 24-të.

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	24
Suharekë	Klinë	Mitrovicë	Gjakovë	Vushtrri	Viti	Malishevë	Istog	Skenderaj	Obiliq	Ferizaj
-40.2	-29.1	-28.3	-25.5	-22.2	-21.9	-21.4	-21.2	-19.1	-15.9	-6.5

Tabela 14 Radhitja e Komunës në krahasim me migrimin ndërkombëtar të banorëve të Komunave tjera



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Migrimi i ultë paraqet një tregues brengosës ekonomi, për shkak të remitencave të ulëta për banorët. Bazuar në numrin e banorëve të Komunës, Gjermania dhe Zvicër kryesojnë. Në Gjermani jetojnë me 5,912 banorë, gjersa në Zvicër 4,607 banorë.

Gjermani	Zvicër	Itali	Austri	Suedi	Amerikë	Francë	Angli	Belgjikë	Sloveni	Te tjerë
5,912	4,607	444	450	617	772	1,530	442	449	103	1,332

Tabela 15 Numri i imigrantëve të Komunës sipas vendqëndrimit

Migrimi më i lartë është shënuar gjatë viteve 1990 – 2000, kur afër 8,000 banorë emigruar jashtë vendit.

>1960	60-64	65-69	70-74	75-79	80-84	85-89	90-94	95-99	2000-2004	2005-2009	2010+	S'janë në dispozicion
11	5	52	150	124	344	863	3,620	4,883	1,960	3,043	718	885
9	3	38	128	88	223	561	2,360	2,684	976	1,606	363	418
2	2	14	22	36	121	302	1,260	2,199	984	1,437	355	467

Tabela 16 Numri i mërgimtarëve të Komunës sipas periudhës së migrimit

Pas vitit 2010 vërehet një ulje e vogël në numrin e banorëve që kanë migruar jashtë vendit. Gjatë kësaj periudhe kanë emigruar jashtë vendit, përafërsisht vetëm 1,600 banorë.

Arsyet më të mëdha që kanë nxitur migrimin në Komunë janë punësimi dhe bashkimi familjar.

Gjithsej	Punësimi	Studimi	Familjare	Lufta 1998/99	Te tjera	Nuk ka të dhëna
16,658	6,535	128	6,917	2,015	636	427

Tabela 17 Arsyet e migrimit

2.3.6.2. Migrimi kombëtar

Sa i përket migrimit kombëtarë Komuna e Ferizajt është në mesin 14 komunave të cilat kanë bilanc pozitiv të migrimit drejt Komunës. Sa i përket migrimit drejt Komunave, Ferizaji zë vendin e shtatë me bilanc pozitiv prej +5.3% të migruesve të rinj. Sa i përket bilancit përfundimtar për vitin 2015, Komuna e Ferizajt ka bilanc negativ prej -3.12%, që dëshmon se më shumë banorë janë duke lëshuar Ferizajt, se sa që migrojnë drejtë tij. Mirëpo, krahasuar me shumicën e Komunave të Kosovës, ky bilanc negativ nuk është aq i madh.

Gjithsej nr i emigrimit	Përqindja e emigrimit në raport me popullsinë rezidente të komunës	Pjesëmarrja e përgjithshme e emigrimit kombëtar	Bilanci i përgjithshëm
7,566	6.97%	3.85%	3.12%

Tabela 18 Bilanci i përgjithshëm i migrimit

2.3.7. Niveli i arsimit

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Komunë të Ferizajt janë evidentuar gjithsejtë 77,044 banorë të cilët janë kualifikuar për anketimin e banorëve sipas nivelit arsimor²⁰.

Pa nivel të përfunduar	Shkolla fillore	Shkolla e mesme e ulët	Shkolla e mesme lartë	Shkolla e lartë	Fakulteti, Baçelor	Pas-universitare	Doktoraturë
4,633	7,405	28,226	30,997	1,781	3,622	328	52

Tabela 19 Numri i banorëve mbi 15-vjeçar sipas nivelit më i lartë arsimor të përfunduar

²⁰ ASK, karakteristikat arsimore të popullsisë të Kosovës, Prishtinë, 2013



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Sa përket nivelit të arsimit dominon numri i banorëve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë, përkatësisht 30,997 banorë, gjersa më së paku ka banorë të cilët kanë përfunduar Doktoraturën, përkatësisht 52 banorë. Brengosës është fakti që 4,633 banorë nuk kanë përfunduar asnjë nivel të arsimit, ku:

- 3,383 janë Shqiptar;
- 699 janë Ashkali;
- 37 janë Romë.

Bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, rezulton që në Komunë jeton një numër i ultë i banorëve që kanë përfunduar studimet universitare, përkatësisht vetëm 5.2% banorë.

Në vijim janë të renditura përqindjet e banorëve sipas nivelit të arsimit:

- 6.01% pa asnjë nivel arsimor të përfunduar;
- 9.61% shkollë fillore të përfunduar;
- 36.64% shkollë të mesme e ulët të përfunduar;
- 40.23% shkollë të mesme e lartë të përfunduar;
- 2.31% shkollë të lartë
- 4.70% Fakultet të përfunduar, Baçelor;
- 0.43% Studime pasuniversitare të përfunduar;
- 0.07% Doktoraturë të përfunduar.
- Gjersa sa i përket analfabetizmit, në vitin 2011 në Komunë janë identifikuar gjithsejtë 3,357 analfabetë.


Klasifikimi	Komuna	Nr. i banorëve <10 vjet	Nr. i banorëve analfabetë	% e banorëve analfabetë
1	Fushë Kosovë	28209	1661	5.89%
2	Lipjan	46463	2390	5.14%
3	Shtime	21896	1100	5.02%
4	Istog	32634	1611	4.94%
5	Kamenicë	30696	1514	4.93%
6	Podujevë	70739	3455	4.88%
7	Viti	38117	1780	4.67%
8	Skenderaj	41408	1891	4.57%
9	Gjilan	75980	3437	4.52%
10	Gjakovë	79130	3458	4.37%
11	Obiliq	17317	748	4.32%
12	Rahovec	46449	1990	4.28%
13	Deçan	33363	1380	4.14%
14	Suharekë	48912	2009	4.11%
15	Malishevë	42512	1731	4.07%
16	Hani i Elezit	7558	299	3.96%
17	Ranillug	3451	133	3.85%
18	Glllogoc	47305	1807	3.82%
19	Klinë	31271	1187	3.80%
20	Ferizaj	88480	3357	3.79%

Tabela 20 Analfabetizmi për grupmoshën mbi 10-vjeçare, krahasuar me Komunit tjera

Në krahasim me Komunit tjera, Ferizaj radhitet në vendin e 20-të me vetëm 3.79% banorë analfabet, që tregon për një numër relativisht të ultë.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt




Grafika 9 Diagrami i Komunave sipas përqindjes së banorëve analfabet

Analiza e banorëve sipas grupmoshëve, tregon që përqindja më e madhe e banorëve analfabet në Komunë i takojnë grupmoshës mbi 50-vjeçare. Gjersa, sa i përket përbërjes gjinore, 6.1% të të gjithë banorëve analfabet janë femra dhe 1.5% janë meshkuj. Gjersa, sa i përket përbërjes gjinore, 6.1% të të gjithë banorëve analfabet janë femra dhe 1.5% janë meshkuj, ku vërehet një dallim i madh me mbi 50% për moshat mbi 20-vjeçare. Mirëpo, ky dallim ka filluar të zvogëlohet në gjeneratat e reja të 25 viteve të fundit, që dëshmon për ngritje në emancipimin e gjinisë femërore në Komunë.

	%	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65+
Meshkuj	1.5	86	29	18	46	29	31	29	18	32	29	35	292
Femra	6.1	78	42	66	88	75	87	91	122	152	180	184	1,518
Total	3.8	164	71	84	134	104	118	120	140	184	209	219	1,810
		4.89%	2.11%	2.50%	3.99%	3.10%	3.52%	3.57%	4.17%	5.48%	6.23%	6.52%	53.92%

Tabela 21 Numri i analfabetëve në Komunë, sipas grupmoshëve



Grafika 10 Numri i analfabetëve në Komunë, sipas grupmoshëve



2.4. Veçoritë mjedisore

2.4.1. Gjeomorfologjia

Territori i Komunës së Ferizajt gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore.


Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës.

Komuna paraqitet në ndarje të tërthortë në Rrafshin e Kosovës e rrafshlartat e Jezercit, Neredimes në përrëndim dhe rrafshlarta e fshatrave Zllatar, Rahavicë etj. në juglindje. Lugina e Moravës. Kjo zonë ka lidhje më të afërt hapësinore me Lipjanin dhe me Kaçanikun. Qyteti i Ferizaj shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe luginës së Moravës. Majat më të larta në lindje dhe përrëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.

Pjesët më të larta janë kryesisht të mbuluara me pyje, një zonë e madhe pyjore e mbrojtur shtrihet në male në veripërrëndim. Pas luftës 1990 është bërë një vend i rëndësishëm për rekreacion.

Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës të relievit të territorit të Komunës së Ferizajt sipas të cilave:

- pjesa më e madhe e sipërfaqeve janë rrafshina me 44.53 %;
- nga ana jugpërrëndimore 10.98 %;
- të lindjes 4.03 %;
- pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %;
- verilindore 7.96%; dhe
- veripërrëndimore 6.71%.



Harta 6 Gjeomorfologjia e terrenit dhe lartësitë mbidetare



2.4.2. Gjeologjia dhe tokat


Morfologjinë e relievit të hapësirës së Ferizajt si dhe Kosovës e kanë përcaktuar fuqitë e brendshme dhe të jashtme gjatë një kohe të gjatë gjeologjike. Krijimi i hapësirës së Ferizajt nuk mund të shikohet si hapësirë e ndarë nga ai i Kosovës.

Territori i Kosovës i takon sistemit orogjenik të Tetisit i rrudhosur në depozitimet e formuara gjatë mesozoikut dhe pjesërisht kenozoikut. Ndërtimi gjeologjik i Ferizajt përbëhet kryesisht prej: Serpentine; Ranor, marlstone; Ranor, lymore, marlstone, rere me olistoliths (flishit rërë); Gur ranor, mudstone, siltstone; Ranor, marlstone, rere; Ranor, konglomerat, mudstone, lymore; Tarraca lumore; Rife gëlqeror, gur gëlqeror rudist; Rife gëlqeror; Rreshpe kuarc kuarcite; kuarcite metakuarcsandstone, konglomerat; Proluvium; Paraschist (phyllite, sericite schist, quartz schist, metasandstone); Rreshpe orto (epidote, aktinolite dhe rreshpe klorite); Orto rreshpe (epidote rreshpe, rreshpe chlorite, intercalations pjesërisht diabaz); Orto rreshpe (epidote rreshpe, actinolite rreshpe chlorite, intercalations pjesërisht diabaz); Quartzite mikë, metasandstone, metamudstone; Metaquartz poroze; Metadiabaz, metaspilit; Përzjerje me olistoliths; Mermer, gëlqeror në rikristalizim; Mermeri kuarcite, rreshpe sericite; Mermer, cherty rreshpe gëlqerore, partly black recrystallised limestone; Mermer, rreshpe gëlqeror; Mermer; Limestone, marlstone, siltstone, sandstone (calcareous flysch); Guri gëlqeror me qert; Sediment lumor dhe liqenor; Diabaz, spilite, basalt; Konglomeratit breccia, ranore, gur gëlqeror; Argjilë, rërë, zhavorr, mergelore, pjesërisht linjitet; Breccias and blocks; Biotite, muskovite, reshpe; Amfibolite, amfibole, reshpe; Alluvium.

Përbërja gjeologjike e dheut në Komunën e Ferizajt ofron kushte të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Përbërja gjeologjike është si vijon:

1. Tokë e kuqërremtë-kafe e lesivuar mbi sediment të kuqërremtë 22 %
2. Tokë e kuqërremtë – kafe ranore deltinore 20 %
3. Smonicë e pa karbonizuar 10 %
4. Smonicë në proces të kafenizimit 7 %
5. Smonicë e kafenizuar..... 5 %
6. Smonicë e lesivuar me pseudoglej..... 8 %
7. Tokë livadh – argjilore 5 %
8. Tokë podzollake – pseudoglej 10 %
9. Tokë e kafenjtë e cektë dhe mesatarisht e thellë 7 %
10. Tokë aluviale ranore, deltinore dhe e kafenizuar 5 %
11. Tokë e aglejuar mineralo – moçalike 1 %

Në të dy anët e lumit Neredime mbi rrafshinat aluviale janë të përhapura sendimentet liqenore të pliocenit. Ato janë të përfaqësuar me argjila ranore dhe mergele. Si një rezultat i një ndërtimi gjeologjik të llojllojshëm kemi një larmi të mineraleve të metaleve.



PUNËDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizajt
Ferizaj Municipality
Ferizaj, 70000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJT
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJT

REVISION - REVIZIM		REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM	REVISION - REVIZIM
Rev	DATE	PERSHIRJE	DESCRIPTION	POWER	APPROVED	REVISION	REVISION	REVISION	REVISION
A	2016	Hartimi i pare	First Issue						

0 436 67 14 21 10
1:25,000

Projektori Gjeneral: "Inzhenera Meriçka"
Sistemi Geografik: "MapInfo/MapXpress"
Sistemi Koordinues: "National Coordinates"
Mbrojtja: "Ferizaj, Shqipëri"
Brendi: "Kosovo"

Formati:
Formati:
A0

Shallja:
Scale:
1/25,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE

Harta Pedologjike
Soil Map

Vizimi: 1 0 0

Harta 7 Përbërja pedologjike



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.4.3. Lartësia mbidetare

Territori i Komunës së Ferizajt gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore.

Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës.

Komuna paraqitet në ndarje të tërthortë në Rrafshin e Kosovës e rrafshlartat e Jezercit, Neredimes në përrëndim dhe rrafshlarta e fshatrave Zllatar, Rahavicë etj. në juglindje. Lugina e Moravës. Kjo zonë ka lidhje më të afërt hapësinore me Lipjanin dhe me Kaçanikun. Qyteti i Ferizajt shtrihet në mes të Rrafshit të Kosovës dhe luginës së Moravës. Majat më të larta në lindje dhe përrëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.


Pjesët më të larta janë kryesisht të mbuluara me pyje, një zonë e madhe pyjore e mbrojtur shtrihet në male në veripërrëndim. Pas luftës 1990 është bërë një vend i rëndësishëm për rekreacion.



Nga të dhënat e përgjithshme të Komunës të relievit të territorit të Komunës së Ferizajt sipas të cilave:

- pjesa më e madhe e sipërfaqeve janë rrafshina me 44.53 %;
- nga ana jugpërrëndimore 10.98 %;
- të lindjes 4.03 %;
- pjesa veriore si më negative është kryesisht në terrenet e larta rreth 5.78 %;
- verilindore 7.96%; dhe
- veripërrëndimore 6.71%.

Pjerrtësia e terrenit (%)	Sipërfaqja (ha)	Sipërfaqja (ha)
0 - 3.817 %	11,824	34.93%
3.817 - 8.80%	5,099	15.06%
8.80– 14.09	4,631	13.68%
14.09 – 19.38	3,794	11.21%
19.38 – 24.96	3,199	9.45%
24.96 – 30.83	2,394	7.07%
30.83 – 37.29	1,611	4.76%
37.29 – 45.80	941	2.78%
45.80 – 74.88	326	0.96%
Totali	33,854	

Tabela 22 Pjerrtësia e terrenit sipas përqindjes dhe sipërfaqes në hektarë



PUNEDHËNESI: EMPLOYER:  Komuna e Ferizajt Ferizaj Municipality Ferizaj, 70000	PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJT MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJT	REVISION - REVIZIONI		Formati: Format: A0	TITULLI I HARTES MAP TITLE														
		<table border="1"> <thead> <tr> <th>Rev.</th> <th>DATE</th> <th>PËRSHKRIM - DESCRIPTION</th> <th>Pipëri/Author</th> <th>Kontrolluar/Checked</th> <th>Verifikuar/Validated</th> <th>Miratuar/Approved</th> <th>Ndërkohë/Date</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>A</td> <td>2016</td> <td>Hartimi i parë - First Issue</td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Rev.	DATE	PËRSHKRIM - DESCRIPTION	Pipëri/Author	Kontrolluar/Checked	Verifikuar/Validated	Miratuar/Approved	Ndërkohë/Date	A	2016	Hartimi i parë - First Issue						Projektimi Global: Transerrience Mercator Sistemi Geografik Koordinator: GCS 1993 UTM Sistemi Koordinativ Nacional: Kosovo/RSB1 Mbledhja Përbërëse: Qendrore Rrjeti: Niveli i Parë
Rev.	DATE	PËRSHKRIM - DESCRIPTION	Pipëri/Author	Kontrolluar/Checked	Verifikuar/Validated	Miratuar/Approved	Ndërkohë/Date												
A	2016	Hartimi i parë - First Issue																	

Harta 9 Pjerrtësia e terrenit



2.4.4. Klima

Të dhënat për kushtet klimatike janë marrë nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës për periudhën 1949 – 2007 të cilat janë dhënë për rajonin e Ferizajt dhe të Shtimes. Komuna e Ferizajt karakterizohet me klimë kontinentale, si edhe pjesa më e madhe e Fushës së Kosovës. Lumi më i madh Neredime përkshkon tërë territorin e komunës.

Tempëraturo

Tempëraturo mesatare vjetore në Komuna e Ferizajt është 10 gradë celsius, gjersa 9 gradë celsius në viset malore. Muajt më të nxehtë janë Korriku dhe Gushti më tempëraturo mesatare 20,6 dhe 20,5 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është janari më –1,4 gradë celsius. Maksimumi absolut i tempëraturos së ajrit është në Gusht 37,3 gradë celsius, ndërsa minimumi –26,0 gradë celsius. Sipas të dhënave të IHMK. Në vitin 1963 në Ferizaj është regjistruar tempëraturo maksimale ekstreme -34.0 gradë celsius.

Lagështia relative e ajrit

Ka vlerë mesatare vjetore 74,7% më muajin gusht më të thatë (63%) dhe me muajin më lagështi më të madhe janarin (86,1%). Sipas të dhënave të IHMK. Lagështia më e lartë mesatare sillet prej 85.0 % deri 87.0 %, në muajt Dhjetor dhe Janar, ndërsa ajo më e ultë në muajt Prill dhe Maj, e cila sillet prej 68.2 % deri 68.4 %. Kohë me vranësi më të lartë ka janari me 7.3/10, ndërsa vranësi më të ultë ka gushti me 3.8/10.

Vrantësimi dhe diellosja

Në këtë regjion vrantësimi mesatar vjetor është 57% gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellëta është 57,9 (15,9% nga viti), sipas të dhënave të IHMK. Insolimi mesatar vjetor në Ferizaj është 2 034 orë me diell. Muaji me më shumë orë me diell është gushti me 264.6 orë, ndërsa dhjetori karakterizohet me kohën më të shkurtër të insolimit, mesatarisht 63.8 orë.

Të reshurat


Sasitë e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë. Sasitë mesatare vjetore sillen rreth 673,3 mm në Ferizaj, sipas të dhënave të IHMK. Muaji me më së shumti të reshura është maji, me 105.6 mm, ndërsa me më së paku gushti, me 42.2 mm. Mesatarisht toka e Ferizajt është 51.8 ditë e mbuluar me borë. Në janar ka më së shumti borë (17.0 ditë), ndërsa më së paku borë ka prilli (1.0 ditë).

Era

Frekuencën më të madhe vjetore në rajonin e Ferizajt e kanë erërat verilindore (NE) me 226 0/00, ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsejtë 36 0/00. Shpejtësia mesatare është më e madhja të era jugpërendimore (SË) 4,0m/sek, sipas të dhënave të IHMK.

Shtypja atmosferike

Sipas pozitës gjeografike të Ferizajt, ndryshimet e elementeve dhe dukurive atmosferike janë në konditat normale të ndryshimit të shtypjes atmosferike për këtë rajon.



PUNEDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizajt
Ferizaj Municipality
Ferizaj, 70000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJT
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJT

REVIZIONI - REVIZIONE	DATA	PERSHIRJE - DESCRIPTION	POLETA - AUTHOR	KONTROLI - CHECKER	REVISOR	MIRATIMI - APPROVAL	REVISOR
A	2016	Hartimi i pare - First Issue					



Projekcion Global: Transverse Mercator
Sistemi Gjergjeq: Koordinatave: GCS: ETRS 1989
Skenimi Koordinatave Referenc: UTM: EPSG:31471
Metri i Referenc: Greqiaq
Niveli i Referenc: Meters

Formati:
Format: A0

Përfaqësues:
Scale: 1:25,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE

Ekspozicioni i terrenit

Terrain aspects

1 | N | 0

Harta 10 Ekspozicioni diellor



2.4.5. Ndryshimet klimatologjike në Komunën e Ferizajt

Në sajë të të dhënave të elementeve dhe dukurive meteorologjike të elaboruara në Komunën e Ferizajt në periudhën 50 vjeçare ka ndryshime në klimën e rajonit të Ferizajt në kufijtë e ndryshimeve në rajon ku temperatura minimale dhe ajo maksimale është në rritje në kufijtë 02 deri në 04 gradë celsius. Komuna e Ferizajt nuk mundet me qenë i izoluar nga ndikimet të cilat vijnë nga rajoni si rezultat i zhvillimit tekniko teknologjik dhe mos respektimit të masave mbrojtëse për uljen e shkallës së ndotjes së ambientit nga gazrat e shkarkuara nga aktivitetet njerëzore, dyoksidit të karbonit, oksideve të azotit, komponentëve halogjenure, hidrokarbureve, hidrofluoreve, përflluoreve dhe heksafluoreve si dhe kimikateve të rrezikshme të cilat kanë mbet nga fabrikat. Këto fabrika për momentin janë jashtë prodhimit si Trepça, Fabrika e supërfosfatit, Korporata energjetike e Kosovës, Fabrika e baterive në Gjilan, Fabrika e Çimentos në Han të Elezit, Fabrika e Bismutit në Prizren, Fabrika e lëkurës në Pejë e shumë institucione të tjera të cilatmë parëkanë pushuar së punuari.

Kosova ka obligime ndërkombëtare për respektimin e lëshuarjës së ujërave dhe ajrit nga territori i sajë në kufijtë e lejueshëm të saktësuar në këto konventa si ajo e Dablnit, Danubit si dhe asaj të Kyotos më karakter ndërkombëtar (IPCC) e (UNFCCC) si dhe aplikimit të obligimeve të konventës së Landfildit për uljen e shkallës së ndotjes nga viti 1995 deri në 2008. Automobilat të cilët janë në përdorim në Kosovë janë ndotës të mëdhenj sepse janë transportuar në Kosovë pa iu shtruar asnjë kontrolli dhe vazhdojnë të qarkullojnë në komunikacion pa asnjë kontroll dhe atest për shkallën e ndotjes, sipas kësaj konvente të cekur më lartëshkalla e ndotjes duhet të ulët deri në 25%.Më qëllim të zvogëlimit të ndikimit të ngrohjes së atmosferës (efektit të serës) pavarësisht nga madhësia dhe shtrirja gjeografike e Komuna e Ferizajt vendi ynë duhet të ndër marrë masat adekuate për uljen e shkallës së ndotjes, si vijon:

1. Zbatimi i ligjit mbi mbrojtjen e mjedisit dhe planifikimit hapësinor të Kosovës;
2. IHMK të bëjë regjistrin dhe kadastralin e ndotësve në gjendje të lëngët, ngurtë dhe të gazet si dhe të gjitha burimeve ndotëse në Ferizajt;
3. Të ngritën rrjetat e monitorimit të resurseve të ajrit, ujit dhe dheut;
4. Të shfrytëzohen burimet alternative të prodhimit të energjisë elektrike si nga era, dielli dhe uji;
5. Të merren masat më të rrepta ligjore për ndërprerjen e prerjes së drunjve të pyjeve në rajonin e Ferizajt;
6. Të gjitha mjetet motorike të cilat nuk i plotësojnë kushte për përdorim të hedhën jashtë përdorimit;
7. Proceset e emisionit dhe emisionit të jenë nën kontroll të rreptë ligjore dhe lirimi i këtyre grimcave në atmosferë nga proceset kimiko- teknologjik të përfitimit të energjisë elektrike të monitorohet nga KEK dhe IHMK;
8. Kontroll i rreptë nga MMPH-i të gjitha deponive në Ferizajt dhe rrethinë;
9. Të ndërpritet ndezja e mbeturinave kontejner në lokalitet e banimit;
10. Të bëhet një propagandë më e madhe për vetëdijesimin e popullatës së Ferizajt dhe rrethinës për ruajtjen e mjedisit se është në interes të tyre;
11. Mjetet e informimit të jenë më në nivel më anë të emisioneve edukativo- arsimore për mbrojtjen e mjedisit si dhe rreziqet që vijnë nga ngrohja e atmosferës.

2.4.5.1. Tiparet klimatike

Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore

Temperatura mesatare vjetore në Komuna e Ferizajt është 10 gradë celsius, dhe dominon klima kontinentale, gjersa që në viset malore, janë në 9 gradë celsius. Muajt më të nxehtë janë Korriku dhe Gushti më temperaturë mesatare 20,6 dhe 20,5 gradë celsius, ndërsa më i ftohti është Janari më –1,4 gradë celsius.


	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-1.2	0.9	5.7	9.9	14.6	17.9	19.9	19.8	16.0	10.5	5.3	0.9	10.0

Tabela 23 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën1949 – 2007



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt




Grafika 11 Temperatura mesatare për muajt dhe vjetore e ajrit për periudhën 1949 – 2007

Maksimumi absolut i temperaturës së ajrit është në gusht 37,3 gradë celsius, ndërsa minimumi –26,0 gradë celsius. Sipas të dhënave të IHMK, në vitin 1963 në Ferizaj është regjistruar temperatura maksimale ekstreme -34.0 gradë celsius.

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	14.8	18.2	28.5	29.8	32.3	36.3	39.3	37.7	34.4	29.3	22.0	19.4	28.5


Tabela 24 Temperatura maksimale absolute për muajt dhe vjetore për periudhën 1949 – 2007



Grafika 12 Temperatura maksimale absolute për muajt dhe vjetore për periudhën 1949 – 2007

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t °C	-27.2	-25.2	-16.6	-5.3	-2.4	0.5	3.9	3.0	-4.0	-5.6	-17.6	-12.4	-7.2

Tabela 25 Temperatura minimale absolute për muajt dhe vjetore për periudhën 1949 – 2007



Grafika 13 Temperatura minimale absolute për muajt dhe vjetore për periudhën 1949 – 2007

Reshjet



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025


i Komunës së Ferizajt

Sasitë e të reshurave në këto rajone janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë. Sasitë mesatare të reshjeve vjetore, sipas të dhënave të IHMK, sillën rreth 673,3 mm në Ferizaj.

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
H _{mest}	38.7	36.7	36.1	48.5	69.3	60.1	47.2	44.3	44.9	51.3	66.2	52.1	595.4

Tabela 26 Shuma mesatare mujore dhe vjetore e të reshurave në mm për periudhën 1949 – 2007

Shuma mesatare vjetore e reshjeve është, Hvjet = 595.4 mm.




Grafika 14 Mesatarja mujore dhe vjetore e të reshurave në mm për periudhën 1949 – 2007

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
t (h)	68	93	141	171	218	232	280	274	221	171	92	57	2018

Tabela 27 Shuma mesatare e diellosjes në orë për periudhën 1961 – 2007

Shuma mesatare vjetore e diellosjes është, Tvjet = 2018 h/




Grafika 15 Mesatarja e sdiellosjes në orë për periudhën 1961 – 2007

Lagështia relative e ajrit

Ka vlerë mesatare vjetore prej 74,7%, me mesataren më të ultë prej 63% gjatë muajit Gusht dhe më të lartë prej 86.1 % gjatë muajit Janar.

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mesatarja
Ferizaj	86.1	80.2	75.9	71.0	71.5	69.5	65.0	63.0	66.2	78.1	84.5	85.5	74.7

Tabela 28 Vlera mesatare shumëvjeçare në % e lagështisë relative për periudhën 1949 - 2007



Grafika 16 Vlera mesatare shumëvjeçare në % e lagështisë relative për periudhën 1949 - 2007

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mesatarja
-------	---	----	-----	----	---	----	-----	------	----	---	----	-----	-----------




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Shtypja atmosferike	941.2	943.2	940.9	939.7	946.9	948.7	946.7	941.3	947.8	948.6	948.3	946.9	945
---------------------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-------	-----


Tabela 29 Shtypja atmosferike mesatare mujore dhe vjetore për periudhën 1949 - 2007



Grafika 17 Shtypja atmosferike mesatare mujore dhe vjetore për periudhën 1949 - 2007

Erërat

Frekencën më të madhe vjetore në Komuna e Ferizajt e kanë erërat verilindore (NE) me 226 0/00, ndërsa më të voglën ato lindore (E) me gjithsejtë 36 0/00. Sipas të dhënave të IHMK, shpejtësia mesatare është më e madhja të erërave jugpërendimore (SW) 4,0m/sek.



Grafika 18 Trëndafili i erës në Komunën e Ferizajt

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
N	236	232	214	192	203	191	225	254	339	216	188	236	226
NE	105	91	89	77	57	60	85	68	65	93	93	94	81
E	80	47	57	37	73	42	31	45	31	74	81	67	56
SE	25	37	63	51	23	14	23	20	27	35	46	47	34
S	98	76	115	138	96	74	63	41	49	101	120	98	90
SË	20	37	37	30	23	32	23	27	21	27	17	27	27
Ë	34	44	35	71	81	83	72	79	41	40	32	52	56
NË	30	56	43	90	58	58	82	125	78	42	54	38	62
C	372	380	347	314	386	446	396	341	349	372	369	341	368

Tabela30 Shpeshtësitë e qetësisë së erës sipas muajve të vitit dhe drejtimit të erës nëFerizaj

Drejtimi/ muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
N	2.4	2.4	2.8	3	2.6	2.4	2.6	2.6	2.4	2.2	2.8	1.9
NE	1.9	2.1	1.9	2.4	2.1	2.1	2.1	1.8	1.8	1.9	1.9	1.8

E	3.4	2.4	2.4	2.2	2.4	1.9	2.1	2.2	1.9	3.4	2.8	2.4
SE	4.4	4.4	4.8	6.7	3.6	3	2.8	2.2	3.2	3.2	4.8	4.6
S	3	2.8	2.8	5	3.4	2.4	2.4	2.2	1.9	2.4	3	3
SË	2.2	2.8	2.4	2.4	2.6	2.4	2.2	2.4	1.6	1.8	2.4	2.4
Ë	2.6	2.6	3	3.4	3	2.4	2.4	2.4	2.2	2.1	2.4	2.2
NË	3	3.4	3.6	3	2.2	2.8	2.8	2.8	2.8	2.6	2.8	2.8


Tabela 31 Shpejtësia mesatare e erës sipas muajve të vitit dhe drejtimit të erës në Ferizaj

2.4.6. Hidrografia

Rajoni përreth Ferizajt merret si mbarimi i Rrafshit të Kosovës dhe lidhja e saj hapësinore me Anamoravën. Ky rajon kufizohet me Malin e Sharrit në jugperëndim, me Karadakun dhe Anamoravën në lindje, dhe me Malet e Drenicës në veriperëndim. Nëpër territorin e Komunës rrjedhin lumenj dhe përrenj të shumtë. Lumi kryesor është ai i Neredimes, i cili kalon edhe nëpër qytetin e Ferizajt. Ky lum është i mbuluar brenda qytetit. Hidrografinë e këtij lumi e përbëjnë 13 përrenj. Lartësia mbidetare e lumit në Ferizaj është 580m. Komuna e Ferizajt ka ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Ujërat Sipërfaqësore

Ujërat sipërfaqësore rrjedhin përgjatë lumit Neredime, i cila është degë e rëndësishme e Lumit Lepenc. Lumi Neredime përbëhet prej dy lumenjve, Lumi i Madh dhe Lumi i Vogël, që burojnë në rrëzën jugore të malit të Neredimës, në lartësi mbidetare prej 1200m është 0.9m³/sec. Gjatësia e rrjedhës së lumit Neredime është 29 km, sipërfaqja e pellgut 255km², ndërsa sasia mesatare . Lumi Neredime është rrjedhë e dobët për shkak të bigëzimit – bifurkimit, fenomen i rëndësishëm gjeografik, i njohur edhe në botën e jashtme. Bifurkacioni gjendet 1 km në veriperëndim të Ferizajt, mbi dhe nën vendin e quajtur te Mulliri i Nikës. Si fenomen natyror është i njohur që nga viti 1321. Ujërat tjerë sipërfaqësor në territorin e Komunës së Ferizajt, janë në shfrytëzim për ujitjen e tokës, lumi i Pleshinës dhe i Gremës, që bashkohen me lumin Neredime të fshati Gurëz (dega e lumit Neredime që derdhet në lumin Lepenc). Sipas disa matjeve që janë bërë në maj të vitit 2007 nga një Institut i Londrës, kapaciteti prurës i lumit Neredime është 848 l/sec. Mirëpo ky kapacitet në shfrytëzim, në korrik-gusht bie në 30 l/sec.




Harta 11 NënPELLJET e Lumit Neredime

Ujërat nëntokësore

Rezervat e ujërave nëntokësore të hulumtuara janë përgjatë degës së dytë në veri-lindje të Neredimës. Shpuarjet që janë bërë më herët në oborrin e fabrikës së gypave, kanë prurje prej 70 l/sec. Disa shpuarje që janë bërë në disa fshatra, së fundi, nga Komuna, nga Elektrovati dhe BP, rezultojnë se sasia e ujërave nëntokësore për shpuarje, sillet

njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia dhe dëmtimi i pyjeve, shkatërrimi i habitateve natyrore, ndikimi i urbanizmit, transportit dhe turizmit, grumbullimi pa kriter i bimëve mjekuese dhe kërpudhave etj.



Grafika 19 Spektri floristik i llojeve bimore të Maleve të Sharrit me status ndërkombëtar të mbrojtur²¹

Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë, siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit etj., shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme. Nga kjo nuk janë kursyer as zonat e mbrojtura me vlera të veçanta të trashëgimisë natyrore si: Bifurkacioni i lumit Neredime, ndërtimet e shtëpive, ndërhyrjet (ngushtimet) në shtretërit e dy degëve të lumit, derdhja e ujërave të ndotura etj. Bifurkacioni i lumit Neredime nga Mulliri i Nikës, dega që derdhet në drejtim të lumit Sitnicë, nuk funksionon fare si pasojë e faktorit njeri. Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllim të kërkimeve shkencore të mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve. Të ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve të përkujdesjes së shërbimeve mjedisore të mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të turizmit dhe rekreacionit etj. Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës do të definohet me aktet nënligjore, në pajtim me ligjin, të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori. Për çdo zonë të mbrojtur të natyrës përcaktohet shkalla e I, II dhe III e mbrojtjes.

Akti për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës do të përcaktojë qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikat të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i menaxhimit nga organi që e venë nën mbrojtje (komuna) dhe i cili miratohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).


Emri i objektit	Viti i shpalljes	Kategoria mbrojtëse
1. Bifurkacioni i lumit Neredime	1979	Rezervat special natyror
2. Zona turistike 120 ha	01.Nr.4603, dt: 17.09.2002	Zona turistike është shpallur hapësira në mes lumit të vogël dhe të madh të Neredimes

Tabela 32 Zonat e mbrojtura nga niveli qendror

2.4.8. Rrjeti ekologjik

Sistem koherent i kompozuar nga të gjitha zonat e caktuara të mbrojtjes në Komunën e Ferizajt që përmbajnë tipet e habitateve dhe habitatet e llojeve të mbrojtura me Ligj, të cilat funksionojnë për të mundësuar tipet e habitateve natyrore dhe habitaveve të llojeve që të mirëmbahen nëse kërkohet, të rikthehen në gjendje të mëparshme të statusit të ruajtjes në formën e tyre natyrore.

²¹PLVM Ferizaj. 2009-2015



PUNEDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizajt
Ferizaj Municipality
Ferizaj, 70000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJIT
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJIT

Rev.	DATE	PERSHKIMI - DESCRIPTION	Krijuesi / Author	Kontrollues / Checked	Ndërkohë / Date	Miratues / Approved	Nënbërje / Note
A	2016	Hartimi i pare - First Issue					

Projeksioni Global: Transversale Mercator
Sistemi Gjeografik i Koordinatave: GCS UTM 1989
Sistemi Koordinuesh Nacional: Kosovo/RSB
Meridiani Fiksuar: Greenwich
Njësiti: Kilometra

Format:
Format: A0
Përfaqja:
Scale: 1/28,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE

Njesite Hidrogeologjike
Hydrogeological Units

Vizatimi Nr. / Drawing No. I N O

Harta 13 Harta e lumenjve dhe hidrografia



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.5. Kapacitetet njerëzore dhe financiare të komunës

2.5.1. Kapacitetet njerëzore

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, në Komunë të Ferizajt janë evidentuar gjithsejtë 77,044 banorë të cilët janë kualifikuar për anketimin e banorëve sipas nivelit arsimor.

Pa nivel të përfunduar	Shkolla fillore	Shkolla e mesme e ulët	Shkolla e mesme lartë	Shkolla e lartë	Fakulteti, Baçelor	Pas-universitare	Doktoraturë
4,633	7,405	28,226	30,997	1,781	3,622	328	52

Tabela 33 Numri i banorëve mbi 15-vjeçar sipas nivelit më i lartë arsimor të përfunduar

Sa përket nivelit të arsimimit dominon numri i banorëve të cilët kanë përfunduar shkollën e mesme të lartë, përkatësisht 30,997 banorë, gjersa më së paku ka banorë të cilët kanë përfunduar Doktoraturën, përkatësisht 52 banorë.

Sa i përket kapaciteteve administrative të Komunës, Komuna ka punonjës me kualifikime të mjaftueshme, ku 52% kanë kualifikime SNKA 2, 3, 4, gjersa 48% kanë kualifikime SNKA 5, 6.

Drejtoritë	SNKA 2	SNKA 3	SNKA 4	SNKA 5/6		
				Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3
Kabineti I kryetarit	0	3	0	3	10	1
Prokurimi	0	1	0	2	2	1
Administrata e përgjithshme	0	34	1	6	7	0
Financave	0	15	4	6	9	0
Urbanizmit dhe Mjedisit	0	2	2	1	8	0
Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	0	3	2	1	2	0
Infrastruktura Publike	0	3	0	0	3	1
Arsimit	0	2	0	4	6	1
Kulturës, Rinise dhe Sportit	2	24	1	2	12	2
Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	0	3	1	2	19	0
Qendra Rezidenciale	2	5	0	1	0	1
Pronës, Kadastër dhe Gjeodezisë	0	13	1	2	2	0
Bujqësisë dhe Pylltarisë	0	9	1	0	10	0
Zyra e Komuniteteve	2	8	2	0	0	0
Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	4	23	3	0	0	0
Gjithsej:	10	148	18	30	90	7

Tabela 34 Pasqyra e kualifikimeve të edukimit formal të shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive

Sa i përket përvojës së punëtorëve administrativ të Komunës, 14% të punonjësve kanë përvojë pune 0-5 vjet, 13% të punonjësve kanë përvojë pune 6-10 vjet, 33% të punonjësve kanë përvojë pune 11-15 vjet, 15% të punonjësve kanë përvojë pune 16-20 vjet, 39% të punonjësve kanë përvojë pune 21-41 vjet.

Drejtoria	Vite përvojë pune:				
	0- 5	6- 10	11- 15	16- 20	21-41
Kabineti I kryetarit	4	0	6	1	7
Administrata e përgjithshme	5	5	14	5	17
Financave	5	4	5	3	13
Urbanizmit dhe Mjedisit	3	0	0	3	4
Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit	1	0	6	0	1
Infrastruktura publike	2	0	1	1	3
Arsimit	0	1	4	1	5
Kulturës, Rinise dhe Sportit	5	8	15	5	11



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Shendetesise dhe Mireqenjes Sociale	4	1	3	4	13
Pronës, Kada. dhe Gjeodezisë	0	3	5	4	9
Bujqësisë dhe Pylltarisë	5	6	3	3	3
Qendra Rezidenciale DSHMS	1	2	6	1	0
Zyra e Komuniteteve	1	0	5	2	5
Shërbimeve Publike dhe Emergjencës	1	5	15	7	12
Gjithsej:	37	35	88	40	103

Tabela 35 Pasqyra e përvojës së punës të shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive

2.5.2. Kapacitetet financiare të komunës

Sa i përket kapaciteteve financiare të Komunës, gjatë 3 viteve të fundit vërehet një rritje progresive.

	Viti	Buxhet i aprovuar	Buxhet i bartur	Totali	Shpenzimi i Buxhetit
Investimet kapitale	2014	9,008,336.00	464,832.89	9,473,168.89	8,283,696.75
Investimet kapitale	2015	9,040,883.00	884,160.33	9,925,043.33	8,283,824.83
Investimet kapitale	2016	7,356,851.00	1,017,249.32	8,374,100.32	
Gjithsej		25,406,070.00	2,366,242.54	27,772,312.54	

Tabela 36 Buxheti për investime kapitale gjatë tre viteve të fundit

	Viti	Grant Qeveritar	Të hyra vetanake	Tëhyra vetanake të bartura	Totali
Investimet kapitale	2014	6,599,584.00	2,408,752.00	464,832.89	9,473,168.89
Investimet kapitale	2015	6,456,819.00	2,584,064.00	884,160.33	9,925,043.33
Investimet kapitale	2016	4,384,602.00	2,972,249.00	1,017,249.32	8,374,100.32
Gjithsej		17,441,005.00	7,965,065.00	2,366,242.54	27,772,312.54

Tabela 37 Të hyrat për investimeve kapitale gjatë tre viteve të fundit



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Kategoria ekonomike:	Buxheti i planifikuar- viti:				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2011	2012	2013	2014	2011- 2012	2012- 2013	2013- 2014	2011- 2014
Rroga dhe paga:	10,082,084.00	10,872,420.00	11,084,100.00	11,273,100.00	(790,336.00)	(211,680.00)	(189,000.00)	(1,191,016.00)
Mallra dhe shërbime:	1,410,170.00	1,759,332.00	1,724,658.00	1,863,960.00	(349,162.00)	34,674.00	(139,302.00)	(453,790.00)
Shpenzime komunale:	510,844.00	294,980.00	373,550.00	400,900.00	215,864.00	(78,570.00)	(27,350.00)	109,944.00
Subvencione dhe transfere:	587,365.00	560,000.00	635,000.00	710,000.00	27,365.00	(75,000.00)	(75,000.00)	(122,635.00)
Shpenzime kapitale:	6,301,214.00	6,084,140.00	6,932,954.00	9,008,336.00	217,074.00	(848,814.00)	(2,075,382.00)	(2,707,122.00)
Gjithsej:	18,891,672.00	19,525,872.00	20,750,262.00	23,256,296.00	(634,200.00)	(1,224,390.00)	(2,506,034.00)	(4,364,624.00)

Tabela 38 Pasqyra dhe trendët e planifikimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2014

Kategoria ekonomike:	Buxheti i planifikuar- viti:				Trendët e rritjes/ zvogëlimit- viti:			
	2011	2012	2013	2014	2011- 2012	2012- 2013	2013- 2014	2011- 2014
Rroga dhe paga:	10,346,561.74	11,036,121.35	11,092,131.69	13,107,042.36	(689,559.61)	(56,010.34)	(2,014,910.67)	(2,760,480.62)
Mallra dhe shërbime:	1,429,691.62	2,083,298.67	2,032,092.17	1,919,774.27	(653,607.05)	51,206.50	112,317.90	(490,082.65)
Shpenzime komunale:	507,534.65	327,375.00	372,207.49	400,854.36	180,159.65	(44,832.49)	(28,646.87)	106,680.29
Subvencione dhe transfere:	578,817.07	573,404.17	628,286.16	726,995.36	5,412.90	(54,881.99)	(98,709.20)	(148,178.29)
Shpenzime kapitale:	6,985,810.66	6,687,945.12	6,964,560.99	8,283,696.75	297,865.54	(276,615.87)	(1,319,135.76)	(1,297,886.09)
Gjithsej:	19,848,415.74	20,708,144.31	21,089,278.50	24,438,361.10	(859,728.57)	(381,134.19)	(3,349,082.60)	(4,589,945.36)

Tabela 39 Pasqyra dhe trendët e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2011- 2014



2.6. Zhvillimi ekonomik

2.6.1. Historik i shkurtër i zhvillimit ekonomik

Popullsia e kësaj treve, gjatë së kaluarës historike, është marrë kryesisht me bujqësi e blegtori, që ishin edhe degët kryesore të ekonomisë. Zhvillimin e bujqësisë e ka kushtëzuar toka që ishte mjaft pjellore, ndërsa blegtorinë e kanë kushtëzuar malet dhe fushat e bollshme të kësaj treve. Me vonë, një zhvillim të dukshëm ka pasur edhe në zejtarë, në industri, në tregti, etj. Gjatë të kaluarës historike, kjo trevë luante një rol të rëndësishëm në aspektin ekonomik dhe tregtar. Nëpër të kalonin karvarie të ndryshme tregtare nga viset e ndryshme të Ballkanit, të cilat shkonin për në Shkup, Prizren, Shkodër dhe në drejtimin tjetër për në Sanxhak, Nish etj.

Pozita e volitshme gjeografike e Ferizajt ka pasur influence të fuqishme në zhvillimin e mëtejshëm të këtij vendi. Rrethina e Ferizajt ka pasur pozitën e përshtatshme gjeografike dhe ushtarake-strategjike të komunikacionit rrugor që nga kohët e lashta, siç është, p.sh., vija rrugore nëpër Neredime dhe nëpër luginën e lumit të Jezercit, në relacionin e njohur Shkodër - Shkup - Selanik, e cila, përpos rëndësisë së madhe ekonomike-gjeografike, ka pasur edhe rëndësi strategjike. Ndërtimi i hekurudhës nga Shkupi deri në Mitrovice, në vitin 1873, e quajtur Hekurudha Vardar - Kosovë, ndikoi që qarkullimi tregtar i viseve të brendshme ballkanike të orientohet kah Selaniku. Kjo ndikoi që edhe Ferizajt të ngrihet si vendbanim dhe me vone si një qendër tregtare, zejtare etj. Kjo mundësoi edhe përqendrimin e popullsisë. Me pushtimin e Kosovës nga pushteti serb në vitin 1912, shpërnguljes së një pjese të madhe të popullsisë nga fshatrat e ndryshme të Kosovës për në Turqi, në Shqipëri e gjetiu, filloi edhe një shkatërrim i ekonomisë. shumë zejtarë, tregtar, bujq e tjerë u shpërngulen nga atdheu. Filloi plaçkitja e pronave shqiptare etj. nga popullata serbe, e cila kishte filluar të vendoset në vendbanimet shqiptare. Gjendja e popullsisë shqiptare, në aspektin ekonomik, u keqësua edhe më tepër gjatë Luftës së Parë Botërore, pastaj, pothuajse me të njëjtin intensitet, vazhdoi edhe në periudhën ndërmjet dy luftërave botërore. Popullata shqiptare ishte në gjendje të mjerueshme në pikëpamje ekonomike. Si degë kryesore ishte bujqësia dhe blegtoria. Mirëpo, për shkak të tagrave të mëdha, shumica e prodhimeve bujqësore është dashur të shiten që të paguhen ato.

Gjate Luftës së Dytë Botërore, nga aspekti ekonomik, nuk kemi ndonjë ndryshim të theksuar. Kjo gjendje vazhdoi edhe pas mbarimit të luftës, me disa ndryshime të vogla në aspektin pozitiv ekonomik. Në këtë kohë formohen edhe kooperativat fshatare, kolektivizimi, marrja e prodhimeve fshatare në formë "të tepricave". Kjo gjendje zgjati deri në fund të viteve gjashtëdhjeta. Në vitet shtatëdhjeta, në kushtet e krijuara shoqërore-politike të gjendjes së Kosovës në ish-federatën jugosllave, vendbanimet e kësaj komune përjetuan një transformim të dukshëm, që zgjati deri në vitet tetëdhjeta. Pra, gjate kësaj kohe pati ndryshime të dukshme në strukturën ekonomike në favor të zhvillimit të industrisë, bujqësisë etj., dhe kjo beri të mundshme nxitjen e mëturjes dhe veprimtarive ekonomike dhe joekonomike. Kjo ndikoi në shtimin e të punësuarve në organizatat ekonomike dhe joekonomike të cilat realizonin të ardhura të konsideruara, rezultate afariste, dhe standard më të lartë të banorëve në përgjithësi.

Në aspektin ekonomik, si degë kryesore ishte bujqësia. Nga prodhimet bujqësore në këtë trevë, kryesisht kultivohen drithërat, siç janë misri, gruri, tërshëra, thekra, pastaj bimët industriale - duhani, luledielli, panxharsheqeri etj., perimet - patatet, fasulja, lakra, specat etj., bimët foragjere, pemët, sidomos mollët, vishnjat, kumbullat, dardhat, pjeshkat, arrat, por edhe hardhia. Në territorin e kësaj komune ekzistojnë plantazhet e njohura të pemëve. Një kohë në luginën e Neredimes është kultivuar edhe orizi. Përveç bujqësisë, në territorin e kësaj komune ishte e zhvilluar mjaft edhe blegtoria. Për nga aspekti i zhvillimit ekonomik, në qendrën komunale u ndërtuan disa kapacitete të industrisë përpunuese industri-ale, ushqimore etj., siç janë: Fabrika e Gypave, Fabrika e Vajit dhe Yndyrave, Fabrika e frutave ekzotike "Minex", Fabrika e këmbyesve "Eurometali", Vegëltorja, Kombinati i drurit, Plantacioni i pemëve e disa të tjera.



2.6.2. Përmbajtjet ekonomike dhe komerciale

Me qëllim të krijimit të klimës në favor të zhvillimit ekonomik, është siguruar përkrahje institucionale nga institucionet e caktuara. Kjo i referohet, siç u përmend, arsimimit profesional, certifikimit të standardeve profesionale, kualitetit të standardeve të menaxhimit, prodhimit, produkteve etj. Të gjitha këto aktivitete mund të kontribuojnë në stabilizimin NVM, si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës dhe e Ferizajt, për të sjellë shumë prodhime në tregun e Kosovës, duke siguruar edhe mundësi për punësim.

Hapja e bizneseve për shumë njerëz është mënyra e vetme për të krijuar të ardhura personale, edhe pse në të shumtën e rasteve janë të nivelit të ulët. Sot në Kosovë, si edhe në komunën e Ferizajt, preferohet të hapen biznese që kuptohen më së lehti, që nuk kërkojnë ndonjë përgatitje profesionale thelbësore ose trajnim, si p.sh. pompa benzine, autolarje, restorante etj. Edhe pse shkalla e zhvillimit të këtyre aktiviteteve për një entitet është shumë e vogël, si tërësi nuk duhet të anashkalohet, dhe çdo biznes i vogël mund të jetë një bërthamë nga i cili mund të dalin aktivitetet të tjera. Në perspektivën afatshkurtër dhe afatmesme të zhvillimit ekonomik, ka mundësi të zhvillohet industria e ndërtimtarisë, industria e përpunimit të drurit dhe agrobiznesit. Edhe pse mendohet se nuk janë degë inovative të ekonomisë, të bazuara kryesisht në fuqinë punëtore të pakualifikuar, ato mund të zëvendësojnë prodhimet e huaja dhe të krijojnë prodhime Kosovare për eksport.

Ndërmarrësit deri tani kanë qenë të suksesshëm në gjetjen e hapësirave të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë së tyre. Aktualisht, mungesa e zonave ndërtimore nuk mund të jetë pengesë e madhe për zhvillimin e biznesit. Megjithatë, ka pasur kritika të drejtuara AKM-së për shkak të mungesës së fleksibilitetit të saj për të gjetur mënyrat më pak të ndryshme për t'i vënë pronat, tokën dhe ndërtesat në dispozicion për ndërmarrjet lokale, në vend të tyre përjashtimit nga përdorimi. Entitetet e NVM janë të vogla, kështu që strukturat e zonave që duhet të zhvillohen për qëllime të ndërmarrjeve tregtare do të mund të përputheshin me kërkesat e shkallës së tillë. Për të përmbushur kërkesat më të ndryshme, sa i përket madhësisë dhe vëllimit të ndërtesave të lejuara, duhet të planifikohen zona tregtare të llojeve të ndryshme. Çdo shërbim urbanistik mund të jetë i dobishëm. Standardet mjedisore duhet të aplikohen dhe të fuqizohen përmes ligjit. Sistemi i brendshëm i rrugëve duhet të lidhet nëpërmjet sistemit rrugor rajonal.

Autoritetet në komunën e Ferizajt kanë ndërmarrë aktivitete të shumta për zhvillimin e mirëfilltë të bizneseve, duke filluar nga lehtësimi i qasjes në lokacion, dhënia e pëlqimit për plotësimin e kushteve mjedisore, dhënia e lejes së punës, caktimi i tatimeve dhe ngarkesave, dhënia e pëlqimit për shfrytëzimin e tokës bujqësore, caktimi i qirasë për objektet komunale, përmirësimi i infrastrukturës e të ngjashme. Në përmirësimin e mjedisit të biznesit në komunë ka ndikuar edhe kompania amerikane "Brown & Root", në të cilën, sipas disa shënimeve, kishte 4.700 të punësuar.

Në komunën e Ferizajt ekzistojnë edhe rrjetet përkrahës për zhvillimin e bizneseve: Zyra Rajonale për Zhvillim të Bizneseve, OEK - rajonale dhe Shoqata e Biznesit. Veprojnë edhe shoqata të tjera profesionale, si ajo e zejtarëve, blegtorëve, ekonomistëve, juristëve etj.

2.6.3. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, Komuna e Ferizajt e treta për numrin më të lartë të banorëve të cilët i takojnë moshës së punës 15 – 64 vjeçare.

	Komuna	Numri i përgjithshëm i banorëve	Numri i banorëve të moshës 15 - 64
1	Prishtina	198,897	134,336
2	Prizren	177,781	117,178
3	Ferizaj	108,610	70,487
4	Pejë	96,450	63,963




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

5	Gjakovë	94,556	62,197
6	Gjilan	90,178	60,160
7	Podujevë	88,499	56,626
8	Mitrovicë	71,909	46,484
9	Vushtri	69,870	45,728
10	Suharekë	59,722	38,209

Tabela 40 Radhitja e 10 komunave, sipas fuqisë më të lartë punëtore

70,457 banorë apo 64.90% numrit të përgjithshëm të banorëve të Ferizajt janë të moshës 15 – 64 vjeçare, që për shkak të numrit të lartë të fuqisë punëtore paraqet një mundësi të mirë për zhvillim bujqësor dhe industrial në Komunë.




Grafika 20 Diagrami i Komunave sipas numrit të fuqisë punëtore

Sa i përket raportit gjinor të fuqisë punëtore në Komunë, nuk ka ndonjë dallim të madh, mbi të cilën do të krijoheshin strategji të përpikta për krijim e një strategjie të qëndrueshme për sektorë specifik.

Numri i përgjithshëm i banorëve të moshës 15 - 64	Numri i meshkujve të moshës 15 - 64	Numri i femrave të moshës 15 - 64
70,487	35,435	35,052
	50.27%	49.73%

Tabela 41 Numri i fuqisë punëtore sipas gjinisë

Në Komunë janë gjithsejtë 35,435 meshkuj dhe 35,052 femra të cilat janë në moshën e cilësuar të përshtatshme për punësim.



Grafika 21 Diagrami i fuqisë punëtore sipas gjinisë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Bazuar në “Të dhënat e tregut të punës sipas Komunave”, të vitit 2011, në krahasim të përqindjes së të banorëve punësuarve me Komunitat tjera, me gjithsejtë 18,283 të punësuar Ferizaji radhitet në vendin e nëntë, që dëshmon një nivel të lartë të punësimit.

Klasifikimi	Komuna	Numri i banorëve 15 – 64 vjeç	Numri i banorëve të punësuar	%
1	Prishtina	134,336	54,316	40.43%
2	Graçanicë	7,019	2,494	35.53%
3	Mamushë	3,440	1,182	34.36%
4	Fushë Kosovë	22,688	7,563	33.33%
5	Obiliq	13,891	3,771	27.15%
6	Novobërdë	4,354	1,150	26.41%
7	Gjilan	60,160	15,795	26.25%
8	Ferizaj	70,487	18,283	25.94%
9	Pejë	63,963	16,329	25.53%
10	Prizren	117,178	29,527	25.20%
11	Klllokot	1,672	385	23.03%
12	Rahovec	36,775	8,384	22.80%
13	Viti	29,794	6,783	22.77%
14	Gjakovë	62,197	13,955	22.44%
15	Mitrovicë	46,484	10,414	22.40%
16	Istog	25,504	5,699	22.35%
17	Lipjan	36,938	8,073	21.86%
18	Shtërpçë	4,490	979	21.80%
19	Vushtrri	45,728	9,775	21.38%
20	Suharekë	38,209	8,005	20.95%
21	Kamenicë	24,268	5,022	20.69%
22	Partesh	1,245	253	20.32%
23	Dragash	22,200	4,435	19.98%
24	Podujevë	56,626	11,140	19.67%
25	Kaçanik	21,909	4,234	19.33%
26	Glllogoc	37,940	7,268	19.16%
27	Hani i Elezit	6,101	1,167	19.13%
28	Shtime	17,145	3,228	18.83%
29	Ranillug	2,539	473	18.63%
30	Deçan	26,580	4,340	16.33%
31	Skenderaj	32,350	5,125	15.84%
32	Klinë	24,491	3,790	15.48%
33	Malishevë	32,779	4,699	14.34%
34	Junik	3,983	536	13.46%


Tabela 42 Radhitja e Komunave sipas nivelit të punësimit²²

Mirëpo, krahasuar me vendet e zhvilluara, Komuna e Ferizajt që është e dyta në Kosovë me numër të banorëve, numëron vetëm 25.94% banorë në marrëdhënie pune dhe kjo është brengosëse, për faktin që kjo Komunë pranon më së paku remitenca nga diaspora, për dallim nga Komunitat tjera.

²²Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat e tregut të punës sipas Komunave, Prishtinë, 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt




Grafika 22 Diagrami i Komunave sipas numrit të të punësuarve

Sa i përket përbërjes gjinore të të punësuarve, dominon punësimi i meshkujve me gjithsejtë 14,479 të punësuar apo 79.19%, gjersa numri i femrave të punësuar është vetëm 3,804 apo 20.81% të të gjithë të punësuarve.

	Meshkuj	Femra
Numri i banorëve të punësuar	14,479	3,804
Përqindja e banorëve të punësuar	79.19%	20.81%

Tabela 43 Përbërja e të punësuarve sipas përbërjes gjinore²³

Vetëm një e pesta e banorëve të punësuar janë femra, që dëshmon se një pjesë e madhe punësimit në Komunë, përbehet nga punë të rënda fizike.



Grafika 23 Diagrami i banorëve të punësuar sipas gjinisë


Mirëpo, përbërja gjinore është duke u ndryshuar, duke u zvogëluar sepse në grupmoshat e reja 15 – 24 vjeçare numri meshkujve të punësuar është 1,930 banorë apo 73.99%, gjersa numri i femrave të punësuar është 690 banorë apo 26.34%, që dëshmon për rritjen e numrit të femrave të punësuar në të ardhmen.

²³Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat e tregut të punës sipas Komunave, Prishtinë, 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt



Grafika 24 Diagrami i banorëve të punësuar sipas gjinisë dhe grupmohave 15 – 24, 25 - 54 dhe 55 - 64

Sa përket përbërjes së të punësuarve sipas grupmohave, gjeneratat e reja 15 – 24 vjeçare, përbëjnë 14.33% të punësuarve për dallim nga gjeneratat më të vjetra 55 – 64 vjeçare të cilat përbëjnë 8.69% nga të gjithë banorët e punësuar.

Grupmoshat	Numri të punësuarve	% e të punësuarve
15-24	2,620	14.33%
25-54	14,075	76.98%
55-64	1,588	8.69%

Tabela 44 Numri i të punësuarve sipas grupmohave

Gjersa, sa i përket pozitës së punësimit, një pjesë e madhe, përkatësisht 14,829 banorë janë të punësuar, gjersa numri i punëdhënësve është 998.


Grupmoshat	I/e punësuar	Punëdhënës	Vetëpunësuar	U asiston të afërme në biznes familjar
15-24	2,273	60	196	80
25-54	11,227	861	1,764	193
55-64	1,329	77	161	18
Gjithsejtë	14,829	998	2,121	291

Tabela 45 Numri i të punësuarve sipas grupmohave dhe pozitës së punësimit

Bazuar në treguesit e sipërm, rezulton madhësia mesatare e punonjësve për punëdhënës është 6.7 punëtor për punëdhënës.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 25 Diagrami i treguesve të punësimit sipas pozitës

Mirëpo, sipas të dhënave “Të dhënave socio-ekonomike sipas komunave”²⁴, të vitit 2011, rezulton numri i përgjithshëm i banorëve të Komunës të cilët janë duke punuar, rezulton të jetë 23,092, përkatësisht 32.76%.

2.6.4. Burimet kryesore të jetesës

Bazuar në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011, vetëm 23,092 të banorëve apo 21.26%, siguronin burimin e parë të jetesës nga puna, që përbën një tregues shqetësues, sa i përket papunësisë.

	Punë	Patundshmëri apo investime	Pension	Ndihma Sociale	Ndihmesa tjera	Para të dërguara nga jashtë	Mbështetje nga persona të tjerë	Burime tjera
Urban	9,514	343	2,348	1,502	529	1,567	21,882	4,943
Rural	13,578	205	3,675	2,214	323	3,789	37,312	4,886
Gjithsej	23,092	548	6,023	3,716	852	5,356	59,194	9,829
%	21.26%	0.50%	5.55%	3.42%	0.78%	4.93%	54.50%	9.05%


Tabela 46 Popullsia rezidente në bazë të burimit të parë të jetesës sipas komunave

Tabela paraqet një tregues që vetëm 23,550 banorë apo 21.76%, sigurojnë të ardhurat e tyre në mënyrë të pavarur, gjersa 84,970 apo 78.23% janë të papunësuar dhe të varur nga burime tjera të jetesës. Tjetër veçori e numrit të punësuarve është që gati 60% të të gjithë punësuarve jetojnë në zonë rurale.

²⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat socio-ekonomike sipas komunave, Prishtinë, 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 26 Diagrami i burimit të parë të jetesës të banorëve sipas llojit

Gjersa sa i përket burimit të dytë jetësor, në Komunë vetëm 808 banorë, kanë punë dytësore.

	Punë	Patundshmëri apo investime	Pension	Ndhimja Sociale	Ndhimesa tjera	Para të dërguara nga jashtë	Mbështetje nga persona të tjerë	Burime tjera
Urban	164	246	302	219	37	1,115	3,457	11,069
Rural	644	119	638	293	100	2,884	6,038	26,010
Gjithsej	808	365	940	512	137	3,999	9,495	37,079
%	1.46%	0.66%	1.70%	0.93%	0.25%	7.23%	17.18%	67.08%

Tabela 47 Popullsia rezidente në bazë të burimit të dytë të jetesës sipas komunave²⁵

2.6.5. Mirëqenia sociale

Sa i përket mirëqenies sociale, analizat mbështeten në të dhënat publike të Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i pensionistëve ka shënuar një rritje simbolike prej 1.94%. Në Komunë aktualisht jetojnë 5,883 pensionistë, përkatësisht 5.52% të banorëve të regjistruar në vitin 2011.

	2011	2015	Bilanci %
Numri i pensionistëve	6,023	5,997	-0.43%

Tabela 48 Numri i pensionistëve të regjistruar në vitet 2011 dhe 2015

Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i pension kontributdhënësve ka shënuar një rritje prej 4.01%, që dëshmon zvogëlimin papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 1,973 pension kontributdhënës, përkatësisht 1.82% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një shkallë të ultë të punësimit të Ferizajasve.

	2014	2015	Bilanci %
Numri i pension kontributdhënësve	1,897	1,973	+4.01%

Tabela 49 Numri i pension kontributdhënësve të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015

Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i personave me aftësi të kufizuar ka shënuar një rritje prej 7.16%, që dëshmon zvogëlimin papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 943 persona me aftësi të kufizuar, përkatësisht 0.87% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një shkallë të ultë të banorëve me aftësi të kufizuar.

	2014	2015	Bilanci %

²⁵Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat socio-ekonomike sipas komunave, Prishtinë, 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Numri i pensioneve për personave me aftësi të kufizuara	880	943	+7.16%
---	-----	-----	--------

Tabela 50 Numri i pensioneve për persona me aftësi të kufizuar të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015

Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar ka shënuar një rënie prej -9.03%, që dëshmon zvogëlimin papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 131 fëmijë me aftësi të kufizuar, përkatësisht 0.12% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një përqindje të ultë të fëmijëve me aftësi të kufizuar.

	2014	2015	Bilanci %
Numri i pensioneve për fëmijë me aftësi të kufizuara	144	131	-9.03%

Tabela 51 Numri i pensioneve për fëmijë me aftësi të kufizuar të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015

Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i familjeve të dëshmorëve dhe invalidët e luftës ka shënuar një rënie prej -0.35%, që dëshmon zvogëlimin papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 285 familje të dëshmorëve dhe invalidët e luftës, përkatësisht 0.26% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një përqindje të ultë të familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës.

	2014	2015	Bilanci %
Numri i pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës	286	285	-0.35%

Tabela 52 Numri i pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës të regjistruar

Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale ka shënuar një rënie prej +6.81%, që dëshmon rritjen papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 925 familje që kanë përfituar ndihmë sociale, përkatësisht 0.85% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një përqindje të ultë të familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale.

	2014	2015	Bilanci %
Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale	866	925	+6.81%

Tabela 53 Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015


Sipas të dhënave zyrtare të viteve 2014 dhe 2015, numri i anëtarëve të familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale ka shënuar një rënie prej +8.75%, që dëshmon rritjen papunësisë në Komunë. Në Komunë aktualisht jetojnë 3,916 familje që kanë përfituar ndihmë sociale, përkatësisht 3.61% të banorëve të regjistruar në vitin 2011, që dëshmon një përqindje të ultë të anëtarëve të familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale.

	2014	2015	Bilanci %
Numri i familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale	3,601	3,916	+8.75%

Tabela 54 Numri i anëtarëve të familjeve që kanë përfituar ndihmë sociale të regjistruar në vitet 2014 dhe 2015




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 27 Diagrami i numrit të banorëve sipas mirëqenies sociale të vitit 2015

2.6.6. Remitencat

Ashtu siç ilustron grafiku, në krahasim me vitin 2011, disponimi për migrim është rritur te të papunët (për 4.5 pikët të përqindjes) dhe të pranuesit e remitencave (1.6 pikë të përqindjes), por është zvogëluar te kryefamiljaret femra (4 pikë të përqindjes) dhe te kryefamiljarët serbë (4 pikë të përqindjes). Në anën tjetër, sa i përket rajoneve, rritje e theksuar u shënuar te banorët e rajonit të Mitrovicës (7.1 pikë të përqindjes) dhe Gjilanit (5.6 pikë të përqindjes). Rënie e vogël e interesimit për migrim është shënuar në Prishtinë, Prizren dhe Pejë, por kjo rënie është më e theksuar në Ferizaj (5.9 pikë të përqindjes).



Grafika 28 Përqindjet e të anketuarve rajonal dhe pranimit të remitencave (2011 dhe 2012)



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.6.7. Ndërmarrjet

Deri në vitet 1990 sektorët kryesorë industrial të zhvillimit ekonomik në komunën e Ferizajt kanë qenë industria metalike, industria ushqimore dhe industria e drurit. Tani struktura ekonomike e komunës është e bazuar kryesisht në shërbime, tregti, dhe ne disa NVM (ndërmarrje të vogla dhe të mesme) prodhuese. Përveç kësaj, sektori bankar është duke u zhvilluar shumë shpejt gjatë viteve të fundit.

Ne komunën e Ferizajt aktivitetin biznesor e zhvillojnë rreth 3900 biznese. Ferizaj me të drejtë konsiderohet si qendër e zhvillimit ekonomik regional. Degët kryesore të industrisë të cilat kanë shënuar ngritje në kapacitetet e tyre teknologjike dhe njerëzore janë industria e drurit (me me shume se 100 biznese për përpunimin e drurit), industria e ndërtimit, por ka përparime edhe në sektorë të tjerë si bujqësia, turizmi etj.

Nr.	Aktivitetet sipas sektorit ekonomik	2000 - 2016
1	Sektori I Bujqësisë, Pylltarisë dhe Peshkimi	274
2	Sektori I Administrimi Publik dhe Mbrojtja e Sigurimi Social I Detyrueshëm	10
3	Sektori I Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor	1267
4	Sektori I Arsimit	85
5	Sektori I Artit, Argëtimit dhe Rekreacioni	161
6	Sektori I Furnizimi me Rryme, Gaz, Avull dhe Ajër të Kondicionuar	6
7	Sektori I Furnizimit me Ujë, Kanalizim, Veprimtaritë e Menaxhimit dhe të Trajtimit të Mbeturinave	55
8	Sektori I Industrisë Përpunuese	1182
9	Sektori I Minierat dhe Gurorët (Industria Nxjerrëse)	24
10	Sektori I Ndërtimit	754
11	Sektori I Shërbimet Administrative dhe Mbështetëse	176
12	Sektori I Transportit dhe Magazini	1502
13	Sektori I Tregtisë me Shumice dhe Pakice, Riparimi I Mjeteve Motorike dhe Motoçikletave	4046
14	Sektori I Veprimtaritë e Patundshmërisë	28
15	Sektori Veprimtaritë e Shëndetit të Njeriut dhe të Punës Sociale	134
16	Sektori I Veprimtaritë e Tjera Shërbyese	587
17	Sektori I Veprimtaritë Financiare dhe të Sigurimit	28
18	Sektori I Veprimtaritë Profesionale, Shkencore dhe Teknike	328
19	Sektori I Informimit dhe Komunikimi	202
20	Sektori I Veprimtaritë e Ekonomive Familjare si Punëdhënës, Mallrat dhe Shërbimet e Padiferencuara, Veprimtaritë e Ekonomive Familjare për Përdorim Vetanak	1
21	Sektori I Veprimtaritë e Trupave dhe Organizatave Ndërkombëtare	0
22	Te Tjera	212

Tabela 55 Numri i ndërmarrjeve private Ferizajase të regjistruara 2000 -2016

Sipas regjistrimit të numrit të ndërmarrjeve të regjistruara sipas komunave për tremujorin e dytë të vitit 2016, në Komunën e Ferizaj-it janë regjistruar më shumti biznese të reja, pas Prishtinës, që tregon se aktivitetet ekonomike janë duke u shtuar, me gjithsejtë 231 ndërmarrje të reja të regjistruara.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Emertimi	Kodi	Gjithsej	Bujqësi, pylltari dhe peshkataria		Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete financiare dhe sigurimit	Aktivitete të patundshmërisë	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera
			A	B																		
Komunat	2801	223	6	334	11	13	202	779	150	326	114	34	17	170	101	6	42	60	51	162		
1 19 Prishtinë	702	15	1	46	7	3	36	197	14	96	67	9	5	95	30	5	16	18	11	31		
2 25 Ferizaj	231	13	1	31	-	-	30	71	15	20	9	2	2	7	6	-	3	4	5	12		
3 17 Pejë	180	14	-	23	-	1	11	44	5	26	6	4	1	12	6	-	6	3	1	17		
4 20 Prizren	179	7	-	18	-	-	6	57	15	31	2	2	-	7	12	1	4	4	4	9		
5 04 Gjilan	149	3	-	14	-	-	6	47	23	16	-	2	-	10	4	-	-	6	3	15		
6 11 Mitrovicë	133	4	-	21	1	-	8	30	16	15	5	-	2	4	5	-	3	9	2	8		
7 02 Gjakovë	132	2	-	20	1	1	12	42	4	21	3	2	1	1	1	-	1	2	4	14		
8 27 Vushtrri	91	5	-	13	-	-	4	26	9	8	4	1	-	3	6	-	1	1	-	10		
9 03 Glllogoc	89	29	-	10	-	1	12	17	4	4	1	1	-	4	1	-	-	-	-	5		
10 09 F.Kosovë	87	6	-	7	-	-	5	25	3	14	2	2	2	4	5	-	-	2	6	4		

Tabela 56 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara sipas komunave në TM2 2016



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Emërtimi		Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash...	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike...	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitetet financiare dhe sigurimit	Aktivitetet të patundshmërisë	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitetet të shërbimeve tjera
Kodi	Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
Komunat	657	43	1	50	-	4	52	242	67	81	15	2	7	19	10	1	8	6	7	42
1 19 Prishtinë	99	2	-	7	-	1	7	37	6	9	4	1	2	9	3	1	1	1	1	7
2 20 Prizren	72	3	-	5	-	-	5	29	3	17	1	-	1	1	-	2	-	-	4	
3 25 Ferizaj	54	1	-	4	-	-	6	19	8	8	1	-	-	2	1	-	-	1	-	3
4 02 Gjakovë	38	5	-	4	-	1	1	15	4	2	-	1	1	1	-	-	-	-	2	1
5 18 Podujevë	35	4	-	2	-	-	2	17	2	2	2	-	-	-	1	-	-	-	3	
6 17 Pejë	33	2	-	1	-	-	2	12	8	3	1	-	-	-	-	1	-	-	3	
7 16 Rahovec	29	3	1	2	-	-	3	11	3	3	-	-	-	1	-	-	-	-	2	
8 04 Gjilan	26	2	-	-	-	-	1	10	-	6	1	-	-	3	2	-	-	-	1	
9 21 Skenderaj	26	4	-	2	-	1	3	8	3	-	-	-	-	-	-	1	2	1	1	

Tabela 57 Numri i ndërmarrjeve të shuara sipas komunave në TM2 2016

Emërtimi		Bujqësi, pylltari dhe peshkatar	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash ...	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike...	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitetet financiare dhe sigurimit	Aktivitetet të patundshmërisë	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	Arsim	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitetet të shërbimeve tjera
Kodi	Gjithsej	A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S
Të reja	231	13	1	31	-	-	30	71	15	20	9	2	2	7	6	-	3	4	5	12
1 Të shuara	54	1	-	4	-	-	6	19	8	8	1	-	-	2	1	-	-	-	3	
2 Bilanci	177	12	1	27	0	0	24	52	7	12	8	2	2	5	5	0	3	3	5	9

Tabela 58 Bilanci ndërmarrjeve të regjistruara dhe të shuara në TM2 2016



2.6.8. Potencialet e zhvillimit ekonomik

2.6.8.1. Toka bujqësore

Pjesët qendrore të Komunës janë sipërfaqe të rrafshëta. Kjo tokë është shumë pjellore dhe bujqësia paraqet degë shumë me rëndësi të zhvillimit ekonomik. Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes urbane e cila e degradon tokën bujqësore dhe e dëmton degën më vitale të ekonomisë Kosovare. Për shkak të sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore, të punëshme dhe pyjeve, përmes zhvillimit të politikave të mirëfillta për këtë sektor, Komuna ka mundësi që të përmirësoj dukshëm mirëqenien e banorëve të saj.

Lloji i shfrytëzimit	Djerrinë	Kullos/livadhe	Tokë bujqësore
Sipërfaqja (ha)	202.68	28.34	15395.48

Tabela 59 Sipërfaqja sipas shfrytëzimit të tokës bujqësore


Sipas vlerësimit të tokës bujqësore, rezulton se në Komunë ka 15626.5 hektarë të tokës bujqësore, që nuk është tjetërsuar, që përbën 44.89% të territorit është tokë bujqësore, 0.59% djerrinë dhe 0.08% kullosë/livadh.

Gjersa, sa i përket klasifikimit të tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore, Komuna e Ferizajt ka në dispozicion këto sipërfaqe:

Përshtatshmëria e tokës bujqësore	Sipërfaqja (ha)	Përqindja
Tokë e klasit të parë	3437.83	22 %
Tokë e klasit të dytë	3125.5	20 %
Tokë e klasit të tretë	1562.85	10 %
Tokë e klasit të katërt	1094.065	7 %
Tokë e klasit të pestë	781.525	5 %
Tokë e klasit të gjashtë	1250.52	8 %
Tokë e klasit të shtatë	781.625	5 %
Tokë e klasit të tetë	1563.35	10 %

Tabela 60 Sipërfaqja dhe përqindja e tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë

Duke marrë parasysh që 50 % të tokës bujqësore është përshtatshmeri të klasit 1 – 4, Komuna ka një potencial të lartë për zhvillimin e prodhimitarisë bujqësore.



Grafika 29 Diagrami i sipërfaqeve në hektarë të tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë

Prodhimtaria bujqësore

Në komunën e Ferizajt mbjelljet vjeshtore toka kryesisht mbillet me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore me misër dhe bimë foragjere për blegtori. Drithërat, kullosat, livadhet (prej të cilave kositet sana), dhe bimët foragjere janë sipërfaqe të konsiderueshme. Kultura tjera të rëndësishme janë: pemët dhe përimet. Më parë (para viteve të 90-ta) kulturat industriale si duhani, bimët vajore dhe panxhar sheqeri ishin të rëndësishme. Mos funksionimi i



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

njësive përpunuese të NSH-ve, mungesa e mjeteve stimulative me kredi apo subvencione nga Qeveria komunale dhe qendrore, tani këto kultura nuk kultivohen fare (pangjari).

Nga sipërfaqet me kultura bujqësore pjesëmarrje më të madhe ka gruri (5100 ha). Janë tri ndërmarrje bujqësore të cilat zhvillojnë veprimtari, por të kufizuar, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, mekanizmit bujqësor të vjetruar si dhe pamundësisë së sigurimit të të hyrave. Prodhimet e fermerëve nga sektori privat i plotëson vetëm nevojat për konsum familjar, rrjedhimisht nuk mbetet asgjë për treg. Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik dhe sektor që siguron dhe afron më së shumti të hyra në periudhën e pasluftës, sepse 2/3 e popullsisë në komunën tonë jeton në zonat rurale. Kryesisht të ardhurat e tyre i krijojnë nga aktivitetet bujqësore, por indikator mjaft i rëndësishëm i zhvillimit të aktiviteteve bujqësore është zhvillimi i industrisë ushqimore e bazuara në produktet bujqësore.

Drithërat, llojet dhe prodhimtaria, 2012- 2015

	Prodhimi (t/ ha)/gjithsej t				Trendet e rritjes/ zvogelimit- viti:			
	2012	2013	2014	2015	2012-2015	2012-2013	2013-2014	2014-2015
Grurë	20175	20379	21009	22059	1885	204	630	1050
Misër	7013	7084	7303	7668	655	71	219	365
Elbi	61	61	63.4	67	6	1	2	3
Thekra	87	88	90.65	95	8	1	3	5
Drithërat tjerë kokërr	0	0		0	0	0	0	0
Bishtajoret kokërr					0	0	0	0
Fasule kokërr	288	291	300	315	27	3	9	15
Bizele kokërr	1	1	0.74	1	0	0	0	0
Bishtajoret tjera	0	0		0	0	0	0	0
Kultura tjera	0	0		0	0	0	0	0
Kultura industriale	0	0		0	0	0	0	0
Duhani	0	0		0	0	0	0	0
Luledielli	5	5	5	5	0	0	0	0
Bime aromatike	0	0		0	0	0	0	0
kultura tjera industriale	0	0		0	0	0	0	0
Patatet	1347	1361	1403	1473	126	14	42	70
Bime dekorative	0	0		0	0	0	0	0
Gjithsej	28977	29270	30175	31684	2707	293	905	1509

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjellbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 61 Prodhimtaria e drithërave në Komunë

Pemët, llojet dhe prodhimtaria, 2012- 2015

	Prodhimi (t/ ha)				Trendet e rritjes/ zvogelimit- viti:			
	2012	2013	2014	2015	2012-2013	2013-2014	2014-2015	2012-2015
Mollë	947	967	1007	1047	19	40	40	100
Dardhë	159	162	169	176	3	7	7	17
Ftua	30	31	32	33	1	1	1	3
Mushmollë	20	20	21	22	0	1	1	2
Kumbull	421	429	447	465	9	18	18	44
Qershi	24	24	25	26	0	1	1	2
Vishnje	43	44	46	48	1	2	2	5
Pjeshkë	1	1	1.25	1	0	0	0	0
Kajsi	2	2	2.2	2	0	0	0	0
arra	3	3	3.34	3	0	0	0	0
Lajthia	8	8	8.5	9	0	0	0	1
Mjedra	148	151	157	163	3	6	6	16
Manaferra	17	17	18	19	0	1	1	2
Dredhëza	39	39	41	43	1	2	2	4
Gjithsej	1861	1899	1978.29	2057	38	79	79	196

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjellbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 62 Prodhimtaria e pemëtarisë në Komunë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Qumështi, llojet dhe prodhimtaria, 2012- 2015

	Prodhimi (l)			
	2012	2013	2014	2015
Gjithsej qumësht pa u përpunuar	9986493	10191819	11029410	13288240
Qumështi,	2995950	3057546	3308823	3986472
Djathi	798919	815345	882353	1063059
Kosi	1997299	2038364	2205882	2657648
Gjizë	332883	339727	367647	442941
Gjithsej				

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjelbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 63 Prodhimtaria e qumështit në Komunë

Shpendët, koncentrimi, 2011- 2014

	Koncentrimi (nr.)			
	2012	2013	2014	2015
Gjela,pula,zogj	33461	34144	34841	36583
Pula	89939	91774	93647	98329
Gjithsej	123400	125918	128488	134912

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjelbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 64 Prodhimtaria e shpezëve në Komunë

Mekanizimi përpunues, koncentrimi, 2011- 2014

Llojet	Koncentrimi (nr.)			
	2012	2013	2014	2015
Traktor			2998	3058
Kombaj per korre dhe sillaz			80	82
kamioneta			205	209
Rimorkio			1689	1723
Kositëse me traktorë			409	417
Kositëse lëvizëse			95	97
Mbledhëse bari			421	429
Makina mbjellëse gruri			255	260
Makina mbjellëse misri			187	191
Plug			2291	2337
Lesë me dhembe			1184	1208
Makina për nxjerrjen e patateve			29	30
Freze			235	240
Shpërndarës i plehut mineral			336	343
Shpërndarës i plehut organik			52	53
Lese me disqe			869	886
Makinë lidhëse për duaj bari dhe kashte			188	192
makine për zhveshjen e misrit			18	18
Mikser për koncentrat			37	38
Makine për mjelje			168	171
Ngarkues pleh shtalle			33	34
Pajisje për ftohje të qumështit			23	23
Pajisje për nxjerrjen e mjaltit			28	29
Spërkatëse të grurit			13	13
Spërkatëse të pemëve-atomizer			79	81
Gjithsej			11922	12160

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjelbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 65 Inventari i pajisjeve bujqësore në Komunë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Sektori i blegtorisë

Zhvillimi i blegtorisë në Ferizaj është në varshmëri nga trendët e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Vlerësohet se të dhënat me të cilat disponojnë vendi janë potencial i mjaftueshëm për zhvillimin e aktiviteteve blegtorale në nivel të krahasueshëm me komunat tjera por edhe ato të regionit.

Trendët aktuale të zhvillimit të blegtorisë në vend varen nga investimet e kapitalit individual në ngritjen e objekteve të reja, megjithatë sipas vlerësimit të gjendjes aktuale në teren të ngritja e objekteve dhe infrastrukturës blegtorale po bëhet dhe duhet të bëhet aty ku nuk paraqet rrezik në planet urbane në nivel lokal dhe planin zhvillimor komunal në përgjithësi. Zhvillimet në blegtori janë të rregulluara me Ligjin e Blegtorisë së Kosovës dhe Strategjinë Zhvillimore 10 vjeçare.

Nevoja për politikën e prodhimit blegtorale

Dokumenti i Strategjisë jep udhëzime për programin 10 vjeçar të zhvillimit të sektorit të Blegtorisë përmes programeve zhvillimore si rezultat i rishikimeve teknike dhe ekonomike të sektorit të prodhimit blegtorale si dhe aspekteve të ndërlidhura me sektorin e prodhimit të kulturave bujqësore.

Bazat për hartimin e politikës janë cekur në Librin e Gjellbër të Ministrisë, përmes së cilit synohet zhvillimi i politikës me një qasje pjesëmarrëse. Kjo d.m.th. këshillim/diskutim me Komunat, OJQ-të që veprojnë në këtë sektor dhe organizatat e fermerëve, përpunuesit dhe tregtarët. Politikat e përgjithshme janë parashtruar në kapitullin II të Librit të Gjellbër. Synim kryesorë i politikës në aspektin afat shkurtër-mesëm është që të krijohet vende pune dhe të ngritë të ardhurat e fermerëve të varfër të ekonomive të vogla bujqësore; të ndihmojnë në zgjerimin e aktiviteteve. Njëkohësisht politika do të promovon lëvizjet drejt komercializimit. Është e nevojshme që të bëhet e ditur nevoja për të baraspeshuar kërkesat “sociale” për të ndihmuar fermerët e vegjël dhe kërkesat “zhvillimore” për inkurajimin e njësive më të mëdha komerciale të veprimtarisë bujqësore dhe njësive agro-përpunuese, të gjitha këto politika janë relevante edhe sot kur po punohet Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt

Mundësitë prodhuese

Aktualisht ekzistojnë tendenca për kalim nga sistemi i ekonomive të vogla fermeri në atë të mesëm (ferma komerciale). Ekonomitë e vogla fermeri do të vazhdojnë të ekzistojnë kryesisht nëpër fshatra të larta. Numri i ekonomive të vogla fermeri nuk do të rritet. Fermat komerciale (25-50 lopë qumështore, 30-60 ha) do të zhvillohen në ultësirat më pjellore. Zhvillimi i kësaj shtate do të nxitet nga zhvillimi i industrisë së qumështit dhe mishit si dhe industrisë së përpunimit të ushqimit të kafshëve.

Gjedhët, koncentrimi, 2011- 2014

	Koncentrimi (nr.)			
	2012	2013	2014	2015
Lope	4961	5063	5166	5446
Mëshqerre	796	812	829	854
Viça	3618	3692	3767	4000
Gjithsej	9375	9567	9762	10300

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK ,
Raporti i Gjellbër 2015 nga MBPZHR dhe AUK

Tabela 66 Inventari i gjedhëve në Ferizaj 2012,2013 dhe 2014

Delet, koncentrimi, 2011- 2014

	Koncentrimi (nr.)			
	2012	2013	2014	2015
Dele mbarështimi	5538	5652	7300	7665
Qengj	5411	5522	3500	3675
Gjithsej	10949	11174	10800	11340

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK ,
Raporti i Gjellbër 2015 nga MBPZHR dhe AUK

Tabela 67 Inventari i deleve në Ferizaj 2012,2013 dhe 2014



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Dhite, koncentrimi, 2011- 2014

	Koncentrimi (nr.)			
	2012	2013	2014	2015
Capë	94	96	400	412
Dhi	517	528	200	206
Gjithsej	611	624	600	618

Burimi: Regjistrimi i Bujqësisë në Kosovë nga ASK dhe Raporti i Gjellbër 2015 nga MBPZHR

Tabela 68 Inventari i dhive në Ferizaj 2012,2013 dhe 2014

Sektori i pylltarisë

Në kudër të Librit të Gjellbër të Kosovës- “ Strategjia për zhvillimin e qëndrueshëm Bujqësor dhe Rural në Kosovë”, e hartuar gjatë viteve 2001-2002 dhe e miratuar në muajin maj 2003 është edhe zhvillimi i Sektorit të Pylltarisë në Kosovë. Sektori i pylltarisë, ngjashëm me sektorët tjerë për kohë të gjatë është ballafaquar me probleme dhe sfida të shumta, shumë prej të cilave nuk janë zgjidhur deri në këtë kohë. Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 42% në sipërfaqen e përgjithshme të Kosovës, rendësin e tyre ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike kanë rendësi dhe ndikim të madh në planifikimin hapësinor.

Kosovë ka 430000 ha (40.25 % e territorit të Kosovës) është e mbuluar me tokë pyjore dhe gjysmë - natyrore, nga të cilat komuna e Ferizajt posedon 13860.50 ha apo 3.22 % të mbulshmërisë së përgjithshme të territorit të Kosovës.

Pyjet dhe resurset pyjore me pjesëmarrjen e tyre afro 39.6% në sipërfaqen e përgjithshme të komunës së Ferizajt, rendësin e tyre ekologjike, sociale, shëndetësore dhe ekonomike kanë rendësi dhe ndikim të madh në planifikimin hapësinor. Struktura pyjore ekzistuese, sasia e sipërfaqeve të zhveshura, nevoja e shpalljes së zonave të mbrojtura, nevoja e ruajtjes së tokave pyjore, zhvillimi i infrastrukturës pyjore, ndërrimi i destinimit të tokave pyjore etj. imponojnë qasje serioze të trajtimit të këtij sektori si komponent e rëndësishme e planifikimit hapësinor.

Lloji pyjor	Sipërfaqe (ha)
Pyjet e larta (trungishtë)	4145.10
Pyjet e uleta (cungishte)	2318.50
Pyjet e degraduara	2585.70
Shkurre/kaçuba	685.20
Totali	9734.50

Tabela 69 Sipërfaqet sipas llojit të pyjeve

Sipërfaqja e tërësishme e mbuluar me pyje në komunën e Ferizajt është afërsisht rreth 13860.50 ha, apo 39.6% të sipërfaqes së tërësishme të komunës së Ferizajt. Prej tyre rreth 4126 ha është në pronësi private, ndërsa 9734.50 ha janë pronë publike - shtetërore. Klasifikimi në bazë të kategorive të pronësisë dhe llojeve kryesore të pyjeve është paraqitur në tabelën më poshtë:

- Pyjet e ulëta (cungishte), vlerësohen me se 24 % të zonës pyjore, ndërsa rreth 43% vlerësohen si pyje të larta (trungishte). Ndërsa të tjerat janë klasifikuar si të degraduara dhe shkurre. Përveç këtyre zonave, ekzistojnë edhe 50 ha të tjerë, të klasifikuar si tokë pyjore.
- Masa drunore e përgjithshme është vlerësuar rreth 1031778 m³.
- Sipërfaqja e përgjithshme e pyjeve dhe tokave pyjore është 13860.50ha, prej të cilave vetëm pyje janë rreth 9049.30 ha.
- Vëllimi i përgjithshëm drunor në është rreth 1031,778 m³. Vëllimi mesatar vjetor për hektar është 114m³/ha.

Sipas të gjitha analizave të bëra shtimi vjetor për pyjet e larta është 3 - 5 m³/ha, ndërsa për pyjet e ulëta nga 1.5 - 3 m³/ha.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt


Llojet (speciet) kryesore drunore

Për nga shtrirja hapësinore llojet kryesore drunore në komunën e Ferizajt janë dushku dhe ahë nga gjetherënësia ndërsa pisha, bredhi, hormaoqi larqi, etj nga gjethembajtësit, llojet tjera drunore janë: frashëri, shkoza, lajthia, verriri, plepi, panjat, gështenja.

Duke ditur rëndësin e pyjeve në mjedis është shumë e rëndësishme dhe parimore që pyjet të zhvillohen dhe menaxhohen me mençuri dhe në përputhje me parimet e menaxhimit qëndrueshëm të pyjeve. Mjedi natyror në Kosovë është dëmtuar për shkak të prerjes së tepërt të pyjeve, prerjes ilegale dhe efekteve të përhapjes së pakontrolluar urbane. 40% e pyjeve publike dhe 29% e pyjeve private i janë nënshtruar aktiviteteve të pakontrolluara dhe ilegale të prerjes së drunjve, kjo dukuri ka qenë e pranishme edhe në komunën e tonë. Gjendja është shumë kritike në pyjet halore, ku është vënë në rrezik e tërë ekzistenca e zonave të mëdha pyjore nëse nuk ndërmerren veprime të menjëhershme dhe të fuqishme. Rezultatet e regjistrimit konfirmojnë gjithashtu se zabelet, sidomos në tokat pyjore publike, i janë ekspozuar prerjes serioze.

Regjistrimet e pyjeve tregojnë nevojën urgjente për intervenim në menaxhim të pyjeve shumë të reja dhe të mesme, duke filluar nga pastrimi deri te rrallisja për tregti. Prandaj, është me rëndësi të veçantë në qoftë se pyjet do të menaxhohen në potencialin e tyre më të lartë ekonomik dhe mjedisor.

Duke pasur parasysh nevojat shoqërore - ekonomike, mjedisore, kulturore dhe shpirtërore, synimi kryesorë i kriterëve dhe treguesve është të nxiten me kohë praktikatat e menaxhimit të përmirësuar të pyjeve dhe zhvillohet më tutje prona më e shëndoshë dhe më produktive, duke pasur parasysh nevojat shoqërore-ekonomike, mjedisore, kulturore dhe shpirtërore.



Harta 14 Zonat sipas klasave të përshtatshmërisë së tokave bujqësore



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.6.9. Pasuritë nëntokësore


Komuna e Ferizajt është mjaft e pasur me pasuri natyrore. Në të njëjtin kompleks hasim edhe në llojlojshmërinë e shkëmbinjve dhe mineraleve të pastuduara sa duhet. Ndërkaq, zonat e rrafshëta janë të mbuluara nga depozitimet e neogjenit dhe nëpër këto shtresa hasim në minerale të dobishme, siç janë: rëra e kuarcit afër Mirosalës, rëra argjilore te fusha e aeroportit bujqësor, mineralet e plumb-zinkut te fshati Mirash, uji mineral afër fshatit Gaçkë dhe shtresa të linjtit që ndodhen në gjithë hapësirën e depozitimeve neogjene, si dhe naftën e supozuar në thellësi 1600 m. Në lindje të komunës së Ferizajt supozohen rezervat e argjilës.

Afër fshatit Zllatar ekziston masa e leuciteve (mineral fosfor) si material për prodhimin e plehrave artificiale.

Lloji i pasurive nëntokësore	Sipërfaqja (ha)
Kuarc dhe quartzite	215.63
Argjila	2016.22
Zhavorr dhe rërë	70.52
Shkëmbgëlqeror	104.41
Shkëmb i mermerizuar	247.56
Shkëmb kaolin dhe kaolin argjillore	56.73
Depozitat e linjtit	657.63

Tabela 70 Sipërfaqet në hektarë të pasurive nëntokësore


Komuna është e pasur me pasuri nëntokësore dhe me një strategji të mirëfilltë të eksploatimit këtyre pasurive mund të arrihet një rimëkëmbje e zhvillimit ekonomik dhe gjenerimit të vendeve të reja të punës.



Grafika 30 Diagrami i sipërfaqeve në hektarë i pasurive nëntokësore

Kuarc dhe Kuarcite	Shkëmb argjilor	Zhavorr dhe rërë	Shkëmb gëlqeror	Shkëmb i mermerizuar	Depozitat e linjtit
Koshare	Babushi	Muhoc	Greme	Jezerc	Babush
Slivova	Bablak	Talinoc i Muhaxh.			Cërnillë
Dremjak	Prelez i Muhaxh.				Mirash
Kosinë	Prelez i Jerlive				
Loshkobare	Surqinë				
Ferizaj	Papaz				
	Sazli				
	Rahavicë				
	Mirosalë				
	Bibaj				

Tabela 71 Pasqyra e burimeve natyrore sipas lokacionit



Legjenda/Legend

- Kufiri komunal
- Kufiri kadastral

Vendndodhja e mineraleve

- q
- mw
- w
- Guroret
- Lumenjet
- Prronjet

Depozitimet e mineraleve

- Quartz dhe quartzite
- Shkëmb argjilor
- Shkëmb dunitë
- Zhavorë dhe rër
- Shkëmb kaolin dhe kaoline argjillore
- Shkëmb gëlqerorë
- Shkëmb mermerizuar
- Depozitat e linjtit

PUNËDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizaj
Ferizaj Municipality
Lipjan, 70.000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJ
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJ

MOIP - PZHK

Rev.	DATE	PERSHKRIMI - DESCRIPTION	Krijuesi - Author	Kontrolluesi - Checked	Ndërkohë - Date	Aktuar - Approved	Niveli - Stage
A	2018	Hartim i pare - First Issue					



Projezioni Global: Transversa Mercator
Sistemi Gjegjeqsk: Koordinata: GCS-ETRS 1989
Sistemi Koordinativ Nacional: Kosova/RSB1
Mendimi Filester: Gjuvise
Niveli: Kujdesore

Formati:
Format: A0

Për pjesë:
Scale: 1/25,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE

Resurset minerale
Mineral resources

Vizimi Nr:
Drawing No:

I N O

Harta 15 Pasuritë nëntokësore

2.7. Infrastruktura teknike

2.7.1. Ujësjiellësi

2.7.1.1. Burimet e furnizimit

Qyteti i Ferizajt furnizohet me ujë nga katër burime, uji merret nga katër lumenj me rrjedhje direkte pastaj që të katër kaptimet e ujit shkojnë në fabrikën për trajtimin e ujërave në Pleshinë dhe nga aty përmes rezervuarit V=5000 m³ furnizohet pjesa Urbane dhe fshatrat Nikadin, Doganaj, Dubravë, Pleshinë e Poshtme, Zaskok, Talinoc i Jerlive dhe Blenisht.

Kapaciteti i Burimeve të ujit dhe sasi të e nxjerrjes apo kapjes sipas KRUK' Bifurkacioni' janë:

1. Lumi i Madh-Jezerc (80-100) l/s, apo (5480-6480) m³/ditë, me pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 33.73 km².
2. Lumi i Vogël-Neredime (45-70) l/s, apo (3888-6048) m³/ditë, me pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 14.09 km².
3. Përroi i Sylës-Pleshinë (20-45) l/s, apo (1728-3888) m³/ditë, me pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 7.87 km².
4. Përroi i Pukës-Pleshinë (10-25) l/s, apo (864 - 2160) m³/ditë, që ka pellg ujëmbledhës me sipërfaqe 3.11 km².

Të gjitha këto burime-apo kaptime të ujit trajtohen në fabrikën për pastrimin e ujërave të pijshëm në Pleshinë. Kapaciteti maksimali pastrimit të kësaj fabrike është 200-250 l/s.




Figura 1 Skema e sistemit të furnizimit me ujë për qytetin e Ferizajt

2.7.1.2. Fabrika për trajtimin e ujit

Burimi kryesor për furnizimin me ujë të pijshëm për qytetin e Ferizajt është fabrika për prodhimin e ujit në fshatin Pleshinë, e cila daton nga data 1965 me një kapacitet të vogël për prodhimin e ujit afërsisht 80 l/s që plotësonte nevojat minimale të asaj kohe, ndërsa në vitin 1988 është bërë një renovim i cili u vu në funksion, duke ju falënderuar qeverisë Zvicerane në vitin 2002-2003 ku fabrika për prodhimin e ujit pësojë një renovim rrënjësor me një vlerë investive 2,000,000 €. Në këtë investim pësoan ndryshime të mëdha ku Fundërruesi, Sistemi i Filtrimit, Sistemi i Dozimit të kemikaleve dhe laboratorit tani në çdo moment kontrollon ujin e trajtuar dhe të patrajtuar. Tani kjo fabrikë funksionon në mënyrë automatike dhe me këtë është rritë kualiteti i ujit, përparësi tjetër e FPU-it është se në kohë reale përcjellët procesi i përpunimit të ujit nga dhomat komanduese nëpërmes sistemit kompjuterik SCDA-s ku njëkohësisht bëhet edhe ruajtja e të dhënave në Data Bazë.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Foto 2 Lumi i madh kaptimi dhe fabrika në Pleshinë/FPU

2.7.1.3. Pjesa Urbane - Gjendja ekzistuese e furnizimit me ujë

Në kuadër të nevojës së analizës gjendjes ekzistuese të sistemit të furnizimit me ujë të Qytetit, pjesëve Urbane dhe rurale janë angazhuar ekupe profesionale për të analizuar dhe planifikuar këtë gjendje në mënyrë që në të ardhmen të kemi një sistem të qëndrueshëm të furnizimit me ujë të pijes. Aktualisht, KRUK ‘ Bifurkacioni’ Sh. A. e cila është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën e Ferizajt, e cila ofron shërbime për pjesën e qytetit dhe 7 fshatrave të cilat furnizohen nga burimet sipërfaqësore. Koha e furnizimit me ujë të pijshëm është 19 orë. Burimet e marrjes së ujit për qytetin dhe 7 fshatra janë ujërat sipërfaqësor (Lumi i Madh, Lumi i Vogël, Përroi i Sylës dhe Përroi i Pukës), ku uji merret nga katër lumenj me rrjedhje direkte pastaj që të katër kaptimet e ujit shkojnë në fabrikën për trajtimin e ujërave në Pleshinë dhe nga aty përmes rezervuarit $V=5000m^3$ furnizohet pjesa urbane dhe vendbanimet si: Talinoc i Jerlive, Nikadin, Doganaj, Dubravë, Pleshinë.

	Vendbanimet	Burimi dhe Kaciteti	Nr i Banorëve	Kyçje Shtëpiake në databazë
1	Doganaj	200 l/s (Pleshinë)	1100	144
2	Dubravë+ Blenisht	200 l/s (Pleshinë)	1472	265
3	Ferizaj	200 l/s (Pleshinë)	42628	10387
4	Nikadin	200 l/s (Pleshinë)	3718	753
5	Talinoc i Jerlive	200 l/s (Pleshinë)	3428	112
6	Pleshinë e Poshtme	200 l/s (Pleshinë)	4 506	220
7	Zaskok	200 l/s (Pleshinë)	1235	270

Tabela 72 Vendbanimet që furnizohen me ujë nga fabrika në Pleshinë

Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRUK “Bifurkacioni” i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardevë të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Fabrikë funksionon në mënyrë automatike dhe me këtë është rritë kualiteti i ujit, përparësi tjetër e FPU-it është se në kohë reale përcjellët procesi i përpunimit të ujit nga dhomat komanduese nëpërmes sistemit kompjuterik SCDA-s ku njëkohësisht bëhet edhe ruajtja e të dhënave në Data Bazë. Aktualisht fabrika në Pleshinë ka kapacitet prodhues prej 200-250 l/s.

Sipas raporteve nga KRUK “Bifurkacioni” pjesa urbane me 7 fshatrat arrin 95% të mbulueshmërisë së furnizimit me ujë të pijshëm.

2.7.1.4. Rrjeti Shpërndarës Ekzistues

Fabrika në Pleshinë furnizon me ujë zonën urbane dhe 7 fshatra përreth me:


- Numri i kyçjeve dhe lloji: 12500 Amvisëri duke përfshirë rreth 1400 konsumatorët komercial dhe institucional.
- Gjatësia e përgjithshme e rrjetit në pjesën urbane me furnizim me ujë të pijshëm është $L= 124,000.00 m'$;
- Materialet në sistemin e ujësjellësit (10%AC, 5% PVC, 5% Zn, 80 % HDPE);



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

- Numri i pompave dhe rezervuarëve (Pompa 0, Rezervuari Betoni 1 copë me V=5000m³).

Gjithashtu gjatë dekadës së fundit janë bërë zëvendësime të tubave të vjetra dhe thuhet diku rreth 74 km gjatësi ose 60 % janë zëvendësuar që nga viti 2000 e këndej ku pjesa më e madhe e zëvendësimeve është bërë gjatë vitit 2010-2013 dhe kryesisht zëvendësimet e bëra janë kryesisht me diametër të vegjël dhe të mesëm. Sistemi shpërndarës i furnizimit me ujë përfshin pjesë urbane:



Harta 16 Rrjeti shpërndarës i ujësjellësit në pjesën Urbane

Materialet e tubave nga vendburimet deri te fabrika në Pleshinë:

Vendburimi	Materiali	Diametri	Gjatësia
Përroi i Pukës FPU-Pleshinë	AC	DN 200mm	850m
Përroi i Sylës FPU-Pleshinë	AC	DN 200mm	1100m
Lumi i vogël FPU-Pleshinë	AC	DN 250mm	10000m
Lumii madh FPU-Pleshinë	HDPE	Ø 400mm	9500m

Tabela 73 Burimet e furnizimit me ujë dhe gjatësitë e tubave nga burimi deri te fabrika

Sipas gjendjes ekzistuese rezulton se në pjesën urbane mbulueshmëria e furnizimit me ujë sipas numrit të banorëve arrin 98 %.

Nr	Emri i Vendburimeve	X	Y	Z	Sasia e Burimit (l/s)
1	Lumi i Madhë	7,502,689.38908	4,691,979.30249	722	85
2	Lumi i Vogël	7,504,319.02116	4,690,169.91837	725	55
3	Përroi i Sylës	7,508,186.31325	4,688,588.40293	740	30
4	Përroi i Pukës	7,509,042.95957	4,688,505.12050	705	20
5	Përroi Neredime Epërme	7,503,029.27783	4,691,529.79241	821	

Tabela 74 Burimet sipërfaqësore Pjesa Urbane

2.7.1.4.1. Burimet e furnizimit për pjesën rurale

Burimet kryesore të furnizimit me ujë të fshatrave të Ferizajt janë burime nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të sistemit të pompimit thithës, këto puse ndodhen në zona të caktuara të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese dhe poshtu janë paraqitur edhe në hartën e burimet e ujit:

Nr	Emri i Vendburimeve	X	Y	Z	Sasia e Burimeve (Prurjeve)
1	Pusi 1 (Muhoc)	7,511,963.70569	4,694,986.73418	579	6.8
2	Pusi 1 (Dremjak)	7,507,503.27441	4,695,649.30699	579	10



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Nr	Emri i Vendburimeve	X	Y	Z	Sasia e Burimeve (Prurjeve)
3	Pusi 3 (Mirashë)	7,515,695.86470	4,700,602.10657	560	6.8
4	Pusi 1 (Mirshë)	7,515,510.86615	4,700,706.75317	560	Ska pomp
5	Pusi 2 (Mirashë)	7,515,543.95225	4,700,845.71478	560	3.5
6	Pusi 1 (Bablak)	7,512,331.76488	4,700,699.56876	551	5
7	Pusi 1 (Cërnillë)	7,515,285.21897	4,701,092.06440	558	10
8	Pusi 1 (Mirasalë)	7,519,474.62785	4,696,750.74308	614	1.5
9	Pusi 2 (Mirasalë)	7,519,690.58553	4,696,839.17749	623	3.5
10	Pusi 2 (Gurëz)	7,516,096.98636	4,686,489.05462	531	6.8
11	Pusi 1 (Gurëz)	7,516,212.12598	4,686,375.80564	532	6.8
12	Pusi 1 (Varosh)	7,513,505.02152	4,689,069.67566	553	10
13	Pusi 2 (Varosh)	7,513,486.11518	4,689,029.40515	553	10
14	Pusi 1 (Kosinë)	7,510,649.26595	4,697,443.60140	551	6.8
15	Pusi 1 (Talinoci Muhaxherëve)	7,513,576.48749	4,695,187.12958	569	6.5-ska
16	Pusi 2 (Talinoci Muhaxherëve)	7,514,105.29785	4,695,408.90096	569	6.8
17	Pusi 1 (Softaj)	7,516,508.34108	4,697,174.09150	565	11
18	Pusi 1 (Greme)	7,513,000.97846	4,688,536.25688	556	
19	Pusi (Surqinë)	7,514,562.52408	4,700,809.21372	558	6.8

Tabela 75 Burimet nëntokësore

2.7.1.5. Rrjeti shpërndarës ekzistues

Vendbanimet (fshatrat) që furnizohen me ujë në Komunën e Ferizajt janë paraqitur në formë tabelore duke përfshirë edhe kapacitetin e burimeve, numrin e kyçjeve shtëpiake, gjatësinë e tubave etj.

Nr	Vendbanimet	Burimi dhe Kapaciteti	Nr i Banorëve	Nr. i konsumatorëve	Gjatësia (m)
1	Cërnillë	8 l/s (Cernillë)	957	159	7,967
2	Gurëz (Gurëz)	15 l/s (Gurëzë)	323	57	5,921
3	Komogllavë	15 l/s (Gurëzë)	4404	542	14,139
4	Koshare	32 l/s (Kosinë/Mohoc)	2077	253	
5	Kosinë	32 l/s (Kosinë/Mohoc)	1082	130	
6	Lloshkobare	32 l/s (Kosinë/Mohoc)	2075	265	
7	Mirashë	12 l/s (Mirashë)	1883	254	6,979
8	Mirosalë	7 l/s (Rahavicë)	1427	218	11,516
9	Muhoc	32 l/s (Kosinë/Mohoc)	686	98	
10	Rahavicë	7l/s (Rahavicë)	1257	180	17,400
11	Slivovë	32 l/s (Kosinë/Mohoc)	1490	169	
12	Talinoc i Muh.	10 l/s (Talinoci Muh.)	1961	180	6,436
13	Tërn	32 l/s (Kosinë)	1138	178	
14	Varosh	30 l/s (Varosh)	2483	472	14,572
15	Softaj	10-12l/s	496	129	7,254
16	Pojatë	10-12l/s	1 047	212	6,956
17	Papaz	10-12l/s	516	101	6,958
18	Sazli	10-12l/s	782	200	6,9985
19	Dremjak		1 235	270	
20	Bablak	5 l/s (Pa rezervuar, me pompim)	258	124	

Tabela 76 Vendbanimet të cilat kanë sistem të furnizimit dhe menaxhohen nga KURK Bifurkacioni

Vendbanimet që kanë sistem të furnizimit, por që menaxhohen nga vetë banorët, janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Nr	Vendbanimet	Burimi dhe Kapaciteti	Nr i Banorëve	Nr i shtëpive	Gjatësia (m)
1	Balaj	15-20 l/s (klorifikues)	992	256	
2	Manastircë	2.5 l/s	1 346	265	
3	Gaçkë	Me Gravitcion	2 368	484	1,712



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

4	Surqinë	8 l/s	222	43	5,363
5	Babush		235	140	2,892
6	Neredime e Epërme	15-20 l/s (klorifikues)	1 648	303	
7	Neredime ePoshtme	15-20 l/s(klorifikues)	1337	320	
Totali:			8148 banorë	1811 shtëpi	

Tabela 77 Vendbanimet që kanë sistem të furnizimit, por që menaxhohen nga vetë banorët

Vendbanimet që janë në proces të instalimit të rrjetit të ujësjellësit janë të paraqitura në tabelën vijuese:

Nr	Vendbanimet	Burimi dhe Kpaciteti	Nr i Banorëve	Nr i shtëpive	Gjatësia (m)
1	Prelez i Muhaxher.		982	215	15,558
2	Bibaj		1180	270	
3	Fshati i Vjetër		992	257	285
4	Greme		4421	1241	19,246
5	Rakaj		976	228	17,718
6	Prelez i Jerlive		1510	24	9,774
Totali:			10061 banorë	2235 shtëpi	

Tabela 78 Vendbanimet në proces të instalimit të rrjetit të ujësjellësit

Vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

Nr	Vendbanimet	Burimi dhe Kapaciteti	Nr i Banorëve	Nr i shtëpive	Gjatësia (m)
1	Sojevë		1530	333	
2	Zllatar		1203	255	
3	Burrnik		46	228	
4	Jezerc		454	84	
5	Dardani (Tankosiq)		2096	499	
6	Pleshinë e Epërme				
Totali:			5329 banorë	1399 shtëpi	

Tabela 79 Vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit

Nga të gjitha të dhënat e paraqitur sipër, rezulton se nga 45 fshatra sa ka komuna e Ferizajt:

- 35 fshatra kanë Sistem të Ujësjellësit,
- 6 fshatra sistemin e kanë në ndërtim e sipër dhe brenda vitit 2016 pritet të përfundojnë dhe
- 6 fshatra nuk kanë ende sistem të ujësjellësit.


Numri i konsumatorëve, materialet ekzistuese të rrjetit, gjatësia e rrjetit dhe objektet përcjellëse janë:

- Numri i kyçjeve dhe lloji (3295 Amvisëri, 90 konsumator tjerë si: biznese të vogla, biznese të mëdha, Industri dhe Institucione etj.)
- Gjatësia e përgjithshme e rrjetit me furnizim me ujë të pijshme L= 180,000m' ose L=180,00km;
- Materialet në sistemin e ujësjellësit HDPE dhe RC-100 (HDPE 100%)
- Numri i pompave dhe rezervuarëve (Pompa0, Rezervuar Betoni10 copë me vëllime nga V=180-1000 m3).


Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon KRUK "Bifurkacioni " iplotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Metoda e pastrimit, trajtimit - përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorimit. Në raportet e hartuara dhe përshkrimet e gjendjes aktuale: Rrjetet e ujësjellësve të realizuara gjeri në vitin 2016 në fshatrat e Ferizajt arrin mbulueshmërinë e furnizimit me ujë të pijshëm 80 % të vendbanimeve.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 31 Mbulueshmëria e furnizimit me ujë



Legjenda/Legend

- Rrjeti _Ujësjetësit
- Kufiri komunal
- Mbuleshmëria me Ujësjetës**
- Vendbanimet të cilat nuk kanë sistem të ujësjetës
- Vendbanimet të cilat janë në proces të ndërtimit të sistem të ujësjetës
- Vendbanimet të cilat kanë sistem të ujësjetës
- Lumejt**
- Lumenjet
- Pronjet

PUNËDHËNËSI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizaj
Ferizaj Municipality
Lipjan, 70,000

PLANI ZHVILLIMORE KOMUNAL I FERIZAJ
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJ

REV.	DATE	PERSHKRIMET	DESRIPTION	Krijuesi	Kontrollo	Nënshkrim	Mirator	Nënshkrim
Rev.	DATE	PERSHKRIMET	DESRIPTION	Author	Checked	Visa	Approved	Visa
A	2016	Hartimi i parë	First Issue					



Projektori Global: Transversa Mercator
Sistemi Gjyegjeftik i Koordinatave: GCS ETRS 1989
Sistemi Koordinatë Nacional: Kosovë/SHK
Meridiani Përqendër: Greqësi
Projeksi: Kilmerna

Formati:
Format: A0

Përmasa:
Scale: 1/20,000

TITULLI I HARTES
MAP-TITLE

Infrastruktura e furnizimit me ujë
The infrastructure of water supply

Vizatimi Nr:
Drawing No:

I N 0

Harta 17 Rrjeti i ujësjetësit



2.7.2. Kanalizimi

2.7.2.1. Rrjeti ekzistues i ujërave të zeza, atmosferike dhe industriale

Ferizaj është qytet i rrethuar me shumë fshatra dhe thuajse i gjithë qyteti dhe fshatrat kanë të ndërtuar sistemin e kanalizimit ku shkarkimet e ujërave të zeza bëhen kryesisht në lumin Neredime dhe në disa përroska të afërta ku numri i pikave të shkarkimeve arrin në 22 pika shkarkimi dhe më këtë ndotin ujin e lumit Neredime.

Te gjitha kanalizimet e ndërtuara gjere me tani janë të ndërtuara si sisteme të përbashkëta ku:

- Ujërat atmosferike në pjesën urbane të qytetit shkarkohen në të njëjtin kolektor me ujerat e zeza ; dhe
- Ujërat Industriale shkarkohen pa trajtim paraprak në kolektorin e ujëra ve të zeza apo atmosferike.

Fshatrat e Ferizajt në bazë të topografisë së terrenit janë të shtrira në katër zonat vijuese:

- Zona Veri;
- Zona Jug;
- Zona Lindje; dhe
- Zona Komogllavë.

Në vitet e fundit, nga viti 2006 e tutje, komuna e Ferizajt ka pasur një program pothuajse të vazhdueshëm të instalimit të kanalizimeve në fshatrat rurale të Ferizajt. Tabela vijuese tregon shtrirjen e rrjetit ekzistues:

Lloji		Pjesa Urbane		Total
		Qendra e Qytetit	Pjesa e ree Lindjes	
Rrjeti	m'	70285	46700	116985
Pusetat	nr	2144	1305	3449

Tabela 80 Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve dhe numri i pusetave në pjesën urbane të Ferizajt

Lloji		Pjesa Rurale-Fshatrat				Total
		Jug	Veri	Lindje	Komogllavë	
Rrjeti	m'	138380	155423	62598	16514	372915
Pusetat	nr	3757	4301	1735	476	10269

Tabela 81 Gjatësia e rrjetit të kanalizimeve dhe numri i pusetave në pjesët rurale në tri zonat e Ferizajt

Aktualisht, KRUK Bifurkacioni operon dhe mirëmban sistemet e ujërave të zeza në **17** fshatra dhe është duke planifikuar për të marrë përsipër përgjegjësinë edhe për **24** fshatra në të ardhmen e afërt. Pasi të gjitha sistemet e kanalizimeve ekzistuese janë marrë përsipër KRUK Bifurkacioni do të jetë përgjegjës për **L=372 km** rrjet të kanalizimeve në zonat rurale plus 117 km në qytet, dhe duke e bërë një rrjet të përgjithshme prej **L=489 km**.

Gjeri më tani numri i fshatrave që kanë sistem të kanalizimit janë:

- 17 Fshatra, që menaxhohen nga KRUK Bifurkacioni;
- 24 Fshatra, që planifikohen të hyjnë në sistem të menaxhimit;
- 2 Fshatra, që nuk kanë sistem të kanalizimit.

2.7.2.2. Materialet e përdorura

Materialet e përdorura gjatë periudhave kanë evoluar dhe atë varësisht nga zhvillimi i teknologjisë ku në vazhdimësinë etapën e fundit në rrjetin e qytetit janë bërë zëvendësime të shumta të tubave.

Deri në dekadën e fundit janë përdorur tubat e betonit, qeramikës dhe PVC ku në 10 vjetshin e fundit janë zëvendësuar me materialet e PE SN së, dhe po ashtu janë rritur diametrat e tyre në pjesë të caktuar të sistemit si dhe janë rritur gjatësitë në pjesët e zgjeruara urbane.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Gjatësia e rrjetit në pjesën Urbane L=117000m' ose L=117.00 km gjatë të tubave.

Në tabelën vijuese janë paraqitur gjatësitë e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në pjesën urbane:

Diametri i tubave	Betonit	Qeramikë	PVC	PESN
160.00			1,530	15,800
200.00	1,900	1,530	13,640	4,000
250.00	3,000	1,850	6,840	12,500
300.00	6,600	4,000	4,700	7,500
400.00	7,300		3,600	2,200
500.00	1,900			3,200
600.00	5,600			1,000
800.00	1,960			
1,000.00	5,600			
1,200.00	498			
Totali (m)	32,114	7,387	30,502	46,168

Tabela 82 Gjatësitë e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në pjesën urbane

Vendbanimet që kanë rrjet të kanalizimit në zonën e Veriut, shkarkohen në 14 pikat vijuese:

Vendbanimi	Gjatësia(m)
1. Muhoc	
2. Pjesa Veriore Ferizaj zonaindustriale	
3. Talinoc i Muhaxherëve	11675
4. Talinoc i Jerlive	
5. Sazli	5909.33
6. Pojatë	32594
7. Softaj	4194.89
8. Papaz	56217
9. Rahavicë	23084
10. Cërnillë	14085
11. Babush	7949
12. Surqinë	23384
13. Mirash	68002
14. Bablakderi te ITU	
15. Prelez i Jerlive	64010
16. Prelez i Muhaxherëve	30582
17. Kosine	5169
18. Loshkobare	10171
19. Slivove	1947
20. Dremjak	9093
21. Koshare	13465
22. Tërn (Trim)	8690

Tabela 83 Gjatësitë e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në zonën veri

Vendbanimet që kanë rrjet të Kanalizimit në zonën e Jugut, shkarkohen me 8 pika vijuese:

Vendbanimi	Gjatësia(m)
23. Neredime e Epërme	12013
24. Neredime e Poshtme	8737
25. Balaj	8470
26. Manastirc	



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

27. Dubravë	
28. Pleshinë	7857
29. Doganaj	
30. Greme	33689
31. Varosh	16029
32. Gaçkë	3454
33. Rakaj	12402
34. Gurëz	19355
35. Bibaj	33523
36. Zaskok	
37. Nikadin	14781

Tabela 84 Gjatësitë e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në zonën jug

Vendbanimet që kanë rrjet të Kanalizimit në zonën e Lindjes shkarkohen vetëm në një pikë afër fshatit Dardani, janë të paraqitura në vijim:

Vendbanimi	Gjatësia(m)
1. Zllatar	6852
2. Dardani (Tankosiq)	13535
3. Sojevë	21474
4. Mirosalë	15873
5. Fshati i Vjetër	40414

Tabela 85 Gjatësitë e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në zonën lindore

Vendbanimi	Gjatësia(m)
Komogllavë	43078

Tabela 86 Gjatësia e tubave për çdo material që është në sistemin e kanalizimit në zonën lindore


Nga përshkrimi i gjendjes aktuale shpërndaja e rrjeteve të kanalizimeve deri në vitin 2016 arrin mbulueshmërideri në 98 % të banorëve.

Vendbanimet e vetme që nuk kanë qasje në rrjet të kanalizimit, janë vendbanimet vijuese, të zonës jugore:

- Burrnik; dhe
- Jezerc.

Rrjeti i kanalizimit nuk trajtohet nga impiantet, por në zonën veriore, ujërat e zeza të vendbanimeve vijuese derdhet në gropa septike:

1. Muhoc;
2. Talinoc i Jerlive;
3. Bablak, jashtë funksion;
4. Tërn.



Legjenda/Legend

- Pikat_e_shkarkimit_Uj_zez
- Rrjeti i Kanalizimit

Mblueshmëria me Sistem të Kanalizimit

- Jo
- Po

Kufiri komunal

Kufiri kadastral

PUNËDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizaj
Ferizaj Municipality
Lipjan, 70,000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJ
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJ

MUP - RZHK

Rev.	DATE	PËRSHKRIMI - DESCRIPTION	Ripunëtor / Author	Kontrollues / Checker	Përzotues / Approver	Miratues / Approved	Ndërkohë / Note
A	2016	Hartimi i parë - First Issue					



Projeksioni Global: Transverse Mercator
Sistemi Koordinativ Horizontal: OCS EPSG:31469
Sistemi Koordinativ Vertikal: Kosovo84
Mbrojtja: Fillova: Drenus
Mbrojtja: Kilometra

Formati:
Format: A0

Përpyesja:
Scale: 1/28,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE

Infrastruktura e kanalizimit
The infrastructure of canalization

Uzatimi Nr:
Sheet No: 02/03/17

I N O

Harta 18 Rrjeti i kanalizimit



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt


2.7.3. Infrastruktura e energjisë elektrike

Pozita e favorshme e Ferizajt në rrafshin e Fushë Kosovës, me të gjitha arteriet kryesore që kalojnë nëpërmes komunës, i ka siguruar furnizim relativisht të qëndrueshëm me energji elektrike. Problemi kryesor për komunën është gjendja jo e mirë e sistemit të furnizimit me energji elektrike.

Komuna e Ferizajt furnizohet me energji elektrike nga Trafo-stacioni TS Prishtina IV, 220/110 kV, fuqije 2x150 MVA, përmes largpërçuesit LP 110kV të shënuar si 118/5, Al-Çe 3x150mm², -30.23- deri te TS 110/35kV, Ferizaj, fuqije (20+31.5) MVA, përmes së cilit bëhet shpërndarja për furnizimin e trafostacioneve TS 35/10(20)kV dhe atë:

- TS 35/10kV të shënuar si Ferizaj II, fuqije (2x8)MVA;
- TS 35/10 (20)kV të shënuar si Ferizaj I, fuqije (2x8)MVA dhe
- TS 35/10kV të shënuar si Ferizaj III, fuqije (2x8)MVA;
- Nga zbarrat e TS 110kV Ferizaj e përmes LP 110kV, nr.118/3, Al-Çe 3x150mm² – 28,66 furnizohet TS 110/6 kV Sharr, dhe nga këto zbarra TS110kV Ferizaj, përmes LP179/2 Al-Çe 3x150mm² – 39,4 , furnizohet TS 110/35kV Theranda (2x31,5 MVA).

Kjo lidhje unazore i mundëson Komunës së Ferizajt furnizim me energji elektrike nga Rrafshi i Kosovës dhe Rrafshi i Dukagjinit. Ferizaj ka pozitë shumë të volitshme për shkak se përmes territorit të tij kalojnë largpërçuesit LP të nivelit 400, 220 dhe 110 kV.



Harta 19 Rrjeti i furnizimit me rrymë elektrike

2.7.4. Infrastruktura e telekomunikimit

Të gjitha pjesët e komunës nuk kanë qasje në telefoni, as në kablo nëntokësore dhe as përmes telefonisë mobile. Mbulimi me valë të telefonisë mobile është veçanërisht i dobët në disa zona të largëta malore. Prioritet duhet t'u jepet të gjithë banorëve që të kenë qasje edhe në telefoninë fikse, edhe në atë mobile. Pikërisht për këtë është e




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

nevojshme të ndërtohen antena të telefonisë mobile edhe në viset malore, ku qytetarët do të kenë qasje adekuate në këto shërbime telefonike.

Nr. i ndërtesave	Ekonomi familjare+Biznese	Nr. i banorëve	Nr. i fshatrave të pambuluara me TiK
25275	18318	108690	20

Tabela 87 Karakteristika e shtrirjes së rrjetit kablovik



Harta 20 Rrjeti i PTK-së

2.7.5. Infrastruktura e menaxhimit të mbeturinave

Ruajtja e mjedisit të qytetit nga mbeturinat është treguar si shumë efikase, përmes një sistemi funksional grumbullues të tyre. Kjo mënyrë efikase e mbrojtjes së ambientit nga ndotja duhet të aplikohet në tërë territorin e komunës. Kjo mënyrë e grumbullimit e organizuar të mbeturinave dhe e grumbullimit të tyre në deponitë përkatëse, do të ndikojë në ngritjen e vetëdijesimit të popullsisë në lidhje me rrezikun nga ndotja e hedhjes së mbeturinave dhe do ta përsosë kontrollin shoqërorë mbi to.

Momentalisht, mbeturinat janë grumbulluar dhe depozituar përkohësisht në deponinë transite afër fshatit Gërlicë. Nga aty mbeturinat janë transportuar në deponinë rajonale në Gjilan, ku mbeturinat ruhen pa asnjë trajtim të mëtutjeshëm. Në të ardhmen, kur të rregullohet menaxhimi i mbeturinave sipas rregulloreve të BE, mbeturinat do të digjen dhe vetëm hiri do të depozitohet. Vetëm disa deponi të tilla për djegien e mbeturinave do të jenë të nevojshme në tërë Kosovën dhe, me sa duket, ato do të ndërtohen në kombinim me deponitë rajonale të sotme. Prioriteti i parë për menaxhimin e mbeturinave është zgjerimi i sistemit të grumbullimit të mbeturinave në tërë komunën, si dhe të pastrohen pjesët e depozitimit ilegal të mbeturinave të deritashme.

Mbeturinat transportohen në deponinë transite ditore dhe pastaj përcillen në deponinë rajonale të Komunës së Gjilanit. Të gjitha deponitë janë të mbyllura por nuk janë trajtuar, prandaj ekziston rreziku i ndotjes së mjedisit. Ndotja e mjedisit bëhet edhe nga deponitë ilegale.

2.8. Infrastruktura e transportit dhe transporti



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

2.8.1. Infrastruktura e transportit dhe transporti

Ferizaj është i vendosur në udhëkryqin ndërmjet rrugëve të rëndësishme nacionale, rrugës M2 e cila lidhë qytetin e Mitrovicës dhe Shkupit, dhe rrugës M25-3 e cila lidhë qytetin e Prizrenit dhe Gjilanit. Pozicioni strategjik i qytetit të Ferizajt, me ndërlidhje të mira jo vetëm vendore por edhe ndërkombëtare të ndikuara nga vendndodhja edhe e hekurudhës, kanë ofruar mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik të shpejtë të komunës së Ferizajt.


2.8.2. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Sa i përket shtrirjes së rrugëve publike, Komuna qëndron shumë mirë, sepse nga 344 km² të territorit, 3.37 km² janë rrugë të asfaltuara, që përafërsisht 1% të territorit.

Përbrenda Komunës shtrihen rrugët publike me sipërfaqet vijuese:

Lloji i rrugës	Autoudha	Nacionale	Regjionale	Urbane	Rurale
Sipërfaqja (ha)	176.73	17.8	16.94	18.39	107.15
Përqindja (%)	52.44%	5.35%	5.09%	5.53%	32.22%

Tabela 88 Sipërfaqet sipas llojit të rrugëve



Grafika 32 Diagrami i sipërfaqeve në hektarë të rrugëve publike të asfaltuara sipas llojit

Gjersa sa përket raportit të rrugëve komunale të asfaltuara në mes të vendbanimeve rurale dhe urbane për kokë banori, kryesojnë vendbanimet rurale me 16.33 m² për kokë banori në krahasim ato urbane prej 4.31 m² për kokë banori.

	Rrugë rurale	Rrugë urbane
Sipërfaqja (m ²)	1,077,534	183,954
Numri i banorëve	65,982	42,628
m ² /kokë banori	16.33	4.32


Tabela 89 Raporti i rrugëve komunale të asfaltuara në mes të zonës rurale dhe urbane

Sasia e lartë e rrugëve të asfaltuara në vendbanime rurale, krahasuar me ato urbane, është si pasojë numrit të lartë të vendbanimeve rurale të shkapërderdhura dhe lineare, të cilat kërkojnë më shtrirje më të lartë të rrugëve publike.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt



Grafika 33 Diagrami i raportit në m², të rrugëve komunale të asfaltuara për kokë banori në mes të zonës rurale dhe urbane

2.8.3. Rrugët nacionale dhe rajonale

Qyteti i Ferizajt është i lidhur mirë me qytetet kryesore të Kosovës si dhe me pjesën veriore të Maqedonisë. Rrjeti rrugor kryesor përbëhet nga rrugët autoudhë, nacionale dhe rajonale. Autoudha “Arben Xhaferi”, e cila është në ndërtim e sipër do të ketë ndikim të jashtëzakonshëm për Komunën dhe banorët e fshatrave në pjesën lindore të Ferizajt. Rruga nacionale M2, e cila konsiderohet ndër rrugët më të rëndësishme, kalon nëpër pjesën lindore të qytetit të Ferizajt dhe mundëson lidhjen e qytetit të Ferizajt me Shkupin dhe kryeqendrën e Kosovës Prishtinën.



Rruga nacionale M2, e cila konsiderohet ndër rrugët më të rëndësishme, kalon nëpër pjesën lindore të qytetit të Ferizajt dhe mundëson lidhjen e qytetit të Ferizajt me Shkupin dhe kryeqendrën e Kosovës Prishtinën dhe Mitrovicën, duke vazhduar nëpërmjet Mitrovicës lidhjen edhe me Malin e Zi, Bosnjën dhe pjesët e Serbisë. Nga ana tjetër, Nëpër qytetin e Ferizajt kalon rruga nacionale M 25.3 e cila vjen nga qyteti i Gjilanit dhe kalon në pjesën qendrore të qytetit, respektivisht nëpër rrugën “Ahmet Kaçiku” dhe vazhdon nëpër Shtime në drejtim të Prizrenit. Ndërsa, dy rrugë rajonale (R 122 dhe R 206) e lidhin Ferizajn me qytetet dhe fshatrat tjera të Kosovës.

Harta 21 Shtrirja e rrugëve kryesore në Komunë


2.8.4. Rrugët brenda zonës urbane

Rrugët në qytetin e Ferizajt, kryesisht janë dy shiritore (me nga një shirit qarkullues për kahe), përveç një pjese të rrugës “Brim Ademi” e cila ka nga dy shirita qarkullues për kahe dhe rruga “Rexhep Bislimi” e cila është pjesë e rrugës nacionale M 25.3. Rrjeti ekzistues rrugor në qytetin e Ferizajt është i përbërë nga rrugë me karakter të ndryshëm. Rrugët kryesore radiale me karakter urban (“V. Gërvalla”, “Enver Topalli” dhe “Ismet Ramadani”) janë rrugë me karakter dhe elemente gjeometrike më të mira për të përballuar fluksin e qarkullimit të automjeteve.

Ndërsa, disa rrugë radiale të kategorisë së tretë lidhin qytetin e Ferizajt me zonat rurale të komunës, në malet në Përëndim dhe malet në lindje. Rruga e asfaltuar rishtas për në Greme mundëson lidhjen me rrugën kryesore për në Brod, Brezovicë dhe qafën e Prevallës. Megjithatë, zakonisht, shumica e rrugëve të rëndësishme me të lartë dhe më të ulët, drejtpërdrejt, lidhen me Nacionalen.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Harta 22 Harta e rrjetit rrugor për Komunën e Ferizajt

Rrugët, në kuadër të komunës, për nga kualiteti janë përgjithësisht duke filluar nga një gjendje e keqe në atë të pranueshme. Rrugët lokale të cilat lidhin lokacione të ndryshme brenda qytetit të Ferizajt kanë karakter të ndryshëm.

Rrugët e kategorisë më të lartë janë plotësuar nga rrugë lidhëse të kategorisë më të ulët. Shumica e rrugëve lokale nuk kanë gjerësinë e mjaftueshme dhe elementet gjeometrike të tyre nuk ofrojnë kushte të mira për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, sidomos mungesa e trotuareve dhe shtigjeve për çiklist shkakton vështirësi për këmbësorë dhe çiklist.


Nr.	Emri i rrugës	Gjatësia (m`)	Sipërfaqja (m ²)
1	Dëshmorët e Kombit	3000	21000
2	Rexhep Bislimi	1230	9470
3	Reçakut	2600	18720
4	Epopeja e Jezercit	2500	12500
5	Pleshinës	1200	4800
6	H.Sylejmani	376	1692
7	Gjergj Kastrioti	365	1585
8	Astrit Bytyçi	643	5039
9	Lidhja e Prizrenit	1330	7007
10	Hasan Prishtina	1150	5700
11	Njazi Bajraktari	439	2392
12	Lubotenit	680	2720
13	Janinës	306	1224
14	M. Shemsedini	308	2163
15	E.Topalli	670	3685
16	K.Hetemi	272	1496



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Nr.	Emri i rrugës	Gjatësia (m`)	Sipërfaqja (m ²)
17	Beteja e Kaçanikut	210	735
18	M. Bakija	540	3240
19	Tiranës	430	1720
20	Bislim Rexhepi	500	2500
21	Kerçovës	163	685
22	Shën Jeronimi	290	1450
23	E.Duraku	442	2973
24	Dukagjinit	516	2064
25	Isa Boletini	583	2332
26	Shkumbinit	199	826
27	G. Tërbeshi	1229	5970
28	M. Shemsedini	637	2548
29	Dardania	410	2225
30	Riza Matoshi	1605	6670
31	Sh. Polluzha	398	1950
32	Migjenit	200	800
33	A. Kaqiku	1175	10857
34	V. Gërvalla	1280	11520
	Totali	27876	33926

Tabela 90 Gjatësia dhe sipërfaqja e rrugëve në Komunën e Ferizajt




Harta 23 Harta e rrjetit rrugor të zonës urbane

2.8.5. Rrugët e planifikuara nga niveli qendror

Autostrada “Prishtinë -Shkup” e cila është në ndërtim e sipër, në territorin e Komunës së Ferizajt i ka tri kyçe. Dy në rrugën nacionale M2 (Babush i Muhaxherëve dhe në vendin e quajtur “Fusha e Pajtimit”) dhe kyçja tjetër është në kryqëzimin e rrugëve nacionale M2 dhe M25.3, respektivisht në fshatin Bibaj. Kyçja në anën jugore, është bërë për të shërbyer për lidhjet me rrugët regionale në komunën e Vitisë dhe me rrugët e Brezovicës/Tetovës. Kyçja në veri duhet të shërbejë gjithashtu si një lidhje e re dhe shpejt në mes të autostradës Prishtinë - Shkup me autostradën Prishtinë – Prizren.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Harta 24 Autoudha "Arbër Xhaferi" e cila kalon nëpër territorin e Komunës së Ferizajt



Harta 25 Lokacioni i qasjeve në autoudhën "Arben Xhaferi"

Për ta evituar ngarkesën e qarkullimit të automjeteve në zonën qendër të qytetit, me PZHU është paraparë përmirësimi i standardit të rrugës që e lidh rrugën M2 dhe M25-3 dhe të rritet kapaciteti i udhëkryqeve. Kapaciteti ekzistues i rrugës M2 në pjesën lindore të qyteti, si dhe mundësia e zgjerimit të tij janë të kufizuara për shkak të zhvillimeve komerciale përgjatë rrugës. Rritja e vullshme e shkallës së motorizimit në përgjithësi, e në veçanti transportit komercial i cili zhvillohet midis Maqedonisë dhe pjesës qendrore, përqendrore dhe veriore të Kosovës, ka ndikuar që ngarkesa e rrugës nacionale M2 të jetë shumë e madhe.

Për shkak të fluksit të madh të automjeteve dhe strukturës së qarkullimit, kapaciteti është gjithnjë në rënie dhe niveli i shërbimit nuk i plotëson kërkesat e qarkullimit.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Nga niveli qendror, Ministria e infrastrukturës ka filluar realizimin projektit në një segment rrugor në pjesën veriperëndimore, i cili mund të inkorporohet në planifikimin e unazës së jashtme.

2.8.6. Unaza/ qarkorja e jashtme

Duke marrë parasysh rritjen e vullshme të shkallës së motorizimit, infrastrukturën rrugore jo funksionale, sigurinë e pamjaftueshme për lëvizje aktive (këmbësorët dhe çiklistët) dhe kushtet ambientale, atëherë shkarkimi i qendrës së qytetit nga numri i madh i automjeteve nuk mund të kuptohet vetëm si një objektiv i thjeshtë, por si prioritet. Me qëllim që pjesa e qendrës së qytetit të planifikohet në atë mënyrë që prioritet të i jepet lëvizjeve aktive dhe transportit kolektiv, është e nevojshme devijimi i fluksit të qarkullimit të automjeteve të cilat nga pjesët periferike të qytetit kanë për qëllim trafikun transit.

Qarkorja e brendshme do të ketë për qëllim, që trafiku transit të mos kalojë nëpër qendër të qytetit. Kjo do të mundësohet me përmirësimin e elementeve gjeometrike të rrugëve ekzistuese nëpër të cilat mund të kalojë qarkorja e brendshme dhe krijimin e rrugëve të reja. Gjerësia e rrugës duhet të përmbushë kërkesën e fluksit të qarkullimit dhe të ofrojë kapacitet të mjaftueshëm dhe nivel të mirë të shërbimit. Për këtë arsye, përpos zgjerimit të rrugës, është e nevojshme rregullimi i udhëkryqeve në mënyrë që të rritet kapaciteti i tyre në degët hyrëse dhe të zvogëlohen pikat konfliktuozë për rritjen e sigurisë së lëvizjes. Në pjesën e rrugës nacionale M2, një pjesë e së çiles do të jetë pjesë e qarkores së brendshme, është e nevojshme të bëhet ri-projektimi i udhëkryqeve ekzistuese.

Udhëkryqi në kryqëzimin e rrugës “Reçaku” me rrugën nacionale “M2” ka nevojë për rregullim. Bazuar në karakterin e rrugëve të cilat kryqëzohen mes vete (rruga qarkore me nga dy shirita për kahe dhe rruga nacionale, gjithashtu me nga dy shirita për kahe) bëhet fjalë për një qarkullim përafërsisht të balancuar në hyrje, dhe me këtë rast rrethrotullimi do të ishte opsioni më i pranuar për rregullimin e qarkullimit dhe zvogëlimin e pikave konfliktuozë. Rrethrotullimi në kryqëzimin e rrugës “Vëllezërit Gërvalla” me rrugën nacionale “M2” ka nevojë për ri-projektim. Gjendja ekzistuese e rrethrotullimit (vetëm me një shirit në sipërfaqen qarkulluese të rrethrotullimit), nuk ofron kapacitet të mjaftueshëm për karakterin e rrugës dhe fluksin e qarkullimit. Prandaj, duhet të ketë elemente gjeometrike të përmirësuar në përshtatje me gjerësinë e planifikuar të rrugës nacionale. Në kryqëzimin e rrugëve nacionale M2 dhe M25.3 (Shkup-Prishtinë dhe Gjilan-Ferizaj) për momentin është e vendosur nyjellorja (udhëkryqi në disnivel) i formës “gjysmë tërfojë”.


Për përmbushjen e kërkesave të fluksit të qarkullimit dhe eliminimin e pikave konfliktuozë, kompletimi i këtij udhëkryqi nga forma ekzistuese (“gjysmë tërfojë”) në modelin e “tërfojes” do të ishte një zgjidhje e përshtatshme. Pas analizës së karakterit të rrugëve është vlerësuar se, “TËRFOJA” është zgjidhja më e thjeshtë e udhëkryqit në disnivel me program të plotë të shpërndarjes hapësinore. Rekomandohet për përdorim për nivelin funksional të shërbimit “B”-“A”²⁶. Skema simetrike funksionale përmban tetë rampa lidhëse: katër direkte për kthim djathtas dhe katër indirekte për kthim majtas. Kryqëzimi i formës “TËRFOJA” paraqet zgjidhjet e kapacitetit me regjim të kufizuar të shpejtësisë. Përdoret te kryqëzimi i rrugëve të rangut të lartë të komunikacionit. Pikat tjera kyçëse në qarkoren e brendshme duhet të jenë në përshtatje me projektin e hekurudhës, duke zbatuar kriteret e sigurisë që mundësisht të shmangen kalimet në të njëjtin nivel me hekurudhën. Nëse, një gjë e tillë nuk është e mundur, atëherë të respektohen kriteret e sigurisë në pjesët e rrugës ku bëhet kalimi në të njëjtin nivel. Bazuar në kategorinë dhe gjerësinë e shiritave, në pjesën veriore dhe lindore (Rruga nacionale M2 dhe rruga e “Reçakut”) ofrojnë kapacitet të mjaftueshëm për qarkullimin transit. Kjo do të mundësohet edhe me realizimin e projektit të autostradës, sepse rruga nacionale M2 do të shkarkohet nga qarkullimi transit dhe për nga funksioni do të jetë më tepër një pjesë e rrugës urbane. Gjithashtu edhe një pjesë e rrugës “Rexhep Bislimi” në pjesën jugore është zgjeruar

²⁶Sipas HCM-së (Highway Capacity Manual), Nivelet e Shërbimit ndahen nga Niveli A (niveli më i mirë i shërbimit) –F (Niveli më i dobët i shërbimit).



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

me nga dy shirita qarkullues për kahe, duke mundësuar kapacitet të mjaftueshëm për këtë pjesë të qarkores së brendshme.




Harta 26 Qarkorja e brendshme

2.8.7. Unaza/ qarkorja e brendshme

Duke pasur parasysh se në pjesën jug-përëndimore dhe në veçanti në pjesën përëndimore të qytetit ngarkesa e trafikut është më e vogël, atëherë orientimi i trafikut në këto pjesë do të jetë një opsion i përshtatshëm për të devijuar trafikun transit. Devijimi i fluksit të trafikut nga qendra e qytetit të Ferizajt, mundësohet me realizimin e qarkores së jashtme e cila do të mundësojë devijimin e trafikut transit regional dhe ndërkombëtar prej Shkupit, Gjilanit, Prishtinës dhe Prizrenit.

Ministria e infrastrukturës ka filluar realizimin projektit në një segment rrugor në pjesën veripërëndimore, i cili mund të inkorporohet në planifikimin e unazës së jashtme. Duke pasur parasysh kalimin në të njëjtin nivel me hekurudhën dhe kushtet e sigurisë, ky projekt kushtëzon vazhdimësinë e unazës së jashtme duke ndjekur të njëjtin trase të rrugës.



Harta 27 Qarkorja e brendshme dhe e jashtme



2.8.8. Kryqëzimet dhe korsitë kryesore

Rregullimi i qarkullimit në qytetin e Ferizajt është i organizuar me tipe të ndryshme të udhëkryqeve (Fig.3). Tipet e udhëkryqeve në rrjetin rrugor janë:

- Një udhëkryq me sinjalizim ndriçues-semafor, që punon me kohë fikse;
- Gjashtë rrethrotullime (6 rrethrotullime); dhe
- Një udhëkryq në disnivel (nyjellore) e tipit “gjysmë tërfojë”.
- Ndërsa, udhëkryqet tjera janë të rregulluara me rregulla të përgjithshme të qarkullimit dhe

Rrethrotullimet në qytetin e Ferizajt dallojnë nga tipet dhe veçoritë e tyre. Nga numri i përgjithshëm i rrethrotullimeve, dy prej tyre janë me nga dy shirita urban, dy janë vetëm me nga shirit urban, ndërsa dy prej tyre nuk kanë ishull qendror të deniveluar dhe mund të kategorizohen si “mini rrethrotullime”.



Udhëkryqi në disnivel (nyjellorja) në kryqëzimin e rrugëve “Prishtinë – Shkup” dhe Ferizaj – Gjilan është e tipit “gjysmëtërfojë”. Ky lloj i udhëkryqit në disnivel është formë e udhëkryqit në disnivel funksionon me gjysmëprogram të shpërndarjes hapësinore. Lidhjet kyçëse realizohen me nga dy rampa direkte dhe dy indirekte të cilat për drejtimin dytësorë lidhen me ndihmën e dy udhëkryqeve sipërfaqësore trekrahëshe. Numri i niveleve është dy. Pozicioni i rampave (mbushëse dhe zbrazëse) është i caktuar nga kushtet e terrenit. Me ndërtimin e elementeve përkatëse, kjo zgjidhje mund të avancohet deri te programi i plotë i udhëkryqit në disnivel.

Harta 28 Tipet e udhëkryqeve në rrjetin rrugor

Në rrugët kryesore, në hyrje të udhëkryqeve, përdoren shiritat e përbashkët për lëvizje drejt dhe majtas. Pra, nuk ekzistojnë shiritat e posaçëm për kthime majtas. Duke pasur parasysh se lëvizjet majtas janë në konflikt me të gjitha drejtimet e lëvizjes, në hyrje të udhëkryqeve, përpos zvogëlimit të kapacitetit ulet edhe shkalla e sigurisë në trafik.

2.8.9. Modelet e qarkullimit të trafikut

Përpos qarkullimit rrugor, në komunën e Ferizajt zhvillohet edhe trafiku hekurudhor. Ferizaj ndodhet në linjën ndërkombëtare “Akropolis” që dikur kishte qarkullim të përditshëm nga Munih (Gjermani) në Athinë (Greqi) (shkuarja Ferizaj 07:35)²⁷. Hekurudha është akoma e një rëndësie të veçantë për Kosovën, sidomos për eksportin e xehes (Ferro-Nikel) dhe importin e karburanteve, mallrave të ndryshëm. Megjithatë, është një infrastrukture e dobët dhe jo efikase, duke pasur parasysh se në të nuk është investuar ndjeshëm kurrë, që nga ndërtimi i saj. Kjo është një hekurudhë me një linjë dhe e pa elektrifikuar, kufizuar nga peshat për transport dhe, në veçanti e kufizuar në mbulimin në lidhje me transportin e pasagjereve, në shpejtësi etj.

²⁷ Dokument planifikimi-Transporti dhe Mobiliteti, Ferizaj 2011



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Sot, hekurudha nuk ju mundëson transport një numri të madh të pasagjereve në Ferizaj, për shkak të ofertës së kufizuar të trenave, dhe sasisë shumë të ulet të mallrave, rënies së industrisë lokale dhe riorganizimit të logjistikës së mallrave, bazuar në terminale të veçanta për karburantet dhe konteneirëve. Nuk ka të dhëna lidhur me ngarkesën e rrjetit rrugor dhe jolinearitetin e qarkullimit në qytetin e Ferizajt. Gjithashtu mungojnë të dhënat lidhur me strukturën e qarkullimit, respektivisht lidhur me lëvizjet aktive (praninë e këmbësorëve dhe çiklistëve në strukturën e përgjithshme të qarkullimit).

2.8.10. Linjat transportuese ndërkomunale, urbane dhe rurale

2.8.10.1. Transporti publik rajonal

Stacioni i Ferizajt është qendër e rrjetit të transportit publik, i cili ofron me shumë së 100 nisje/ditë (orari i udhëtimeve i vitit 2009). Linjat direkt të udhëtimit lidhin Ferizajn me qendrat(stacionet) të tjera në Prishtinë dhe Gjilan. Gjithashtu janë linjat që lidhin me qytetet fqinje të Kaçanikut, Vitisë dhe kryesisht në Shtime.²⁸

Rrjeti rajonal i transportit publik që lidhë qytetin e Ferizajt me qytetet e mëdha ose lidhin me linjat tjera rajonale është dhënë në tabelën vijuese:

Nr.	Udhëtimet nga Ferizaj	Shkuarjet në ditë
1	Prishtinë	49
2	Klllokot-Gjilan	30
3	Klllokot-Viti	6
4	Gurëz-Viti	20
5	Shtime	33
6	Shtime-Lypjan	13
7	Shtime-Rashticë	4
8	Shtime-Prizren	3
9	Shtime-Godanc	3
10	Shtime-Mollopolc	3
11	Shtime-Zotaj	3
12	Shtime-Janjevë	2
13	Zotaj	8
14	Gadime	8
15	Kaçanik	12
16	Kaçanik-Hani i Elezit	14
17	Sllatinë	5

Tabela 91 Udhëtimet me autobusë nga Ferizaj drejtë Komunave tjera

2.8.10.2. Transporti publik komunal

Shërbimet e rregullta të transportit publik brenda territorit të komunës janë të organizuara nga vetë komuna. Transporti publik brenda territorit të Komunës është dhënë në tabelën vijuese:

Nr.	Relacionet Zona Urbane-Rurale Ferizaj (Vijat e transportit publik komunal)
1	Ferizaj-Gurëz
2	Ferizaj-Rahavicë
3	Ferizaj-Mirash
4	Ferizaj-Zllatar
5	Ferizaj-Mirosalë
6	Ferizaj-Komogllavë
7	Ferizaj-Kosin
8	Ferizaj – Rakaj

²⁸Komuna e Ferizajt, Dokument planifikimi-Transporti dhe Mobiliteti, Ferizaj 2011




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Nr.	Relacionet Zona Urbane-Rurale Ferizaj (Vijat e transportit publik komunal)
9	Ferizaj-Terrn
10	Ferizaj-Pleshinë
11	Ferizaj-Dmnjak
12	Ferizaj-Cernillë
13	Ferizaj-Surqinë
14	Ferizaj-Topojan
15	Ferizaj-Neredime
16	Ferizaj-Jezerc
17	Ferizaj-Pojatë
18	Ferizaj-Papaz

Tabela 92 Udhëtimet me autobusë nga Ferizaji drejtë Komunave tjera



Harta 29 Transporti publik komunal

2.8.10.3. Transporti publik urban

Pozicioni strategjik i qytetit të Ferizajt, me ndërlidhje të mira jo vetëm vendore por edhe ndërkombëtare të ndikuara nga vendndodhja edhe e hekurudhës, kanë ofruar mundësi të mëdha për zhvillim ekonomik të shpejtë të komunës së Ferizajt. Lidhur me këtë, komuna e Ferizajt, duhet të ketë parasysh krijimin e një stacioni të ri të autobusëve i cili do të shërbejë si një ndërlidhëse jo vetëm për qytetin e Ferizajt por edhe për rajone tjera.

Stacioni i ri i autobusëve është mëse i nevojshëm për Ferizajn edhe për ndarjen e flukseve të ndryshme të transportit. Me qëllim që të krijohet një ndërlidhje funksionale ndërmjet stacionit të propozuar të autobusëve dhe stacionit të hekurudhës në qendër, është e nevojshme të krijohen linja të autobusëve urban të cilat lidhin këto dy stacione duke krijuar atraktivitetin e zonës dhe përmbushjen e kërkesave për lëvizje. Gjatë analizës së transportit urban në qytetin e Ferizajt, janë marrë në konsideratë parametrat bazë për planifikimin e linjave urbane, si: mbulueshmëria, udhëtimi direkt- shtrirja direkte e linjave, ndërlidhja funksionale me linjat tjera, shpejtësia e lëvizjes, koha e qarkut dhe intervali i përcjelljes.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Udhëtimi direkt ndërlidhet me shtrirjen gjatësore të linjave, me qëllim që linjat të mos kenë përthyerje të panevojshme dhe të zgjatet koha e udhëtimit. Sistemi radial i linjave urbane i përgjigjet qytetit të Ferizajt, që përpos mundësisë për linja direkte, këto linja shtrihen në rrugë me karakter më të lartë - me elemente gjeometrike adekuate për transport urban

Pas analizës së këtyre parametrave është vlerësuar se, për një rrjet funksional të transportit urban, për qytetin e Ferizajt janë paraparë 3 linja. Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për transport urban, për qytetin e Ferizajt janë paraparë linjat si në vijim:

- Linja Nr. 1 “ Talinoc i Jerlive- Stacioni i autobusëve – Stacioni i trenit – Nikadin”,
- Linja Nr. 2 “Lagja Sherret – Spitali i qytetit- Bibaj” dhe
- Linja Nr. 3 “Xhamia në Sallahane – Qendër - Talinoc i Muhaxherëve”.



Harta 30 Harta e linjave të qarkullimit të transportit urban

2.8.11. Hapësirat ekzistuese për parkim

Mungesa e vendeve të parkimit veçanërisht është e theksuar në qendrat e qyteteve, kjo ndodhë edhe për shkak të koncentrimit të aktiviteteve që bëhen pikërisht në qendër dhe për shkak të strukturës së trashëguar të trafikut.

Për këtë qëllim, në qytetin e Ferizajt është analizuar zona qendër.

Nga të dhënat e incizuara në terren për zonën qendër (zonën më atraktive të qytetit) janë fituar të dhëna të rëndësishme të cilat ndërlidhen me karakteristikat themelore të parkingjeve (koeficientin e ndërrimit, zënien dhe frekuencën e parkimit).²⁹

Analiza e parametrave bazë të parkingut, qendër - “në afërsi të Kuvendit Komunal”

²⁹ Instituti INSI, Vlerësimi i fizibilitetit për projektin e parkingjeve në qendër të qytetit Ferizajt, Ferizaj, 2017



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt




Harta 31 Lokacioni i parkingut, qendër - "në afërsi të Kuvendit Komunal"

Kohëzgjatja	Më pak se 1 h	1-2 h	2-3 h	3-4 h	4-5 h	5-6 h	6-7 h	7-8 h	8-9 h	9-10 h	10-11 h
Nr. i parkimeve të shfrytëzuara	209	96	67	64	8	1	7	2	5	3	5

Tabela 93 Kohëzgjatja dhe numri i parkimeve të shfrytëzuara

Ora	06:00-07:00	07:00-08:00	08:00-09:00	09:00-10:00	10:00-11:00	11:00-12:00	12:00-13:00	13:00-14:00	14:00-15:00	15:00-16:00	16:00-17:00	17:00-18:00	18:00-19:00	19:00-20:00	20:00-21:00	21:00-22:00	Gjithsej
Hyrje	29	29	45	47	30	39	28	38	41	13	18	19	42	17	12	12	467
Dalje	2	2	30	53	17	41	32	60	43	22	23	29	13	29	19	4	418
Akumulimi	27	54	69	63	76	74	70	48	46	40	37	27	56	44	37	45	813
Vëllimi	27	56	99	116	93	115	102	108	87	62	60	56	69	73	56	49	1228

Tabela 94 Shfrytëzimi sipas orëve



Grafika 34 Diagrami i shfrytëzimit i sipas orëve

Periudha kohore	Maksimumi për orë	Minimumi për orë	Mesatarja për orë	Ndryshimet brenda orës (koeficienti i ndërrimit)	Koeficienti i ndërrimit (R)
06:00-22:00	115	27	71	$K = 115/71 = 1.61$	$R = 467/72 = 6.4$

Tabela 95 Karakteristikat e vëllimit për periudhën kohore 06:00-22:00

Maksimumi për orë	Min. për orë	Mesatarja për orë
76	27	51,5

Tabela 96 Karakteristikat e akumulimit për periudhën kohore 06:00-22:00



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Ora	06:00-07:00	07:00-08:00	08:00-09:00	09:00-10:00	10:00-11:00	11:00-12:00	12:00-13:00	13:00-14:00	14:00-15:00	15:00-16:00	16:00-17:00	17:00-18:00	18:00-19:00	19:00-20:00	20:00-21:00	21:00-22:00	Gjithsej
Hyrje	29	29	45	47	30	39	28	38	41	13	18	19	42	17	12	12	467
Dalje	2	2	30	53	17	41	32	60	43	22	23	29	13	29	19	4	418
Akumulimi	27	54	69	63	76	74	70	48	46	40	37	27	56	44	37	45	813
Vëllimi	27	56	99	116	93	115	102	108	87	62	60	56	69	73	56	49	1228

Tabela 97 Shfrytëzimi sipas orëve

Analiza e parametrevë bazë të parkingut, qendër - "në afërsi të Spitalit Rajonal"



Harta 32 Lokacioni i parkingut, qendër - "në afërsi të Spitalit Rajonal"

Kohëzgjatja	Më pak se 1 h	1-2 h	2-3 h	3-4 h	4-5 h	5-6 h	6-7 h	7-8 h	8-9 h	9-10 h	10-11 h
Nr. i parkimeve të shfrytëzuara	209	96	67	64	8	1	7	2	5	3	5

Tabela 98 Kohëzgjatja dhe numri i parkimeve të shfrytëzuara

Ora	06:00-07:00	07:00-08:00	08:00-09:00	09:00-10:00	10:00-11:00	11:00-12:00	12:00-13:00	13:00-14:00	14:00-15:00	15:00-16:00	16:00-17:00	17:00-18:00	18:00-19:00	19:00-20:00	20:00-21:00	21:00-22:00	Gjithsej
Hyrje	50	46	24	21	32	12	11	8	34	22	26	28	79	23	39	11	498
Dalje	16	31	29	44	21	17	18	23	34	12	24	51	35	25	38	27	445
Akumulimi	66	81	76	53	64	59	52	37	37	47	49	26	70	68	69	53	939
Vëllimi	82	112	105	97	85	76	70	60	71	59	73	77	105	93	107	80	1384

Tabela 99 Shfrytëzimi sipas orëve

Periudha kohore	Maksimumi për orë	Minimumi për orë	Mesatarja për orë	Ndryshimet brenda orës (koeficienti i ndërrimit)	Koeficienti i ndërrimit (R)
06:00-22:00	112	32	72	$K=112/72=1.55$	$R=498/81=6.14$


Tabela 100 Karakteristikat e vëllimit për periudhën kohore 06:00-22:00

Maksimumi për orë	Min. për orë	Mesatarja për orë
81	26	53,3

Tabela 101 Karakteristikat e akumulimit për periudhën kohore 06:00-22:00



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt




Grafika 35 Diagrami i shfrytëzimit sipas orëve

Pas analizës së parametrave të mësipërm, është konstatuar se:

- Numri i automjeteve që kanë qëndruar deri në një orë (0-1 h) ka qenë mjaft i madh
- Nga kjo rrjedh se, rreth 45% e automjeteve qëndrojnë deri në një orë/ ose më pak se një orë në parkim,
- Numri i automjeteve që qëndrojnë në parkim deri në 4 orë, gjithashtu është i madh
- Ndërsa, numri i automjeteve që qëndrojnë mbi 4 orë, është relativisht i vogël (1- 8 automjete),
- Koeficienti i ndërrimit sillet rreth 1,61 aut./brenda orës, respektivisht një vendparkim shfrytëzohet nga 1,6 automjete brenda një ore.
- Koeficienti i ndërrimit është mjaft i lartë, rreth 6,4. Nga kjo rrjedh se kërkesa për ndërrim është mjaft e madhe.
- Pas analizës së zënies së sipërfaqeve të parapara për parkim është vlerësuar se, ngarkesa më madhe sillet nga ora 09:00-16:00 (Tabela 4). Ndërsa, nga 16:00-18:00 kërkesa zvogëlohet, duke vazhduar të rritet nga ora 18:00-20:00. Pas orës 20:00-22:00 kërkesa është stabile me rreth 48-50% të zënies.

Pas analizës dhe konstatimeve nga rezultatet e incizimit në terren, është vlerësuar se, Komuna duhet të zhvillojë politikën e menaxhimit të parkimit:

- të krijohen parkingje publike me kapacitet më të madh, kryesisht në zonën qendër,
- të zbatohen politika të tilla të parkimit, që mundësojnë qëndrim sa më të shkurtër në zonën qendër, me qëllim që të rritet koeficienti i ndërrimit dhe të përmbushen kërkesat e qytetarëve për shërbime të nevojshme në zonën qendër,
- të zbatohen normat e parkimit, varësisht objekteve dhe veprimtarive që realizohen.



Legjenda/Legend

- Rruget magjistrale
- Rruget regionale
- Rruget regionale të pa asfaltuara
- Rruget lokale
- Rrjet hekurudhor
- Stacion kryesorë i autobusëve
- Rruget magjstral
- Rruget egjonale
- Rruget lokale
- Rruget e pakategorizuara
- Kufiri komunal
- Kufiri kadastral

PUNEDHËNESI:
EMPLOYER:



Komuna e Ferizajt
Ferizaj Municipality
Ferizaj, 70000

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I FERIZAJT
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN OF FERIZAJT

REVIZIONI - REVIZION		REVIZIONI	DATA	PERIUDHA	DESKRIBIMI	Kryetar	Kryetarja	Ndihet	Miratohet	Ndihet	Ndihet
A	2016	Hartimi i pare									
Rev.	DATE	PERIUDHA		DESKRIBIMI							



Projeksioni Gjeneral: Transverse Mercator
Sistemi Koordinatë: Koordinatë GCS ETRF 1989
Sistemi i Referencës: Niveli i Referencës DTM
Mbrojtja e Hartës: Gërmim
Niveli i Referencës

Formati:
Format: A0

Përfaqja:
Scale: 1/25,000

TITULLI I HARTES
MAP TITLE:

Infrastruktura Rrugore

Roads Infrastructure

Watershed:
Scale: 1 0

Harta 33 Infrastruktura rrugore



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2.9. Infrastruktura publike dhe sociale

2.9.1. Administrata publike

Në kuadër të sektorit të gjendjes civile në Ferizaj, janë 11 zyre të gjendjes civile që iu ofrojnë shërbime për banorët e Komunës. Dy zyre është në zonën urbane, gjersa 9 janë në vendbanimet rurale. Zyra e gjendjes civile janë të vendosura në ndërtesë të Komunës, Spital, Babush, Dardani, Fshati i Vjetër, Gaçkë, Kosinë, Neredime e Epërme, Softaj, Talinoc i Muhaxherëve dhe Zaskok.

Numri zyrove	Numri i banorëve	Zyre për 10000 banorë
11	108,610	1.01

Tabela 102 Raporti i zyrove të gjendjes civile në raport me numrin e banorëve

Përkrahja e përpunimit të prodhimeve bujqësore	Struktura e bizneseve private me orientim joprodhues
Ngritja e prodhimtarisë bujqësore	Orientimin e kapitalit nga jashtë
Promovimi i konsolidimit të tokave bujqësore	Mungesën e investimeve direkte të huaja (FDI)
Kthimi i fondeve financiare nga jashtë dhe lirimi i fondeve të bllokuara	Nivelin jo të kënaqshëm të zhvillimit të turizmit rural
Përfshirja e diasporës në identifikimin e tregjeve globale për produktet e Ferizajt e të Kosovës dhe promovimi i tyre	Pjesa më e madhe e të tekstit të poshtë shënuar duhet analizuar edhe në funksion të çështjeve dhe sfidave.

Tabela 160 SWOT analiza e zhvillimit ekonomik

3.3.1. Përmbledhje e ekonomisë lokale

3.3.1.1. Ekonomitë familjare, punësimi dhe papunësia

Në Komunë janë gjithsej 18,359 ekonomi familjare, me mesatarisht 5.9 anëtarë për familje dhe mesatare prej 13m² hapësirë banimi për kokë banori. Sa i përket krahasimit të madhësisë së nukleusit familjar, Ferizajsit kanë një numër të ultë të anëtarëve për familje, që dëshmon se ka pak familje, të cilat jetojnë në bashkësi sipas traditës. Numri i vogël i anëtarëve për familje, paraqet një tregues pozitiv për zhvillimin ndërtesave për banim në të ardhmen, gjersa hapësira mesatare e banimit prej 13m² është e ultë krahasuar me hapësirën mesatare prej 22m² për kokë banori të vendeve të Bashkësisë Evropiane.

Me 70,487 banorë të moshës 15 – 64, fuqia punëtore e Komunës së Ferizajt radhitet e treta pas Prishtinës dhe Prizrenit në krahasim me Komunat tjera, që paraqet një tregues joshës për investitor të interesuar në zhvillimin e



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

ndërmarrjeve të mëdha në Komunën tonë. Mirëpo, sa i përket përqindjes së banorëve të punësuar me vetëm 25.94% të punësuar, Komuna e Ferizajt radhitet e teta. Në krahasim me Komunat me mbi 100,000 banorë, Ferizaj radhitet e treta pas Prishtinës dhe Gjilanit, që dëshmon për një zhvillim të mirë ekonomik lokal. Vetëm 0.50% të banorëve sigurojnë të ardhura nga qiraja, që dëshmon se sektori i patundshmërive nuk edhe aq i zhvilluar, që ndikon negativisht në mirëqenien ekonomike të banorëve. Komuna e Ferizajt ka vetëm 5.55% të banorëve, që pranojnë pensione dhe vetëm 3.42% të banorëve që pranojnë ndihma sociale, që dëshmon një gjendje të mirë ekonomike të banorëve.

Tjetër faktor i rëndësishëm ekonomik është që në krahasim me Komunat tjera, me gjithsejtë 18,359 prona private, Komuna e Ferizajt radhitet e treta pas Prishtinës dhe Prizrenit. Numri i lartë i pronave dëshmon që një e konsiderueshme e ekonomive familjare e Ferizajt posedon pronë private. Mirëpo, krahasuar përqindjen e numrit të banorëve të cilat emigruar jashtë vendit me Komunat tjera, Ferizaj radhitet e 24-ta me vetëm 6.5% Ferizajas të cilët jetojnë jashtë Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh përqindjen e ultë të familjeve që pranojnë remitenca nga diaspora, Komuna duhet të përqendrohet shumë në krijimin e vendeve të reja të punës.

3.3.1.2. Sektorët ekonomik, struktura e tyre dhe ekonomia bujqësore

Sa i përket sektorëve ekonomik, sektori i tregtisë me shumice dhe pakice, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave kryeson me gjithsejtë 4046 ndërmarrje të regjistruara në Komunën tonë, që dëshmon se Ferizaj është kryeqendër e Kosovës për tregti të automjeteve, shumica e të cilave shtrihet pranë rrugës nacionale. Sektor tjetër i zhvilluar ekonomik në Komunë është ai i transportit dhe magazinimit, i cili numëron gjithsejtë 1502 ndërmarrje të regjistruara që paraqet një tregues të mirë për zhvillimin e Komunës si terminal i Kosovës për mallra, gjersa në vendin e tretë radhitet sektori akomodimit dhe shërbimeve ushqimore me gjithsejtë 1267 ndërmarrje të regjistruara. Vendin e katërt me gjithsejtë 1182 ndërmarrje të regjistruara zë sektori i industrisë përpunuese, që paraqet një mundësi shumë të mirë të zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen për shkak se investitorët janë të interesuar të hapin fabrika të reja pranë vendeve që kanë traditë dhe punëtorë të aftë për prodhimtari përpunuese industriale.

Fatkeqësisht, përkundër sipërfaqes së madhe të tokës pjellore, ku 57% e territorit është e klasave I – IV të përshtatshmërisë së tokës, sektori i bujqësisë nuk është i zhvilluar krahasuar me potencialin prodhues që ka. Vetëm 274 ndërmarrje janë të regjistruara në sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe peshkimit. Ndonëse vërehet një rritje e ultë në prodhimtarinë e drithërave dhe tejet e ultë në prodhimin e fasuleve, kulturat tjera bujqësore njëvjeçare nuk janë duke u kultivuar mjaftueshëm, krahasuar me kapacitet që ka. Duke marrë parasysh që Ferizaj është i njohur për cilësinë e lulediellit, gështenjave dhe fasule të Neredimes, prodhimi i tyre mbetet i ultë. Sa i përket prodhimit të pemëve, prodhimi i mollëve, dardhave, kumbullave, mjedrave dhe dredhëzave është në rritje e sipër, që shënon një trend pozitiv të prodhimtarisë bujqësore në Komunë.

Gjatë katër viteve të fundit, prodhimtaria e qumështit është një ndër sektorët bujqësore të cilat kanë shënuar një rritje madhe prej 35%. Sa i përket zhvillimit të blegtorisë gjatë katër viteve të fundit, është rritur numri i gjedhëve për 10%, i deleve për 25% dhe cjapeve për 400%, që shënon rritjen më të madhe. Komuna është e pasur me sipërfaqe pyjore, mirëpo mungon një strategji për përfshirjen e tyre në kuadër të zhvillimit të tyre të qëndrueshëm ekonomik, që do të hapte vende të reja të punës në Komunë.

3.3.1.3. Shfrytëzimi i resurseve natyrore

Komuna është e pasur me pasuri nëntokësore të cilat nuk janë në shërbim për zhvillimit ekonomik. Komuna është e pasur me kuarc dhe kuarcite, argjilë, zhavorr dhe rërë, shkëmb gëlqeror, shkëmb i mermerizuar, shkëmb kaolin dhe kaolin argjilore si dhe depozita të linjitit, të cilat nuk janë në shfrytëzimin optimal të tyre. Gjatë 16 viteve përbrenda Komunës kanë vepruar vetëm 24 ndërmarrje të sektorit të minierave dhe guroreve apo industrisë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

nxjerrëse, që dëshmon për një shkallë të ultë të eksploatimit të pasurive nëntokësore përbrenda Komunës, të cilat do të gjeneronin vende të reja të punës.

3.3.2. Ndërlidhja e veprimtarive me komunat dhe shtetet fqinje

Duke marrë parasysh, pozitën e saj qendrore në mes të Prishtinës dhe Shkupit, rruga nacionale dhe autoudha e re që është në përfundim e sipër, dhe lidhjen hekurudhore që ndërlidhë Ferizajn me shtete tjera, paraqet një përparësi shumë të madhe në raport me komunat dhe shtetet fqinje dhe paraqesin një mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të tregtisë me shumicë dhe magazinimit të mallrave të importuara në Kosovë. Në Komunë veprojnë operatorë të rëndësishëm ekonomik që furnizojnë komunat dhe shtetet fqinje me tuba, asfalt, materiale ndërtimore dhe karburante të importuara. Zhvillimi i Komunës si terminal i Kosovës është shumë i volitshëm për Kosovën, sepse do të zvogëlonte dukshëm transportin e automjeteve të rënda në rrugët publike dhe do të hapte vende të reja pune për banorët e Ferizajt.

3.3.3. Resurset dhe shërbimet turistike

Përkundër faktit që në Komunën të Ferizajt shtrihet një fenomen i rrallë natyror, Bifurkacioni i Neredimës nuk vizitohet mjaftueshëm nga turistë vendor apo ndërkombëtar. Përderisa janë bërë investime të mëdha në hapësirat publike që shërbejnë për rekreacion, mungojnë hapësirat për qëndrim shumëditor, bujtina apo kampingje, si dhe shërbime ushqyese. Duke marrë parasysh afërsinë e bifurkacionit me malet e Jezercit, Komuna në bashkëpunim me nivelin qendror duhet të trajtojë një strategji dhe një plan rregullues të hollësishëm që do të nxiste turizëm me qëndrim shumëditor në shtrirjen e këtyre dy pasurive natyrore.

Siç ka dëshmuar Dokufesti në Prizren, trashëgimia natyrore dhe kulturore e një vendi më së miri promovohet përmes festivaleve ndërkombëtare, për të cilat nevojitet një përkushtim afatgjatë i Komunës dhe bizneseve të interesuara për faktorizimin e këtyre ngjarjeve. Kështu që nevojitet një strategji e qëndrueshme për joshjen e turistëve ndërkombëtar përmes aktiviteteve ndërkombëtare. Gjersa, sa i përket kapaciteteve hoteliere, regjioni i Ferizajt aktualisht ka 17 hotele që mundësojnë fjetjen e 281 mysafirëve brenda një nate, që dëshmon për një kapacitet shumë të ultë për zhvillimin e turizmit në Komunë. Sipas ASK-së, numri i vizitorëve është dyfishuar në vitin 2016, krahasuar me vitet paraprake.

Ferizaj	Vizitor	Net	Numri i fjetjeve në ditë
TM1 2014	163	194	3.23
TM1 2015	114	147	2.45
TM1 2016	322	391	6.52
Gjithsej	599	732	12.20

Tabela 161 Frekuenca e vizitorëve që qëndruan në hotele gjatë tre viteve

Bazuar në tabelën e sipërme vërehet një rritje në numrin e vizitorëve në hotele, që dëshmon për shtimin e numrit të turistëve në Komunë, mirëpo nëse krahasojmë atë me 2009 dhe 2012 vërehet një rënie prej 50% të vizitorëve në hotele.

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gjithsej
Vizitor	1,374	10,532	9,972	7,153	10,012	5,878	4,229	6,214	55,364
Net	1,834	12,407	10,923	7,584	12,731	8,887	4,450	6,719	65,535

Tabela 162 Frekuenca e vizitorëve që qëndruan në hotele shtatë vitet e fundit

Bazuar në analizat e tetë viteve të fundit, vërehet një rënie në numrin e turistëve, kështu që në shërbim të zhvillimit ekonomik nevojitet një strategji për shtimin e numrit të turistëve, së bashku me ngritjen e kapaciteteve hoteliere.

3.3.4. Zonat ekonomike dhe ndikimi i tyre

Në Komunë të Ferizajt nuk ka zona të lira ekonomike, mirëpo Plani Zhvillimor Komunal paraprak ka përcaktuar zona industriale/komerciale përgjatë rrugës nacionale dhe pjesën veriore të unazës së brendshme urbane. Bazuar në



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

zhvillimet aktuale të zonave të planifikuara për shfrytëzim industrial/ komercial, zhvillimet aktuale përputhen me veprimtaritë e parapara për këtë zonë, ku dominojnë ndërtesa tregtare, kryesisht të shtrira përgjatë rrugëve kryesore, në shtrirje lineare. Në fakt kjo zonë është zgjeruar edhe më tej në pjesën veriore, përtej zonës së planifikuar.

Ndonëse, Ferizaj tashmë është ka marrë rolin e kryeqytetin të Kosovës për automjete, auto-pjesë dhe orendi shtëpiake, duke përfshirë pajisjet elektrike. Përderisa, në të kaluarën kjo zonë ka qenë e frekuentuar shumë nga udhëtarë të rastit duke kaluar transit, autoudha e re paraqet një kërcënim për zhvillimin e suksesshëm të këtyre zonave, andaj është shumë e rëndësishme që të zgjerohet kjo zonë në drejtim të kyçjes në autostradën e re. Ky zgjerim në pjesën veriore përgjatë rrugës nacionale do të siguronte një vazhdimësi të veprimtarive ekonomike, do të zvogëlonte humbjen e tokës bujqësore dhe do të fuqizonte ndërmarrjet ekzistuese që veprojnë në këtë zonë.

Bazuar në shfrytëzimin aktual të tokës vërehen tre akset vijuese të zhvillimit ekonomik:

1. Rruga regjionale Babush – Gurëz;
2. Rruga regjionale Ferizaj – Bibaj – Sojevë – Dardani;
3. Rruga Ferizaj – Doganaj – Greme; dhe
4. Pjesa veriore e unazës së brendshme.

Në mënyrë që të mënjanohet trafiku i automjeteve të rënda në rrugët ekzistuese, fuqizimi i këtyre zonave për zhvillim është i domosdoshëm.



3.4. Infrastruktura teknike

3.4.1. Instalimet e rrjetit të energjisë termike

Përparësitë	Dobësitë
Dendësia e lartë e zhvillimit të ndërtimeve	Mungesa e respektimit të vijave ndërtimore
Konfiguracioni i terrenit i përshtatshëm	Mungesa e rrjetit ekzistues të energjisë termike
Pozita gjeografike e mirë për kyçe në rrjetin e gazsjellësit të planifikuar TAP	
Resurset e linjtit brenda shtrirjes territoriale të Komunës	
Studimi i fizibilitetit të hartuar për energji termike	
Mundësitë	Kërcënimet
Lidhja me rrjetin e gazifikimit TAP të planifikuar	Ndotja e mjedisit nga shfrytëzimi i linjit
Shfrytëzimi i resurseve të linjtit	Ndotja e mjedisit nga grumbullimi i mbeturinave
Krijimi i ngrohjes qendrore për djegies së mbeturinave duke zvogëluar koston operative	

Tabela 163 SWOT analiza e rrjetit termik

3.4.1.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Në Komunën e Ferizajt nuk ekziston rrjet furnizues me energji termike, përpos një ngrohtoreje që është e ndërtuar për të shërbyer vetëm kazermën ushtarake.

3.4.1.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Në mënyrë që të mbrohen pyje

t dhe mjedisi, Komuna e Ferizajt duhet që të ndërtojë një rrjet të energjisë termike për zonën urbane e cila është në vazhden e ndërtimeve të banesave kolektive. Për të siguruar energji termike, Komuna mund të planifikojë ndërtimin e një termocentrali pranë depozitave të linjtit në Cërnillë, Mirash apo Babush, i cili do të furnizonte dhe shumicën e vendbanimeve rurale të cilat shtrihen në pjesën veriore me ngrohje qendrore. Në mënyrë që të sigurohet një arsyeshmëri për investimet në një termocentral dhe rrjetin shpërndarës, Komuna duhet të shqyrtojë edhe mundësinë e furnizimit me ujë të ngrohtë sanitar për 12 muaj të vitit. Investimi në furnizimin qendror me energji termike, përpos që do të mbrojë pyjet e Ferizajt në të njëjtën kohë do të përmirësojë dukshëm edhe gjendjen materiale të banorëve, pasi që shpenzimet e tyre për ngrohjen e hapësirave të brendshme dhe ujit sanitar do të zvogëlohen dukshëm. Mirëpo në rast se Komuna vendosë të ndërmarrë një investim të tillë, rrjeti i shpërndarjes së energjisë termike duhet jetë kompatibil të shpërndajë gazin, i cili në një të ardhme të afërt planifikohet të furnizojë tërë Republikën e Kosovës.

3.4.1.3. Kapacitetet e nevojshme

Në vijim është tabela e shpenzimeve të përafërta të investimeve kapitale për të ofruar banorët e Ferizajt me energji termike:

Përshkrimi	Vlera
Ngrohtorja	21.428.000,00 €
Termo-përçuesi 130/75°C	6.093.143,00 €
Nënstacionet termike 130/75°C; 90/70 °C	1.879.570,00 €
Mjetet investive të përgjithshme	29.400.713,00
Shpenzimet tjera	1.764.043,00
Shpenzimet e përgjithshme të investimit	31.164.756,00

Tabela 164 Vlera e investimeve kapitale për krijimin e rrjetit të ngrohjes termike

3.4.2. Instalimet e rrjetit të ujësjellësit

Përparësitë	Dobësitë
-------------	----------



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

80% të vendbanimeve rurale gëzojnë qasje në rrjet të ujësjellësit	20% të vendbanimeve rurale nuk gëzojnë qasje në rrjet të ujësjellësit
95% të vendbanimeve urbane gëzojnë qasje në rrjet të ujësjellësit	Materiale të vjetërsuara të rrjetit ekzistues në zonë urbane
Ujërat nëntokësore shtrihen në 50% të territorit të Komunës	Mospërfshirja e të gjitha rrjeteve lokale në menaxhim të kompanisë publike
Terreni i përshtatshëm për ndërtimin e rrjetit furnizues me ujë të pijshëm	Kapacitetet e pamjaftueshme të fabrikës së ujit të pijshëm
	Mungesa e ujëmatëseve zonale të ndara të ujësjellësit
	Dimensione joadekuate të gypave ekzistues
	Ujërat nëntokësore ofrojnë kapacitete të pamjaftueshme
	Mos përcaktimi e zonave mbrojtëse për burime dhe rezervuar të ujërave sipërfaqësore
Mundësitë	Kërcënimet
Shfrytëzimi i kapaciteteve të ujërave nëntokësor përmes hapjes së puseve	Mungesa e ujëmatëseve individual për konsumatorët ujësjellësit
Ngritja e sasisë së akumuluar në Jezerc	Burimet e pamjaftueshme të ujërave sipërfaqësore
Furnizimi me ujë shtesë nga sistemi i ujit Ibër Lepenc	Shembja e dheut pranë fabrikës së ujit

Tabela 165 SWOT analiza e rrjetit të ujësjellësit

3.4.2.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Normat e furnizimit të vendbanimeve, me sasinë e nevojshme ditore të ujit janë si ne vijim:

1. Ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri:

- 1.1. për vendbanime ≥ 100001 banor: ≥ 300 litra/banor;
- 1.2. për vendbanime $\geq 50001 - 100000$ banor: $\geq 250 - 300$ litra /banor;
- 1.3. për vendbanime $\geq 20001 - 50000$ banor: $\geq 200 - 250$ litra /banor;
- 1.4. për vendbanime $\geq 5001 - 20000$ banor: $\geq 150 - 200$ litra /banor;
- 1.5. për vendbanime < 5000 banor: $\geq 100 - 150$ litra /banor.

2. Ujë për shfrytëzim për nevojat jo-konsumuese-rekreacion/ ujë për mirëmbajtje të hapësirave publike:

2.1. Sipërfaqet e gjelbra, rrugët dhe sheshet: 1.50 litër/m².

Fabrika e ujit të pijshëm në Pleshinë e cila furnizon banorët në zonën urbane dhe fshatrave si Doganaj, Dubravë, Nikadin, Talinoc i Jerlive, Pleshinë e Poshtme dhe Zaskok prodhon vetëm 200l/s, që i plotëson nevojat vetëm për 38,000 banorë, gjersa numri aktual i këtyre vendbanime është 58,087 banorë. Përpos sasisë së pamjaftueshme të ujit, sipas KURK "Bifurkacion"-it, rreth 40% të sasisë së ujit humbet për shkak të defekteve në rrjetin ekzistues. Përderisa shumica e vendbanimeve janë të kyçur në rrjetin e ujësjellësit, vendbanimet rurale vijuese nuk kanë rrjet që furnizon banorët me ujë të pijshëm:

- Burrnik;
- Jezerc;
- Dardani;
- Sovejë;
- Pleshinë e Epërme; dhe
- Zllatar.
- Një pjesë e konsiderueshme e rrjetit ekzistues që shtrihet në zonën urbane është i vjetërsuar dhe i përbërë nga materialet si azbest-çimento (AC) dhe çeliku (Fe), të cilat janë të dëmshme për shëndetin e konsumatorëve dhe gypa tjerë PVC dhe zinkuar (Zn).



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.4.2.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Duke u bazuar në projeksionet e numrit të banorëve për vitin 2025 prej 90,000 banorë për zonën urbane dhe Doganaj, Dubravë, Nikadin, Talinoc i Jerlive, Pleshinë e Poshtme dhe Zaskok, fabrika e ujit në Pleshinë duhet të ngrit kapacitet ekzistuese të furnizimit me ujë në së paku 300l/s dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të eliminuar humbjet që shkakton rrjeti i vjetërsuar i ujësjellësit. Gjersa për të plotësuar nevojat afatgjate të banorëve për 30 vitet e ardhme, Komuna duhet të ngrit kapacitetet ekzistuese në 700l/s për të furnizuar me ujë të gjitha vendbanimet. Duke marrë parasysh që ngritja e kapaciteteve prodhuese të fabrikës së ujit, ndërrimi i gypave të rrjetit ekzistues dhe i rezervuarëve dhe klorinatorëve sipas Direktivës së BE-së për ujë të pijes (98/83/EC) është prioriteti më i lartë i Komunës, buxheti i Komunës për investime është i kufizuar për ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit. Kështu që bazuar në numrin e projektuar të banorëve në Burrnik dhe Jezerc, që pritet të braktisen tërësisht brenda njëzet viteve, prioriteti i instalimeve të ujësjellësit duhet të përqendrohet në Dardani, pastaj në Pleshinë të Epërme, pastaj në Sojevë dhe përfundimisht në Zllatar.

Në rast se parashihet zhvillim i turizmit rural në Jezerc, atëherë ky vendbanim mund të trajtohet me prioritet të lartë për instalimin e ujësjellësit, për furnizim të bujtinave që planifikohen të ndërtohen në të ardhmen. Për të monitoruar humbjet në rrjetin e ujësjellësit nevojitet të instalohen ujëmatësit zonal brenda qytetit. Zonat e burimeve nuk janë të mbrojtura sipas Udhëzimit Administrativ për Zonat e Mbrojtura Sanitare, kështu që nevojitet të zohen masat mbrojtëse.

3.4.3. Instalimet e rrjetit të kanalizimit

Përparësitë	Dobësitë
95% të vendbanimeve rurale dhe urbane gëzojnë qasje në rrjet të kanalizimit	5% të vendbanimeve rurale nuk gëzojnë qasje në rrjet të kanalizimit
	Rrjeti ekzistues në Dardania, Greme, Manastirc nuk funksion si duhet
	Përzjerja e ujërave atmosferike dhe fekale në zonën përendimore
	Shkarkimi i ujërave të zeza në 22 pika të ndryshme
Mundësitë	Kërcënimet
Ndërtimi i tre impianteve të ujërave të zeza	Shtrirja kolektorit kryesor në pronë private dhe në zonë të banuar
Ndërtimi i tre kolektorëve të ujërave të zeza në zonat veri, lindje dhe jug	Mungesa e impianteve për përpunimin e ujërave fekale
Shfrytëzimi i ujërave të trajtuara nga impiantet për nevojat e ujitjes	Shtrirja e rrafshët e relievit në pjesën më të madhe të Komunës

Tabela 166 SWOT analiza e rrjetit të kanalizimit

3.4.3.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Me përjashtim të Burrnikut dhe Jezercit, të gjitha vendbanimet kanë rrjet të kanalizimit, i cili mbulon nevojat e banorëve dhe është në gjendje kryesisht të mirë. Mirëpo, një pjesë e rrjetit që shtrihet në rrugët periferike të zonës urbane, rrjeti ekzistues krijon vërshime gjatë të reshurave të mëdha të shiut, për arsye se nuk ekziston një ndarje e mbledhjes së ujërave të zeza dhe të reshurave atmosferike. Në Muhoc, Talinoc i Jerlive dhe Tërn ujërat e zeza shkarkohen në gropat septike dhe pastaj në lumenj që gjenden në afërsi. Ujërat e zeza shkarkohen në 22 pika shkarkimi që ndotin lumenjtë Neredime, Sitnicën dhe Moravën, kështu që nevojitet ndërtimi i impianteve për trajtimin e këtyre ujërave, sipas direktivave të Bashkimit Evropian.

3.4.3.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Në mënyrë që të mënjanohej problemet ekzistuese në rrjetin e kanalizimit, pjesa e rrjetit që mbledhë ujërat e zeza dhe atmosferike duhet të ketë rrjet të ndarë për mbledhjen e tyre. Duke marrë parasysh që ujërat e zeza ndotin lumenjtë, Komuna duhet të ndërtojë impiante për trajtimin e ujërave të zeza. Bazuar në studimin e WYG International, të financuar nga Komisioni Evropian, Komuna ka nevojë për ndërtimin e katër impianteve në



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Komogllavë, pjesën veriore, jugore dhe lindore. Paraprakisht, nevojitet ndërtimi i kolektorëve të ri, për t'i lidhur pikat e kanalizimit dhe për t'i transportuar ato deri te Impiantet për Trajtimin e Ujërave të Zeza (ITUZ). Në disa rrugë periferike të zonës urbane një pjesë e rrjetit ekzistues nevojitet të ndërrohet me gypa të PESN.

3.4.4. Instalimet e rrjetit të drenazhimit

Përparësitë	Dobësitë
Relievi i përshtatshëm për zgjerimin e rrjetit të drenazhimit	Vetëm 12% të rrjetit ekzistues të kanalizimit në zonën urbane është e ndarë vetëm për rrjet të drenazhimit
Përshkueshmëria e lartë e ujit nga sipërfaqet tokësore	Mosmirëmbajtja adekuatë të disa kanaleve të hapura
Mundësitë	Kërcënimet
Krijimi i akumulimeve të reshurave atmosferike përmes rrjetit të zgjeruar	Mungesa e rrjetit të drenazhimit ndikon në përmbytje në zona të caktuara
Zgjerimi i rrjetit të drenazhimit	

Tabela 167 SWOT analiza e rrjetit të kanalizimit

3.4.4.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Sipas Raportit të Fizibilitetit për Impiantet e Ujërave të hartuar nga WGY International dhe KRUK Bifurkacioni, sistemi i drenazhimit (K. Atmosferik) në Ferizaj ka një gjatësi të përgjithshme afërsisht prej 13000 m' ose L=13 km, shumica prej të cilave është ndërtuar në vitet 1970 dhe ka filluar të zgjerohet në 10 vitet e fundit. Kanalizimet Atmosferike janë përgjithësisht vetëm në rrugët kryesore dhe janë ndërtuar nga tuba e betonit në varg 600 deri në 1500 mm diametër. Krahasuar me gjatësinë e sistemit të kanalizimit në tërësi, vetëm rreth 12% e zonës së qytetit përfiton nga një sistem i veçantë drenazhe apo kanalizimit atmosferik. Në pjesët më të mëdhatë qytetit, sidomos në pjesët e largëta nga rrugët kryesore ku ekziston kanalizimi atmosferik, kolektorët mbledhin fluksin e shiut dhe veprojnë pjesërisht si sistem i kombinuar, që shkaktojnë përmbytjet nga pusetat gjatë reshjeve të rënda dhe intensive.³⁹

Duke marrë parasysh që vetëm 12% të kanalizimit që shtrihet në zonën urbane është e ndarë nga rrjeti i kanalizimit, pjesë të ndryshme të qytetit vërshohen gjatë reshjeve atmosferike duke dëmtuar materialisht banorët këtyre zonave. Rrejtë ekzistues i kanalizimit nuk është i projektuar për mbledhjen e të reshurave atmosferike, kështu që nevojitet krijimi i rrjetit të ndarë për mbledhjen e të reshurave atmosferike. Përpos që do të mbronte banorët e zonës urbane nga përmbytjet, ndërtimi i rrjetit të ri të drenazhimit, do të siguronte burime shtesë të ujit dhe do të mbronte ujërat sipërfaqësor nga ndotja.

3.4.4.2. Vlerësimi i nevojave për të ardhmen

Për të gjitha investimet e ardhme në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit brenda zonës urbane, Komuna duhet të ndërtojë edhe rrjetin e veçantë të drenazhimit për mbledhjen e të reshurave atmosferike, që mundet të përdoret në të ardhmen për ngritjen e kapaciteteve ekzistuese të burimeve të ujit të pijshëm, ujitjen e tokave bujqësore, prodhimin e energjisë së ripërtërishtme apo për pastrimin e rrugëve publike në zonën urbane.

3.4.5. Instalimet e rrjetit të ujitjes

3.4.5.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Komuna e Ferizajt aktualisht nuk ka rrjet të ujitjes të zonës urbane apo tokave bujqësore. Në bazë të strategjisë së ujërave të Republikës së Kosovës janë planifikuar disa akumulacione (diga) të reja në lokacione të ndryshme. Kjo strategji ka paraparë që deri në vitin 2034, të ndërtohen dy diga në pellgjet Lepenc dhe Stinicë, nga të cilat është planifikuar të ujitjen tokat bujqësore të Komunës së Ferizajt. Në tabelën vijuese janë të paraqitura veçoritë e akumulimeve të planifikuara ujore:

³⁹WYG International, Feasibility Study for Ferizaj Wastewater Treatment Plant - Volume 1 – Main Report, Ferizaj, 2014



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Nr	Akumulimi	Lumi/rrjedha e ujit	Ujëmbledhësi	Rrjedhja mesatare	Rrjedhja Vjetore	Vëllimi
			Km ²	m ³ /Sekondë	Milion m ³	Milion m ³
1	Firajë	Lumi Lepencë	229	5.34	168.3	16.5
2	Shtime	Lumi Topillë	102	66	20.9	113
	Gjithsejtë		331	71.34	189.2	129.5

Tabela 168 Akumulimet ujqor të planifikuara nga niveli qendror

3.4.5.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Duke marrë parasysh investimet e parapara të nivelit qendror për ujtitjen e tokës bujqësore brenda një periudhë afatgjate, Komuna nuk ka nevojë të investojë në këtë drejtim, mirëpo duhet të marrë parasysh këtë projekt madhor gjatë planifikimit.

3.4.6. Instalimet e rrjetit të telekomunikacionit

Përparësitë	Dobësitë
100% mbulueshmëri të telefonisë mobile 2G dhe 3G.	70% të territorit nuk ka qasje në rrjetin tokësor telefonik dhe kabllorik
Nyja kryesore shpërndarëse e fijeve optike është e vendosur në Komunën e Ferizajt	Mbi 20 fshatra nuk qasje në shërbimet e PTK-së përmes rrjetit kabllor
Instalimi nëntokësor i rrjetit kryesor të telekomunikimit në 95% të territorit të zonës urbane të ndërtuar	Teknologjia telekomunikuese ekzistuese e instaluar ka nevojë për avancim teknologjik deri në masën e përkrahjes së shërbimeve telekomunikuese 4G dhe 5G LTE.
Mbulueshmëri nga operatorë të ndryshëm	Mbulueshmëria në nivel jo të kënaqshëm me rrjeta telekomunikuese kabllore optike FTTH(Fiber To The Home) dhe rrjeta telekomunikuese mobile 4G dhe 5G LTE
	Rrjetat ekzistuese telekomunikuese kabllore të vjetra (Cu-Coopër/Baker)në mase të madhe
Mundësitë	Kërcënimet
Zgjerimi i rrjetit ekzistues optik	Privatizimi i Telekomit të Kosovës
Largimi i të gjitha instalimeve mbitokësore të PTK-së	Buxheti i pamjaftueshëm për investime kapitale
Sinkronizimi i investimeve kapitale të PTK-së me ato të Komunës	
Implementimi i teknologjive të reja telekomunikuese 4G dhe 5G LTE- për telefoni mobile dhe FTTH (Fiber To The Home-për rrjeta kabllore)	
Ndërtimi i rrjetave të reja telekomunikuese të avancuara 4G dhe 5G LTE- për telefoni mobile dhe rrjetave kabllore optike FTTH(Fiber To The Home -për rrjeta kabllore optike) në zonat e pambuluara	
Zëvendësimi i rrjetave ekzistuese kabllore të vjetra (Cu-Coopër/Baker)me rrjeta të reja telekomunikuese optike kabllore FTTH(FTTH- Fiber To The Home)	

Tabela 169 SWOT analiza e rrjetit të telekomunikacionit

3.4.6.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Komuna e Ferizajt ka mbulueshmëri të mirë me rrjet të telekomunikacionit, me 100% mbulueshmëri të telefonisë mobile 2G dhe 3G. 95 % të rrjetit është i instaluar në sipërfaqen tokësore. Mirëpo, rrjeti optik nuk është shtrirë në tërë territorin e Komunës. Aktualisht rrjeta kabllore e bakrit (Cu) në tërë regjionin e Ferizajt numëron 24500 çiftore nga të cilat rreth 3500 janë të evidentuara si çiftore rezervë në tokë ndërsa pjesa tjetër 21000 çiftore ndodhen në daljet kabllore në shtylla; dalje të brendshme dhe dalje të ulëta etj. Shumë nga këto çiftore janë ndërtuar pas vitit 2000 me kablo KT59GM e në vitet e fundit me kablo KT59GM- xDSL dhe edhe përkundër



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

karakteristikave të mira elektrike prapë se prapë shfaqen kufizime në dhënien e shërbimeve të avancuara brezgjera. Andaj lind nevoja që për një kohë relativisht të shkurtër këto rrjeta Cu të zëvendësohen me rrjeta optike FTTH, duke filluar zëvendësimin e rrjetave me të vjetra me kablo KT10 e deri te ato të ndërtuara viteve të fundit me kablo GM dhe xDSL.

Duke filluar nga avantazhi teknologjik që ofrojnë rrjetat GPON dhe kufizimet shumë më të vogla në krahasim me rrjetat Cu, veçanërisht kufizimet në distancë (rrjeta GPON deri në 20km) atëherë kemi menduar që rrjeta GPON në region të dizajnohet (Centralizohet) në 7 Njjet e Qasjes nga 17 sa tani janë aktuale. Nga këto 7NQ rrjeta GPON duhet të mbuloje tërë regionin edhe aty ku jemi prezent me Cu edhe lokalitetet tjera ku nuk kemi rrjetë. Këto lokacione të 7NQ janë përzgjedhur në mënyrë që gjeografikisht mundësojnë të ndërtojmë rrjeta GPON me konsumatorin fundor më së largu 13Km dhe ku ne jemi të pranishëm me infrastrukturë me objekt të ndërtimit të fortë, ka furnizim stabil me energji elektrike dhe furnizim alternativ me gjenerator dhe ku shumica e objekteve (90%) janë në pronësi të PK-së. Në Komunë shtrihet këto 7 zona kabllor optike me kapacitet të ODF=15000 porte GPON dhe 20 vendbanime rurale nuk kanë qasje në shërbimin kabllor TiK. Mirëpo, në Komunë shërbimet e PTK-së nuk kanë mbulueshmëri me:

- Teknologjive të reja telekomunikuese 4G dhe 5G LTE- për telefoni mobile;
- Rrjet kabllor cilësor FTTH (Fiber To The Home-për rrjeta kabllor);

3.4.6.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Investimet kapitale të PTK-së të planifikuara për 5 vitet e ardhme në Komunë janë:

- Faza e parë viti 2016.....2.000 linja GPON
- Faza e dytë viti 2017.....4.000 linja GPON
- Faza e tretë viti 2018.....7.000 linja GPON
- Faza e katërt viti 2019.....9.000 linja GPON
- Faza e pestë viti 2020.....10.000 linja GPON

Duke marrë parasysh që teknologjia e fundit nuk është e instaluar në Ferizaj, Komuna duhet të bashkërendojë veprimtarinë e tyre me PTK-në dhe operatorë tjerë të shërbimeve të telekomunikacionit, me theks të veçantë në instalimet nëntokësore të kabllove optike. Në të ardhmen Komuna duhet të parashoh ndërtimin e rrugëve me kanal të veçantë nëntokësor për instalimet e kabllove optike. Mirëpo, duke marrë parasysh se edhe operatorë tjerë ofron shërbime kabllorike është e domosdoshme që Komuna të ndërmjetësojë një marrëveshje në mes të gjithë operatorëve që të shfrytëzojnë të njëjtat fibra për transmetimin e të dhënave digjitale. Në mungesë të një marrëveshje të tillë, synimet e Komunës për të larguar shtyllat dhe kabllot nga trotualet e ngushta përmes instalimeve nëntokësore nuk do të realizohen sepse pavarësisht investimeve të PTK-së për të instaluar rrjetën kabllorike nëntokësore, operatorët tjerë që ofrojnë shërbime kabllorike do të vazhdojnë të shtrijnë rrjetin e tyre mbitokësor.

3.4.6.3. Vlerësimi i kapaciteteve financiare

Pasi që investimet e instalimeve të shërbimeve të telekomunikacionit janë përgjegjësi e operatorëve, Komuna nuk është përgjegjëse për vlerësimin e kapaciteteve të tyre financiare.

3.4.7. Infrastruktura e grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave

Përparësitë	Dobësitë
Ekzistenca e deponisë mbron ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësore	Moszbatimi i dënimeve për hedhje të jashtëligjshme të mbeturinave



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Pozita qendrore e Ferizajt dhe ndërtimi i autoudhës së re favorizon Komunën për ndërtimin e një pike qendrore të riciklimit për Republikën e Kosovës	Mungesa e ofrimi të shërbimeve për të gjithë banorët e Komunës, përkatësisht 35% të territorit
	Mungesa e përzgjedhjes së mbeturinave për riciklim
	Moszbatimi i ligjit për mbeturina nga Komuna
	Mungesa e lokacionit të përcaktuar për varrimin e shtazëve të ngordhura
	Mungesa e lokacionit të përcaktuar për mbeturina ndërtimore
	Menaxhimi adekuat i pikës e transferimit në Gurëz
Mundësitë	Kërcënimet
Riciklimi i mbeturinave	Ndotja e mjedisit nga deponitë

Tabela 170 SWOT analiza e infrastrukturës së grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave

3.4.7.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Kompania Regjionale për Mbeturina “Pastërtia” Sh. A. që është përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në Ferizaj, zbaton përgjegjësitë e saj me 14 kamionë, 2 traktorë, 3 autofshisa, 2 kamionë për pastrimin e borës, 3 autocisterna dhe 1 ngarkues.

- Kjo kompani ofron shërbime për:
- 58.50% të amvisërive, përkatësisht vetëm 10,740 ekonomi familjare nga gjithsejtë 18,359;
- 95.53% të bizneseve, përkatësisht 1,688 nga gjithsejtë 1,767; dhe
- 73.33% të institucioneve, përkatësisht 55 nga gjithsejtë 75.
- Mbulueshmëria e territorit me grumbullimin e mbeturinave është i pamjaftueshëm sepse gati gjysma e njësive të banimit përbrenda Komunës nuk kanë shërbime të grumbullimit të mbeturinave nga Kompania Regjionale për Mbeturina “Pastërtia” Sh. A., që ndikon dukshëm në ndotjen e mjedisit.

3.4.7.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Komuna në bashkëpunim me Kompaninë Regjionale për Mbeturina “Pastërtia” Sh. A., duhet të bashkëveprojë zgjerimin e grumbullimit të mbeturinave nga të gjitha vendbanimet rurale, që do të zvogëlonte ndotjen e mjedisit dhe sipërfaqeve ujore.

3.4.7.3. Kapacitetet e nevojshme

Pasi që investimet në zgjerimin e kapaciteteve të tyre të shërbimit janë përgjegjësi e operatorëve, Komuna nuk është përgjegjëse për vlerësimin e kapaciteteve të tyre financiare, mirëpo duhet që të përcaktojë lokacionet e përshtatshme për deponimin e mbeturinave ndërtimore dhe për varrimin e shtazëve të ngordhura.

Duke u bazuar në normat teknike, norma e gjenerimit vjetor të mbeturinave për kokë banori llogaritet të jetë 1 m³/banor në gjendje jo të ngjeshur, me rritje vjetore të vëllimit të mbeturinave të përlllogaritura për ciklin e planifikuar jetësor (kohëzgjatjen), llogaritet të jetë 2%.

Sipas prognozës maksimale të banorëve deri në 180,000 banorë gjatë 8 viteve të ardhme, kapacitet e nevojshme për deponimin e mbeturinave është 180,000 m³/banor.

3.4.8. Infrastruktura e rrjetit elektrik

Përparësitë	Dobësitë
Masterplani i miratuar i KEDS-it	Shumica e fshatrave kanë infrastrukturë të vjetruar
Nënstationet e tensionit të lartë dhe të mesëm plotësojnë nevojat aktuale	Mungesë e kapaciteteve të shpërndarjes, trafo dhe largpërçues
Stacioni 400kv në Sojevë	Vonesa e shfrytëzimit të energjisë së ripërtërishme



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Babushi, Gaçka, Jezerci dhe Komogllava kanë problem me tension të mesëm
	Mungesa e incizimit gjeodezi të rrjetit nëntokësor dhe mbitokësor
	Ndërprerje të shpeshta të furnizimit
Mundësitë	Kërcënimet
Zvogëlimi i humbjeve teknike dhe komerciale	Rrjeti ekzistues mbitokësor paraqet rrezik
Rritja e kualitetit të tensionit dhe siguria	
Ngritja e kapaciteteve ekzistuese dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja	
Kalimi në nivelin 20kV	
Marrja parasysh e zonave me zgjerim	
Ndërtimi i trafostacionit 110/10 (20) kV	
Krijimi i unazave energjetike përreth zonës urbane	
Shtimi i trafostacioneve 10/0.4 kV	
Identifikimi i sipërfaqeve të përshtatshme për shfrytëzimin e burimeve të ripërtërishme	

Tabela 171 SWOT analiza e infrastrukturës së rrjetit elektrik

3.4.8.1. Inventari i infrastrukturës ekzistuese

Rrjeti elektrik është i shtrirë në të gjitha vendbanimet e Komunës. Stacioni i 400KV në Sojevë paraqet një mundësi të mirë për furnizim të qëndrueshëm të rrymës elektrike në Komunë. Mirëpo, furnizimi me energji elektrike në Komunë karakterizohet me këto mangësi:

- Humbje të mëdha të energjisë për shkak të daljeve shumë të gjata në TM dhe TU, numrit të madh të TS-ve në një linjë dhe mungesës së balancës në TRD (>70% të ngarkuar, të ngarkuar<35%);
- Mungesë e sigurisë së furnizimit për shkak të pajisjeve të vjetërsuara, ndërtimeve të egra dhe linjave të gjata radiale me shumë degëzime të shtërngakuara;
- Cilësia e ultë e tensionit për shkak të humbjeve të mëdha teknike deri në 23.5% total, prej të cilave 15% janë humbje teknike dhe rënieve të mëdha të tensionit.

3.4.8.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike linjat mbitokësore dhe nëntokësore, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në bazë të vlerësimit të ndikimit të fushës magnetike dhe elektrike të krijuar nga rrjeti i linjave mbitokësore;
2. në largësi nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies⁹⁹.
 - 2.1. 40 m nga autoudhat;
 - 2.2. 20 m nga rrugët nacionale; dhe
 - 2.3. 10 m nga rrugët rajonale dhe lokale.
3. për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët kallkan të ndërtesës, nuk ka kufizim;
4. për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2.00 m;
5. për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1.00 m nga vija ndërtimore.

Duke marrë parasysh investimet e planifikuara, Komuna duhet të bashkërendis investimet kapitale në bashkëpunim me KEDS-in për të harmonizuar ndërtimin e rrjeteve të reja dhe infrastrukturën teknike dhe të transportit. Nevojitet të përcaktohet një lokacion i përshtatshëm për ndërtimin e një trafostacioni 110/10(20) që do të stabilizonte dukshëm furnizimin me rrymë. Në kuadër të këtij funksioni dhe me zgjerimin e ndërtimeve brenda zonave urbane nevojitet të përcaktohen lokacionet e përshtatshme për ndërtimin e trafostacioneve të reja 10/0.4 kV.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.5. Infrastruktura e transportit dhe transporti

Përparësitë	Dobësitë
Ne Komunë shtrihen të gjitha kategoritë e rrugëve publike	Mos zbatimi i udhëzimit administrativ për njerëz me aftësi të kufizuara
Shtrirja e hekurudhës në Komunë	Mungesa e trotuareve në rrugët publike rurale
Sistem efikas i dënimit të parkimeve ilegale	Korridorët qarkullimit publik shumë të ngushta
Monitorimi i parkingjeve ilegale përmes kamerave	Mungesa e shtigjeve për çiklistë
Autostrada ndikon në transportimin më të shpejtë të mallrave dhe lehtëson rrugët nacionale	Përafërsisht, 29 pikëkalime të binareve nuk janë të menaxhueshme
Ndërmarrja publike për menaxhimin e parkingjeve	Vetëm një kyçje për zonën urbane
Studimi i fizibiliteti për tre zona të reja të parkingjeve për zonë urbane	Hapësira dhe pozita e pamjaftueshme e stacionit të autobusëve
Përcaktimi i kërkesave për parkingje në kushte ndërtimore për të gjitha ndërtimet	Mungesa a vendndalimeve për transportin publik
	Kapacitet i vogël për parkingje
	Shtrirja jo-proporcionale e parkingjeve
	Bllokimi i rrugëve publike nga veturat e parkingut
Mundësitë	Kërcënimet
Planifikimi i rrugëve që do zvogëlonte numrin e pikëkalimeve të rrezikshme	Rastet fatale njerëzore dhe të shtazëve përgjatë hekurudhës, për shkak të mungesës së barrierave
Modernizimi i hekurudhës	Ndërtimi i autoudhës kufizon zhvillimin e blegtorisë
Krijimi i një qendremulti-modale të transportit publik	Kryqëzimet nuk janë sipas standardeve

Tabela 172 SWOT analiza e infrastrukturës së transportit dhe transportit

3.5.1. Shtrirja dhe gjendja e rrugëve ekzistuese

Për shkak të pozitës së saj qendrore në Republikën e Kosovës, Ferizaj qëndron shumë mirë sa i përket rrugëve të asfaltuara. Përafërsisht 1% e territorit është e mbuluar me rrugë të asfaltuara. Të gjitha vendbanimet kanë qasje në rrugë publike të asfaltuar. Me përjashtim të rrugës nacionale brenda zonës urbane, shumica e rrugëve janë në gjendje shumë të mirë. Rrugët në vendbanime urbane dhe rurale janë të mbuluara mjaftueshëm me rrugë publike. Në vendbanime rurale janë të shtruara 16.33 m² për kokë banori, gjersa në rrugët urbane 4.32 m² për kokë banori, që paraqet një mbulueshmëri të mirë me rrugë publike. Sa i përket rrugë në vendbanime rurale më së miri qëndrojnë vendbanimet vijuese:

Emri i vendbanimit	Numri i banorëve 2011	Sipërfaqja (m2)	Mbulueshmëria me rrugë asfaltuara (%)
Burnnik	46	53045.39	49.63%
Gurëz	323	228623.2	20.35%
Softaj	496	137054.31	17.43%
Rakaj	976	337202.92	15.71%
Jezerc	454	248942.44	14.96%
Balaj	992	236821.84	11.90%
Mirosalë	1,427	448704.88	10.67%
Varosh	2,483	859339.42	10.44%
Pojatë	1,047	283864.82	10.25%
Surqinë	222	78079.18	9.18%
Gaçkë	2,368	545234.86	8.77%
Mirash	1,883	574013.21	8.65%
Neredime e Epërme	3,718	332837.86	8.18%
Muhoc	686	302545.03	7.92%
Prelez i Jerlive	1,510	614733.18	6.99%



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Emri i vendbanimit	Numri i banorëve 2011	Sipërfaqja (m2)	Mbulueshmëria me rrugë asfaltuara (%)
Doganaj	1,100	240772.44	6.92%
Sazli	782	241789.88	6.39%
Slivovë	1,490	412344.76	6.12%
Neredime e Poshtme	1,648	406131.81	6.01%

Tabela 173 Radhitja e vendbanimeve rurale me mbulueshmëri të lartë me rrugë të asfaltuara

Gjersa vendbanimet rurale të cilat kanë pak rrugë të asfaltuara në raport me sipërfaqen e vendbanimeve janë të radhitura në vijim:

Emri i vendbanimit	Nr.i banorëve 2011	Sipërfaqja (m2)	Mbulueshmëria me rrugë asfaltuara (%)
Kosinë	1,082	377664.02	5.81%
Koshare	2,077	584539.57	5.76%
Talinoc i Jerlive	3,428	552455.57	5.69%
Bibaj	1,180	414971.65	5.64%
Rahavicë	1,257	384322.03	5.52%
Prelez i Muhaxherëve	982	316668.18	5.39%
Dremjak	1,235	271870.97	5.34%
Tërn	1,138	286083.69	5.20%
Bablak	258	243408.23	5.15%
Greme	4,421	1121359.89	5.11%
Babush	235	492446.79	4.91%
Lloshkobare	2,075	667628.55	4.81%
Fshat i Vjetër	992	503361.63	4.68%
Komogllavë	4,404	2300574.74	4.66%
Nikadin	1,337	692475.43	4.56%
Papaz	516	167025.24	3.97%
Pleshinë e Ep dhe e Po.	4,506	783323.72	3.78%
Zllatar	1,203	346206.1	3.55%
Dardani	2,096	1327424.51	3.33%
Sojevë	1,530	2464717.76	2.58%
Zaskok	643	400293.76	2.47%
Cërnillë	957	322367.89	2.16%
Talinoc i Muhaxherëve	1,961	1059594.91	1.51%
Manastircë	1,346	261171.47	1.43%

Tabela 174 Radhitja e vendbanimeve rurale me mbulueshmëri të ultë me rrugë të asfaltuara

Gjersa sa i përket zonës urbane vetëm 2.37% të sipërfaqeve urbane janë të mbuluara me rrugë të asfaltuara. Bazuar në projeksionet e banorëve për tetë vitet e ardhme, prioritet duhet të jetë asfaltimi i rrugëve për vendbanimet vijuese, të cilët pritet të rriten me numër të banorëve:

1. Neredime e Epërme;
2. Raka;
3. Varosh;
4. Pojatë;
5. Doganaj;
6. Slivovë; dhe
7. Talinoc i Jerlive.



3.5.2. Rrugët e planifikuara nga niveli qendror

Në Komunën e Ferizajt shtrihen shumë rrugë të planifikuara nga niveli qendror, të cilat zënë 211.47 ha të tërë territorit. Autoudha e re “Arben Xhaferi” shtrihet në 176.73 ha, gjersa rrugët nacionale në 17.81 ha dhe 16.94 ha në rrugët regjionale, të cilat lidhin shumë vendbanime rurale. Shumica e rrugëve të nivelit qendror janë në gjendje të mirë, me përjashtim të pjesës urbane të rrugës nacionale Prishtinë – Shkup, e cila është shumë e dëmtuar. Autoudha e re do të ndikon negativisht në zhvillimin e bujqësisë, në veçanti atë të blegtorisë, dhe tëzonës ekzistuese industriale dhe komerciale. Gjatë hartimit të këtij dokumenti ka filluar edhe ndërtimi i rrugës Prelez i Jerlive, Muhoc dhe Lloshkobare, që paraqet unazën e jashtme e Komunës dhe do të liroj dukshëm ngarkesën ekzistuese të automjeteve.

3.5.3. Intensiteti dhe kapaciteti i kryqëzimeve dhe korsive kryesore

Ndonëse me hapjen e autoudhës së re, lëvizja përgjatë rrugës nacionale Prishtinë – Shkup do të përmirësohet dukshëm, rrugët kryesore urbane ende mbeten shumë të ngarkuara me një shpejtësi mesatare të lëvizjes prej 5km/orë. Me përjashtim të rrugës nacionale, lëvizja në rrugët rurale është kryesisht e mirë dhe zhvillohet kryesisht sipas shpejtësive optimale të lejuara. Në mungesë të rrethrotullimit, kryqëzimi i unazës së re të brendshme dhe i nacionales Prishtinë – Shkup është shumë i rrezikshëm për ngasësit e automjeteve.

Përpos ndërtimit të unazës së brendshme në pjesën veriore të zonës, Komuna po ashtu ka zgjeruar edhe rrugën urbane në drejtim të rrugës “Joe Biden Jr.”, mirëpo kjo rrugë ngushtohen në drejtim të qendrës dhe ngadalëson shumë trafikun. Sa përket kryqëzimeve, shumica e tyre rregullojnë trafikun përmes rrethrotullimeve me përjashtim të një semafori të vendosur në udhëkryqin pranë stacionit të trenave.

Shumica e udhëkryqeve nuk kanë sinjalizim të mjaftueshëm dhe lëvizja e automjeteve nuk drejtohet nga policë të trafikut gjatë orëve të stërngakuara. Lëvizja e automjeteve vështirësohet edhe më shumë nga nxënësit gjatë periudhave të fillimit dhe përfundimit të mësimdhënies në shkolla fillore, të mesme dhe të mesme të ulëta.

3.5.4. Modelet e qarkullimit të trafikut

Përpos qarkullimit me automjete, Komuna e Ferizajt ka gjithashtu edhe transportin hekurudhor, i cili aktualisht funksionon me kapacitete të kufizuara. Duke marrë parasysh, që Republika e Kosovës synon të modernizojë hekurudhën, është shumë e rëndësishme që Komuna të bashkërendojë planifikimin me autoritetin Hekurudhat e Kosovës. Pas përfundimit të investimeve të parapara, zona përreth stacionit të trenave do të ngarkohet shumë me automjete dhe këmbësor që do të përdorin këtë mënyrë të transportit. Në anën tjetër, Hekurudha e modernizuar do të shërbej edhe për lëvizjen e mallrave, kështu që Komuna duhet të planifikojë një terminal për mallra në afërsi të kyçjes në autoudhën e re.

3.5.5. Linjat transportuesendërkomunale, urbane dhe rurale

Sa i përket transportit publik të mallrave dhe njerëzve, në dispozicion janë transporti hekurudhor dhe rrugor, përmes autobusëve dhe kamionëve. Ndonëse transporti hekurudhor aktualisht shërben vetëm për lëvizje të udhëtarëve, pas modernizimit të hekurudhës ekzistuese, në të ardhmen pritet të bëhet edhe transporti i mallrave. Sa i përket transportit ndërkomunal të njerëzve, shumica e udhëtarëve përdorin autobusin dhe trenin. Për shkak të numrit të madh të udhëtarëve ndërkomunal, stacioni aktual i autobusëve nuk plotëson nevojat hapësinore, kështu që nevojitet të përcaktohet një hapësirë më e madhe.

Transporti publik urban dhe rural përmes autobusëve numëron tre vija të qarkullimit dhe lidhë shumë fshatra me zonën urbane. Duke marrë parasysh se të gjitha shkollat e mesme të larta janë të vendosura në zonë urbane, është shumë e rëndësishme që këto lidhje të transportit urban të kalojnë sa më afër këtyre ndërtesave arsimore, duke i u përshtatur orarit të mësimdhënies. Mirëpo, përkundër numrit të konsiderueshëm të linjave transportuese, vendndalje të destinuara për këtë shërbim nuk ekzistojnë.



3.5.6. Shfrytëzimi i rrugëve

Përderisa gjatë ditës, rrugët në zonën urbane janë të stërngakuara me automjete, rrugët publike shfrytëzohen nga një numër i vogël i këmbësore dhe çiklistëve. Shumica e trotuareve janë të ngushta, në plotësojnë kriteret e parashtruara nga Udhëzimi Administrativ për Qasje nga Njerëzit me Qasje të Kufizuar dhe me shtylla të infrastrukturës teknike, kryesisht të rrymës, të cilat pengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve. Përkundër relievit të rrafshët dhe të përshtatshëm të për lëvizje me biçikleta, asnjë rrugë në zonën urbane nuk ka shtegun e veçantë për çiklistë. Shtigjet e veçanta për çiklistë po ashtu mungojnë edhe në rrugët rurale drejtë zonës urbane, të cilat do të mund të përdoren nga nxënësit e shkollave të mesme të ulëta.

3.5.7. Hapësirat ekzistuese për parkim

Ngjashëm me Komunitat tjera në Kosovë, edhe Ferizaj ballafaqohet me mungesë të hapësirave të mjaftueshme për parking. Duke marrë parasysh, që përafërsisht 60% të banorëve jetojnë në vendbanime rurale, transporti publik dhe parkingjet janë shumë të rëndësishme për Komunitetin e Ferizajt. Të gjitha parkingjet e analizuar, gjatë ditës janë të stërbushura me automjete dhe nuk kanë hapësira të lira për vendosjen e automjeteve shtesë.

3.5.8. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike, 3. minimumi i gjerësisë së profilit për infrastrukturën e rrugëve publike urbane. Këto gjerësi do të shërbejnë

gjatë përcaktimit të vijave rregulluese që përcaktojnë profilin e infrastrukturës rrugore publike janë:

- 3.1. Rrugë të rrjetit nacionale apo regionale- 23,00 m;
- 3.2. Rrugë transite urbane- 21,00 m;
- 3.3. Rrugë transite nëpërmjet vendbanimeve- fshatrave- 9,50 m;
- 3.4. Rrugë përmbledhëse/ shpërndarëse- 10,50 m;
- 3.5. Rrugë servitore- 9,00 m;
- 3.6. Rrugë banesore- 8,50 m;
- 3.7. Rrugë industriale- 10,00 m;
- 3.8. Rrugë qasëshe/ dy kahëshe- 5,50 m; dhe
- 3.9. Rrugë qasëshe/ një kahëshe - 3.5 m.

Bazuar në vlerësimet e sipërme, Komuna e Ferizajt ka nevojë të përqendrohet në krijimin e një strategjie të qëndrueshme të transportit, fillimisht duke prioritetizuar transportin publik përmes politikave hapësinore duke:

- Investuar në krijimin e shtigjeve të veçanta për transport publik dhe çiklistë;
- Zgjeruar trotuaret ekzistuese sipas Udhëzimit Administrativ për Qasje nga Njerëzit me Qasje të Kufizuar dhe duke larguar shtyllat ekzistuese;
- Përcaktuar një lokacion të përshtatshëm për stacionin e ri të autobusëve; dhe
- Krijuar hapësira të reja parkingu përmes PPP-ve.

3.6. Infrastruktura publike

3.6.1. Shërbimet mjekësore

Përparësitë	Dobësitë
Ofrimi i shërbimeve në gjitha lokalitetet	Mungesa e barnave esenciale



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Ekziston infrastruktura shëndetësore në gjithë komunën.	Numri i limituar i punëtorëve shëndetësor në raport me standardet
Shtëpia me bazë në komunitet për përkujdesje për personat me neçje në shëndetin mendor	Mos funksionimi i dy ambulanteve në dy lokalitete (Bablak dhe Babush)
Ekziston kuadri i mjaftueshëm	Hapësira e pa mjaftueshme e objekteve shëndetësore
Ekziston rrjeti i shëndetësisë private	Mungesa e ligjit për sigurime shëndetësore
Ofrimi i vizitave shtëpiake mjekësore	
Instituti i shëndetit publik	
Qendra e shëndetit mendor	
Ekziston shërbimi shëndetësor primarë dhe sekondarë.	
Mundësitë	Kërcënimet
Ndërtimi i spitalit të ri	Sëmundjet infektive
Ndërtimi i objektit të ri të institutit kombëtarë të shëndetit publik	Mungesa e menaxhimit adekuat të mbeturinave medicinale

Tabela 175 SWOT analize shërbimeve shëndetësore

3.6.1.1. Inventari i ndërtesave shëndetësore

Sipas strategjisë dhe standardeve të mjekësisë familjare, niveli qendror synon që ofroj një mjek familjar të kujdesit shëndetësor për 2000 - 2500 banorë, përmes shtrirjes territoriale dhe organizimit të QKMF-së përmes Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe Ambulantëve të Mjekësisë Familjare. Bazuar në këtë parim, Komuna e Ferizajt do të duhej të kishte së paku 43 mjekë të angazhuar në Qendrat e Mjekësisë Familjare dhe Ambulantet e Mjekësisë Familjare, mirëpo aktualisht janë të angazhuar vetëm 32 mjekë që ushtrojnë përkujdesje e mjekësisë familjare në 7 QMF dhe 12 AMF.

Vetëm 4 QMF dhe spitali gjenden përbrenda zonës urbane, gjersa sa i përket zonës rurale përkujdesja mjekësore familjare ofrohet përmes 3 QMF-ve dhe 12 AMF-ve, që paraqet një raport të mirë prej 1 pike të përkujdesjes mjekësore familjare për 3 fshatra, me rreze mesatare të mbulueshmërisë prej 10.5km. AMF në Loshkobare ka rrezen më të ultë të mbulueshmërisë prej vetëm 4km, gjersa më e larta është ajo e Mirash-it me 18km.

3.6.1.2. Vlerësimi i nevojave për ndërtime në të ardhmen

Sipas normave teknike, normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve shëndetësore të nivelitparësor janë si në vijim:

1. Numri i banorëve: 0.20 m²/banor.
2. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh): 50 %.

Numri total i njësive mjekësore do të varet nga projeksionet e popullsisë, shpërndarja e vendbanimeve dhe popullsisë si dhe nga nevojat e përgjithshme për kujdes dhe mjekim.

Distanca optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore:

1. Ndërtesat e qendrave të mjekësisë familjare: 10 km;
2. Ndërtesat e punkteve të mjekësisë familjare: 3 km.

Sikurse të gjitha Komunitet tjera, edhe Ferizaj ofron shërbime shëndetësore në bazë të numrit të lejuar të punonjësve që niveli qendror përcakton për secilën Komunë. Kështu që, Komuna aktualisht nuk ka mundësi që të shtojë numrin e personelit mjekësor dhe duhet të ri-organizojë strukturën e shërbimeve në rast se planifikon të ndërtojë ndonjë QMF apo AMF shtesë. Sa i përket zonës urbane, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal paraprak, Komuna ka 8 lagje urbane. Kështu që në të ardhmen nevojiten të ndërtohen edhe 4 QMF shtesë që do të plotësojnë nevojat e banorëve të secilës lagje urbane. Mirëpo, gjendja e ndërtesave të AMF-së në Loshkobare, Dardani dhe Mirosalë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

nuk është e mirë, kështu që Komuna duhet të shqyrtojë mundësinë për ri-ndërtimin e tyre apo zhvendosjen e këtyre shërbimeve në AMF-të të cilat gjenden në afërsi. Projektet e parapara për ndërtim të hapësirave për përkujdesje mjekësore janë të radhitura në vijim:

- Ndërtimi i Spitalit Rajonal për të cilin është destinuar parcela e përshtatshme nga Kuvendi Komunal;
- Ndërtimi i Qendrës së mjekësisë Familjare në fshatin Dardani ku gravitojnë MBI 10 000 banorë;
- Ndërtimi i QMF- së në fshatin Neredime për ofrim të shërbimeve shëndetësore për banorët e rrethinës;
- Ndërtimi i QMF-se në rrugën Kadri Zeka për ofrim të shërbimeve shëndetësore për 12000 banorë;
- Ndërtimi i institutit të shëndetit publik i cili po ashtu do të mbulojë regjionin me pesë komuna; si dhe
- Rrënimi i objektit ekzistues të Dispanseri i Rëntgenit dhe ndërtimi i një objekti shëndetësorë i cili do të funksiononte për shërbime laboratorike si dhe ato të Rëntgenit.

3.6.2. Ndërtesat arsimore

Përparësitë	Dobësitë
Ekzistojnë gjitha objektet për zhvillim të arsimit të gjitha niveleve	Mungesa e kabineteve profesionale
Ekzistimi i infrastrukturës për arsimin e lartë publik	Mungesa e sallave të kulturës fizike në gjitha shkollat
Ekzistimi i infrastrukturës së arsimit të lartë në sektorin privat	Mungesa e shkallëve emergjente
	Mungesa e infrastrukturës shëndetësore nëpër shkolla
	Mungesa e infrastrukturës përcjellëse në afërsi të shkollave
Mundësitë	Kërcënimet
Krijimi i qasjeve të lirë për nxënës me nevoja të veçanta	Fatkeqësitë elementare
Ndërtimi i sallave sportive nëpër shkolla	Paraqitja e dukurive devijuese
Hapja e paraleleve parashkollore	
Ndërtimi i çerdheve të reja	

Tabela 176 SWOT analiza e shërbimeve arsimore

3.6.2.1. Inventari i ndërtesave arsimore

Bazuar në gjendjen aktuale, shumica e vendbanimeve rurale kanë shkolla fillore dhe të mesme të ultë. Vetëm Bibaj dhe Dubrava nuk kanë shkollë fillore dhe të mesme të ultë. Një pjesë madhe e këtyre institucioneve arsimore në vendbanime rurale zhvillojnë mësimdhënien në dy ndërrime dhe nuk kanë sallë të mbyllur sporti për zhvillimin e lëndës së edukatës fizike. Shumica e shkollave fillore dhe të mesme të ulëta rurale nuk plotësojnë kriterin hapësinor të 8m² për nxënës.

	Vendbanimet rurale	Emri i shkollës fillore të mesme ultë	Sipërfaqja e ndërtuar (m ²)	Numri i nxënësve	m ² për nxënës	Sipërfaqja e nevojshme sipas kriterëve të MASHT (m ²)	Dallimi sipërfaqes mes kriterëve të MASHT dhe gjendjes ekzistuese (m ²)
1	Bablak	Tërrn 1	585	24	24.4	192	393
2	Balaj	Pavarësia	566	232	2.4	1856	-1290
3	Burrnik	Imri Halili 1 - Burrnik	245	3	81.7	24	221
4	Cërnillë (Rezare)	Halit Ibishi	281	199	1.4	1592	-1311
5	Dardania	Dituria	845	426	2.0	3408	-2563
6	Dramjak	Hajriz Muhadini	419	220	1.9	1760	-1341



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Vendbanimet rurale	Emri i shkollës fillore të mesme ultë	Sipërfaqja e ndertuar (m ²)	Numri i nxënësve	m ² për nxënës	Sipërfaqja e nevojshme sipas kriterëve të MASHT m ²)	Dallimi sipërfaqes mes kriterëve të MASHT dhe gjendjes ekzistuese(m ²)
7	Dramjak	Hajriz Muhadini 1	540	36	15.0	288	252
8	Doganaj	Naim Frashëri	253	247	1.0	1976	-1723
9	Fshat i Vjetër	Muharrem Shemsedini	593	501	1.2	4008	-3415
10	Gaçkë	Imri Halili	396	465	0.9	3720	-3324
11	Gërlicë	Besim Rexhepi	160	5	32.0	40	120
12	Greme	Enver Topalli	702	261	2.7	2088	-1386
13	Greme	Jeta e Re	1,779	511	3.5	4088	-2309
14	Jezerc	Skënderbeu	1,510	78	19.4	624	886
15	Jezerc	Skenderbeu 1	106	2	53.0	16	90
16	Komogllavë	Besim Rexhepi	1,113	451	2.5	3608	-2495
17	Komogllavë - Llugë	Besim Rexhepi 1	580	347	1.7	2776	-2196
18	Koshare	Deshmoret e Koshares	887	347	2.6	2776	-1889
19	Lloshkobare	Përparimi (Bilal Shala)	712	288	2.5	2304	-1592
20	Kosinë	Përparimi 1 (Bilall Shala) 1	554	93	6.0	744	-190
21	Manastircë	Dëshmorët e Lirisë	450	433	1.0	3464	-3014
22	Mirash	Ali Hadri	552	380	1.5	3040	-2488
23	Mirosalë	Mejdi Xhaferi	409	292	1.4	2336	-1927
24	Muhoc	Ganimete Tërbeshi 1	762	133	5.7	1064	-302
25	Nekodim	Rizah Matoshi	741	247	3.0	1976	-1235
26	Nerodime e Epër.	Konstadin Kristoforithi 1	517	26	19.9	208	309
27	Nerodime e Posht.	Konstadin Kristoforithi	1,051	328	3.2	2624	-1573
28	Papaz	Abetarja 2	714	40	17.9	320	394
29	Pleshinë	Pesë Dëshmorët e UÇK-së	468	352	1.3	2816	-2348
30	Pojatë	Abetarja 2	580	46	12.6	368	212
31	Prelez I Jerlive	Ismajl Qemajli	382	259	1.5	2072	-1690
32	Prelez I Jerlive	Ismajl Qemajli 1-	233	52	4.5	416	-183
33	Prelez i Muh.	Liman Rekaj	232	204	1.1	1632	-1400
34	Prelez i Muh.	Liman Rekaj 1	333	84	4.0	672	-339
35	Rahovicë	Kemajl Hetemi	540	209	2.6	1672	-1132
36	Rakaj	Dardania	410	242	1.7	1936	-1526
37	Sazlië	Abetarja 1	265	252	1.1	2016	-1751
38	Slivovë	Mic Sokoli	645	253	2.5	2024	-1379
39	Softaj	Abetarja	1,342	324	4.1	2592	-1250
40	Sojevë	Ramadan Rexhepi	410	288	1.4	2304	-1894
41	Talinoc i Muh.	Dy Dëshmorët	622	343	1.8	2744	-2122
42	Tërn (Trimi)	Tërrn	689	340	2.0	2720	-2031
43	Varosh	Visar Dodani	648	410	1.6	3280	-2632
44	Zaskok	Naim Frashëri	1,462	867	1.7	6936	-5474
45	Zllatar	4 Prilli	363	280	1.3	2240	-1877

Tabela 177 Raporti i sipërfaqeve ekzistuese në zonë rurale me kërkesat minimale hapësinore të MASHT



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Vendbanimet rurale	Emri i shkollës fillore të mesme ultë	Sipërfaqja e ndertuar (m ²)	Numri i nxënësve	m ² për nxënës	Sipërfaqja e nevojshme sipas kriterëve të MASHT (m ²)	Dallimi sipërfaqes në mes kriterëve të MASHT dhe gjendjes ekzistuese (m ²)
1	Zona Urbane 5	Afrim Abazi	1,200	252	4.8	-18%	2016
2	Zona Urbane 8	Astrit Bytyqi	1,900	642	3.0	-47%	5136
3	Zona Urbane 7	Vezir Jashari	1,100	783	1.4	-31%	6264
4	Zona Urbane 1	Tefik Çanga	1,547	1,300	1.2	-18%	10400
5	Zona Urbane 2	Ganimete Tërbeshi	794	739	1.1	-40%	5912
6	Zona Urbane 1	Jeronim De Rada	1,365	1,349	1.0	-16%	10792
7	Zona Urbane 5	Ahmet Hoxha	1,370	1,439	1.0	-40%	11512
8	Zona Urbane 1	Gjon Serreçi	1,600	2,551	0.6	-26%	20408

Tabela 178 Raporti i sipërfaqeve ekzistuese në zonë urbane me kërkesat minimale hapësinore të MASHT

Vendbanimi	Emri i institucionit arsimor	m ² /nxënës	+/-%
Kosinë	Përparimi 1 (Bilall Shala) 1	6.0	7%
Muhoc	Ganimete Tërbeshi 1	5.7	68%
Prelez i Jerlive	Ismajl Qemajli 1- Lagjja e Grajqe.	4.5	0%
Softaj	Abetarja	4.1	-46%
Prelez i Muhaxherëve	Liman Rekaj 1	4.0	-10%
Greme	Jeta e Re	3.5	-41%
Neredime e Poshtme	Konstadin Kristoforithi	3.2	-35%
Nikadin	Rizah Matoshi	3.0	-28%
Greme	Enver Topalli	2.7	-6%
Rahavicë (Rahishte)	Kemajl Hetemi	2.6	-42%
Koshare	Deshmoret e Koshares	2.6	-57%
Slivovë	Mic Sokoli	2.5	-64%
Lloshkobare	Përparimi (Bilal Shala)	2.5	-79%
Komogllavë	Besim Rexhepi	2.5	14%
Balaj	Pavarësia	2.4	-33%
Tërn (Trimi)	Tërn	2.0	-39%
Dardania	Dituria	2.0	-30%
Dremjak	Hajriz Muhadini	1.9	-64%
Talinoc i Muhaxherëve	Dy Dëshmorët	1.8	-43%
Rakaj	Dardania	1.7	-47%
Zaskok	Naim Frashëri	1.7	16%
Komogllavë - Llugë	Besim Rexhepi 1	1.7	-46%
Varosh	Visar Dodani	1.6	-26%
Prelez i Jerlive	Ismajl Qemajli	1.5	-62%
Mirash	Ali Hadri	1.5	-50%
Sojevë	Ramadan Rexhepi	1.4	-48%
Cërnillë (Rezare)	Halit Ibishi	1.4	25%
Mirosalë	Mejdi Xhaferi	1.4	21%
Pleshinë	Pesë Dëshmorët e UÇK-së	1.3	-48%
Zllatar	4 Prilli	1.3	-52%
Fshat i Vjetër	Muharrem Shemsedini	1.2	-17%
Prelez i Muhaxherëve	Liman Rekaj	1.1	-42%
Sazlië	Abetarja 1	1.1	-30%
Manastircë	Dëshmorët e Lirisë	1.0	-41%
Doganaj	Naim Frashëri	1.0	-23%



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Vendbanimi	Emri i institucionit arsimor	m ² /nxënës	+/-%
Gaçkë	Imri Halili	0.9	0%

Tabela 179 Insititucinet parauniversitare rurale të cilat nuk përmbushin kriteret hapësinore prej 8m²/nxënës

Bazuar në analizën sipërfaqeve dhe raportin e rritjes/rënies së numrit të nxënësve, duhet të sigurohet sipërfaqe shtesë për të gjitha shkollat e përfshira në tabelën e sipërme. Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta vijuese urbane janë të stërngakuara me numër të madh të nxënësve në zonë urbane dhe nuk plotësojnë kërkesën minimale hapësinore prej 8m²për nxënës. Komuna ka 8 shkolla të mesme të larta dhe shkollat vijuese. Shkollat vijuese të mesme të larta nuk plotësojnë kërkesën minimale hapësinore prej 6.5 m² për nxënës.

Vendbanimi	Emri i institucionit arsimor	m ² /nxënës	m ² /nxënës
Zona Urbane 5	Afrim Abazi	4.8	-18%
Zona Urbane 8	Astrit Bytyqi	3.0	-47%
Zona Urbane 7	Vezir Jashari	1.4	-31%
Zona Urbane 1	Tefik Çanga	1.2	-18%
Zona Urbane 2	Ganimete Tërbeshi	1.1	-40%
Zona Urbane 1	Jeronim De Rada	1.0	-16%
Zona Urbane 5	Ahmet Hoxha	1.0	-40%
Zona Urbane 1	Gjon Serreçi	0.6	-26%

Tabela 180 Institucionet parauniversitare urbane të cilat përmbushin kriteret hapësinore prej 6.5m²/nxënës

- Gjersa sa i përket çerdheve publike për fëmijë, Komuna ka vetëm 2 institucione të tilla.

3.6.2.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të arsimit parashkollor janë si në vijim:

1. Numri i fëmijëve:

1.1. Ndërtesat e çerdheve:

1.1.1. për një grup: 30 m²/fëmijë;

1.1.2. për dy grupe: 25 m²/fëmijë;

1.1.3. për tri grupe: 25 m²/fëmijë;

1.1.4. për katër grupe: 20 m²/fëmijë;

1.1.5. për dhjetë grupe: 40 m²/fëmijë;

1.1.6. për njëzet grupe: 30 m²/fëmijë.

1.2. Ndërtesat e kopshteve:

1.2.1. nga një deri në dy grupe: 24- 32 m²/fëmijë;

1.2.2. nga tri deri në katër grupe: 20- 25 m²/fëmijë;

1.2.3. nga pesë deri në gjashtë grupe: 18- 22 m²/fëmijë.

2. Numri i banorëve:

2.1. Ndërtesat e çerdheve: 0.30 m²/banor;

2.2. Ndërtesat e kopshteve: 1.00 m²/banor.

Të bazohen në projeksionet e kërkesave, faktorëve socio ekonomik, karakteristikave të hapësirës/ zones, si dhe gjendjes dhe kapacitetit të shërbimeve ekzistuese.

3. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh):

3.1. Ndërtesat e çerdheve: 30%;

3.2. Ndërtesat e kopshteve: 25%.

4. Distanca optimale shërbyese, respektivisht rrezja optimale shërbyese në vijë ajrore:

4.1. Vendbanime urbane:



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- 4.1.1. Ndërtesat e çerdheve: 300 m;
- 4.1.2. Ndërtesat e kopshteve: 500 m.
- 4.2. Vendbanime rurale:
- 4.2.1. Ndërtesat e çerdheve: 300 m;
- 4.2.2. Ndërtesat e kopshteve: 900 m.

Duke marrë parasysh projeksionet e numrit të banorëve dhe gjendjes së tyre institucioneve arsimore, prioritet duhet të jetë krijimi i hapësirave shtesë për mësimdhënie në vendbanimet vijuese rurale, të raditura në bazë të prioriteteve:

Prioritet i lartë	Prioritet i mesëm	Prioritet i ultë
Kosinë	Lloshkobare	Mirash
Muhoc	Komogllavë	Sojevë
Prelez i Jerlive	Balaj	Cërnillë (Rezare)
Softaj	Tërn (Trimi)	Mirosalë
Prelez i Muhaxherëve	Dardania	Pleshinë
Greme	Dremjak	Zllatar
Neredime e Poshtme	Talinoc i Muhaxherëve	Fshat i Vjetër
Nikadin	Rakaj	Prelez i Muhaxherëve
Rahavicë (Rahishte)	Zaskok	Sazlië
Koshare	Komogllavë - Llugë	Manastircë
Slivovë	Varosh	Doganaj
	Prelez i Jerlive	Gaçkë

Tabela 181 Nevoja për ndërtimin e shkollave fillore dhe të mesme të ulta në vendbanime rurale

Në zonë urbane, Komuna duhet të ndërtojë së paku tre shkolla fillore dhe të mesme të ultë për zonat vijuese urbane:

1. Zona urbane 3;
2. Zona urbane 4; dhe
3. Zona urbane 6.

Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta janë gjendje të shkollat vijuese janë gjendje të dobët fizike, janë të raditura në vijim:

- | | | |
|------------------------------|------------------------------------|--|
| 1. Jeronim De Rada - Ferizaj | 2. Besim Rexhepi Komogllavë | 3. Shkolla PNF në Gurëz |
| 4. Prilli – Zllatar | 5. Abetarja – Softaj | 6. Naim Frashëri – Zaskok |
| 7. Pesë Dëshmorët – Plashinë | 8. Skenderbeu – Lagja e Ukzmajlëve | 9. Konstandin Kristoforidhi – Neredime |

Gjersa sa i përket shkollave të mesme të larta, Komuna duhet të ndërtojë së paku edhe tre shkolla të mesme të larta. Komuna duhet të ndërtojë së paku edhe gjashtë çerdhe publike për fëmijë, për secilën lagje urbane që nuk ka një të tillë.

3.6.3. Posta

3.6.3.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Sa i përket shërbimeve postare, Posta e Kosovës shërben banorët e Ferizajt përmes pikave vijuese të shërbimit:

- 7 pika në zonë urbane;
- 2 pika në zonë rurale, në Babush dhe Doganaj.
- Andaj, zona urbane është mjaftueshëm e mbuluar me shërbime postare, gjersa në zonë rurale ofrimi i shërbime është mjaftë i kufizuar, veri në veri dhe jug.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.6.3.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Varësisht nga vizioni monocentrik apo policentrik, Posta e Kosovës në përputhje me Planin Zhvillimor Komunal do të ofrojë shërbime qytetarëve nga nënqendrat, varësisht nga planifikimi i Komunës. Duke marrë parasysh, që këto shërbime mungojnë, sugjerohet që krijohen së paku dy pika të reja të shërbimeve në vendbanimet rurale lindore dhe përqendrore.

3.6.4. Administrata publike

Përparësitë	Dobësitë
Ekzistojnë zyrat e gjendjes civile në lokalitete	Mungesa e hapësirave të mjaftueshme
Stafi i mjaftueshëm profesional	Objekti i komunës si i tillë nuk ka hapësira të mjaftueshme për kryerjen e punëve administrative
Infrastrukturë e mjaftueshme digjitale	
Mundësitë	Kërcënimet
Ofrimi i dokumenteve zyrtare për qytetarë në qytet dhe nëpër fshatra	Pakënaqësitë dhe protestat e qytetarëve
Ndërtimi i një objekti të ri të administratës ose zgjerimi i hapësirave ekzistuese	
Ofrimi i dokumentit për qytetarë në qytet dhe nëpër fshatra	

Tabela 182 SWOT analiza e shërbimeve të administratës publike

3.6.4.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Ofrimi i shërbimeve është në nivel të kënaqshëm dhe është mirë i shpërndarë për të ofruar shërbime administrative banorëve në zona rurale dhe urbane gjithashtu.

Mirëpo, brengosës është fakti që Komuna nuk ka asnjë E-kioskë të vendosur në tërë territorin e saj, që do të ofronte shërbime edhe jashtë orarit zyrtar të punës. Përpos ofrimit të shërbimeve 24-orë në ditë, E-kiosqet zvogëlojnë dukshëm ngarkesën e punëtorëve nga palët në zyre të gjendjes civile.

3.6.4.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike sipërfaqet minimale të parcelës së infrastrukturës së institucioneve administrative janë si në vijim:

1. Numri i banorëve:

1.1. Ndërtesat e institucioneve të administratës publike (me përjashtim të burgjeve): 0.62 m²/banor. Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

2. Indeksit të shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh):

2.1. Ndërtesat e institucioneve të administratës publike (me përjashtim të burgjeve): 80%.

Duke u bazuar në prognozën maksimale prej 180,000 banorë deri në vitin 2024, Komuna duhet të sigurojë një sipërfaqe prej 111,600 m² për administratë publike.

Përcaktimi i lokacioneve të përshtatshme dhe vendosja e së paku tre E-kiosqeve përbrenda territorit të Komunës.

3.7. Infrastruktura sociale

Përparësitë	Dobësitë
Ndërtesa e Muzeut	Gjendja fizike e vjetërsuar
Ndërtesa e Teatrit	Lumenjtë me sasi të vogël të ujit për zhvillimin e peshkatarisë
Ndërtesa e Galerisë	Pyjet përbrenda Komunës nuk kanë shtazë të mjaftueshme të egra për zhvillimin e gjuetisë
Ndërtesa e Bibliotekës	Mungesë e madhe të fushave sportive dhe lodrave publike për fëmijë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Ndërtesa e Kinemasë	
Mundësitë	Kërcënimet
Zhvendosja e muzeut të qytetit në ndërtesën e bibliotekës	Humbja e gjeneratave të reja të talentuara artistike dhe sportive
Financimi i festivaleve kulturore ndërkombëtare	
Ndërtimi i një objekti të ri të multi-funksional kulturor	

Tabela 183 SWOT analiza e infrastrukturës sociale

3.7.1. Ndërtesa kulturore

3.7.1.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Komuna ka një galeri arti, një muze të qytetit, një teatër, një kinema të qytetit dhe qendër kulturore, kështu që Komuna disponon mbulon të gjitha veprimtaritë kulturore. Mirëpo, në rast se Komuna dëshiron që të nxisë turizmin në këtë Komunë, gjendja e këtyre ndërtesave nuk është e kënaqshme për të tërhequr vizitorë të mjaftueshëm dhe për të zhvilluar një turizëm të qëndrueshëm kulturor. Ndërtesat ekzistuese nuk plotësojnë nevojat dhe teknologjike për zhvillimin e veprimtarive artistike për të cilat janë përcaktuar ato. Në veçanti, për shkak të festivalit tradicional të teatrit dhe “Kosovarja këndon”.

3.7.1.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Duke u bazuar në norma teknike normat minimale për sipërfaqen e parcelës të infrastrukturës së kulturës janë si në vijim:

1. Numri i banorëve:

1.1. Ndërtesat e bibliotekave: 0.25 m²/banor;

1.2. Ndërtesat e teatrove: 0.20 m²/banor;

1.3. Ndërtesat e kinemave: 0.20 m²/banor.

Të përcaktohen duke marrë parasysh karakteristikat e popullsisë, projeksione demografike, faktori gjeografik, shërbimet ekzistuese dhe funksionaliteti i tyre si dhe kërkesat për shërbime të reja.

2. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh):

2.1. Ndërtesat e bibliotekave: 60%;

2.2. Ndërtesat e teatrove: 80 %;

2.3. Ndërtesat e kinemave: 80 %.

Infrastruktura e institucioneve kulturore, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në pjesën/ pjesët qendrore të vendbanimeve;

2. në afërsi të shfrytëzimeve të ngjashme;

3. në parcela kadastrale për zhvillim të cilat mundësojnë zgjerim të mundshëm në të ardhmen;

4. në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;

5. në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;

6. në largësi më të madhe se 100 m nga ndërtesat e garazheve.

Duke marrë parasysh buxhetin dhe tokën komunale të kufizuar, Komuna duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një qendre multi-funksionale kulturore në të cilën do të vendosen galeria e re, teatri i ri, biblioteka e qytetit dhe kinematë. Duke marrë parasysh që kinematë tashmë janë kryesisht private, ndërtimi i këtyre hapësirave do të ndërtohej përmes PPP-së. Këto hapësira duhet të ofrojnë hapësira parkingu me pagesë në bodrum, që do të shërbenin për zbutjen e ngarkesës së madhe të automjeteve në qendër të qytetit. Krijimi i një qendre multi-funksionale do të siguronte prani të vizitorëve gjatë ditës dhe mbrëmjeve, duke siguruar vizita dhe qarkullim të vazhdueshëm të njerëzve, dhe duke ringjallur pjesë të anashkaluar të qytetit.

Duke u bazuar në projeksionet maksimale prej 180,000 banorë deri në vitin 2024, Komuna duhet të sigurojë një sipërfaqe prej:

- 45,000m² për biblioteka;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- 32,000 m² për teatro; dhe
- 32,000 m² për kinema.

3.7.2. Ndërtesat dhe hapësirat sportive

3.7.2.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Përderisa, shumica e infrastrukturës të sektorëve të ndryshëm komunal, qëndrojnë mirë, infrastruktura publike sportive dhe rekreative pothuajse nuk ekziston. Përderisa në zonën rurale ekzistojnë dy fusha sportive futbollit, në zonën urbane nuk ekziston asnjë fushë sportive publike, që do të krijonte mundësi për të banorët e rinj të merren me sport. Ndonëse në pjesën veriperëndimore të qytetit është përcaktuar një sipërfaqe e madhe për zhvillimin e fushave sportive, nuk ka pas investime kapitale për këtë pjesë. Duke marrë parasysh mungesën alarmante të fushave publike sportive, Komuna duhet të prioritetizohen hapësirat sportive, rekreative dhe lodrave për fëmijë.

3.7.2.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Duke marrë parasysh që Komuna ka përcaktuar 8 zona urbane, Komuna në periudhën vijuese 8 vjeçare duhet krijojë së paku tetë të hapura fusha sportive basketbolli dhe hendbolli dhe lodra fëmijësh për banorët e secilës zone urbane. Në mungesë buxheti dhe tokës Komuna duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për përmirësimin dhe ndriçimin e fushave të hapura sportive të institucioneve shkollore, të cilat pas orarit të punës mund të shfrytëzohen nga banorët e lagjeve përkatëse. Në rast se Komuna parasheh ndërtimin e sallave sportive për shkollat ekzistuese, fushat ekzistuese sportive duhet që të jenë në shërbim të banorëve të lagjeve.

Është thelbësorë që gjatë viteve të ardhme të investohet në infrastrukturën sportive në pjesën veriperëndimore, në mënyrë që të zhvillohet kjo zonë para se të tjetërsohet toka e destinuar përmes shfrytëzimeve tjera. Fillimisht mendohet të investohet në:

- Fushë e hapur futbollit të madh;
- Dy fusha të hapura futsalli/handbolli;
- Dy fusha të hapura basketbolli me nga katër kosha anësor;
- Katër fusha të hapura tenisi;
- Pishinë olimpikë të mbyllur;
- Shtegu olimpik i vrapimit;

3.8. Hapësira peshkimi

Gjendja e florës dhe faunës nuk është e kënaqshme, shkaktarë të kësaj gjendje janë: gjuetia e paligjshme dhe pa kriter, përndjekja dhe kapja e kafshëve me qëllim tregtie, shqetësimi i vazhdueshëm nga ana e njeriut, peshkimi i paligjshëm, prerja, djegia e pyjeve, ndotja e madhe e lumenjve nga shkarkimi i pa kontrolluar i ujërave të zeza.

Në territorin e komunës ka mundësi të ndërtimit të disa hurdhavetë peshqve, peshkataria do të kontribuojë përmirësimin të strukturës ushqimore të popullsisë. Përveç këto hurdhave krijonëkushte për rritjen e peshkut, në radhe të parë për nevoja sportive.

3.8.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Në komunën e Ferizajt aktualisht zona të peshkimit mundë të llogariten disa pjesë të rrjedhave të sipërme të lumit Neredime në të cilat peshkohet, por duhet të theksohet se ndotja e madhe e lumenjve ka bërë që shumë vende për peshkim në lumin Neredime të shuhen.

3.8.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Me kapacitetet hidrografike që i ka komuna e Ferizajt mundë të ndërtohen disa hurdhave të peshqve të cilat do të ndikonin në rritjen dhe zhvillimin e kësaj kulture si dhe do të shërbenin si sport.



3.9. Hapësira gjuetie

Në të ardhmen në komunën e Ferizajt mundë të caktohen hapësirat për gjueti nga shoqata e licencuar e gjuetisë, këtë hapësira mundë të jenë në bjeshkët e Jezercit dhe të Burrnikut duke pasur në konsiderim ruajtjen e llojeve shtazore të cilat janë në rrezik të zhdukjes në ato ekosisteme.

3.9.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Janë të evidentuara zonat në Jezerc, Neredime dhe Burrnik.

3.9.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Mundë të caktohen dy zona njëra të jetë në Neredime dhe Jezerc dhe tjetra në Burrnik dhe Gaçkë.

3.9.3. Bibliotekat

3.9.3.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Në zonën urbane, Komuna ka një Bibliotekë të qytetit e cila ka mesatarisht 350 vizitorë të rregullt.

3.9.3.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Ndonëse, kjo hapësira ekzistuese nuk plotëson kërkesat ekzistuese, sidomos ato të për të arkivuar publikimet ekzistuese, të cilat janë duke dëmtuar strukturën ekzistuese, sugjerohet që biblioteka ekzistuese të zhvendoset në qendrën e re multifunkionale, gjersa ndërtesa ekzistuese të shërbejë për muze të qytetit.

3.9.4. Ndërtesa komuniteti

Në kuadër të PZHK-së janë paraparë ndërtesa të cilat do të shkojnë në shërbim të komunitetit, në distanca sa më të shkurtra në kuptimin hapësinor dhe në rrugë sa më afër grupeve dhe kategorive të ndryshme sociale.

3.9.4.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Në pjesën e gjendjes ekzistuese Profilin komunaljanë të prezantuara gjitha ndërtesat në shërbim të komunitetit sipas kategorive.

3.9.4.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike, normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve të mirëqenies sociale dhe komunitetit janë si në vijim:

1. Numri i banorëve:

1.1. Ndërtesat e institucioneve për shërbime sociale dhe familjare: 0.25 m²/banor;

Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

1.2. Ndërtesat e institucioneve të komunitetit: 0.20 m²/banor.

Të përcaktohen në bazë të nevojës, duke pasur parasysh aspiratat e komunitetit dhe konsiderata të tjera relevante. Infrastruktura e institucioneve mirëqenies sociale dhe komunitetit, duhet të planifikohet në lokacione, si në vijim:

1. në terren të rrafshët;

2. në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;

3. në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;

4. në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore, hekurudhore dhe ajrore). Sipas analizës së gjendjes ekzistuese nevojitet që në secilin lokalitet që përbëhen nga disa vendbanime të ketë objekte në shërbim të komunitetit.

Duke u bazuar në projeksionet maksimale prej 180,000 banorë deri në vitin 2024, Komuna duhet të sigurojë një sipërfaqe prej:



- 36,500m² për shërbime sociale dhe familjare; dhe
- 23,000 m² për institucione të komunitetit.

3.9.5. Parqet publike

3.9.5.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Një tjetër aspekt shqetësues është mungesa e parqeve në zonën urbane. Përpos një parku të vogël pranë stacionit të autobusëve, në të cilin vërehet një investim simbolik, parqe tjera publike nuk ekzistojnë. Njëkohësisht, përgjatë rrugëve urbane publike vërehet mungesa e drunjve, të cilët do të përmirësonin cilësinë e ajrit dhe shëndetin e banorëve në zonën urbane pothuajse nuk ekzistojnë në pronë publike. Ekzistojnë disa drunj të mbjellur përgjatë binarëve të hekurudhës, mirëpo kjo sasi është e pamjaftueshme për të siguruar një mjedis të shëndetshëm.

Kështu që, Komuna duhet të investojnë shumë në krijimin e parqeve publike dhe mbjelljen e drunjëve gjatë 8 viteve të ardhme.

3.9.5.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike, Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së hapësirave të gjelbra janë si në vijim:

1. Numri i banorëve:

- 1.1. Parqet publike në kuadër të lagjes: 1.00 m²/banor;
- 1.2. Parqet publike në kuadër të vendbanimit: 2.00 m²/banor;
- 1.3. Brezat e gjelbër përgjatë rrugëve: 1.00 m²/banor;
- 1.4. Brezat e gjelbër përgjatë rrjedhave ujore: 2.00 m²/banor.

Në mënyrë që të krijohet një qytet në shërbim të të qytetarëve dhe mjedis i shëndetshëm, Komuna duhet investojë në një park publik për Ferizajasin e rinjtë dhe të moshuar. Duke marrë parasysh investimet e parapara të Komunës në pjesën veriperëndimore të qytetit, që është destinuar për rekreacion, masterplani i kësaj pjese duhet të integrojë edhe një park publik për ecje dhe piknik të banorëve që jetojnë në banesa kolektive.

Duke marrë parasysh që është propozuar që binarët hekurudhor përgjatë qendrës së qytetit do të vendosen në sipërfaqen aktuale, atëherë sipërfaqja ekzistuese mbi të cilën shtrihen binarët e hekurudhës, mund të përdoret për krijimin e një parku publik qendror në një të ardhme të afërme dhe të lidhet me pjesën rekreative në veriperëndim të kryeqytetit.

Duke u bazuar në projeksionet maksimale prej 180,000 banorë deri në vitin 2024, ku planifikohet që numri i banorëve në urbane të jetë 80,000 banorë, Komuna duhet të sigurojë një sipërfaqe prej:

- 180,000 m² park publik për tërë vendbanimin urban;
- 18,000 m² park publik në kuadër të secilës lagje urbane;
- 18,000 m² park publik në kuadër të Pleshinës e Epërme dhe e Poshtme, Greme, Komogllavë, Neredime e Epërme, Talinoc i Jerlive.
- 9,000 m² park publik në kuadër të Varoshit, Gaçkë, Dardani, Koshare, Lloshkobare, Talinoc i Muhaxherëve, Mirash, Neredime e Poshtme, Sojevë, Prelez i Jerlive, Slivovë, Dubravë, Mirosalë, Manastircë, Nikadin, Rahavicë, Dremjak, Zllatar, Bibaj, Tërn, Doganaj, Kosinë dhe Pojatë.
- 5,000 m² park publik në kuadër të Balaj, Fshat i Vjetër, Prelez i Muhaxherëve, Rakaj, Cërnillë, Sazli, Muhoc, Zaskok, Papaz, Softaj, Jezerc, Gurëz, Bablak, Babush, Surqinë dhe Burrnik.



3.9.6. Varrezat

3.9.6.1. Inventari i hapësirave ekzistuese

Përderisa shumica e fshatrave kanë hapësira të mjaftueshme për varreza, në zonën urbane varrezat ekzistuese të qytetit nuk plotësojnë nevojat e ardhme 8 vjeçare. Po ashtu edhe lokacioni i varrezave kryesore të qytetit nuk është i përshtatshëm, sepse është pranë zonës të destinuar për banim dhe institucioneve arsimore parauniversitare.

3.9.6.2. Nevojat hapësinore për të ardhmen

Sipas normave teknike, normat minimale për sipërfaqen e parcelës së varrezave janë si në vijim:

1. Numri i banorëve:

1.1. Varrezat: 1.50 m²/banor.

Të përcaktohen duke marrë parasysh kërkesën e shërbimeve dhe disponueshmërinë e ambienteve të përshtatshme.

2. Indeksi i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (ISHPKZh) e varrezave është 40%:

Për zonën urbane Komuna duhet të:

1. Shqyrtojë në bashkëpunim me bashkësitë fetare për mënyra alternative të varrimit, që do të zbuste ngarkesën e madhe për hapësira të reja në zonën urbane.

2. Në rast se Komuna vendos për të përcaktuar një lokacion të përshtatshëm, në zonë urbane, sipërfaqja pranë spitalit të ri regional paraqet një mundësi të mirë për krijimin e hapësirave të reja.

Gjersa sa i përket krijimit të hapësirave të reja në zonën rurale, lokacionet e reja duhet të jenë pranë ndërtesave fetare.

Duke u bazuar në projeksionet maksimale prej 180,000 banorë deri në vitin 2024, Komuna duhet të sigurojë një sipërfaqe prej:

- 150,000 m² për zonën urbane; dhe
- 100,000 m² për zonat rurale;



3.10. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Sfida e përgjithshme përballë ndotjes së mjedisit dhe fatkeqësive është parandalimi dhe reduktimi i fatkeqësive të shkaktuara nga faktori “njeri” dhe fatkeqësitë natyrore.

Bazuar në gjetjet nga hulumtimet në terren, sistemi ekzistues i kanalizimit kontribuon në rritjen e përmbytjeve dhe kontaminimin e ujërave nëntokësor. Një numër i konsiderueshëm i objekteve shfrytëzojnë pusët për ujë të pijshëm kështu që sistemi ekzistues i kanalizimit rrit rrezikun nga kontaminimi. Ndërtimi i infrastrukturës gjegjësisht rrugëve, sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe ujërave atmosferike do të minimizonte rrezikun nga kontaminimi i tokës dhe ujërave duke kufizuar zhvillimet do të mundësonte ruajtjen e brezit të gjelbër përgjatë lumit të Neredimës.

Komuna duhet të rritë kualitetin e menaxhimit të pyjeve përmes përmirësimit të mekanizmave ekzistues. Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për të marrë leje për prerjen e drurëve në pronën e tyre. Komuna do të mbështesë aktivitetet dhe projektet për rigjenerimin /ripyllëzim të zonave të degraduara.

Me qëllim për të parandaluar dhe për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive bazuar në rezultatet nga analizat e profilit, sfidat kryesore janë dhëne më poshtë:

Komuna e Ferizajt ka identifikuar kontrollimin e zhvillimit dhe përmirësimin e kushteve në zonat e prira për përmbytje, si një sfidë kryesore. Menaxhimi i duhur i shfrytëzimit të tokës dhe kufizimi i zhvillimit në zonat e prira për përmbytjeve do të ulë ndikimin e përmbytjeve dhe përmirësojë cilësinë e jetës së qytetarëve. Komuna ka identifikuar kërcënimet vijuese nga rreziqet natyrore:

- Përmbytjet;
- Tërmetet;
- Erozionet;
- Zjarret;
- Qetë endacakë.

Për shkak të lumenjve dhe përroskave që kalojnë përbrenda territorit të Komunës, nevojitet të krijohet një strategji e qartë parandalimin e kësaj dukurie negative.

Një tjetër sfidë për Komunën është që të zbatohet në mënyrë rigorozë kodi i ndërtimit për ndërtimet e reja, dhe të bëhet vlerësimi i objekteve publike (objekteve kritike) me qëllim për të minimizuar demet e shkaktuara nga tërmetet.

Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja është një sfidë tjetër.

Parandalimi i zjarreve dhe mbrojtja e banorëve dhe pronave është sfidë që duhet të tejkalohet. Ndërmarrja e aktiviteteve të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për parandalimin e zjarreve dhe ndërtimi i kapaciteteve për trajtimin e rreziqeve të shkaktuara nga zjarri do të minimizonte rreziqet e shkaktuara nga zjarret.

Ulja e shkallës së ndotjes në përgjithësi dhe menaxhimi mbeturinave dhe mbrojtjen e lumenjve nga degradimi i mëtejshëm është sfidë për mbrojtjen e mjedisit.



3.10.1. Mjedisi

Nga analiza e gjendjes në komunën e Ferizajt të bërë nga grupet punuese sa i përket Mjedisit, u konstatua se mbrojtja e mjedisit nuk është vetëm problematikë ekologjike ose teknologjike, por problematikë më e thellë dhe më e gjerë që shkon drejtë dimensionit social, e madje edhe politik. Meqenëse mjedisi përbën pjesën integrale të zhvillimit hapësinor, parashikohet që ai të planifikohet e jo vetëm që të merremi me eliminimin e pasojave në këtë drejtim, por ekipet kanë paraparë mbrojtjen e mjedisit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshirë krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin. Për këtë arsye, janë paraparë hapësirat e deponive në nivel vendbanimi, dhe nivel komunale. Janë paraparë masa edhe për amortizim të efekteve dhe mbrojtje nga ndotësit dhe kërcënuesit e tjerë mjedisor, si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor.

3.10.1.1. Ndotja e ajrit

Për minimizimin e ndotjes së ajrit si një nga komponentët kryesore të mjedisit duhet të merren këto masa në të ardhmen në komunën e Ferizajt:

- Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit, gazrave karbonike, metaleve të rënda përgjatë rrugëve kryesore siç shihet edhe në hartë.
- Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritja e parqeve të reja në hapësirat e identifikuar si të lira, dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve.
- Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të gazrave dhe aerosolëve të ndryshme.
- Përcaktimin e kriterëve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Ferizajt, nënqendrat.
- Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të makinave nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë.
- Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga industria dhe makinat lëvizëse, me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve të tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.
- Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia pjellore, rrjedhat e ujit dhe energjia gjeotermale).
- Minimizimin e shfrytëzimit të automjeteve dhe shfrytëzimin e transportit publik.
- Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe shtigjet për çiklist dhe ecje në këmbë, siç shihet në hartë.
- Planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (afër shkollave, spitaleve etj.)
- Rekonstruimi i rrugëve (qarkoreve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet mbeturinave etj.)..

3.10.1.2. Ndotja e ujit

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese, sa i përket cilësisë, resurseve dhe burimeve ujore, është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimin e nevojave për të sotmen, dhe për të ardhmen. Prandaj, është parashikuar që:

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale, termale dhe termo - minerale dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen siç shihet në hartën hidrologjike të komunës së Ferizajt, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona, nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Merren masat për moslejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërat e përdorura dhe të ndyta prej vendbanimeve, duke rekomanduar trajtim në dalje me grupa septike dhe forma tjera, vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.
- Merren masat për moslejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërat e përdorura dhe të ndyta që vijnë prej kapaciteteve industriale, duke montuar dhe kompletuar aparate pastrimi të ujërave të përdorura.
- Në të ardhmen, është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike, biologjike dhe kimike. Për këtë qëllim, është e nevojshme;
- Dokumentacioni investivo-teknik për industrinë e reja, duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale, nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.
- Nevojat e popullsisë për ujë, do të rriten vazhdimisht. Në periudhën e ardhshme, sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shëndoshë të pijes për popullsinë e kësaj komune, do të jetë edhe në të ardhmen problem serioz. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth, janë paraparë edhe në këtë dokument për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë. Është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, e rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Pos kësaj, shfrytëzimi racional i ujërave në këtë komunë, është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.
- Zonat të cilat duhet mbrohen nga ndotja për shkak të sensitivitetit të lartë.
- Akumulacionet e mundëshme në të ardhmën sipas zonave të përcaktuara në Planin Hapsinor të Kosovës janë akumulacioni i Shtimës dhe Firajës, që do të mundësonin furnizim më të mirë me ujë të zonave urbanë në të cilat shtrihet funksioni i këtyre akumulimeve dhe duhet të jenë në harmoni me zhvillimin e bujqësisë dhe furnizimin me ujë të pijshëm për zonën e Ferizajt.
- Të përcaktohen masat mbrojtëse për zonat e mbrojtura, si dhe zonat me ndjeshmëri më të lartë në Hartën Zonale të Komunës.

Duke marrë parasysh se PZHK është dokument strategjik, është analizuar dhe është marrë për bazë Planin Hapsinor i Kosovës dhe pikat rajonale për trajtimin e ujërave të ndotura. Bazuar në arsyeshmërinë dhe studimin e arsyeshmërisë (Raporti i Fizibilitetit për impiantet e ujërave të ndotura të hartuar nga WGY International) është konstatuar se variantet që janë analizuar janë shumë më të qëndrueshëm në aspektin social, mjedisor e sidomos funksional dhe financiar.

Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturinat (të gjitha tipet e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara, dhe të cilat kanë marrë parasysh këtë faktor, deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

3.10.1.3. Ndotja e tokës

Toka konsiderohet si një burim thelbësor dhe kryesisht jo i rinovueshëm, bazuar në analizën e grupeve punuese dhe gjerësinë e dijes dhe të kuptuarit e sistemeve të tokës dhe rolin kyç që luan toka brenda sistemit të gjerë të mjedisit, vazhdimi i humbjes së tokës do të kishte efekte shkatërruese në jetën tonë. Bujqësia dhe pylltaria dhe një varg aktiviteteve, janë të varura nga toka dhe këto do të kërcënoheshin, e deri te furnizimi me ujë dhe lëndë ushqyese për rritjen e bimëve dhe përkrahjen fizike të bimëve dhe të gjallesave tjera: një varg funksionesh e lidhjesh me ruajtjen e ekosistemeve. Për shkak të kësaj game të gjerë të funksioneve që kryhen nga toka dhe marrëdhëniet e saj me mjedisin tjetër, komponenta e tokës nuk është konsideruar si e izoluar, andaj në fazën e analizës iu është kushtuar rëndësi e veçantë. Për këtë arsye, parashihet: mbrojtje fizike dhe cilësore e tokës. Përpos mbrojtjes së ajrit dhe të ujit, parashohim edhe futjen e politikave për mbrojtjen e tokës për të siguruar "Lidhjen e humbur" në mbrojtjen e mjedisit edhe në komunën Ferizajt.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe të resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllimet jo bujqësore, me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar.
- Për të mundësuar prodhimtari të rregullt dhe të sigurt me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, botës bimore, shtazore dhe ambientit parashikohet mbrojtja e tokës bujqësore nga ndotja e cila planifikohet të bëhet me këtë plan;
- Planifikohet ujitje e tokës bujqësore dhe masa të tjera për të ngritur shkallën më të ultë të të përshtatshmërisë së tokës.
- Masa më të rrepta për ruajtjen e tokës bujqësore dhe me sensitivitet më të lartë;
- Planifikohet definimi i korridoreve të largpërçuesve 110 kV 220 kV dhe 400 kV për të cilët do të ruhen korridore ku do të ndalohen gjitha ndërtimet për lartëpërçuesin 110 kV 20 metra korridor, për lartëpërçuesin 220 kV 30 metra korridor dhe 40 metra për 400 kV;
- Planifikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave (shih hartën e vërshimeve dhe erozioneve) të toka e cila ka bonitet të lartë, dhe masa të tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit;
- Planifikohet që në zonat të cilat janë pa destinime (përpos banimit dhe ndërtimeve të përkohshme) të hartohen projekte rrikultivimi të tokës bujqësore;
- Planifikohet mbrojtja nga erozionet nga shpërlarja e elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimit dhe meliorimit të zonave të degraduara;
- Planifikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës përmes në tokat bujqësore, dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen amulloret ose mbetjet bimore).
- Planifikohet zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.
- Planifikohet rivitalizim i zonave ku janë shfrytëzuar pasuritë e ndryshme sipërfaqësore dhe nëntokësore, siç janë në Cërnillë dhe në Gurëz, etj.
- Në të ardhmen duhet të bëhet izolimi profesional i vendit ku është goditur me uranium të varfëruar.

3.10.1.4. Ndotja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve. Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë. Ndërtesat duhet të jenë të projektuara dhe e ndërtuara në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij intensiteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit Nr. 2004 / 15 për Ndërtim.

Gjatë kërkesave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla. Me rregulloren komunale duhet ndaluar kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera që me zhurmë pengojnë qetësinë dhe pushimin e njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga një orar i caktuar dhe veprimtari të caktuara.




Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.10.1.5. Sipërfaqet me ndotje të lartë

Sipërfaqet me ndotje të lart janë sipërfaqe në të cilat ka pasur të deponuara mbetje industriale dhe mbetje të materialeve të rrezikshme si dhe vendet ku është gjuajtur me uranium të varfëruar gjatë luftës së fundit në Kosovë. Në komunën e Ferizajt janë tetë vende kë është goditur me Uranium të Varfëruar në Ferizaj, Doganaj, në Gurëz në dy vende, Bibaj, Sojevo, Mirosalë dhe në Rahovicë.

Sipërfaqe të tilla në komunën e Ferizajt duhet që të izoloohen dhe rehabilitohen në mënyrë profesionale.



3.10.1.6. Masat e përcaktuara në Raportin e Vlerësimit Strategjik

3.10.1.6.1. Konceptet urbane të përdorimit të tokës, përfshi zhvillimin e qendrave

Në analizën vendbanimeve është vërejtur se në Ferizaj kemi problem me shtrirjen shumë disperse (objekte të shpërndara) të ndërtimeve të cilat më tutje paraqesin problem në ofrimin e infrastrukturës dhe elementeve tjera urbane. Cilësohet si problem me përmasa serioze zgjerimi i tokës ndërtimore në mënyrë spontane, pastaj shtrirja e ndërtimeve në tokat bujqësore sidomos në zonën përgjatë magjstraleve Shkup -Prishtinë, Ferizaj - Shtime sidhe në magjstralen Ferizja – Gjilan.

Harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës tregon destinimin për përdorim të tokës deri në vitin 2024. Këtu prezantohen edhe kufijt e rinj ndërtimor edhe zhvillime tjera. Kjo do të sjellë humbjen e mëtejshme të tokës bujqësore, por njëkohësisht do të sigurojë ruajtjen e pjesës së konsiderueshme të tokës me plleshmëri, tokës së pasur me resurse dhe pyjeve. Kemi të prezantuar edhe zonat e shënuara me ngjyrë e cila potencialisht mund të paraqesin pikat e nehta mjedisore.

Konfliktet e mundshme për hapësira mund të adresohen vetëm nëpërmjet zbatimit më të mirë të këtyre planeve. Masa e parë duhet të jetë arritja e një marrëveshjeje për mbrojtjen e këtyre zonave, e cila duhet të ndiqet nga plane rregulluese dhe tjera për komunën, të cilat do të vihen në zbatim. Kjo është një sfidë e madhe për qeverinë komunale, gjë që pranohet deridiku edhe në Planin Zhvillimor Komunal të Ferizajt. Gjatë procesit të hartimit janë organizuar takimet me komunitetin për të filluar këtë proces. Rreziku kryesor mjedisor do të ishte nëse nuk arrihet marrëveshja për një vizion të përbashkët për Ferizaj.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Zhvillimi dhe rritja e Ferizajt besohet se do të vazhdojë, e në fakt sa më shumë sukses ekonomik të prodhojë Ferizaj, aq më shumë do të përshpejtohet rritja e saj. Kjo do të ishte e dëshirueshme dhe është në të mirë të Kosovës, duke supozuar se realizohen investimet në infrastrukturën mjedisore dhe menaxhimi efektiv komunal, komuna e Ferizajt ka mundësi të akomodojë një numër shumë më të madh popullsie me zgjerimin e kufinjeve ndertimore dhe turisteve me zgjerimin e kapaciteteve receptive turistike. Burimet ujore nuk janë të mjaftueshme. Kapaciteti mjedisor mbajtës i Ferizajt nuk përbën problem, ndërkohë që problem përbëjnë menaxhimi dhe planifikimi urban jo-efektiv dhe nevoja për financimet mëdha në infrastrukturën mjedisore. Plani i nesh këto probleme dhe përpiket në mënyrë realiste të punojë brenda këtyre kufizimeve.

3.10.1.7. Ndikimi në klimë

Komuna e Ferizajt vlerësohet se nuk ka indikacione se me aktivitetin aktual dhe ate që do të ket në perspektivë të ndikoj në klimën globale, pasi që komuna e Ferizajt përpos fabrikës së tubave dhe disa industrive përpunuese të vogla nuk ka ndonjë industri apo objekt industrial që do të emitonte gazra të serrës në atë mas sa të ketë ndikim në klimën globale. Është e rëndësishme që të bëhen studime për të vlerësuar rritjen e temperaturës dhe faktorëve tjerë klimatik. Megjithatë komunikacioni hekurudhor dhe ai rrugor sidomos tani me ndërtimin e autostradës në mënyrë të pashmangshme do të shkaktojë një ndikim në mikroklimën rajonale duke ndikuar edhe në ngritjen e temperaturave dhe praninë e ndotësve në ajër, ujë dhe tokë.

3.10.1.8. Mbrojtja e pyjeve, zonave të gjelbra ekzistuese dhe zhvillimi i zonave të reja

Destinimet për shfrytëzim të planifikuar të tokës të propozuara nga PZHK-ja krijojnë mundësinë për struktura reja të pyjeve, kryesisht për përdorim të ndryshem, kështu duke krijuar edhe habitate natyrore dhe mjedisje atraktive. Komuna duhet që në kuadër të zbatimit të planit të ket në prioritet projektet si:

- Projekte pyllëzimi konform planit;
- Projekte ripyllëzimi dhe mirë mbajtje konform planit;
- Numrin e këtyre strukturave që do të lejohet dhe ku do të lejohet (apo nuk do të lejohet) ngritja e tyre;
- Projekte për ndërtim të infrastrukturës si rrugët malore melorim dhe drenazhim për pyjet, etj.
- Arkitekturën e tyre për të siguruar harmoninë vizuale me mjedisin rrethues;

3.10.1.9. Cilësia e ajrit

Plani Zhvillimor Komunal adresonë problemet ajrit në aspektin e ndotjes dhe cilësisë së tij. Prania e komunikacionit hekurudhor e autostradës "Arbën Xhaferi" dhe magjistrave Prishtinë – Shkup, Gjilan – Ferizaj dhe Ferizaj - Shtime në këtë komunë është një element që tregon se ka shkarkim të konsiderueshëm të gasrave në atmosfer, si dhe lirim të zhurmave të ndryshme që vijnë nga komunikacioni. Ndërkohë që rritja e parashikuar për trafikun në vitin 2024 do të bëjë që cilësia në përgjithësi e ajrit të përkeqësohet, veçanërisht për Pb, SO_x, NO_x, të cilat aktualisht janë brenda normave të BE-së dhe Kosovës. Zbatimi i standardeve më strikte për çlirimet në ajër nga automjetet, permiresimi dhe kontrolli i cilësisë se karburanteve menaxhimi më i mirë i trafikut, përfshire përdorimin e rritur të bicikletave, si dhe furnizimi i plotë me energji (për të ulur përdorimin e gjeneratorëve) ka shumë gjasa të ngadalësojnë përkeqësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit për një periudhë afat-shkurtër deri në afat-mesme. Grimcat e imëta PM₁₀ (të ngurta, të lëngshme ose gaz) mund të depërtojnë në mushkëri duke shkaktuar efekte të mëdha shëndetësore të tilla si sulmet në zemër, kanceri në mushkëri, bronkitin kronik dhe ndikimi më seriozi i katekut të moshuarit, fëmijët dhe diabetikët. Efekte të vogla shëndetësore përfshijnë. Këto efekte shëndetësore ndikojnë në cilësinë e jetës së çdokujt dhe ndërhynë në mirëqenien ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore të banorëve të komunës së Ferizajt. Duhet bërë vlerësimi i ndikimit të cilësisë së ajrit mbi shëndetin dhe ekonominë nëpërmjet llogaritjes së shkallës së semundshmerise me qëllim vlerësimin sasior të dëmit në shëndet dhe koston ekonomike



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

që sjell ndotja e ajrit për Komunën. PZHK-ja adreson mirë problemet e zhurmës, si dhe ka dhënë disa rekomandime dhe ka propozuar masa se si zhurma të reduktohet.

3.10.1.10. Rrugët e propozuara

Plani propozon një kategorizim të rrugëve lokale dhe ndryshim ose zgjerim të traseve të disa rrugëve regjionale dhe magjistraleve si dhe propozon unazën e jashtme komunale dhe unazën urbane. Komuna e Ferizajt është një territor tranzit në mes të qendrave nacionale vjen në shprehje edhe infrastruktura tjetër e cila diktohet nga niveli nacional dhe e cila ka impaktet më të larta mjedisore. Me probleme të përafërta përballen edhe rrugë të tjera të propozuara, të cilat kalojnë nëpër zona të gjelbra në të cilat janë masat adekuate për ruajtjen e tyre.

Rekomandimet që dalin nga VSM-ja janë:

- Definimi i koridoreve ekologjike gjatë realizimit të rrugëve të planifikuara;
- Studime mbi gjendjen e biodiversiteti dhe i habitateve natyrore në komunën e Ferizajt;
- Hartim i projekteve për rehabilitim të zonave me potenciale rrezatimi, por edhe planifikimi i mundësive për trajtimin e rrezatimit dhe uraniumit të varfëruar në vendet ku është goditur me bomba në luftën e fundit mendohet të paraqitet si një burim vazhdueshëm i ndotjes në komunën e Ferizajt;
- Harta i projekteve për rehabilitim të zonave erozive dhe të vërshimeve por edhe planifikimi i mundësive, masave dhe projekteve për trajtimin e Erozionit dhe Vërshimeve në aspektin e zonave dhe shkallëve të erozionit;
- Definimi i zonave ekonomike në aspektin e tipit të industries apo afarizmit dhe krijimit të bazave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishme të zonave duke ofruar bazat për trajtim të zonave ekonomike me masa fizike, natyrore dhe teknologjike që të jetë miqësor edhe në aspektin mjedisor;
- Të bëhen projekte duke u bazuar edhe në PZHK vendet dhe mundësit, projektet dhe zhvillime për pyllëzim dhe ripyllëzim si masa të rëndësishme mjedisore;
- Projekte për rehabilitim të zonave, vijave ose mundsist edhe pikave të zeza të ndotura nga mbeturinat dhe planifikohen mundësi trajtimi edhe se është përmend riciklimi si një mundësi por ka edhe mundësi tjera, definimi i hapësirave për deponi tranzite dhe sistemit të grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave dhe proceset tjera;
- Definimi dhe trajtimi si zona konform standardeve dhe ligjeve në fuqi për ujrat nëntokësor dhe sipërfaqësor;
- Definimi dhe trajtimi i koridoreve transportuese në aspektin mjedisor;
- Definimi i pejsazheve, parqeve dhe monumenteve tjera me vlera ose ndikime mjedisore dhe parashikimi i masave;
- Trajtimi i ngrohjes së qytetit të Ferizajt por edhe vendbanimeve si një dimension i rëndësishëm i ndotjes dhe ndikimit në ekosisteme;
- Definimi dhe trajtimi i zonave të pasura me florë dhe faunë.



3.10.2. Sipërfaqet me rrezikshmëri

3.10.2.1. Përmbytjet

Historikisht, sikur edhe në vendet tjera në rajon, zvogëlimi i dëmeve si pasojë e përmbytjeve ka qenë i fokusuar më shumë në teknikat e mëparshme, që kishin të bënin me shmangien e përmbytjeve duke ndërtuar struktura për kontrollimin e tyre siç janë ndërtimi i digave kontrolluese, brigjeve dhe modifikimi i kanaleve. Megjithatë masat e tilla të kontrollit nëpërmjet strukturave, kanë rezultuar si jo të suksesshme gjatë kohës.

Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet në prona mund të menaxhohen ose nëpërmjet mosshfrytëzimit për ndërtim (kufizim zhvillimi) në zonat e prira për përmbytje.

Meqë përmbytjet hyjnë në grupin e fatkeqësive të cilat mund të paralajmërohen, me anë të parashikimit të motit, kështu që zvogëlimi i dëmeve materiale të shkaktuara nga përmbytjet mund të bëhet duke marrë masat adekuate, siç janë: vendosja e thasëve me rërë përgjatë brigjeve të lumit, zhvendosja e të mirave materiale nga niveli i cili mund të përmbytet etj.

Në mënyrë që të mënjanoen dëmet nga përmbytja në të ardhmen, Komuna duhet të:

- Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.
- Rregullimi i sistemit të drenazimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.
- Përmirësimi i shtratit të lumit për të dy degët e bifurkacionit
- Ndërtimi i sistemit të drenazimit në zonën hapësirave të lira për rekreacion te Gjymnazi.
- Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit në segmentin të "Ura e Dudit" dhe më poshtë.
- Pastrimi, rregullimi dhe mbulimi i pjesshëm i kanalit.

3.10.2.2. Erozioni dhe sedimentimi

Territori komunës së Ferizajt është kryesisht i rrafshet megjithatë, është e nevojshme për të ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin dhe uljen e shkallës së erozionit gjatë zhvillimeve të reja. Në zonat ku është shkalla e lartë e erozionit duhet pyllëzuar dhe ndërtimi i barrierave aty ku është e nevojshme. Për të arritur këtë strategji veprimet e planifikuara janë paraqitur më poshtë.

3.10.2.3. Rrëshqitjet e tokës

Në Komunë nuk janë shënuar raste të rrëshqitje të tokës.

3.10.2.4. Ortekët dhe shpatet e pjerrëta

Në Komunë nuk janë shënuar raste të ortekëve.

3.10.2.5. Tërmetet

I tërë territori i komunës së Ferizajt është i rrezikuar nga ndikimi i tërmeteve me intensitet të ndryshëm. Hartat sizmike, të cilat janë pjesë e këtij dokumenti përcaktojnë nivelin e intensitetit të tërmetit për një periudhë të caktuar të kthimit. Për objektet banuese përdoren hartat me periudhë të kthimit 475 vite. Ndërsa, te objektet me rëndësi më të madhe siç janë pendët, përdoren hartat më periudhë të kthimit 1000 vite.

Shfrytëzimi i këtyre hartave gjatë fazës së projektimit dhe zgjidhjes së lokacionit, përdorimi i koeficienteve adekuat gjatë llogarisë së objektit dhe respektimi i rregullave bazë për objektet me rezistencë ndaj tërmeteve do të kishte kontribut të jashtëzakonshëm në zbutjen e ndikimit të tërmeteve në objektet kritike dhe objektet tjera.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Qëllimi kryesor i përfilljes së rregullave për ndërtim rezistent apo të qëndrueshëm ndaj tërmetejeve është që në rast të ndonjë tërmeti në të ardhmen të mos ketë humbje në njerëz si dhe dëmet materiale të jenë sa më të vogla dhe të riparueshme.

3.10.2.6. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarri

Çdo objekt të cilit i jepet leja e ndërtimit duhet të posedojë edhe planin e evakuimit në rast të zjarrit. Ky aprovim jepet nga zyrtarë të profesionalizuar komunal. Nëse objekti nuk e ka këtë plan, atëherë leja e ndërtimit duhet të ju pezullohet. Banorët në ndërtesë duhen të jenë të vetëdijshëm për këtë plan dhe vend ndodhjen e hidrantëve në objektin ku ata jetojnë.

Në zonën rurale ka nevojë për ngritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të parandaluar si zjarret në pyje, sidomos në stinën e verës. Këto duhet të bëhet me aktivitete për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve, përmes fletushkave, prezantimeve, edukimit të fëmijëve në shkolla, simulimeve të ndryshme etj.

3.10.2.7. Masat e nevojshme të parandalimit dhe mbrojtjes

Në mënyrë që të parandalohen përmytjet në të ardhmen, Komuna duhet të ndërmarrë veprimet vijuese:

- Ndalimi i ndërtimeve në zona të rrezikuara nga përmytjet;
- Rregullimi dhe mirëmbajtja e shtretërve të lumenjve të cilat shkaktojnë përmytjet;
- Ndërtimi i rrjetit të drenazhimit në zona të rrezikuara nga përmytjet;
- Ri-pyllëzimi i zonave në shpatet pranë zonave të rrezikuara nga përmytjet;

Në mënyrë që të parandalohen fatalitetet dhe dëmet materie nga tërmetet në të ardhmen, Komuna duhet të ndërmarrë veprimet vijuese:

- Përcaktimin e kushteve ndërtimore dhe mbikëqyrjen rigoroze gjatë ndërtimit të tyre;
- Përcaktimi i zonave të evakuimit në rast të tërmetit;
- Hartimi i hartave mikro-sizmike për të gjitha zonat urbane;
- Identifikimi i ndërtesave të cilat janë të rrezikuara nga tërmeti.

Në mënyrë që të parandalohen fatalitetet dhe dëmet materie nga zjarri në të ardhmen, Komuna duhet të ndërmarrë veprimet vijuese:

- Planifikimi dhe ndërtimi i hidrantëve në zonat urbane;
- Përcaktimi dhe krijimi i zonave mbrojtëse në zonat rurale ku rastet e zjarrit janë dukuri që shpeshherë paraqitet;
- Vetëdijesimi i banorëve të zonave të rrezikuara nga zjarri;
- Përcaktimin e kushteve ndërtimore që mundësojnë qasjen e papenguar nga zjarrfikësve në ndërtesa;

Në mënyrë që të mbrohet mjedisi, Komuna duhet të ndërmarrë veprimet vijuese:

- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara;
- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësore përgjatë brigjeve të lumenjve dhe rrugë publike që lidhin zonën urbane me fshatrat fqinje;
- Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave (riciklimin, selektimi i mbeturinave);
- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

3.11. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Përparësitë	Dobësitë
Jezerci si resurs natyror me peizazhe	Mungesa e infrastrukturës
Peizazhe të bukura	Mungesa e rrugëve që i lidhë lagjet mes veti
Bimësi e llojllojshme	Emigrimi, depopullimi
Lumi i madh	Mungesa e studimeve në këtë fushë
Lumi i vogël	Mungesa e turistëve me qëndrim shumëditor
Vend arkeologjik	Mungesa e festivaleve ndërkombëtare
Mundësitë	Kërcënimet
Zhvillimi i turizmit malor	Kapacitete të pamjaftueshme hoteliere
Zhvillimi i turizmit kulturor	
Zhvillimi blegtoral	

Tabela 184 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

3.11.1. Trashëgimia natyrore

Përparësitë	Dobësitë
Monument natyre Bifurkacioni	Keqpërdorimi i ujit
Lokaliteti i Dafne	Mos mirëmbajtja e mullinjve që ndodhen në dy degët e bifurkacionit
Trungjet e vjetra si monumente natyrore	Ndërhyrjet jo adekuate e faktorit njeri në monument natyror
Ujëvara në Jezerc	Ndërtimet e egra rreth brigjeve
Monument natyre Bifurkacioni	Mungesa e promovimit
Lokaliteti i Dafne	Mungesa e hulumtimeve
	Prerja e pa kontrolluar e pyjeve
	Shfrytëzimi i burimeve të ujit në mënyrë individuale nga banorët
Mundësitë	Kërcënimet
Zhvillimi i turizmit	Tharja e shtratit të lumit nga tejshfrytëzimi i ujit të lumit Neredime
Përcaktimi i zonës së mbrojtur	Dëmtimi i pakthyesëm i elementeve natyrore
Shpallja e monumentit Bifurkacionit monument i rëndësisë së veçantë	Humbja e vlerave së monumenteve dhe zonave natyrore
Definimi i kufirit të zonës së mbrojtur	

Tabela 185 SWOT analize asetëve të trashëgimisë natyrore

“Plani Hapësinor i Kosovës – Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010 – 2020+” ka përcaktuar Bifurkacionin e Neredimës dhe Arnenin në Neredime si lokacione të mbrojtura natyrore, mirëpo numri i vizitorëve nuk është i kënaqshëm. Në anën tjetër këto dy lokacione me vlera të rralla nuk janë të përcaktuara si sipërfaqe e mbrojtur. Gjersa pyjet në Jezerc, si trashëgimi natyrore nuk gëzojnë ndonjë status të mbrojtur hapësinor.

3.11.1.1. Rezervatet strikte

Në Komunë nuk ka rezervate strikte.

3.11.1.2. Monumentet natyrore

Në Komunë nuk ka monumente natyrore

3.11.1.3. Peizazhet natyrore

Përparësitë	Dobësitë
Shpella e Burrnikut – fshati Burrnik	Mungesa e infrastrukturës
Fshati Jezerc	Mungesa e një studimi për zonat e peizazheve
Peizazh i pyjeve të Burrnikut	Dëmtimi dhe degradime i pyjeve
Peizazh i pyjeve të Pleshina	Mungesa e shtigjeve për këmbësor
Peizazh i parkut “Liria”	Ndërtimet e egra
Peizazhi “fusha e madhe” Rahavicë-Mirash	Sinjalizimi, sensibilizimi



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Parku i pishave në Mirosalë	Mungesa e kampanjave informuese
Peizazh agrar ish Fidanishte	Mungesa e fondeve
Peizazh në Dremjak	Mungesa e pyllëzimit
Peizazh në Varosh	Hedhja e mbeturinave, deponitë e egra
Peizazh i staneve Greme dhe Burrnik	
Mundësitë	Kërcënimet
Zhvillimi i turizmit, zhvillimi ekonomik	Eksplotimi gurit
Mundësi për rekreacion	Ndërtimet e egra shkatërrojnë pamjet
Studime për zonat	Prerja dhe djegia e pyjeve
	Zjarrëvëniet

Tabela 186 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë natyrore

Komuna është e pasur me peizazhe natyrore pyjore, agrare, stane dhe shpella të cilat mund të zhvillohen në atraksione turistike në të ardhmen, mirëpo nuk gëzojnë mbrojtje ligjore dhe nuk janë të përcaktuara si sipërfaqe të mbrojtura. Mungesa e shpalljes së tyre sipërfaqe e mbrojtur, status ligjor hapësinor, përmes të cilës do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, vlera e tyre dhe mjedisi rrethues mund të degradohet në përmasa të padëshirueshme.

3.11.2. Trashëgimia kulturore

3.11.2.1. Trashëgimia arkitekturale

Përparësitë	Dobësitë
Objektet e trashëgimisë Fetare (xhamia, teqetë, kisha)	Mungesa e projekteve për restaurim
Objekt i stacioni të trenit	Sinjalizimi adekuat
Objektet e trashëgimisë arsimore (Shkolla "Jeronim De Rada", Biblioteka, shkolla e Pleshinës, Mejtepet	Konstruksionet e dobëta
Objektet e trashëgimisë administrative (Arkivi Historik i Ferizajt, Posta e vogël, gjykata e kundërvajtjes,	Mungesa e hulumtimeve në kuptimin e toponimeve
Objekte të trashëgimisë kulturore dhe sportive, Teatri i qytetit,	Restaurimi duke mos i respektuar standardet për mbrojtje të kësaj trashëgimie
Objekt të banimit shtëpia e Gjon Sereqit,	Ndërtimet në afërsi të këtyre objekteve
Mundësitë	Kërcënimet
Zhvillimi i turizmit	Humbja e këtyre objekteve
Fuqizimi i imazhit të qytetit dhe komunës	Dëmtimi i imazhit historik të qytetit dhe komunës

Tabela 187 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë arkitekturale

Komuna e Ferizajt ka shumë ndërtesa me vlera të trashëgimisë arkitekturale të cilat janë të shpallura nën mbrojtje të përkohshme dhe janë të paraqitura në pjesën e Profilit Komunal, mirëpo gjendje e tyre fizike kërkon investime për restaurimin e tyre. Përkundër faktit që ato janë shpallur nën mbrojtje të përkohshme, këto ndërtesa me vlera të trashëgimisë kulturore nuk e kanë të përcaktuar perimetrit dhe zonën mbrojtëse (bufer) ashtu siç e kërkon Ligji për Trashëgiminë Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkon Ligji për Planifikimin Hapësinor. Mungesa e shpalljes së tyre si sipërfaqe e mbrojtur sipërfaqe e mbrojtur në Planin Zhvillimor Komunal, përmes të cilës do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, vlera e tyre dhe mjedisi rrethues mund të degradohet në përmasa të padëshirueshme.

Komuna duhet të përcaktojë ndërtesat të cilat kanë nevojë për restaurim dhe të përgatis një plan të investimeve, për restaurimin e ndërtesave nën mbrojtje të përkohshme të cilat mund të bashkë-financohen me qeverinë qendrore apo organizata ndërkombëtare.

3.11.2.2. Trashëgimia arkeologjike

Përparësitë	Dobësitë
Lista e zonave arkeologjike të identifikuara	Mungesa e qasjes në ruajtjen e këtyre zonave



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Ndërtimet e egra në këto zona
	Zonat ndodhen në prona private
Mundësitë	Kërcënimet
Incizimet gjeofizike të këtyre zonave	Zhdukja si rezultat i ndërtimeve të egra
Projekte përstudim dhe hulumtim të këtyre vlerave	Mungesa e fondeve për sinjalizim dhe hulumtim
Shfrytëzimi i këtyre vlerave për turizëm	
Fuqizim i imazhit të Komunës	
Infrastruktura ligjore dhe prioritizimi	
Krijimi i Muzeut Arkeologjik për këto eksponate në Varosh	

Tabela 188 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë arkeologjike

Komuna e Ferizajt ka shumë ndërtesa me vlera të trashëgimisë arkeologjike, të cilat janë të shpallura nën mbrojtje të përkohshme dhe janë të paraqitura në pjesën e Profilit Komunal. Përkundër faktit që ato janë shpallur nën mbrojtje të përkohshme, këto ndërtesa me vlera të trashëgimisë kulturore nuk e kanë të përcaktuar perimetrin dhe zonën mbrojtëse (bufer) ashtu siç e kërkon Ligji për Trashëgiminë Kulturore, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkon Ligji për Planifikimin Hapësinor. Mungesa e shpalljes së tyre si sipërfaqe e mbrojtur në Planin Zhvillimor Komunal, përmes të cilës do të kontrollohen zhvillimet e ardhme në këto zona, vlera e tyre dhe mjedisi rrethues mund të degradohet në përmasa të padëshirueshme.

3.11.2.3. Trashëgimia shpirtërore

Përparësitë	Dobësitë
Artizanalet	Mungesa e festivaleve
Mitet	Mungesa e riparimeve të gjërave të vjetra
Legjendat	Mungesa e festivaleve të kësaj trashëgimie
Vallet (vallja e kaçakëve)	
Ritualet, Dasmata, Vdekjet	
Ushqimet tradicionale	
Tregimet e moçme (Meseletë)	
Besëtytnitë	
Lojërat tradicionale	
Festivali i valleve dhe muraleve	
Mundësitë	Kërcënimet
Ndarja e një buxheti të veçantë për këtë lloj të trashëgimisë	Harresa e kësaj trashëgimie
Krijimi i një trupe rezidente për kultivimin e kësaj trashëgimie	
Ndërtimi i një qendre informative	

Tabela 189 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë shpirtërore

Sikurse edhe shumë vise tjera të Kosovës edhe Komuna e Ferizajt është e pasur me trashëgimi shpirtërore, mirëpo mungojnë organizimet e ngjarjeve të cilat do të promovonin këto vlera, veçanërisht gjatë verës kur brezat e rinj të cilët janë lindur dhe jetojnë jashtë Republikës së Kosovës do të gëzonin mundësinë për të u njoftuar me trashëgiminë shpirtërore të Ferizajt. Në Ferizaj aktualisht, muzeu shërben si muze etnologjik dhe organizohet festivali vjetor i këngës, "Kosovarja Këndon".

3.11.2.4. Trashëgimia e luajtshme

Përparësitë	Dobësitë
Ekzistimi i muzeut	Mungesa e hapësirës së mjaftueshme
Lista e inventarit të kësaj trashëgimie	Mungesa e një objektit të veçantë
Kategorizimi i kësaj trashëgimie	Mungesa e informimit
Gatishmëria e popullatës për të bashkëpunuar në grumbullimin dhe inventarizimin e kësaj trashëgimie	



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Mundësitë	Kërcënimet
Ekspozita lëvizëse	Shkatërrimi i kësaj trashëgimie
Ndërtimi i një objekti të ri	Dëmtimi deri te humbja e vlerave për shkak të moskujdesit profesional.
Kampanja informuese	

Tabela 190 SWOT analiza e asetëve të trashëgimisë së luajtshme

Përkundër shumë shtrirjeve arkeologjike në Komunë, Ferizaj ende nuk ka një muze arkeologjik që do të vendoste eksponatet e gjetura në këtë rajon. Duke marrë parasysh, pozitën qendrore në Kosovë si dhe afërsinë me qendrën turistike Brezovicë, Komuna do të përfitonte shumë nga themelimi i një muzeu arkeologjik që do të ekspozonte gjetjet arkeologjike të këtij rajoni. Promovimi i vlerave kulturore të rajonit do të josthe turistët alpin si dhe kalimtarët e transit që të vizitojnë qytetin, duke nxitur zhvillim ekonomik përmes turizmit.

3.11.2.5. Peizazhet kulturore

Përparësitë	Dobësitë
Kisha dhe xhamia në një parcelë	Mos restaurimi i tyre
Sahat kulla	Ndërtimet në afërsi
Mullinj të ujë në Neredime	Ndërhyrjet jo adekuate
Panorama e kamerierit të hotel Lybeteni	
Xhamia e Gremës	
Manastiri i Shën Uroshit	
Mundësitë	Kërcënimet
Kampanja informuese	Humbja e kësaj trashëgimie
Sensibilizim rreth këtyre zonave	

Tabela 191 SWOT analiza e peizazheve kulturore

Nga të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, i vetmi lokalitet që gëzon mbrojtje të përhershme dhe ka zonat e definuara sipas ligjeve të Republikës së Kosovës është Manastiri i Shën Uroshit, që është shpallur Zonë e Veçantë e Mbrojtur. Sikurse edhe pasuritë tjera të trashëgimisë kulturore edhe peizazhet kulturore janë të papërcaktuara përmes përcaktimit të zonimit të perimetrit dhe zonës mbrojtëse si sipërfaqe e mbrojtur për të cilat do të zhvillohen kushte të veçanta zhvillimi.

3.11.3. Vlerësimi i ndikimit hapësinor

Trashëgimia natyrore dhe kulturore paraqet pasuri e cila duhet të mbrohet dhe zhvillohet për të nxitur zhvillimin ekonomik përmes turizmit dhe ndërkombëtarizimit të Ferizajt. Ruajtja dhe zhvillimi i kësaj pasurie të rrallë, përpos që do të shërbejë gjeneratat e ardhme për të njohur me civilizimin e një treve, në anën tjetër do të ndikojë në zhvillimin socio-ekonomik të banorëve dhe gjenerimin e vendeve të reja të punës.

Në mënyrë që të ruhet dhe zhvillohet pasuria e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, Komuna duhet të përgatis një plan të investimeve dhe përcaktimin e masave mbrojtëse përmes përcaktimit të zonave të veçanta dhe sipërfaqeve të mbrojtura për lokacionet të cilat janë shpallur nën mbrojtje të përhershme nga qeveria qendrore dhe lokacionet me interes lokal.

3.11.3.1. Parqet kombëtar

Fatkeqësisht, në Komunë nuk shtrihet asnjë Park Kombëtar të shpallur nga niveli qendror, mirëpo në afërdi gjendet Parku Kombëtar Sharr, i cili përpos që kontribuon në krijim e një peizazhi të bukur, ky park mund nxis zhvillimin e truzimit për vizitorët që vizitojnë atë. Mirëpo, në bashkëpunim me nivelin qendror, Komuna në bashkëpunim me Komunitat fqinje mund të nxis ecuritë për shpalljen e territorit pyjeve të Jezercit si Park Kombëtar, për të cilin do të zhvillohet një regjim i posaçëm i zhvillimit hapësinor për të krijuar një mjedis tërheqës për vizitor vendor, regional dhe ndërkombëtar.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.11.3.2. Sipërfaqet e mbrojtura

Fatkeqësisht, edhe pse Komuna është e pasur me trashëgimi kulturore asnjë pjesë e territorit të Komunës nuk është e përcaktuar si sipërfaqe e mbrojtur, të cilat janë kërkuar edhe me ligjin e vjetër por kërkohej edhe me ligjin e ri për planifikimin hapësinor.

Kështu që, përmes këtij Plani Zhvillimor Komunal, Komuna duhet që fillimisht të përcaktojë sipërfaqet e mbrojtura 50-100m nga perimetri i lokacioneve të cilat janë shpallur nën mbrojtje të përhershme nga qeveria qendrore dhe lokacionet që cilësohen me vlera të trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore të interesit lokal dhe pastaj përmes kushteve të veçanta zhvillimore dhe ndërtimore të ruaj mjedisin rrethues të këtyre lokaliteteve.

3.11.3.3. Zonat e veçanta

Sipas normave teknike. Në zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës ndalohen apo kufizohen aktivitetet në vijim:

1. Ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës;
2. Ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve;
3. Mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve;
4. Deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura;
5. Ndryshimi i regjimit të ujërave;
6. Përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike;
7. Kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës;
8. Mbjellja e monokulturave;
9. Grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre;
10. Shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia, peshkimi;
11. Veprimtaritë rekreative- sportive;
12. Vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera;
13. Aktivitete të tjera të cilat mund të rrezikojnë vlerën e mbrojtur të natyrës.

Në Komunë shtrihen zona dhe monumenti natyror i mbrojtur, të shpallura nga niveli qendror, Bifurkacioni Neredimës dhe Arneni në Neredime, në të cilat është investuar pjesërisht në të kaluarën.

Duke marrë parasysh shtrirjen e të këtyre dy zonave në afërsi të pyjeve të Jezercit, Komuna mund të shpall këto territore si Zonë e Veçantë e interesit lokal dhe të përgatis një Plan të Hollësishëm Rregullues, që do të përcaktojë një zhvillim të qëndrueshëm turistik dhe rekreativ, në shërbim të zhvillimit ekonomik.

3.11.3.4. Zonat e veçanta të mbrojtura

Në Komunë shtrihet vetëm një Zonë e Veçantë e Mbrojtur, Manastiri i Shën Uroshit, i cili është në gjendje fizike jo të mirë dhe nuk ka zhvillime negative në mjedisin rrethues të cilat prishin kuadrin peizazhor të Manastirit brenda zonës së përcaktuar të mbrojtur. Sikurse edhe brenda kufijve, po ashtu edhe jashtë kufijve të zonës së nuk ka zhvillime të cilat janë në kundërshtim me Ligjin për Zona të Veçanta të Mbrojtura. Aktivitetet e ndaluara brenda kësaj zone janë:

1. Ndërtimet apo zhvillimet industriale, të tilla si eksplorimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale dhe ndërtimi i digave, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave dhe fabrikave dhe rrugëve transite në zonat rurale.
2. Ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

Çdo aktivitet i ri nga lista e mëposhtme e aktivitetëve mund të kufizohet nëse e kërkojnë rrethanat. Para se të kryhen aktivitetet të tilla në fushat e mëposhtme, komuna do të kërkojë marrëveshjen e Kishës Ortodokse Serbe. Nëse nuk arrihet asnjë marrëveshje, palët do t'ia referojnë çështjen për shqyrtim, në pajtueshmëri me pikën c të nenit 4 të këtij ligji:



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

1. Ndërtimet apo zhvillimet komerciale të tilla si: strukturat ose godinat më të larta se manastiri, ndërtimi i rrugëve, ndërtimi i magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeterive, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të furnizimit me karburant dhe riparimit të automjeteve, supermaketeve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër në shkallë më të gjerë në zonat rurale;
2. Tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike
3. Urbanizimi i tokës bujqësore.



3.12. Vendbanimet

Përparësitë	Dobësitë
Pozita e mirë gjeografike e Ferizajt	Numri i madh i vendbanimeve të shpërndara
Magjistranja Shkup Prishtinë	Shtrirja e vendbanimeve në tokën bujqësore
Hekurudha	Mungesa e infrastrukturës cilësore
Infrastruktura e rregulluar në fshatra	Mungesa e qendrave për rekreacion dhe argëtim
Kufizohet me 7 komuna fqinje	Ekzistimi i objekteve fetare jashtë standardeve
Është qendër rajonale	
Lidhja e mirë me rrugë	
Mundësi e mirë për furnizim	
Resurse të mira natyrore, toka e mirë bujqësore	
Vendbanime me numër të madh të banorëve	
Mundësitë	Kërcënimet
Planifikimi i vendbanimeve në mënyrë policentrite	Migrimi nga fshati në qytet
Caktimi i zonave ekonomike në vendbanimet e mëdha	Zvogëlimi i numrit të nxënësve
Klasifikimi sipas specifikave të cilat i karakterizon vendbanimet (p.sh. Jezerca, Burrniku si vendbanime turistike)	Mos interesimi i të rinjve për zhvillimi e bujqësisë
Shëndrrimi i vendbanimeve të mëdha në nënqendra	

Tabela 192 SWOT analiza e vendbanimeve

Sipas normave teknike, në vijim strukturat e ndërtuara duhet të planifikohen sipas parimeve vijuese:

▪ **Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët**

Sipërfaqe rurale me intensitet të ulët mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë apo zonë mbishtresore që ka për qëllim mbrojtjen e sipërfaqeve të përshtatshme për bujqësi të shkallës së ulët, prodhim të kufizuar pyjor, mbarështim dhe kullosa të kufizuara të kafshëve, dhe zhvillim me intensitet të ulët që i përshtatet mjedisit rural. Është i përshtatshëm për sipërfaqet me karakteristikat e mëposhtme:

1.1.1. Toka nuk është e përshtatshme për bujqësi në shkallë të lartë ose prodhimtari pyjore për shkak të:

1.1.1.1. Kushteve marginale ose të dobëta të tokës, potencialit për erozion, shpateve të pjerrëta, mungesës së ujërave nëntokësore, ose kufizimeve të ngjashme fizike; ose

1.1.1.2. Prania e shfrytëzimeve jokompatibile ose parcelave me madhësi dhe konfiguracion jo të përshtatshëm për bujqësi; dhe

1.1.2. Sipërfaqes i mungon infrastruktura publike dhe shërbimet e nevojshme për të mbështetur zhvillimin më intensiv;

1.1.3. Tokë mbi të cilën është ndërtuar ose është e zotuar për shfrytëzim tjetër deri në atë shkallë sa më nuk është në dispozicion për mbrojtje apo rezervim.

Në përgjithësi, sipërfaqja rurale me intensitet të ulët përbëhet nga tokat dhe fermat e vogla familjare.

Shfrytëzimet e banimit mund të jetë të kufizuara në një apo dy njësi banimi në parcelë për familjet e fermës, që nuk tejkalojnë dendësinë e përgjithshme prej një njësi për hektarë në sipërfaqen rurale me intensitet të ulët.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Mund të sigurohen banim grupor shtesë për punëtorët sezoni të fermave.

Vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Maksimumi i kateve: banim 2; tjera: 3
2. Vlera Maksimale e (ISHPKZh): 10 - 40%
3. Vlera bazë e (ISN) /
4. Vlera maksimale e (ISN) 0.5
5. Dendësia e banimit: 5 - 10 banorë/ ha;

▪ Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë apo zonë mbishtresore për qëllimet e mëposhtme:

- 1.2.1. Inkurajimin e bujqësisë dhe pylltarisë si shfrytëzime dominuese të sipërfaqes;
- 1.2.2. Lejimi i prodhimit të produkteve komerciale bujqësore dhe të pylltarisë;
- 1.2.3. Lejimi i shfrytëzimeve jo-bujqësore dhe jo-pyjore siç janë minierat dhe guroret, vetëm pas konstatimit se shfrytëzimet e tilla do të sigurojnë ruajtjen e tokave bujqësore për përdorim dhe prodhim bujqësor dhe tokat pyjore për përdorim dhe prodhimtari pyjore;

Shfrytëzimet e banimit janë të menduara në radhë të parë për familjet me prona bujqësore dhe pyjore dhe punëtorët, si dhe për pronarët dhe punëtorët e bizneseve mbështetëse.

Vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Maksimumi i kateve për: banim 3; tjera: 4.
2. Vlera Maksimale e (ISHPKZh): 10 - 50%
3. Vlera bazë e (ISN) 0.1
4. Vlera maksimale e (ISN), 0.25
5. Dendësia e banimit: 25-50 banorë/ha;

▪ Sipërfaqja rurale e përgjithshme

Sipërfaqja rurale e përgjithshme është e menduar të mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë ose zonë mbishtresore për ushtrim të vazhdueshëm të bujqësisë komerciale për të garantuar ruajtjen dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të tilla. Është e përshtatshme për sipërfaqet me karakteristikat e mëposhtme:

- 1.3.1. Tokë e cila në nivel kombëtar është e përcaktuar si “e rëndësishme” ose “primare”;
- 1.3.2. Tokë ku veprimtaria mbizotëruese është bujqësia komerciale dhe ku zbatimi i këtyre vlerave numerike është i domosdoshëm për vazhdimësinë e veprimtarive të tilla; dhe
- 1.3.3. Tokë relativisht e lirë nga shfrytëzimet jo-bujqësore.

Shfrytëzimet e banimit janë të menduara për familjet pronare të tokave bujqësore dhe punëtorët, si dhe mund të përfshijnë bujtina pritjeje për turistët.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Numri maksimal i kateve 3
2. Vlera Maksimale e (ISHPKZh): 10 - 25%
3. Vlera bazë e (ISN) 0.25
4. Vlera maksimale e (ISN) 0.5
5. Dendësia e banimit: 1-5 banorë/ha;

▪ Sipërfaqe sub-urbane

Sipërfaqe sub-urbane është e menduar të mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë, ose zonë mbishtresore që zbatohet në atë sipërfaqe në të cilat toka përdoret, ose është e përshtatshme, për prodhimtari bujqësore ose pyjore, ose është kryesisht hapësirë e lirë ose e hapur me struktura të rastit dhe të shpërndara, por në të cilën në dokument të planifikimit hapësinor njihet se këto shfrytëzime janë të përkohshme, të cilat në fund do të hapin rrugë për zhvillim të shfrytëzimeve më intensive të tokës.

Zhvillimi i lejuar i banimit mund të karakterizohet me dendësi dhe mbulim relativisht të ultë të ndërtimit.

Vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Numri maksimal i kateve 2 - 4
2. Vlera Maksimale e (ISHPKZh): 30 - 50%
3. Vlera bazë e (ISN) 1.0
4. Vlera maksimale e (ISN) 2.0
5. Dendësia e banimit: 30 - 105 banorë/ha.

▪ Sipërfaqja urbane e përgjithshme

Sipërfaqja urbane e përgjithshme është e menduar të mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë, ose zonë mbishtresore për të mbështetur sipërfaqet e banimit me dendësi të ultë deri të mesme me shfrytëzime komerciale në shkallë të ultë. Disa shfrytëzime tjera, si publike dhe sociale, gjithashtu duhet të lejohen për aq kohë sa nuk kanë ndikim negativ në mjedisin për banim.

Vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Numri maksimal i kateve 3 - 7
2. Vlera maksimale e (ISHPKZh): 50 - 70%
3. Vlera bazë e (ISN) 2.5
4. Vlera maksimale e (ISN) 4.0
5. Dendësia e banimit: 105 - 200 banorë/ha.

▪ Sipërfaqe urbane qendrore

Sipërfaqe urbane qendrore është e menduar të mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë, ose zonë mbishtresore për të mbështetur shfrytëzimet me dendësi të mesme deri të lartë, si dhe shfrytëzimet tjera



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

kompatibile me intensitet të mesëm deri të lartë. Dendësia nuk është e rregulluar me numër maksimal të njësive banesore ose të banorëve për hektarë. Përkundrazi, madhësia maksimale e ndërtesave dhe intensiteti i zhvillimit rregullohet me kufizimet e Indeksit të Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN) dhe kushtet tjera zhvillimore.

Për komunat me popullsi më të madhe se (50,000), vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Numri maksimal i kateve /
2. Vlera maksimale e (ISHPKZh): 70%
3. Vlera bazë (ISN) 3.0
4. Vlera maksimale e (ISN) 5.0
5. Dendësia e banimit: /

▪ Sipërfaqe Urbane Kryesore

Sipërfaqe urbane kryesore është e menduar të mund të jetë një zonë, disa zona, nën-zonë, ose zonë mbishtresore e menduar për të siguruar zhvillim për banim dhe komercial brenda sipërfaqeve më urbane dhe intensive të komunës. Lejohet një gamë e gjerë e shfrytëzimeve për të pasqyruar rolin e komunës si qendër komerciale, banimi, kulturore dhe qeveritare. Qëllimi është që zhvillimi të jetë shumë intensiv me ndërtesa të mëdha dhe mbulueshmëri të lartë ndërtimi. Dendësia nuk është e rregulluar me numër maksimal të njësive apo banorëve për hektarë. Përkundrazi, madhësia maksimale e ndërtesave dhe intensiteti i zhvillimit rregullohet me kufizimet e Indeksit të Sipërfaqes së Ndërtuar (ISN) dhe kushtet tjera zhvillimore.

Për komunat me popullsi më të madhe se (100,000), vlerat optimale të planifikimit janë si më poshtë:

1. Numri maksimal i kateve /
2. Vlera maksimale e (ISHPKZh): 70-80%
3. Vlera bazë e (ISN) 4.0
4. Vlera maksimale e (ISN) 7.0
5. Dendësia e banimit: /

3.12.1. Vendbanimet rurale

3.12.1.1. Madhësia

Bazuar në të dhënat e analizuar të madhësisë së shtrirjes sipërfaqësore, janë identifikuar:

- 6 vendbanime të mëdha, +80 ha;
- 15 vendbanime të mesme 40 – 80 ha;
- 23 vendbanime të vogla -40 ha;
- Vendbanimet me sipërfaqe të madhe të shtrirjes janë:

Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia (ba/ha)	Lloji i shtrirjes
Sojevë	1,530	246.47	6.21	Linear
Komogllavë	4,404	230.06	19.14	Shkapërderdhur
Dardani	2,096	132.74	15.79	Linear
Greme	4,421	112.14	39.43	Shkapërderdhur



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia (ba/ha)	Lloji i shtrirjes
Talinoc i Muhaxherëve	1,961	105.96	18.51	Kompakt
Varosh	2,483	85.93	28.89	Shkapërderdhur

Tabela 193 Vendbanimet e mëdha rurale me sipërfaqe + 80 ha

▪ Vendbanimet me sipërfaqe të mesme të shtrirjes janë:

Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia (ba/ha)	Lloji i shtrirjes
Pleshinë e Epërme dhe e Poshtme	4,506	78.33	57.52	Shkapërderdhur
Nikadin	1,337	69.25	19.31	Linear
Lloshkobare	2,075	66.76	31.08	Shkapërderdhur
Prelez i Jerlive	1,510	61.47	24.56	Shkapërderdhur
Koshare	2,077	58.45	35.53	Shkapërderdhur
Mirash	1,883	57.4	32.8	Shkapërderdhur
Talinoc i Jerlive	3,428	55.25	62.05	Kompakt
Gaçkë	2,368	54.52	43.43	Shkapërderdhur
Fshat i Vjetër	992	50.34	19.71	Shkapërderdhur
Babush	235	49.24	4.77	Linear
Mirosalë	1,427	44.87	31.8	Shkapërderdhur
Bibaj	1,180	41.5	28.44	Shkapërderdhur
Slivovë	1,490	41.23	36.13	Shkapërderdhur
Neredime e Poshtme	1,648	40.61	40.58	Shkapërderdhur
Zaskok	643	40.03	16.06	Shkapërderdhur

Tabela 194 Vendbanimet e mesme rurale me sipërfaqe 40 - 80 ha

▪ Vendbanimet me sipërfaqe të vogël të shtrirjes janë:

Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia (ba/ha)	Lloji i shtrirjes
Rahavicë	1,257	38.43	32.71	Shkapërderdhur
Kosinë	1,082	37.77	28.65	Kompakt
Zllatar	1,203	34.62	34.75	Shkapërderdhur
Rakaj	976	33.72	28.94	Shkapërderdhur
Neredime e Epërme	3,718	33.28	111.71	Linear
Cërnillë	957	32.24	29.69	Kompakt
Prelez i Muhaxherëve	982	31.67	31.01	Kompakt
Muhoc	686	30.25	22.67	Kompakt
Tërn	1,138	28.61	39.78	Linear
Dubravë	1,472	28.56	51.54	Kompakt
Pojatë	1,047	28.39	36.88	Shkapërderdhur
Dremjak	1,235	27.19	45.43	Shkapërderdhur
Manastircë	1,346	26.12	51.54	Shkapërderdhur
Jezerc	454	24.89	18.24	Shkapërderdhur
Bablak	258	24.34	10.6	Shkapërderdhur
Sazli	782	24.18	32.34	Kompakt
Doganaj	1,100	24.08	45.69	Kompakt
Balaj	992	23.68	41.89	Kompakt
Gurëz	323	22.86	14.13	Linear
Papaz	516	16.7	30.89	Shkapërderdhur
Softaj	496	13.71	36.19	Shkapërderdhur
Surqinë	222	7.81	28.43	Shkapërderdhur
Burnnik	46	5.3	8.67	Linear

Tabela 195 Vendbanimet e vogla rurale me sipërfaqe - 40 ha



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

3.12.1.2. Funkcionaliteti dhe rrjeti ndërlidhës

Bazuar në Planin Zhvillimor paraprak të Komunës 8 vendbanimet vijuese rurale janë identifikuar si nënqendra sekondare:

- Prelez i Muhaxherëve;
- Zaskok;
- Sojevë; dhe
- Lloshkobare;
- Greme;
- Softaj.
- Neredime e Poshtme;
- Gurëz;

Mirëpo, përpos përcaktimit të fshatrave si nënqendra sekondare dhe hartimit të Planeve Rregulluese për to, të cilat ende nuk kanë filluar të përgatiten, kushte specifike zhvillimore për këto zona nuk ekzistojnë.

Duke marrë parasysh, që qëllimi i nënqendrave sekondare është për të i zhvilluar ato si qyteza me shërbime publike të zgjeruara. Përpos që do të lironin stërngarkimin e qytetit nga banorët e vendbanimeve rurale që vizitojnë qytetin për shkak të shërbimeve publike të cilat mungojnë jashtë qytetit.

Nënqendrat sekondare janë vendbanime me numër të lartë të banorëve, së paku 5,000 banorë, të cilat i shërbejnë së paku 18,000 banorëve të fshatrave rrethuese. Nënqendrat sekondare me shërbimet publike vijuese:

- Çerdhe publike;
- Qendër të mjekësisë familjare;
- Shërbime postare;
- Shkollë fillore dhe të mesme të ultë;
- Zyre të gjendjes civile;
- Shërbime bankare;
- Shkollë të mesme të lartë;
- Rrjet të transportit të shpeshtë publik;
- Treg.

3.12.1.3. Numri i banorëve

Në Komunë aktualisht janë gjithsejtë 45 vendbanime rurale, në të cilat gjatë vitit 2011 jetonin gjithsejtë 65,982 banorë apo 60.75% të numrit të përgjithshëm të banorëve. Përderisa, numri i banorëve gjatë 68 viteve numri i banorëve ishte vazhdimisht në rritje deri në vitin 1998. Për shkak të rrethanave të vështira ekonomike, shumë njerëz nga kjo Komunë migruan jashtë vendit apo drejtë kryeqytetit. Tjetër arsye për rënie në numrin e banorëve është edhe shpërngulja e 8,191 serbëve, 287 malazezëve dhe 177 kroatëve, të cilët përbënin përafërsisht 10% të banorëve të Komunës.

Vendbanimet	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Bablak	302	330	361	370	388	451	258
Babush	289	333	395	369	340	285	235
Balaj	416	466	551	687	941	1,400	992
Bibaj	255	305	341	443	592	794	1,180
Burrnik	355	398	442	450	398	530	46
Cërnillë	455	508	546	688	817	1,011	957
Doganaj	288	323	386	463	582	737	1,100
Dremjak	457	518	612	736	935	1,800	1,235
Dubravë							1,472
Fshat i Vjetër	249	242	250	393	679	795	992
Gaçkë	959	1,020	1,081	1,268	1,723	2,048	2,368
Gurëz	115	134	181	260	250	344	323
Greme	1,470	1,634	1,966	2,576	3,520	5,500	4 421
Jezerc	1,434	1,515	1,630	1,666	1,621	1,778	454
Komogllavë	1,386	1,594	1,851	2,499	3,118	3,551	4,404
Koshare	711	779	925	1,203	1,543	1,810	2,077
Kosinë	452	529	536	605	731	882	1,082
Lloshkobare	516	546	666	920	1,188	1,614	2,075
Manastircë	252	291	364	583	778	1,200	1,346
Mirash	861	932	1,093	1,231	72	73	1,883



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Vendbanimet	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Mirosalë	743	833	782	909	1,056	1,560	1,427
Muhoc	242	263	324	337	445	600	686
Nikadin	435	495	622	862	1,026	1,148	3,718
Neredime e Epërme	845	935	1,219	1,267	1,640	611	1,648
Neredime e Poshtme	586	669	750	945	1,302	1,584	1,337
Papaz	233	295	315	336	397	589	516
Pleshinë	1,025	1,184	1,416	2,035	2,877	3,624	4,506
Pojatë	309	335	407	597	720	797	1,047
Prelez i Jerlive	843	864	941	1,046	1,242	1,435	1,510
Prelez i Muhaxherëve	366	389	446	575	685	866	982
Rahavicë	568	631	877	938	976	1,301	1,257
Rakaj	199	215	164	302	583	759	976
Sazlië	544	573	582	597	716	900	782
Slivovë	482	537	633	806	1,138	1,411	1,490
Softaj	199	250	279	354	366	445	496
Sojevë	519	587	726	906	1,155	1,384	1,530
Surqinë	196	201	230	312	384	500	222
Talinoc i Jerlive	290	309	387	505	727	883	3,428
Talinoc i Muhaxherëve	613	648	652	878	1,126	1,600	1,961
Dardani	669	740	758	720	849	990	2,096
Tërn	560	627	625	716	798	1,100	1,138
Varosh	922	1,029	1,257	1,541	2,035	2,415	2,483
Zaskok	610	766	886	1,070	1,292	1,160	643
Zllatar	530	554	685	856	1,084	1,290	1,203
Qyteti i Ferizajt	6,685	8,165	11,665	22,239	37,723	45,645	42,628

Tabela 196 Numri i banorëve gjatë 68 viteve të fundit sipas vendbanimeve

Bazuar në analizat e numrit të banorëve vërehet se gjatë 68 viteve të fundit, vërehet dallime të mëdha në numrin e banorë në të gjitha vendbanimet. Mirëpo, vlen të theksohet që në Planin Zhvillimor Komunal paraparak një pjesë e konsiderueshme e Talinocit të Jerlive dhe Nikadinit janë pjesë të zonës urbane. Talinoci i Jerlive tashmë është pjesë e Zonës Urbane 2 dhe 3, gjersa Nikadini tashmë është pjesë e Zonës Urbane 6 dhe 7. Duke marrë parasysh shtimin e lartë të popullsisë, Dardania duhet të trajtohen me prioritet të lartë. Bazuar në analizat e numrit të banorëve vërehet se gjatë periudhës 1991-2011, numri i banorëve është shtuar deri me 50% në vendbanimet vijuese:

	Vendbanimet	1991	2011	Shtimi 20-vjeçar	Shtimi vjetor
1	Doganaj	737	1,100	49.25%	2.02%
2	Bibaj	794	1,180	48.61%	2.00%
3	Pojatë	797	1,047	31.37%	1.37%

Tabela 197 Vendbanimet të cilat janë shtuar deri më 50% banorë gjatë periudhës 1991-2011

Duke marrë parasysh shtimin të mesëm të lartë të popullsisë, gjatë periudhës 1991-2011, Doganaj, Bibaj dhe Pojatë duhet të trajtohen me prioritet të mesëm të lartë. Bazuar në analizat e numrit të banorëve vërehet se gjatë periudhës 1991-2011, numri i banorëve është shtuar deri me 30% në vendbanimet vijuese:

	Vendbanimet	1991	2011	Shtimi 20-vjeçar	Shtimi vjetor
1	Rakaj	759	976	28.59%	1.27%
2	Lloshkobare	1,614	2,075	28.56%	1.26%
3	Fshat i Vjetër	795	992	24.78%	1.11%
4	Pleshinë	3,624	4,506	24.34%	1.10%



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Vendbanimet	1991	2011	Shtimi 20-vjeçar	Shtimi vjetor
5	Komogllavë	3,551	4,404	24.02%	1.08%
6	Kosinë	882	1,082	22.68%	1.03%
7	Talinoc i Muhaxherëve	1,600	1,961	22.56%	1.02%
8	Gaçkë	2,048	2,368	15.63%	0.73%
9	Koshare	1,810	2,077	14.75%	0.69%
10	Muhoc	600	686	14.33%	0.67%
11	Prelez i Muhaxherëve	866	982	13.39%	0.63%
12	Manastircë	1,200	1,346	12.17%	0.58%
13	Softaj	445	496	11.46%	0.54%
14	Sojevë	1,384	1,530	10.55%	0.50%

Tabela 198 Vendbanimet të cilat janë shtuar deri më 30% banorë gjatë periudhës 1991-2011

Duke marrë parasysh shtimin të mesëm të popullsisë, gjatë periudhës 1991-2011, Rakaj, Lloshkobare, Fshat i Vjetër, Pleshinë, Komogllavë, Kosinë, Talinoc i Muhaxherëve, Gaçkë, Koshare, Muhoc, Prelez i Muhaxherëve, Manastircë, Softaj dhe Sojevë duhet të trajtohen me prioritet të mesëm. Bazuar në analizat e numrit të banorëve vërehet se gjatë periudhës 1991-2011, numri i banorëve është shtuar deri me 10% në vendbanimet vijuese:

	Vendbanimet	1991	2011	Shtimi 20-vjeçar	Shtimi vjetor
1	Slivovë	1,411	1,490	5.60%	0.27%
2	Prelez i Jerlive	1,435	1,510	5.23%	0.26%
3	Mirash	1,800	1,883	4.61%	0.23%
4	Tërn	1,100	1,138	3.45%	0.17%
5	Varosh	2,415	2,483	2.82%	0.14%

Tabela 199 Vendbanimet të cilat janë shtuar deri më 10% banorë gjatë periudhës 1991-2011

Duke marrë parasysh shtimin të mesëm të popullsisë, gjatë periudhës 1991-2011, Slivovë, Prelez i Jerlive, Mirash dhe Tërn duhet të trajtohen me prioritet të mesëm të ultë. Gjersa vendbanimi Varosh, duhet të trajtohet me prioritet të mesëm të lartë, sepse numëron mbi 2,000 banorë. Bazuar në analizat e numrit të banorëve vërehet se gjatë periudhës 1991-2011, numri i banorëve është shtuar deri me 30% në vendbanimet vijuese:

	Vendbanimet	1991	2011	Shtimi 20-vjeçar	Shtimi vjetor
1	Rahavicë	1,301	1,257	-3.38%	-0.17%
2	Cërnillë	1,011	957	-5.34%	-0.27%
3	Gurëz	344	323	-6.10%	-0.31%
4	Zllatar	1,290	1,203	-6.74%	-0.35%
5	Mirosalë	1,560	1,427	-8.53%	-0.44%
6	Papaz	589	516	-12.39%	-0.66%
7	Sazlië	900	782	-13.11%	-0.70%
8	Neredime e Poshtme	1,584	1,337	-15.59%	-0.84%
9	Babush	285	235	-17.54%	-0.96%
10	Greme	5,500	4,421	-19.62%	-1.09%
11	Neredime e Epërme	2,120	1,648	-22.26%	-1.25%
12	Balaj	1,400	992	-29.14%	-1.71%
13	Dremjak	1,800	1,235	-31.39%	-1.87%
14	Bablak	451	258	-42.79%	-2.75%
15	Zaskok	1,160	643	-44.57%	-2.91%
16	Surqinë	500	222	-55.60%	-3.98%
17	Jezerc	1,778	454	-74.47%	-6.60%
18	Burrnik	530	46	-91.32%	-11.50%

Tabela 200 Vendbanimet të cilat janë zvogëluar në numër të banorëve gjatë periudhës 1991-2011



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Duke marrë parasysh shtimin të mesëm të popullsisë, gjatë periudhës 1991-2011, Rahavicë, Cërnillë, Gurëz, Zllatar, Mirosalë, Papaz, Sazlië, Neredime e Poshtme, Babush, Balaj, Dremjak, Bablak, Zaskok, Surqinë, Jezerc, dhe Burrnik duhet të trajtohen me prioritet të ultë, sepse numri i banorëve është në rënie e sipër. Nga ky grup i vendbanimeve, për shkak të numrit të lartë të banorëve, vendbanimi Greme duhet të trajtohet me prioritet të lartë, sepse numëron mbi 5,000 banorë dhe vendbanimi Neredime e Epërme me prioritet të mesëm të lartë, sepse numëron mbi 2,000 banorë.

Sa i përket parashikimit të numrit të banorëve për 8 vitet e ardhme, bazuar në trendët aktuale, tabelat vijuese paraqet rritjen e banorëve për secilin vendbanim veçmas:

Në aspektin social vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijoj bazat për zhvillim më të qëndrueshëm social dhe mirëqenie sociale duke përfshirë zbutjen e varfërisë dhe papunësisë por edhe rritjen e shansit të arsimimit dhe profesionalizimit deri te plotësimi i një kënaqësie më të madhe qytetare në këtë dimension në aspektin mjedisor vlerësohet se zhvillimi ekonomik i paraparë me këtë kornizë do të krijoj bazat që aktivitetet të zhvillohen në atë mënyrë që të jenë — miqësore ndaj mjedisit në përgjithësi dhe ndikimi i ndotjeve të ajrit, ujit, tokës të jetë në kufijtë e të tolerueshmes duke paraparë masat dhe standardet qysh nga aplikimi për zhvillim të caktuar duke krijuar të ashtu quajturën paketë të kushteve urbane dhe hapësinor.

Parashikimi i dëshiruar hapësinor për territorin e komunës së Ferizajt në fushën e Zhvillimit ekonomik, regjenerimit duke përfshirë turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe fushat tjera bazohet në analizën e situatës komunale dhe vizionin, parimet dhe prioritetet strategjike të cilat rezultuan nga procesi pjesëmarrës në hartimin e këtij dokumenti por edhe nga Strategjia e zhvillimit ekonomik e Ferizajt në këtë drejtim ekipet punuese kanë paraparë që:

- Orientimi themelor i zhvillimit të qëndrueshëm, prodhues-ekonomik dhe miqësor ndaj mjedisit në Komunën e Ferizajt deri në vitin 2024, duhet të jetë itillë që të mundësojë realizimin e Vizionit të Komunës, qëllimeve të parapara, detyrave të zhvillimit si dhe zvogëlimin e dallimeve në pikëpamje të nivelit të zhvillimit krahasuar me komunat tjera në nivel të Kosovës dhe rajonit.

Periodha e ardhshme në këtë pikëpamje duhet të jetë kthesë dhe kualitet i ri sa i përket zhvillimit të Komunës. Orientim themelor i zhvillimit të komunës së Ferizajt gjatë periudhës së ardhshme duhet të jetë në shfrytëzimin e pozicionit, resurseve dhe infrastrukturës për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Ferizajt si komunë ka një pozitë të përshtatshme gjeografike duke qenë se nëpër Ferizajt kalon hekurudha është si një stacion në rrugën Prishtinë-Shkup. Për zhvillim ekonomik si dhe industrializimi i mëtejshëm duhet të kenë ndikim të rëndësishëm si për dinamikën e rritjes së ekonomisë së përgjithshme, ashtu edhe për dispërsionin e strukturës dhe të përhapjes së efekteve në një hapësirë të gjerë në pikëpamje të zhvillimit dhe të veprimtarive të tjera.

Në komunën e Ferizajt bujqësia do të jetë edhe për një kohë të gjatë njëra ndër veprimtarit kryesore të ekonomisë. Ndonëse zhvillimi i bujqësisë në këtë komunë parashikohet të bëhet në kushte mjaft të ndërlikuara që lidhen me rrethanat e përgjithshme në Kosovë, kontributi i bujqësisë do të jetë mjaft i rëndësishëm, Kushtet pedologjike, klimatike dhe sistemet e parapara për ujitje do të bëjnë të mundshëm që të ndryshojë struktura e shfrytëzimit të tokës së punueshme dhe të rritet vëllimi i prodhimit bujqësor, është e domosdoshme që në bujqësi të bëhen integritime më të mëdha, duke e lidhur kështu më shumë prodhimin me përpunimin.

Partneritetet publiko private në prodhimin bujqësorë, në industrinë përpunuese dhe në plasmanin e produktit paraqesin një nga parakushtet themelore zhvillim të bujqësisë në funksion të zhvillimit ekonomik

Pylltaria dhe Kullosat- zënë një vend me rëndësi sa i përket zhvillimit të ekonomisë së komunës Ferizajt. Pasuria pyjore duhet të shfrytëzohet racionalisht, kurse kujdesi intensiv ndaj pyjeve dhe ruajtja e tyre si dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura duhet t'i kontribuojë përparimit të pylltarisë si mbrojtja dhe përmirësimi i sipërfaqeve të destinuara për kullosa dhe pyllëzim në Jezerc dhe në Burrnik dhe i cilësisë së tyre që do të kontribuoj.

Blegtoria: do të vazhdojë të zë një vend të posaçëm në komunën e Ferizajt, kur merren parasysh produktet dhe nënproduktet që merren nga blegtoria;

Turizmi: duke marr për bazë potencialet që ka Ferizajt si Bifurkacioni në lumin Neredime, fshati Jezerc me bjeshkët e tij atraktive si dhe zona e veçantë e mbrojtur manastiri i Uroshit të Shenjtë. Fshati Burrnik ka potencialet tjera turistike malore që paraqesin bazë që duhet shfrytëzuar në funksion të zhvillimit të planifikuar ekonomik. Në Ferizajt janë edhe zonat arkeologjike të cilat po ashtu në të ardhmen do të jenë potencial i zhvillimit ekonomik.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Transporti: Hekurudha dhe rrugët nacionale por edhe autoudha e planifikuar Prishtinë- Shkup që kalon nëpër Ferizaj paraqesin një bazë të fuqishme të zhvillimit ekonomik për Ferizajt;

Ndërtimtaria, Hoteleria, Tregtia, Zejtaria, Energjia, Sistemi Bankarë, Telekomunikimi, Bartja dhe Lëvizshmëria dhe disa veprimtari tjera shërbyese gjate periudhës së ardhshme duhet të zhvillohen në mënyrë më të qëndrueshme dhe më shpejtë, kurse shpërndarja më e barabarte e tyre në hapësirë do t'i kontribuojë përmirësimit të kushteve të jetesës edhe në vendbanime rurale.

Zhvillimi i ardhshëm i ekonomisë i komunës së Ferizajt sipas dinamikës së parapare dhe me një tjetër strukturë do të kërkojë një inkuadrim me intensiv të popullsisë së aftë për punë krahas shtimit gjegjës të përhershëm të produktivitetit të punës, kështu krijohen kushte edhe për ndryshimin e strukturës socio-ekonomike të popullsisë.

Shkalla e ultë e inkuadrimin në punë të popullsisë në komunën e Ferizajt, numri i pamjaftueshëm i punëtorëve të inkuadruar edhe në bujqësi, si dhe pamundësia që të inkuadrohet shtimi i kontingjentit punës për çdo vit, dëshmon nevojën e udhëheqjes së një politike me aktive të inkuadrimin krahas shtimit përkatës të produktivitetit.

Deri në vitin 2025 duhet të shtohet një kontingjenti i aftë për punë, përmes shkollimit dhe kualifikimeve adekuate, ofrimit të mundësive sidomos në sektorin privat, partneriteteve të ndryshme, zhvillimit të ekonomisë së vogël, ofertave në segmente të ndryshme të ekonomisë, si dhe një vëllim më të madh i mjeteve investive, politika investive duhet të mbështetet në zgjerimin e kapaciteteve ekzistuese dhe ngritjen e kapaciteteve të reja si parakushte për zhvillim të gjithëmbarshtëm dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Duhet pritur mjete nga partneritete e mundshme publiko-private, fondet kombëtare dhe ndërkombëtare, huat dhe kreditë përpos të hyrave vetanake të komunës. Përveç me mjete investuese duhet t'u ndihmohet edhe nga aspekti i punëve hulumtuese, hartimi i studimeve dhe i projekteve si dhe me kundra, Institucionet qendrore në këtë drejtim duhet të japin ndihme më të madhe, Këto janë të domosdoshme nga shkak se komuna e Ferizajt hyn në radhën e komunave të zhvillimit dhe me dinamik zhvillimi dhe potenciale më të mëdha se një pjesë e komunave të Kosovës. Bazuar në zhvillimet ekonomike aktuale dhe mundësitë e Komunës së Ferizajt, Plani Zhvillimor Komunal disa qëllime dhe objektiva, për të realizuar synimin e uljes së papunësisë, përmirësimin e gjendjes ekonomike të banorëve të Ferizajt, përmirësimin e kushteve të veprimtarive të operatorëve ekonomik, uljes së varfërisë, etj.

Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat duke u bazuar në vlerësimin e ekonomisë lokale si ekonomitë familjare, punësimi dhe papunësia, sektorët ekonomik dhe struktura e tyre dhe, bizneset përfshirë ekonominë bujqësore, lidhjes së veprimtarive ekonomike me komunat fqinje dhe nëse është relevante me shtetet fqinje, informatave dhe të dhënave të gjendjes ekzistuese të resurseve dhe shërbimeve turistike siç janë hapësirat për akomodim dhe shërbim të ushqimit, zonave ekonomike ekzistuese dhe të planifikuara, përparësive dhe dobësive të ekonomisë lokale, dhe të resurseve dhe potencialeve tjera nëntokësore, sipërfaqësore, pozita, infrastruktura deri te ato njerëzore të rëndësishme përfushën ekonomike.

Komuna ka shumë mundësi për të nxitur zhvillimin ekonomik, për shkak të sipërfaqes së madhe të tokës bujqësore të klasave më të mira të përshtatshme – IV, sipërfaqes së madhe pyjore në pjesën lindore dhe përfundimtare të Komunës, pasurive nëntokësore, traditës dhe reputacionit të mirë të ndërmarrësve ekonomik Ferizajas, si dhe stacionit dhe terminalit hekurudhor, Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese, sipas fushave tematike:

4.2.1.1. Qëllimi

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në gjitha fushat;
2. Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural. Infrastruktura kualitative dhe bashkëkohore në shërbim të zhvillimit ekonomik dhe parakusht për ngritje të nivelit të standardit të jetesës dhe punës për banorët e Komunës së Ferizajt;
3. Krijimi i kushteve për të shfrytëzuar potencialet turistike dhe zonat natyrore për zhvillimin e turizmit në zonën e bjeshkëve të Jezercit dhe bjeshkëve të Burrnikut si dhe bifurkacionit në lumin Neredime;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

4.2.1.2. Objektivat

1. Fuqizimi i NVM;
2. Fuqizimi i zonave industriale dhe për zhvillim ekonomik (Zhvillimi i Zonës ekonomike në nacionalen Shkup -Prishtinë, zona e zhvillimit ekonomik në Gurëz);
3. Ndërtimi i stacionit hekurudhor me objektet përcjellëse deri në vitin 2021;
4. Mbrojtja e tokës bujqësore dhe pyjore dhe ngritja e prodhimtarisë intensive të këtyre sektorëve;
5. Ndërtimi i rrjetit të ujitjes për tokat bujqësore deri në 2034;
6. Zgjerimi dhe zhvillimi i zonave ekonomike ekzistuese deri në vitin 2025;
7. Zgjerimi i eksploatimit të kuarcit dhe quartziteve, argjilës dhe shkëmbit të mermerizuar deri në vitin 2025;
8. Planifikimi dhe zhvillimi i turizmit rekreativ në kompleksin turistik Jezerc – Neredime deri në vitin 2035;
9. Ndërkombëtarizimi i festivalit të teatrove deri në vitin 2035;
10. Krijimi i kushteve ndërtimore të favorshme për investitorë në sektorin e ndërtimtarisë deri në vitin 2018;
11. Ndërtimi i stacionit të ri të autobusëve përmes PPP deri në vitin 2020;
12. Ndërtimi i tre parkingjeve të reja me kapacitet 1,000 përmes PPP deri në vitin 2022;
13. Ndërtimi i terminalit të mallrave në Gurëz, pas modernizimit të rrjetit hekurudhor që pritet të zbatohet në vitin 2021.

4.2.2. Infrastruktura teknike

Zhvillimi i infrastrukturës teknike duhet të bazohet në planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të energjisë termike, rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, ujitjes, drenazhimit, telekomunikacionit, dhe infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave në komunë. Projektet e infrastrukturës në të ardhmen duhet të planifikohen dhe realizohen në dinamikën që do të kontribuojë në përshpejtimin e procesit të rigjenerimit ekonomik. Përgjegjës për organizimin publik dhe zhvillimin e infrastrukturës publike brenda territorit administrativ të komunës së Ferizajt, është Kryetari i komunës i cili është organi më i lartë ekzekutiv i pushtetit lokal.

Duke qenë se komuna është organi më i lartë ekzekutiv në nivelin e pushtetit lokal dhe duke pasur parasysh rolin dhe rëndësinë që ka zhvillimi i infrastrukturës së përgjithshme e në veçanti infrastruktura e ujësjellësit, kanalizimit, trajtimit të ujërave të ndotura dhe ujërave atmosferike, për cilësinë e standardit për jetën e popullsisë dhe zhvillimit socio – ekonomik në përgjithësi, komuna me organet e tjera të administratës lokale ka pa dyshim rolin vendim-marrës në këtë drejtim. Pra, kjo thekson interesin dhe përgjegjësinë e komunës për ofrimin e shërbimeve sa më kualitative për jetën e banorëve jo vetëm për pjesën e cila tani më është e përfshirë me këtë rrjetë të infrastrukturës, por edhe për pjesët të cilat ende nuk janë përfshirë me këtë shërbim.

Rrjeta dhe cilësia e infrastrukturës së paraparë do të paraqet bazën e integritit hapësinorë dhe parakushtin e parë të arritjes së zhvillimit harmonik. Lidhja integrale e infrastrukturës në hapësirë, do të jetë prioritet përmbajtjesor i Planit Zhvillimor Komunal për hapësirën e Komunës së Ferizajt. Drejtimet themelore të infrastrukturës do të iniciojnë polarizimin e potencialeve ekonomike si dhe koncentrimin e popullsisë. Drejtimet e parapara, në radhë të parë, cilësia e tyre, integrimi i të gjitha mundësive transportuese që posedon komuna e Ferizajt dhe rëndësia funksionale duhet t'i kontribuojnë realizimit të drejtpeshimit hapësinor dhe të përgjithshëm të Komunës së Ferizajt. Infrastruktura në Komunën e Ferizajt duhet të sigurojë integrimin racional territorial të ekonomisë, integrimin e hapësirës me rajonet në fqinjësi dhe në kohë dhe hapësirë të caktuar, të siguroje efekte përkatëse në zhvillimin e funksioneve të tjera.

Qëllimet dhe objektivat madhore dhe afatgjate të Komunës synojnë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm të infrastrukturës teknike, në kohë, hapësirë dhe kosto sa më të favorshme, që duhet të përpunohet në hollësi gjatë përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës dhe Planeve Rregulluese të Hollësishme. Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat madhore vijuese, sipas fushave tematike:



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

4.2.2.1. Qëllimi

1. Furnizimi cilësor dhe i qëndrueshëm me ujë të pijes për të gjithë banorët e Komunës;
2. Eliminimi i ndotjes së mjedisit nga ujërat e zeza;
3. Modernizimi dhe Zgjerimi i infrastrukturës për trajtim të ujërave të zeza,
4. Ndarja e ujerave të zeza nga ato atmosferike;
5. Furnizim i qëndrueshëm me energji elektrike;
6. Ofrimi i qëndrueshëm i të gjitha shërbimeve telekomunikuese (TEL+DATA+VIDEO) për të gjithë qytetarët, bizneset, institucionet dhe ekonomitë familjare në komunën e Ferizajt;
7. Ngritja e cilësisë në shërbimin e mbledhjes së mbeturinave.
8. Përmirësimi i rrjetit rrugor me infrastrukturë përcjellëse në drejtim të komunave fqinje si dhe mbështetja e zhvillimit policentrik dhe lehtësim të qasjes së vendbanimeve me ngritjen e infrastrukturës rrugore dhe sigurisë në komunikacionit;
9. Krijimi dhe përmirësimi i kualitetit të hapësirave publike në vendbanimet e komunës së Ferizajt (varrezat, vendndaljet e autobusëve, vendparkimet, hapësirat e gjelbëruara, rehabilitimi i hapësirave tregtare urbane dhe rurale);
10. Infrastruktura e ndriçimit të vendbanimeve në konceptin policentrit dhe në përgjithësi;
11. Ndërtimi i infrastrukturës për stacionit hekurudhor për ngarkim dhe shkarkim-terminal me objektet përcjellëse.

4.2.2.2. Objektivat

1. Ngritja e kapaciteteve të prodhimit të ujit të pijshëm në 1000l/s dhe mbrojtja e tyre deri në vitin 2025;
2. Zvogëlimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues, deri në vitin 2021;
3. Ndërtim i rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet të cilat nuk kanë qasje në rrjet deri në vitin 2020;
4. Digjitalizimi i sistemit të ujësjellësit, deri në vitin 2023;
5. Ndërtimi i katër impianteve të trajtimit të ujërave të zeza deri në vitin 2030;
6. Avancimi teknologjik i pajisjeve ekzistuese në përkrahje të shërbimeve telekomunikuese 4G dhe 5G LTE në periudhën pesëvjeçare deri në vitin 2020;
7. Mbulueshmëria e 100%_te me rrjeta të reja optike kablore të avancuara FTTH(Fiber To The Home) në zonat e pambuluara në periudhën kohore trevjeçare deri në vitin 2022;
8. Zgjerimi dhe përmirësimi i rrjetit ekzistues të energjisë elektrike deri në vitin 2025;
9. Shtrirja e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave për të gjitha vendbanimet e Komunës deri në vitin 2020;
10. Ndërtimi i rrjetit dhe qendrës prodhuese për furnizim me energji termale deri në vitin 2028.

4.2.3. Transporti dhe transporti publik

Transporti dhe transporti publik paraqet një aktivitet shumë të rëndësishëm për qytetarët, institucionet dhe bizneset e Ferizajt. Shërbimet e transportit publik paraqesin segmentin shumë të rëndësishëm për zhvillimin e Komunës për të mundësuar lëvizjen – drejt vendeve të punës, arsim dhe edukim, shëndetësi, tregti, përmbajtje publike dhe rekreacion. Transporti publik është një faktor përmbajtjesor për zhvillim ekonomik, social e mjedisor dhe luan rol shumë të rëndësishëm në relacionet hapësinore midis hapësirave dhe destinimeve të tyre. Përpos që ndikon pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirëson gjendjen socio-ekonomike të banorëve, përmirësimi i shërbimeve të transportit publik minimizon shpenzimet e investimeve kapitale për zgjerime të rrugëve, si dhe krijon vende të reja të punës në kornizën afatgjate kohore.

Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar disa qëllime dhe objektiva duke u bazuar në vlerësimin e shtrirjes dhe gjendjes së rrugëve ekzistuese, kategoritë e rrugëve të planifikuara nga niveli qendror, intensitetit dhe kapacitetit të kryqëzimeve dhe korsive, modeleve të qarkullimit të trafikut, linjave transportuese ndër-komunale brenda komunës (urbane dhe rurale), shfrytëzimin e rrugëve nga makinat, këmbësorët, biçikletat dhe metodat tjera të transportit, dhe të hapësirave ekzistuese për parkim. Transporti në Ferizaj, kryesisht realizohet përmes rrugëve automobilistike dhe hekurudhore, me të shtrirje shumë të mirë, ndonëse rrjeti hekurudhor brenda periudhës së ardhme 8-vjeçare pritet të modernizohet dhe të shtohet numri i udhëtimeve me destinacione ndërkombëtare.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Ferizaj është qendër transporti e rëndësisë rajonale që paraqet parakusht për t'u bërë një qendër e transportit integral. Potencial i rëndësishëm në fushën e transportit janë kushtet e favorshme natyrore për ndërtimin e infrastrukturës së transportit, sepse pjesa qendrore e komunës është rrafshinë dhe pjesë qendrore në regjion. Komuna ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat madhore vijuese, për zhvillimin e transportit dhe transportit publik:

4.2.3.1. Qëllimet

1. Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës rrugore;
2. Organizimi efikas i transportit urban;
3. Zhvillimi dhe modernizimi i transportit hekurudhor;

4.2.3.2. Objektivat

1. Të ndërtohet qarkorja/unaza e brendshme, e cila do të kufizoj qarkullimin nëpër qendër të qytetit deri në vitin 2021;
2. Brenda qytetit të krijohen kushte të cilat do të favorizojnë lëvizjet aktive dhe transportin urban deri në vitin 2022;
3. Të ndërtohet qarkorja/unaza e jashtme e cila do të mundësoj ndërlidhje funksionale të fshatrave, duke krijuar edhe kushte për qarkullim të lehtë dhe të shpejtë në pikat kyçese të autostradës deri në vitin 2025;
4. Të planifikohet rritja e numrit të kyçjeve në autostradë, së paku edhe një kyçje në mes të atyre ekzistuese (Babush i Muhaxherëve dhe Bibaj) deri në vitin 2024;
5. Përcaktimi i lokacionit adekuat për vendosjen e "terminalit multimodal" në dalje të qytetit të Ferizajt deri në vitin 2017.
6. Të hartohet plani i mobilitetit të qëndrueshëm urban dhe rural për komunën e Ferizajt deri në vitin 2021;
7. Hapja e rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese deri në vitin 2024;
8. Krijimi i shtigjeve për çiklistë, këmbësorë dhe pësonave me aftësi të kufizuara deri në vitin 2022;
9. Funksionalizimi i rrjetit të komunikacionit deri në vitin 2024;
10. Integrimi i sistemeve të transportit deri në vitin 2022;
11. Projektimi dhe ndërtimi i rrugëve duke përfshirë kanalet nëntokësore për instalimin e infrastrukturës teknike deri në vitin 2025;
12. Eliminimi i fatkeqësive në hekurudhe deri në vitin 2025;

4.2.4. Infrastruktura publike

Mbrojtja primare në shumicën e vendeve të zhvilluara tani ballafaqohet me sëmundje kronike çrregullimet gjatë zhvillimit, çrregullimet e sjelljes, aksidentet dhe një numër i madh i sëmundjeve infektive të cilat më pare ishin fatale. Mjeku familjar dhe ekipi i KPSH janë duke marrë gjithnjë e më tepër përgjegjësi më të madhe për promovimin e shëndetit dhe parandalimit të sëmundjeve përmes planifikimit të familjes, imunizimit, këshillave kundër pirjes së duhanit dhe faktove tjerë të mënyrës personale të jetesës.

Mjekësia familjare është trung i diturisë që bazohet në praktika familjare. Roli i mjekut familjar është të merret me familjen, individin, të bashkëpunoj me profesionistët tjerë shëndetësor dhe të punoj në ekipet e KPSH pasi është klinikist. Për të i realizuar këto shërbime synojmë një mjekë (specialist i mjekësisë familjare) dhe dy infermiere të trajnuar të mjekësisë familjare në 2000 banorë përkatësisht, 5 mjekë dhe 10 infermiere në 10,000 banorë. Në çdo lokalitet ku kemi 2000 - 2500 banorë synojmë të kemi AMF ndërsa vendbanimet me mbi 4000 banorë, nevojitet të ndërtohet një QMF, që i shërben banorëve të saj dhe fshatrave rrethues. Pas analizës së situatës në nivel komunal dhe njohjes së rolit të komunës së Ferizajt në sistemin edukativ që përveç tjerash shtrihet edhe në mirëmbajtje të infrastrukturës arsimore e përbërë edhe nga objektet dhe pajisjet e tjera për shkollë, transport dhe stafi arsimor, vendosjes së synimit të përbashkët nga të gjithë akterët për një shoqëri të edukuar dhe shkolluar mirë e cila në të njëjtën kohë është edhe komponent e rëndësishme e vizionit të komunës u konstatua se zhvillimet e ardhshme në këtë fushë duhet orientuar.

Ngritjen e kapaciteteve për arsimin bashkëkohor, përmirësimin e sigurisë së nxënësve, përmirësimin e cilësisë së arsimit, përfshirje të barabartë në arsim, ngritje e bashkëpunimit me prindër, Ministrinë e arsimit, asaj të punës,



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

shtete e institucione të ndryshme të cilat hulumtojnë edhe kërkesat e tregut. Mbrojtja dhe sigurimi i lokacioneve për shkolla, përmirësim i infrastrukturës së shkollave ekzistuese dhe plotësim me infrastrukturë përcjellëse që vlen për komplet hapësirën e komunës së Ferizajt ku funksion sistemi arsimor u theksua se duhet krijuar kushte dhe lejuar shkollimin privat dhe bazuar në standarde janë vlerësuar nevojat për ndërtimin e objekteve të reja shkollore me infrastrukturë përcjellëse, ndërtimi edhe i objekteve sportive me qëllim të përmirësimit të kushteve për punë dhe mësim duke përbushur kriteret hapësinore të përcaktuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, prej 7m²/nxënës.

Duke marrë parasysh zhvillimet teknologjike, Komuna synon që të modernizojë shërbimet administrative përmes shërbimeve digjitale dhe E-kiosqeve (dokumatëve) që ofrojnë shërbime 24-orë për banorët e Ferizajt. Riorganizimi i shërbimeve administrative për banorët e Ferizajt dhe ofrimi efikas i tyre është shumë i rëndësishëm për Komunën. Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar disa qëllime dhe objektiva duke u bazuar në vlerësimin e inventarit të ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari publike ekzistuese siç janë ato mjekësore, arsimore, postës, të administratës publike dhe shërbimeve të tjera të ngjashme.

4.2.4.1. Qëllimet

1. Krijimi i hapësirave të reja shëndetësore dhe shërbimeve sociale sa më afër banorëve;
2. Krijimi i infrastrukturës arsimore publike për gjitha nivelet;
3. Krijimi i infrastrukturës së administratës efikase për shërbime administrative sa më afër banorëve.

4.2.4.2. Objektivat

1. Ndërtimi i AMF-ve për vendbanimet me +2000banorë dhe i QMF-ve për vendbanimet me +2000banorëderi në vitin 2024;
2. Ndërtimi i gjithë infrastrukturës publike arsimore prej 8 m² për nxënës deri në vitin 2024;
3. Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase përmes teknologjisë moderne deri në vitin 2022.

4.2.5. Infrastruktura sociale

Zhvillimi i një shoqërie, varet shumë nga infrastruktura sociale. Duke marrë parasysh, që 48% të banorëve it takojnë grupmoshës 0 – 24 vjeçare, infrastruktura sociale është shumë i rëndësishëm për të krijuar një mjedis dhe shoqëri të shëndoshë. Në vendet ku mbizotëron papunësi e lartë është e domosdoshme që infrastruktura sociale të jetë në dispozicion, pasi që banorët e papunësuar duhet të gëzojnë mundësinë që kalojnë kohën e tyre të lirë me miqtë, kolegët fqinjët në hapësira publike. Përderisa, qyteti i Ferizajt ka teatrin, muzeun, galerinë e arteve dhe bibliotekën, gjendja e tyre nuk është në nivelin e duhur.

Mirëpo, hapësirat për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe kreative aspak nuk mjaftojnë për të përbushur kërkesat e banorëve dhe posaçërisht brezave të rinj. Zhvillimi i aktiviteteve sportive, përpos që ndihmon në aftësimin dhe zhvillimin profesional të të rinjve, ato ndihmojnë edhe në ruajtjen e shëndetit të tyre. Plani Zhvillimor Komunal parasheh përmirësimin e kushteve fizike të objekteve ekzistuese dhe krijimin e hapësirave të reja si parakusht për përmirësimin e infrastrukturës sociale. Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar disa qëllime dhe objektiva duke u bazuar në vlerësimin e inventarit të ndërtimeve dhe hapësirave për veprimtari sociale siç janë ato kulturore, sportive, peshkimit, gjuetisë, bibliotekave, për komunitetin, parqeve publike, varrezave dhe shërbimeve të ngjashme.

4.2.5.1. Qëllimet

1. Krijimi i hapësirave të reja kulturore;
2. Krijimi i hapësirave të reja sportive dhe rekreative;
3. Krijimi i parkut të qytetit;
4. Krijimi i hapësirave të varrezave të reja të qytetit dhe fshatrave;
5. Zhvillim social të balancuar për përmirësimin e standardit jetësor.

4.2.5.2. Objektivat

1. Ndërtimi i një qendre të re multikulturore deri në vitin 2025;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2. Ndërtimi i infrastrukturës sportive në verilindje të qytetit deri në vitin 2022;
3. Ndrëçimi i fushave ekzistuese sportive të institucioneve arsimore, për të u shfrytëzuar nga banorët e lagjeve, jashtë orarit mësimor deri në vitin 2024;
4. Ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe efikase përmes teknologjisë moderne deri në vitin 2022;
5. Ndërtimi i parkut publik mbi hekurudhën nëntokësore deri në vitin 2024;
6. Planifikimi dhe ndërtimi i varrezave të reja të qytetit;
7. Krijimi i kushteve për banim të përballueshëm;
8. Dendësimi i njësive të banimit për shfrytëzim racional të territorit.

4.2.6. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

Në kuadër të dokumentit janë analizuar faktorët të cilët ndikojnë në sipërfaqet me rrezikshmëri të cilat ndikojnë në mjedis si tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshëri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse të njerëzimit, të shtazëve dhe të bimëve dhe fatkeqësi të tjera që i shkakton natyra. Në kuadër të fatkeqësive të tjera, janë analizuar fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje. Pastaj janë parashikuar gjendjet e jashtëzakonshme, ato emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rrymë, telekomunikacioni dhe teknologjia informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikut masiv. Nga grupet punuese, është konstatuar se njëra ndër fatkeqësitë natyrore më sfiduese është tërmeti. Prandaj është parashikuar që duhet marrë masa për të lëvizur nga kultura e reagimit, në kulturën e marrjes së masave për amortizim dhe minimizim të dëmeve.

4.2.6.1. Qëllimet

1. Eliminimi i sipërfaqeve me rrezikshmëri (Zonave me nivel të lart të vërshimeve, zonat me potencial të lart për shkaktim të zjarrit, zonat me potencial të lart për shkaktim të sëmundjeve, etj.);
2. Përmirësimi i reagimit në marrjen së masave për amortizim dhe minimizim të dëmeve.

4.2.6.2. Objektivat

1. Përgatitja e rregullores për të gjitha ndërtimet në harmoni me shkallën e rrezikut sizmik, dhe të ndërtohet me standarde deri në vitin 2019;
2. Në objektet e veçanta si dhe në objektet shumëkatëshe, duhet të punohen me arkitekturë a-sizmike;
3. Ndalimi i prerjeve dhe degradimi i pyjeve;
4. Ndalimi i mbikullotjes;
5. Ndalimi i shfrytëzimit të mirave materiale që shkaktojnë erozion;
6. Ndalimi i shfrytëzimit të dheut dhe rërës;
7. Ndërtimi i tarracave, gardoneve dhe pendave në shtretërit e përroskave dhe përrenjve si masa mbrojtëse hidroteknike për ta minimizuar fuqinë gërryese;
8. Ndërtimi i argjaturave në brigjet e lumenjve si masë parandaluese e gërryerjes;
9. Mbjellja e fidanëve pyjore në shtretërit e lumenjve;
10. Ndalimi i nxjerrjes së inerteve në shtretërit e lumenjve;
11. Të mirëmbahen tokat bujqësore;
12. Të aplikohen drejtë praktikat bujqësore;
13. Përdorimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të bëhet në bazë të udhëzimeve të ekspertëve;
14. Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokës në brigjet e lumenjve;
15. Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatijet e rrëpishme deri në vitin 2022;
16. Ndërtimi i mureve rrezistuse deri në vitin 2022;
17. Meliorimi i kullosave;
18. Meliorimi i pyjeve;



19. Ndërtimi i formave tjera antierozive.

4.2.7. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

Trashëgimia kulturore është pasqyrë e vlerave dhe e nivelit kulturor të një vendi. Trashëgimia kulturore është rezultat i procesit të lidhur me zhvillimin e shoqërisë moderne dhe përbën thelbin e identitetit të tyre kulturor, dhe shërben edhe si një referencë intelektuale dhe shpirtërore për brezat e ardhëm. Trashëgimia kulturore është duhet të mbrohet sepse është pasuri e pa ripërtërishme, dhe gjurmët kulturore janë vazhdimisht nën trysinë e zhdukjes dhe zëvendësimit me të rejtën. Trashëgimia kulturore përbëhet nga lloje të ndryshme pasurish që ndërlidhen me një shumëllojshmëri mjedisesh.

Përpos që trashëgimia natyrore dhe kulturore shërben për të lidhur brezat e rinj me brezat paraardhës, kjo pasuri nën trajtimin e duhur mund të vendos Ferizajn si destinacion ndërkombëtar për turistë duke nxitur zhvillimin ekonomik dhe përforcuar identitetin e një vendi dhe shoqërie. Vlerat mund të përkufizohen si cilësi relative sociale të që mund të ndryshojnë gjatë kohës. Në rastin e trashëgimisë kulturore, duhet t'i kushtohet një vëmendje e veçantë lokacioneve që përceptohen si bartëse të vlerave kulturore, duke mos anashkaluar edhe aspektin ekonomik. Disa prej vlerave mund të jenë të lidhura më ngushtë me aspektet thelbësore të monumentit apo lokacionit ndërsa vlera të tjera mund të jenë të lidhura me vendndodhjen gjeografike të burimit dhe marrëdhënien e tij me mjedisin rrethues. Mirëpo, buxheti i Komunës dhe i MKRS-ës është shumë i kufizuar për intervenimet e duhura për të restauruar të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore përbrenda Komunës, kështu që Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese për asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike:

4.2.7.1. Qëllimet

1. Definimi, ruajtja dhe promovimi i zonave dhe monumenteve të natyrës;
2. Identifikimi, inventarizimi, restaurimi dhe konzervimi i trashëgimisë arkitektonike;
3. Definimi i zonave, sinjalizimi dhe përnjohja e trashëgimisë arkeologjike;
4. Ruajtja, avansimi dhe promovimi i trashëgimisë shpirtërore;
5. Inventarizimi dhe sistemimi i trashëgimisë së luajtshme.

4.2.7.2. Objektivat


1. Intervenimi në sigurimin e stabilitetit në objektet e trashëgimisë arkitektonike deri në vitin 2019;
2. Identifikimi i vlerave dhe shpallja e objekteve tjera si vlera të trashëgimisë arkitektonike deri në vitin 2024;
3. Digjitalizimi i në format multimedia trashëgimisë shpirtërore deri në vitin 2020;
4. Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme gjatë vitit 2017.

4.2.8. Shfrytëzimit i planifikuar i tokës

Planifikimi i përdorimit të tokës për dhjetë vitet e ardhshme në komunën e Ferizajt, për grupet punuese ishte sfida e veçantë pasi që në hapësirë duhej të bëhej trajtimi, identifikimi i konflikteve dhe integrimi i të gjitha zhvillimeve me përcaktimin se, çfarë lloje të aktiviteteve të përdorimit të tokës duhet të bëhen, ku ato duhet të bëhen etj. Duke i përdorur standardet ndërkombëtare dhe GIS-in, u lehtësua procesi i vendimmarrjes në kuptimin e destinimit për shfrytëzim të hapësirës dhe në këtë drejtim, grupet punuese dhe spektri i ekspertëve të kyçur në këtë proces, kanë parashikuar se toka në komunën e Ferizajt në masë të konsiderueshme do të vazhdojë të jetë e destinuar dhe e ruajtur për tokë bujqësore dhe pyjore. Pjesë të tjera të tokës, do të jenë të destinuara për vendbanime apo tokë ndërtimore, zona arkeologjike, varreza, gjelbërim, rrugë, deponi të mbeturinave, korridore, industri dhe fusha e sektorë të tjerë të nevojshëm.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt



Grafika 49 Diagrami i përqindjeve sipas destinimit shfrytëzimit të tokës

Destinimi	ha	%	Destinimi	ha	%
Administratë	4.47	0.01%	Qendra Zejtare	0.131	0.00%
Afarizëm/Tregti-Industri	795.4533	2.31%	Religjion	1.756	0.01%
Arsim	36.543	0.11%	Shëndetësi	10.612	0.03%
Banim Individual	6109.3	17.73%	Sport rekreim	81.164	0.24%
Banim Individual me afarizëm	563.99	1.64%	Stacion i Autobusëve	2.495	0.01%
Banim Kolektiv	149.401	0.43%	Terminal	0.231	0.00%
Banim Kolektiv me afarizëm	200.949	0.58%	Zonë e mbrojtur	11.389	0.03%
Brez i gjelbërimit	24	0.07%	Zonë ushtarake-sigurisë	410.754	1.19%
Hapësirë Publike	8.711	0.03%	Tokë bujqësore	11167.69	32.40%
Institucione Shkollore/Çerdhe	4.709	0.01%	Tokë Pyjore	14099.49	40.91%
Kulturë	1.916	0.01%	Lokalitet Arkeologjik	27.75	0.08%
Mbikalim	0.075	0.00%	Varreza	105.94	0.31%
Miniera/gurore	81.657	0.24%	Autostrada	176.73	0.51%
Park	108.402	0.31%	Sipërfaqe Rrugore	126.7	0.37%
Parking	1.541	0.00%	Sipërfaqe ujore	145.5	0.42%
Parking nëntokësor	4.836	0.01%			

Tabela 226 Sipërfaqja dhe përqindja e shfrytëzimit të tokës sipas destinimit

Sa përket shfrytëzimit të tokës, Plani Zhvillimor ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese:

4.2.8.1. Qëllimet

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe racional i tokës;
- Mbrojtja e tokës së përshtatshme bujqësore dhe definimi i zonave ndërtimore dhe zonave tjera që kanë një shkallë të mbrojtjes (zonat me ujëra dhe pasuri tjera nëntokësore dhe sipërfaqësore), ose definojnë me qëllim zhvillim i bazuar edhe në konceptin policentrik dhe të qëndrueshëm hapësinor;
- Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor (definimi dhe trajtimi i zonave të ndotjes, mbrojtja dhe zhvillimi e ekosistemeve dhe zonave të biodiversitetit etj).



4.2.8.2. Objektivat

1. Definimi i zonave ndërtimore deri në vitin 2017
2. Definimi i zonave ndërtimore të vendbanimeve deri në vitin 2019;
3. Definimi i zonave Bujqësore deri në vitin 2017
4. Definimi i zonave Pyjore deri në vitin 2017
5. Definimi i zonave Turistike deri në vitin 2018
6. Definimi i zonave Infrastrukturore deri në vitin 2024
7. Definimi i sipërfaqeve të mbrojtura deri në vitin 2019
8. Përgatitja dhe miratimi i Hartës Zonale të Komunës deri në vitin 2019;
9. Përgatitja dhe miratimi i të gjitha Planeve Rregulluese të Hollësishme për zonat urbane deri në vitin 2021;
10. Përgatitja dhe miratimi i Planeve Rregulluese të Hollësishme për nënqendrat sekondare deri në vitin 2022;

4.2.9. Vendbanimet

Në kuadër të hartimit e Planit Zhvillimor Komunal ekipet komunale të përkrahur nga konsulentët e Institutit INSI kanë analizuar zhvillimet hapësinore të çdo vendbanimi duke marrë për bazë elementet në vijim:

- Profilin e vendbanimit
- Tipologjinë e vendbanimit
- Trendët, Parashikimet dhe proceset demografike
- Problemet momentale
- Sipërfaqet e ndërtuara ekzistuese dhe dendësia e popullsisë; dhe
- Hartat e gjendjes ekzistuese të pasurive dhe vlerave nëntokësore dhe sipërfaqësore duke përfshirë edhe kategoritë e tokave dhe informata tjera

Dhe duke marrë parasysh gjendjen faktike në vendbanimet dhe implikimet që reflekton kjo gjendje është konstatuar se vendbanimeve në komunën e Ferizajt duhet ofruar Koncepti i urbanizimit kompakt. Synimi i këtij koncepti është që edhe nëpër fshatra zhvillimet të jenë të tilla që tentojnë shfrytëzim sa më racional të hapësirës përmes të dendësimit të ndërtimit dhe zhvillimeve brenda një hapësire të kufizuar e prezantuar përmes kufijve ndërtimor të propozuar në nivel të çdo vendbanimi. Në periudhën e ardhshme, procesi i transformimit dhe të pajisjes me përmbajtje urbane të fshatrave dhe popullsisë fshatare do të vazhdoje edhe me intensitet të shtuar, Strukturat e territorit fshatar do të jenë gjithnjë e më të kompletuara. Ato do të jene veçanërisht të kompletuara afër qytetit të Ferizajt dhe në zonat e boshteve të zhvillimit më të theksuara në zonën rreth rrugës nacionale Prishtinë – Shkup, korridori Ferizaj – Koshare si dhe korridori Ferizaj-Dardani si tri korridoret kryesore edhe ai i Nikadines deri në Greme. Këto boshte zhvillimi dhe nën qendrat në to duhet të kenë prioritet në planifikimin hapësinor dhe urban dhe zhvillimet në përgjithësi.

Në fshatra synohet që të shtohet vazhdimisht popullsia e cila është e ndare prej aktiviteteve që lidhen vetëm me punimin e tokës. Në ato hapësirë duhet krijohen kushte për një numër më të madh punëtorësh të cilët do të inkuadrohen në punë aty dhe në vende tjera. Koncepti i ardhshëm i urbanizimit në fshatra edhe më gjerë favorizon këto procese, Kjo kërkon drejtimin e aksioneve të planifikuara në përmirësimin e kushteve të jetesës në fshatra dhe në lidhjen e tyre më të volitshme në komunikacion dhe përfshirjen në të gjitha proceset e lëvizjeve socio-ekonomike. Për zhvillimin modern të fshatit planifikohet që organizimin e brendshëm, madhësitë dhe strukturat hapësinore të fshatit, të cilat do të iu përgjigjen kushteve të ekonomisë së tregut me fokus në përmbajtjet prodhuese, mjedisore e sociale të jetesë. Sa i përket aspektit legal në gjendjen kur po hartojmë këtë dokument, fshati në komunë por edhe në nivel të Kosovës si njësi mbetet vetëm si element i sistemit por pa asnjë funksion qeverisës.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Kushtet e aktiviteteve ekonomike, organizimi i aktiviteteve ekonomike, futja e elementeve urbane dhe mënyrës së jetesës, duhet ti përshtatur pozitës, madhësisë dhe tipit të vendbanimit.

Rregullimi i fshatrave dhe i territoreve të gjëra rurale është bazuar në:

- Kufijtë e planifikuar ndërtimor të çdo vendbanimi
- Zhvillimin e organizimin e prodhimit bujqësor brenda zonës kadastrale të vendbanimit por edhe zonës ndërtimore në zonat e ashtuquajtura zemra e gjelbër (agroekosistemi)
- Zgjerimin e përmbajtjeve të industrisë në ato vendbanime të cilat kane leverdi për këtë;
- Zhvillimin, ndërtimin dhe renditjen si duhet të veprimtarive shërbyese;
- Orientimin hapësinor të zgjerimit territorial me specifikim edhe të disa zonave të mundshme për zgjerim dhe në ndërtimin modern të objekteve të banimit dhe objekteve tjera.
- Me këtë koncept me rastin e ndërtimit të shtëpive e lokaliteteve, do të merren pëlqime, leje dhe do të respektohen më tepër norma e specifika urbane.

Parashikohet zhvillimi përpos qytetit, edhe i nënqendrave sekondare, si: Pleshinë, Doganaj, Greme, Komogllavë, Dardani, Bibaj, Talinoc i Muhaxherëve dhe Softaj. Të bëhet zgjerimi i planifikuar i disa vendbanimeve në pronësi private por dhe komunale, që është prezantuar në hartën: Koncepti i zhvillimit të vendbanimeve. Duhet të bëhet furnizimi sa më shumë që është e mundur me infrastrukturë urbane, i të gjitha vendbanimeve. Zhvillimi i ndërtimeve brenda kufijve të planifikuar ndërtimor, parashikohet zhvillimi dhe organizimi i prodhimit bujqësor brenda zonës së kadastrave të vendbanimit. Parashikohet zgjerimi me përmbajtje i industrisë në ato vendbanime që kanë leverdi për këtë: ndërtimi modern i objekteve të banimit dhe objekteve të tjera, renditja si duhet e veprimtarive shërbyese. Parashikohet që gjatë ndërtimit të shtëpive e lokaliteteve, të merren pëlqime dhe të respektohen më tepër norma specifike urbane dhe angazhimi i organeve kompetente për krijimin e një klime urbanistike, sidomos për pjesët të cilat konsiderohen ende të paprekura.

4.2.9.1. Qëllimet

1. Plotësimi i Planit Zhvillimor Komunal me dokumentet plotësuese të planifikimit hapësinor, Hartën Zonale të Komunës dhe Plane Rregulluese të Hollësishme;
2. Zhvillimi kompakt i vendbanimeve me infrastrukturë moderne;

4.2.9.2. Objektivat

1. Përcaktimi dhe parandalimi i ndërtimeve jashtë kufijve ndërtimorë të vendbanimeve rurale deri në vitin 2017;
2. Zhvillimi kompakt i vendbanimeve.

4.2.10. Vendbanimet Joformale

Sigurimi që vendbanimet joformale janë trajtuar bazuar në udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale të hartuar nga DPH dhe MMPH sipas Ligjit L-03/L-106 për Ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor 2003/14. Veprimet vijuese janë: Rregullimi i VBJ është çështje e planifikimit hapësinor. Sigurimi i pronës, qasje në infrastrukturë adekuate, pjesëmarrje në qeverisje, mund të sigurohet përmes Planifikimit hapësinor dhe Urbanistik. VBJ në komunën e Ferizajt do të trajtohen në atë mënyrë që së pari do të identifikohen në PZHK, do të vihen si projekte me prioritet për komunën dhe pastaj të hartohet Profili dhe Analiza e gjendjes së atyre VBJ, që vijon me hartimin e PRRU për ato vendbanimeve apo me mënyra tjera të intervenimit dhe plotësime në vendbanim varësisht nga gjendja e tij. Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata e nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.

Për ndërtesat e konsideruara si ilegale, sipas ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale, komuna do të fillojë procedurën e legalizimit. Për procesin e legalizimit dhe lëshimin e lejeve valide për ndërtesë komuna do të kërkojë taksë. Përgatitja e profilit të gjendjes ekzistuese të VBJ në tërë territorin e saj do të duhej të shërbente për përcaktimin e



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

prioriteteve për rregullimin e VBJ ndërsa do t'u shërbente. Mirëpo, buxheti i Komunës dhe i MKRS-ës është shumë i kufizuar për intervenimet e duhura për të restauruar të gjitha pasuritë e trashëgimisë kulturore përbrenda Komunës, kështu që Plani Zhvillimor Komunal ka përcaktuar qëllimet dhe objektivat vijuese për asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike:

4.2.10.1. Qëllimet

1. Trajtimi i vendbanimeve joformale

4.2.10.2. Objektivat

1. Rregullimi i 6 vendbanimeve joformale deri në vitin 2022;



4.3. Koncepti i zhvillimit hapësinor

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor i komunës së Ferizajt ka marr parasysh dhe ka reflektuar gjendjen aktuale dhe zhvillimet e planifikuara në këtë drejtim janë trajtuar informata dhe zhvillime të rëndësishme për komunën nga profili i zhvillimit komunal dhe janë trajtuar dokumente dhe strategji planifikimi të nivelit komunal dhe qendror. Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor është provuar të jetë i strukturuar mirë dhe të përmbajë të dhëna të mjaftueshme që të mund të kuptohet si i vetëm në këtë drejtim Ekipi i angazhuar nga komuna e Ferizajt si dhe kompania "INSI" dhe ekipet tjera të angazhuara jashtë komunës kanë punuar bazuar në kërkesat e parapara me ligj, udhëzime administrative dhe struktura është plotësisht e bazuar po ashtu edhe përmbajtjet si nyjet, korridoret dhe përmbajtjet tjera që e bëjnë këtë koncept lehtë dhe si i vetëm i kuptueshëm. Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor pa dyshim që ka krijuar bazën e zhvillimit dhe të shfrytëzimit të tokës gjatë procesit të vendim marrjes dhe do të mundë të shfrytëzohet gjatë hartimit të kushteve zhvillimore të Hartës Zonale të Komunës të Ferizajt.

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Ferizajt u zhvillua duke përdorë konceptet vijuese për të arritur qëllimet dhe objektivat hapësinore:

NYJET: duke i kuptuar **NYJET** si hapësira që mbështesin dhe promovojnë intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve, kemi analizuar fillimisht se cilat nga të gjitha vendbanimet Urbane dhe Rurale mund të konsiderohen si hapësira me një intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve dhe në vazhdimësi në mënyrë të planifikuar mund të mbështesin dhe promovojnë një intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve, janë analizuar edhe trendët demografike përpos intensitet të lartë të shfrytëzimit të tokës dhe aktiviteteve dhe analiza tjera dhe është konstatuar seqë përpos zonës urbane qytetit të **Ferizajt** e cila përfshin zonën kadastrale të Ferizajt dhe të fshatrave **Talinoc i Jerlive, Nikadini** (me gati komplet hapësirën kadastrale) dhe zonave kadastrale të vendbanimeve Doganaj, Zaskok, Pleshinë, Neredime e Poshtme, Loshkobare (me një pjesë shumë të vogël të hapësirës së këtyre zonave kadastrale), por edhe nyjeve tjera si **Prelezi i Muhaxherëve, Softaj, Dardania, Komogllava, Greme, Pleshina e Poshtme, Neredime e Poshtme dhe Koshara** si dhe **Kampi Bonstill**.

KORRIDORET: duke i kuptuar **Korridoret** si lidhjet ndërmjet nyjeve, përgjatë të cilëve kemi zhvillime që karakterizohen me intensitet të rritur ose natyrshëm mund të joshet dhe inkurajohet një intensitet i rritur i zhvillimit, kemi analizuar fillimisht se cilat prej këtyre vijave mund të konsiderohen si korridore duke marrë për bazë një intensitet të lartë të ose vijat ku natyrshëm mundë të joshet dhe inkurajohet intensitet i rritur i zhvillimit dhe mundë të konstatohet se aksi që fillon në Gurëz dhe vazhdon nëpër: Varosh, Fshat i Vjetër, Ferizaj, Talinoc i Muhaxherëve, Talinoc i Jerlive, Muhoc, Prelez i Jerlive, Prelez i Muhaxherëve, Bablak dhe deri te Babushi konsiderohet si **Korridori kryesor (Korridori 1)**, por edhe aksi Dardani, Sojevë, Bibaj dhe Fshat i Vjetër deri në Ferizaj mund të konsiderohet si një korridor dhe për analiza të mëtejme do e konsiderojmë si **(Korridori 2)**, edhe aksi Gaçkë, Greme, Doganaj deri në Ferizaj mund të konsiderohet si një korridor dhe për analiza të mëtejme do e konsiderojmë si **Korridori 3**, edhe aksi që e lidhë Shtimen me Ferizajn gjegjësisht aksi Koshare, Slivovë, Loshkobare deri në Ferizaj mund të konsiderohet si një korridor për analiza të mëtejme do e konsiderojmë si **Korridori 4**.

PLOTËSIMI DHE DENDËSIMI: duke e kuptuar Plotësimin dhe Dendësimin si hapësirën e cila ka mundësi dhe potenciale të mbushen dhe dendësohen me zhvillime të caktuara, mënyrë kjo për të arritur integrimin hapësinor dhe për të rritur kufijtë e popullsisë, në komunën e Ferizajt janë analizuar se cilat janë këto hapësira dhe mund të konstatohet se ka disa hapësira brenda kufijve ndërtimor të zonës urbane të qytetit të Ferizajt të cilat ka mundësi dhe potenciale që të plotësohen dhe dendësohen me zhvillime banimi ose edhe përmbajtje tjera, por ka edhe ka hapësira brenda kufijve ndërtimor të zonave ruralet në fshatrat **Prelezi i Muhaxherëve, Softaj, Dardania, Komogllava, Greme, Pleshina e Poshtme, Neredime e Poshtme dhe Koshara** të cilat ka mundësi dhe potenciale që të mbushen dhe dendësohen me zhvillime qoftë banim ose edhe përmbajtje tjera por edhe fshatra tjera ka mundësi për plotësim dhe dendësim.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

MBAJTJA NËN KONTROLL: Duke e kuptuar konceptin e Mbajtjes nën Kontroll si koncept i cili i referohet nevojës për të kufizuar zhvillimin joefikas me dendësi të ultë, në mënyrë tipike përmes përdorimit të një skaji urban i cili tregon kufirin për zhvillim urban për një periudhë të përkufizuar kohore, në komunën e Ferizajt janë analizuar se cilat janë këto hapësira dhe mund të konstatohet se ka disa ka disa hapësira ku ka zhvillimin joefikas me dendësi të ultë si në afërsi të zonës urbane, po ashtu edhe në disa zona rurale, gati në të gjitha fshatrat me numër të madh të banorëve dhe në këtë funksion gjatë analizës së bërë nga ekipet punuese, koordinatorët dhe të gjitha drejtoritë, WSH punues në Durrës dhe në mënyrë të veçantë me drejtorinë e Bujqësisë dhe Urbanizmit është arritur pajtim në parim që të definohet kufiri ndërtimor në çdo fshat dhe zonën urbane duke u bazuar në gjendjen reale në teren dhe duke provuar me mbrojt sa ma shumë tokë bujqësore, aty ku konstatohet se ka zhvillime joefikas me dendësi të ultë të kufizohen dhe mos të lejohet zhvillim i mëtejshëm po ato zona të mbahen nën kontroll, zhvillimet brenda fshatrave edhe gjatë përcaktimit të kufijve ndërtimor të mos marrin për bazë zhvillimet joefikase me dendësi të ultë por të promovohen konceptet e zhvillimeve kompakte në këtë nivel.

MBROJTJA: Duke e kuptuar konceptin e **MBROJTJES** si koncept i cili i referohet nevojës për mbrojtjen e resurseve të vlefshme natyrore, kulturore, ekonomike dhe të trashëgimisë, në komunën e Ferizajt janë analizuar të gjitha informatat e profilit, hartat e pasurive nëntokësore dhe sipërfaqësore, strategjitë dhe planet e tashme të nivelit sektorial, komunal, të kompanive publike por edhe të nivelit qendror dhe është konstatuar se pasuritë nëntokësore uji dhe pasuritë tjera minerale por edhe ato arkeologjike duhet të ruhen dhe në harmoni të interesave dhe mundësive planifikohen të zhvillohen duke u trajtuar edhe bazuar në kërkesat dhe obligimet ligjore, toka bujqësore e komunës së Ferizajt si një resurs i interesit të veçantë është trajtuar dhe përcaktuar në kufij për mbrojtje dhe zhvillim, peizazhet dhe vlerat natyrore janë trajtuar dhe planifikuar si pjesë e këtij koncepti edhe atë me Jezercin dhe bifurkacionin e lumit Neredime, edhe resurset kulturore si pjesë e Konceptit të Mbrojtjes paraqiten të bollshme në Ferizaj.

ZONAT E RRITJES: Duke e kuptuar se koncepti me **ZONA TË RRITJES** i referohet ri-zhvillimit të zonave të zhvilluara ekzistuese në intensitetet më të larta dhe zhvillimit të tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës, mund lirisht të thuhet se në analizat e bëra në komunën e Ferizajt, bazuar në informatat e profilit, imazhet satelitore, ortofotot por edhe në takimet publike dhe duke i trajtuar kërkesat e shkruara është konstatuar se në disa vendbanime mund të trajtohen **Zonat e Rritjes** por në mënyrë të veçantë zona Urbane dhe pjesët si zona qendrore dhe disa zona që karakterizohen me ndërtime të viteve 50-ta, n 60-ta, 70-ta e 80-ta ti cilat nuk kanë as një vlerë të trashëgimisë përkundrazi paraqesin rrezik për shkak të jo-stabilitetit dhe jo-funksionalitetit dhe në këto zona mund të ketë ri-zhvillim të zonave ekzistuese të cilat do ri-zhvillohen në kuptimin e ofrimit të cilësisë së banimit por edhe me intensitetet më të larta të ndërtimit, ri-zhvillim mund të ketë edhe në disa zona të zhvillimit ekonomik dhe zona tjera. Gjatë këtij procesi në formulimin e këtij koncepti është trajtuar edhe zhvillimi i mundshëm i tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës e cila është trajtuar edhe te koncepti i plotësimit dhe dendësimit.

INFRASTRUKTURA RRUGORE - Duke e kuptuar konceptin e **INFRASTRUKTURËS RRUGORE** si koncept i cili i referohet nevojës për të trajtuar rolin e kësaj infrastrukture në hartimin e konceptit të Zhvillimit Hapësinor për komunën e Ferizajt, koncepti vijues u zhvillua duke përdorë dhe analizuar të gjitha informatat e profilit, strategjitë dhe planet e tashme të nivelit sektorial, komunal, të kompanive publike por edhe të nivelit qendror dhe është konstatuar se Infrastruktura Rrugore duhet të trajtohet në harmoni të interesave, mundësive të akterve të ndryshëm dhe niveleve të ndryshme kompetente por edhe bazuar në kërkesat dhe obligimet ligjore dhe përfundimisht si pjesë e këtij koncepti do jetë segmenti i autoudhës "Arbër Xhaferi" e cila kalon nëpër komunën e Ferizajt, rrugët Regjionale po ashtu janë pjesë e konceptit dhe lidhja me transit i rrugëve regjionale me autostradën si dhe autostradën e re që do lidhë autoudhën "Arbër Xhaferi" me Gjilanin dhe korridoret VIII dhe X.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

INFRASTRUKTURA HEKURUDHORE - Duke e kuptuar konceptin e **INFRASTRUKTURËS HEKURUDHORE** si koncept i cili i referohet nevojës për të trajtuar rolin e kësaj infrastrukture në hartimin e konceptit të Zhvillimit Hapësinor për komunën e Ferizajt, koncepti vijuese u zhvillua duke përdorë dhe analizuar të gjitha informatat e profilit, strategjitë dhe planet e tashme të nivelit sektorial, komunal, të kompanive publike por edhe të nivelit qendrorë dhe është konstatuar se Infrastruktura Hekurudhore duhet të trajtohet në harmoni të interesave, mundësive të akterve të ndryshëm dhe niveleve të ndryshme kompetente por edhe bazuar në kërkesat dhe obligimet ligjore dhe përfundimisht si pjesë e këtij koncepti do jetë segmenti i Hekurudhës i cili kalon nëpër komunën e Ferizajt gjegjësisht nëpër mes të qytetit të Ferizajt dhe varianti i vendosjes nën tokë dhe tanishëm do jenë tejet me ndikim në konceptin e qytetit të integruar ose të vazhdoj me trendin e deri më tashme, po ashtu pjesë e këtij koncepti është edhe trajtimi i stacionit hekurudhor të mallrave dhe lidhja me hekurudhë e linjës Fushë Kosovë -Shkup me Gjilanin dhe korridoret VIII dhe X.

4.3.1. Skenarët e propozuar hapësinor

Ky koncept i Zhvillimit Hapësinor do të analizohet dhe trajtohet përmes skenarëve të mundshëm dhe të propozuar hapësinor që do ti paraqesim me përshkrime tekstuale dhe harta që do të përshkruajnë zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që do të mbrohen, si dhe ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja.

Skenarët e propozuar hapësinor si të tilla do shpallen edhe në shqyrtim publik; dhe skenari i propozuar hapësinor, i cili zhvillohet tutje për të plotësuar të gjitha kërkesat qytetarëve, institucioneve OJQ-ve dhe akterve të tjerë por edhe kërkesat e Udhëzimit Administrativ, do të zgjidhet në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit. Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor përmes hartës për shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe hartave për planet zhvillimore sektoriale do jetë bazë për Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planet e Veprimit.

Ky koncept i Zhvillimit Hapësinor do të analizohet dhe trajtohet përmes skenarëve të mundshëm dhe të propozuar hapësinor që do ti paraqesim me përshkrime tekstuale dhe harta që do të përshkruajnë zgjerimet, kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen, masat mbrojtëse dhe zonat që do të mbrohen, si dhe ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja.

Skenarët e propozuar hapësinor si të tilla do shpallen edhe në shqyrtim publik; dhe skenari i propozuar hapësinor, i cili zhvillohet tutje për të plotësuar të gjitha kërkesat qytetarëve, institucioneve OJQ-ve dhe akterve të tjerë por edhe kërkesat e Udhëzimit Administrativ, do të zgjidhet në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit.

Skenarët e propozuar në vijim:

- Nuk parashohin zgjerime të zonës urbane;
- Janë të bazuar në analiza për kërkesat për shfrytëzimin e tokës në të ardhmen;
- Kanë zonat që do të mbrohen, gjersa masat duhet të përcaktohen në Hartë Zonale të Komunës; si dhe
- Paraqesin ndryshimet e propozuara dhe zhvillimet e reja me interes të mash për Komunën.

Ky Koncept i Zhvillimit Hapësinor përmes hartës për shfrytëzimin e planifikuar të tokës dhe hartave për planet zhvillimore sektoriale do jetë bazë për Prioritetet e Zhvillimit Strategjik dhe Planet e Veprimit.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Skenari 1


Ferizaj si qytet linear në arterien kryesore veri-jugore të Kosovës, duke përcaktuar:

- Zhvillimi i vendbanimeve është përqendruar përgjatë rrugës M2/E65
- Qendra e qytetit është zgjeruar drejt lindjes,
- Zona malore në përëndim është mbrojtur dhe përdorur për rekreacion,
- Stacioni hekurudhor është larguar jashtë qendrës së qytetit, në rrugën M2/E65,
- Stacioni hekurudhor për mallra është ndërtuar në pjesën jugore të komunës

▪ Përparësitë	▪ Mangësitë
Lokacioni në arterien kryesore veri-jugore të Kosovës është i përdorshëm,	Zonat e mëdha të zhvilluara krijojnë rrezik për shtrirjen urbane përgjatë rrugës,
Largimi i hekurudhës e liron qendrën e qytetit nga komunikacioni,	Rruga M2/E65 nuk mund të përmirësohet ose të rindërtohet,
Përqendrimi i zhvillimeve e bën të mundshme mbrojtjen e natyrës dhe tokës bujqësore.	Qendra ekzistuese e qytetit është dobësuar dhe shpërndarë.
	Nuk ka zhvillim të fshatrave në periferi,
	Nuk ka stacion hekurudhor në qendër të qytetit,
	Trafiku i ngarkuar rrjedh përgjatë qytetit,

Konkluzionet

Skenari 1 nuk do të zhvillohet më tepër.



Harta 55 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 1



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Skenari 2


Ferizaj si zonë urbane përgjatë rrugës kryesore, duke përcaktuar:

- Zhvillimi i fshatrave përgjatë rrugës kryesore,
- Zona malore në përfundim është mbrojtur dhe përdorur për rekreacion,
- Stacioni hekurudhor për mallra dhe njerëz është ndërtuar në skaj të pjesës veriore të qendrës së qytetit.

▪ Përparësitë	▪ Mangësitë
Lokacioni në udhëkryqin ndërmjet rrugëve kryesore është i përdorshëm,	Zonat e mëdha të zhvilluara krijojnë rrezik për shtrirjen urbane përgjatë rrugës,
Largimi i hekurudhës e mban larg barrierën në qendër të qytetit, stacioni i hekurudhës ende është afër qendrës së qytetit.	Rruga M2/E65 nuk mund të përmirësohet ose të rindërtohet,
	Qendra ekzistuese e qytetit është dobësuar dhe shpërndarë.
▪	Nuk ka zhvillim të fshatrave në periferi,
▪	Nuk ka stacion hekurudhor në qendër të qytetit,
▪	Trafiku i ngarkuar rrjedh përgjatë qytetit,

Konkluzionet

Skenari 2 nuk do të zhvillohet më tepër.



Harta 56 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 2



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Skenari 3


Ferizaj si komunë poli-centrike me hekurudhë që kalon nëpër qendër të Ferizajt në formën qysh është edhe tani, duke përcaktuar:

- Zhvillimi është përqendruar në qytetin e Ferizajt dhe në disa vendbanime,
- Pjesët e largëta të rrafshinës janë përdorur për bujqësi,
- Zona malore në përfundim është mbrojtur dhe përdorur për rekreacion,
- Një autostradë është ndërtuar në Fushë Kosovë, paralel me rrugën nacionale ekzistuese,
- Një rrugë unazore është ndërtuar jashtë Ferizajt, duke e larguar trafikun nga brendia e qytetit.
- Një korridor i zhvillimit ekonomik Gurëz - Ferizaj - Babush
- Zhvillim edhe në aksin Dardani - Sojevë – Bibaj

▪ Përparësitë	▪ Mangësitë
Zhvillimi i përqendruar është duke përdorur tokën në mënyrë efektive,	Zhvillimi i zonave të mëdha krijon rrezik për shtrirje urbane,
Pjesët e mëdha të rrafshinës mund të përdoren për bujqësi	Përdorimi jo i efektshëm i rrugës unazore me zhvillim vetëm në një anë,
Trafiku i distancave të largëta është mbajtur jashtë qytetit të Ferizajt,	Hekurudha është duke krijuar një barrierë përmes brendisë së qytetit,
Stacioni hekurudhor në qendër të qytetit.	Nuk ka zhvillim në fshatrat e largëta në periferi,
Distancat e shkurtra brenda qytetit,	

Konkluzionet

Skenari 3 do të zhvillohet në kombinim me planet e tjera të veprimit.



Harta 57 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 3



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Skenari 4


Ferizaj si komunë poli-centrike me nëntokë nëpër qendër të Ferizajt, duke përcaktuar:

- Zhvillimi është ndarë ndërmjet qytetit të Ferizajt dhe disa nënqendrave sekondare, i shpërndarë në mënyrë të barabartë nëpër tërë komunën,
- Pjesët e largëta të rrafshinës janë përdorur për bujqësi,
- Zona malore në përendim është e mbrojtur dhe përdoret për rekreacion,
- Rruga unazore është krijuar në kombinim të rrugës ekzistuese dhe të rrugës së re,
- Ndërtimet e reja janë zhvilluar në të dy anët e rrugës unazore.
- Ndërtime kompakte në nivel të vendbanimeve
- Ndërtime të planifikuara në korridoret zhvillimore
- Lidhje funksionale të zonave turistike

▪ Përparësitë	▪ Mangësitë
Zhvillimi i përqendruar në shumë pika është duke e përdorur tokën dhe burimet e tjera në mënyrë efektive,	Pjesët e largëta të fshatrave nuk kanë zhvillim.
Edhe qyteti dhe shumica e pjesëve të fshatrave janë furnizuar me shërbime,	
Përdorimi i pjesëve të mëdha të rrafshinës për bujqësi,	
Distancat e shkurtra brenda qytetit,	
Trafiku i distancave të largëta është mbajtur jashtë qytetit të Ferizajt,	
Stacioni modern hekurudhor në qendër të qytetit.	

Konkluzionet

Skenari 4 do të zhvillohet në kombinim me planet e tjera të veprimit.



Harta 58 Zhvillimi hapësinor sipas skenarit 4



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

4.3.2. Koncepti kryesor për zhvillim hapësinor të komunës së Ferizajt

Ekipi komunal i planifikimit dhe ekipet tjera të angazhuara në hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt kanë analizuar dhe trajtuar disa skenar më saktë katër skenar. Të gjithë skenarët janë analizuar dhe trajtuar bazuar në Nyjet, Korridoret, Plotësimi dhe Dendësimi, Mbajtja nën Kontroll, Mbrojtja, Zonat e Rritjes, Infrastruktura rrugore, Infrastruktura hekurudhore dhe përmbajtje tjera të mundshme.

Të gjithë skenarët që janë analizuar dhe trajtuarishin real dhe kishin përparësitë dhe dobësitë e tyre, por Skenari 4 që do trajtohet më tutje është më i favorshëm në kuptimin Hapësinor, Ekonomik, Social, Mjedisor por edhe Funkcional si dhe të ofroj cilësi për jetë, punë si dhe mbrojtje e zhvillim.

Në Nivel komunal në kuptimin e Nyjeve do paraqitet si koncept policentrik ku përpos zonës urbane qytetit të **Ferizajt** e cila përfshin zonën kadastrale të Ferizajt dhe të fshatrave **Talinoc i Jerlive, Nikadini** (me gati komplet hapësirën kadastrale) dhe zonave kadastrale të vendbanimeve Doganaj, Zaskok, Pleshinë, Neredime e Poshtme, Loshkobare (me një pjesë shumë të vogël të hapësirës së këtyre zonave kadastrale), por edhe Nyjeve tjera si **Prelezi i Muhaxherëve, Softaj, Dardania, Komogllava, Greme, Pleshina e Poshtme, Neredime e Poshtme dhe Koshara** si dhe **Kampi Bonstil**.

Ndërsa në nivel të vendbanimeve do promovojë zhvillime sa ma kompakte që është e mundur. Ky koncept i konsideruar si më racional dhe efikase nga grupet punuese për zhvillim të planifikuar Komunal, si bosht të vetin orientues për arritjen e vizionit të Komunës së Ferizajt e konsideron nevojën e zhvillimit (ekonomik, social, demografike mjedisore) të sinkronizuar, në kohë e hapësirë, të qendrës komunale edhe të nënqendrave të cilat do të jenë në pozitën e vendbanimit komplementar në kuptimin se funksionet themelore të këtyre vendbanimeve policentrike plotësojnë funksionet e vendbanimeve tjera, brenda ndarjes hapësinore policentrike, ashtu që këto të sigurojnë edhe lidhjen funksionale të rregullt dhe të mirë të mbarë hapësirës brenda kësaj komune dhe rajonit.

Specifikat e zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Ferizajt, kërkojnë që në të ardhmen konceptin të urbanizimit të i hyhet në mënyrë tepër elastike. Përveç urbanizimit për qendrën kryesore Ferizajn dhe nënqendrat, lansohet koncepti edhe për urbanizimin kompakt të fshatrave tjera.

Duhet bërë zhvillimi i vendbanimeve me konceptin zhvillimit hapësinor **policentrik**, për plotësimin e rrjetës urbane të vendbanimeve me funksione dhe përmbajtje dhe për një zhvillim më të baraspeshuar hapësinor të territorit të komunës së Ferizajt, vlerësohet prioritet **zhvillimi i shpejtë i qytetit** dhe nënqendrave si në funksion të lidhjeve, shërbimeve, dendësimit si dhe ushtrimit të funksioneve tjera plotësuese sociale, ekonomik e mjedisore.

Qendra komunale (Ferizaj) duhet të orientohet e ndërtohet me të gjitha elementet e strukturës urbane komplete. Ajo do të siguroj mënyrën urbane të jetesës, me të gjitha funksionet dhe përmbajtjet që i përgjigjen urbanizimit të qëndrueshëm, zhvillime të rëndësishme dhe përmbajtje urbane duhet pritur edhe zonat kadastrale të fshatrave **Talinoc i Jerlive, Nikadintë** cilat do ti përgjigjen funksionit të zonës urbane të Ferizajt në hapësirë, komunë, regjion dhe nivel të Kosovës por edhe të këtyre vendbanimeve brenda këtyre zhvillimeve.

Shkalla e urbanizimit duhet të rritet në harmoni me trendët globale, tani më tepër se gjysma e popullsisë botërore jeton në vendbanime urbane. Shtimi i shpejtë i popullsisë urbane, si dhe vendbanimeve dhe popullsisë gjysmë - urbane pritet gjatë viteve në vijim, si rezultat i investimeve për plotësim të standardeve për para qasje të Kosovës në strukturat Evropiane, zhvillimit ekonomik dhe i ndërtimit të kapaciteteve industriale dhe gjatë kësaj periudhe gjerë në vitin 2025.

Numri i vendbanimeve urbane e gjysmë - urbane të propozuara me këtë plan në të ardhmen do të kompletojnë strukturën urbane. Rolin më të rëndësishëm në këtë drejtim do vazhdojë t'a ketë Ferizaj, si qendër administrative dhe komunale dhe vendbanimi i më i madh Komunal.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

Ky koncept në nivel komunal e konsiderohen si korridor që duhet të joshet dhe inkurajohet intensitet i rritur i zhvillimit ekonomik pasi që edhe pjesa më e madhe e këtij korridori edhe sot e ka këtë funksion aksin që fillon në Gurëz dhe vazhdon nëpër: Varosh, Fshat i Vjetër, Ferizaj, Talinoc i Muhaxherëve, Talinoc i Jerlive, Muhoc, Prelez i Jerlive, Prelez i Muhaxherëve, Bablak dhe deri te Babushi dhe që konsiderohet si njëri ndër **Korridoret kryesore (Korridori 1)**.

Në funksion të zhvillimit kompakt në nivel të vendbanimit, ky koncept parasheh dendësime me zhvillime të hapësirave brenda kufijve ndërtimor të zonës Urbane dhe zonave ruralet në fshatrat **Prelezi i Muhaxherëve, Softaj, Dardania, Komogllava, Greme, Pleshina e Poshtme, Neredime e Poshtme dhe Koshara** të cilat ka mundësi dhe potenciale që të mbushen dhe dendësohen me zhvillime qoftë banimi ose edhe përmbajtje tjera por edhe fshatra tjera ka mundësi për plotësim dhe dendësim

Ky Koncept kërkon definim të kufijve ndërtimor në çdo fshat dhe zonën urbane duke u bazuar në gjendjen reale në teren dhe duke synuar për të mbrojtur sa ma shumë tokë bujqësore, aty ku konstatohet se ka zhvillime joefikase me dendësi të ultë, të kufizohen dhe mos të lejohet zhvillim i mëtejshëm po ato zona të mbahen nën kontroll, zhvillimet brenda fshatrave edhe gjatë përcaktimit të kufijve ndërtimor të mos marrin për bazë zhvillimet joefikase me dendësi të ultë por të promovohen konceptet e zhvillimeve kompakte në këtë nivel.

Ky koncept trajton edhe tokën bujqësore të komunës së Ferizajt si një resurs i interesit të veçantë të përcaktuar me kufij për mbrojtje dhe zhvillim, peizazhet dhe vlerat natyrore janë trajtuar dhe planifikuar si pjesë e këtij koncepti edhe atë me Jezercin dhe bifurkacionin e lumit Neredime, që kërkon një planifikim të posaçëm hapësinor, si dhe resurset kulturore janë përmbajtje e rëndësishme e këtij koncepti.

Zonat e Rritjes por në mënyrë të veçantë zona Urbane dhe pjesët si zona qendrore dhe disa zona që karakterizohen me ndërtime të viteve 50-ta, 60-ta, 70-ta e 80-ta të cilat nuk kanë asnjë vlerë të trashëgimisë dhe përkundrazi paraqesin rrezik për shkak të jo-stabilitetit dhe jo-funksionalitetit dhe në këto zona mundë të ketë ri-zhvillim të zonave ekzistuese të cilat do ri-zhvillohen në kuptimin e ofrimit të cilësisë së banimit por edhe me intensitetet më të larta të ndërtimit, ri-zhvillim mund të ketë edhe në disa zona të zhvillimit ekonomik dhe zona tjera.

Infrastruktura Rrugore si pjesë e këtij koncepti do jetë segmenti i autostradës "Arbër Xhaferi" i cili kalon nëpër komunën e Ferizajt, rrugët Regjionale po ashtu janë pjesë e koncepti dhe lidhja me transitin i rrugëve regjionale me autoudhën e re që do lidhë autostradën "Arbër Xhaferi" me Gjilanin dhe korridoret VIII dhe X.

Infrastruktura Hekurudhore si pjesë e këtij koncepti do jetë segmenti i Hekurudhës i cili kalon nëpër komunën e Ferizajt, gjegjësisht nëpër mes të qytetit të Ferizajt dhe varianti i vendosjes nën tokë dhe tanishëm do jenë tejet me ndikim në konceptin e qytetit të integruar ose të vazhdoj me trendin e deri më tashme, po ashtu pjesë e këtij koncepti është edhe trajtimi i stacionit hekurudhor të mallrave dhe lidhja me hekurudhën e linjës Fushë Kosovë - Shkup me Gjilanin dhe korridoret VIII dhe X.



5. Prioritetet e zhvillimit strategjik dhe plani i veprimit

5.1. Prioritetet e zhvillimit strategjik

Bazuar në profilin, vlerësimin e gjendjes ekzistuese, kërkesave të banorëve dhe mundësitë financiare, Komuna ka identifikuar prioritetet e zhvillimitstrategjik të radhitura në vijim.

5.1.1. Zhvillimi ekonomik

1. NVM-të e zhvilluara;
2. Zhvillimi i zonave ekonomike;
3. Zhvillimi i infrastrukturës së përgjithshme dhe specifike;
4. Promovimi i investimeve PPP;
5. Eksploatimi i pasurive nëntokësore;
6. Ruajtja dhe zhvillimi i tokës bujqësore;
7. Zhvillimi i turizmit rekreacional dhe kulturor.

5.1.2. Infrastruktura teknike

1. Ngritja e kapaciteteve prodhuese të ujit të pijshëm;
2. Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;
3. Montimi i ujëmatësve zonal për monitorim të humbjeve;
4. Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit;
5. Zgjerimi i rrjetit të drenazhës;
6. Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues elektrik;
7. Ndërtimi i rrjetit të ngrohjes qendrore termale;
8. 100% mbulueshmëri me rrjet telekomunikues dhe përmirësimi i rrjetit kabllor;
9. Përcaktimi i zonës për varrimin e shtazëve të ngordhura;
10. Përcaktimi i zonës për deponin për mbeturina të ngurta;
11. Përcaktimi i zonës për qendrën për trajtimin e mbeturinave;
12. Përcaktimi i zonës për deponimin e mbeturinave të ngurta.

5.1.3. Transporti dhe transporti publik

1. Hapja e rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese;
2. Krijimi i shtigjeve për çiklistë, këmbësorë dhe personave me aftësi të kufizuara;
3. Eliminimi i fatkeqësive në hekurudhe;
4. Zgjerimi i rrugëve nacionale drejtë kyçjeve të autoudhës së re;
5. Lidhja e fshatrave përmes rrugëve alternative unazore;
6. Fuqizimi i transportit hekurudhor dhe transportit publik dhe ndërrurban.

5.1.4. Infrastruktura publike dhe sociale

1. Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për shërbime publike shëndetësore
2. Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për shërbime publike arsimore
3. Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për aktivitete rekreative
4. Përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës për aktivitete kulturoro-artistike
5. Përmirësimi i shërbimeve administrative për qytetarët.



5.1.5. Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri

5.1.5.1. Mbrojtja e mjedisit

5.1.5.1.1. Mbrojtja e ujit

1. Ndërtimi i sistemit të kanalizimit dhe të sistemit të ujërave atmosferike përgjatë lumenjve;
2. Rregullimi i sistemit të kullimit (drenazhimit) të sipërfaqeve afër lumenjve;
3. Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë përgjatë brigjeve të lumenjve;
4. Hartimi i programeve për ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e vegjetacionit dhe për trajtimin e lumit, si një vlerë natyrore;
5. Hartimi i planit për menaxhimin e mbeturinave (riciklimin, selektimi i mbeturinave);
6. Trajtimi i ujërave të zeza (ndërtimi i impianteve).

5.1.5.1.2. Mbrojtja e mjedisit

1. Ndërgjegjësimi i banorëve për mbrojtjen e pyjeve dhe natyrës në përgjithësi;
2. Bashkëpunimi ndër-komunal për mbrojtjen e pyjeve në zonat ndër-komunale;
3. Ngritja e kapaciteteve në menaxhimin e sektorit të pyjeve.

5.1.5.2. Mbrojtja nga rreziqet natyrore

5.1.5.2.1. Masat mbrojtëse nga përmbytjet

4. Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.
5. Rregullimi i sistemit të drenazhimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.
6. Përmirësimi i shtratit të lumit për të dy degët e bifurkacionit
7. Ndërtimi i sistemit të drenazhimit në zonën hapësirave të lira për rekreacion te Gjymnazi.
8. Pastrimi, përmirësimi dhe rregullimi i shtratit të lumit në segmentin te “Ura e Dudit” dhe më poshtë.
9. Pastrimi, rregullimi dhe mbulimi i pjesshëm i kanalit (në zonën e tretë shih hartën)
10. Zbatimi i dokumentit të VRMF si komponentë e PZHU-se gjatë hartimit të planeve rregulluese.
11. Ndarja e buxhetit vjetor për mirëmbajtjen e lumenjve
12. Në rastin e ndërtimit të objektit në zonat afër lumenjve (jashtë zonës së mbrojtur), duhet të prezantohet projekti detal i drenazhimit të objektit dhe hapësirës ku ndërtohet objekti.
13. Kufizimi i zhvillimeve në zonat të cilat historikisht janë të prira për përmbytje.
14. Përmirësimin e këtyre zonave dhe destinimi i tyre për sipërfaqe të gjelbra.
15. Shenjëzimi në teren i zonës së mbrojtur nga ndërtimet (50 m gjerësi)

5.1.5.2.2. Masat mbrojtëse nga tërmetet

1. Organizimi i fushatave periodike (punëtori, simulime) për vetëdijësimin e popullatës për rreziqet (tërmetet).
2. Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kontrollimin e zhvillimeve në aspekt të ndërtimit rezistues nga forcat sizmike. Kontrolli duhet të verifikoi nëse objekti i cili dotë ndërtohet përmban masat elementare për rezistencë ndaj tërmeteve.
3. Hartimi i hartave mikro sizmike për 8 zonat urbane.
4. Vlerësimi i qëndrueshmërisë së infrastrukturës kritike (shkollat, spitalet, urat, mbikalimet, pendat, etj.) dhe objekteve tjera me rendësi ndaj ndikimeve sizmike
5. Hartimi i projekteve specifike për përforcimin e strukturave ekzistuese aty ku justifikohet arsyeshmëria ekonomike dhe racionale,
6. Përforcimi i objekteve të infrastrukturës kritike me qëllim shfrytëzimin e tyre si qendra për evakuim në raste e fatkeqësive.

5.1.5.2.3. Masat mbrojtëse nga zjarri

1. Ndërtimi i rrjetit të hidrantëve publik në zonën urbane



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

2. Shpërndarja e udhëzimeve si të sillen në ndërtesë në rast fatkeqësie/zjarri
3. Trajnime/ushtrime për banorët si t'i shfrytëzojnë udhëzimet, si të përdorin aparatet për shuarjen e zjarrit.
4. Fletushka për ngritjen e vetëdijes si të parandalohen zjarret në zonat rurale.

5.1.5.2.4. Masat mbrojtëse nga erozioni

1. Ngritja e vetëdijes së komunitetit
2. Ripyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara
3. Ndërmarrja e masave të nevojshme gjatë ndërtimit të rrugëve në zonat rurale

5.1.6. Asetet e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe turistike

1. Definimi i zonës së mbrojtur të fenomenit të bifurkacionit, kompletimi me shtigje për këmbësor, çiklistë dhe përmbajtjeve tjera;
2. Marrja e masave në sigurimin e stabilitetit të objekti i arkivit të qytetit
3. Marrja e masave në sigurimin e stabilitetit të objekti i Bibliotekës së Qytetit
4. Shpallja si objekt i mbrojtur shtëpia e Gjon Sereqit
5. Shpallja si objekte të mbrojtura të gjithë mullinjtë e vjetër të Ferizajt (Mulliri i Kukës)
6. Studimi dhe hulumtimi dhe gjurmimi i zonave arkeologjike në Varosh
7. Studimi dhe hulumtimi dhe gjurmimi i zonave arkeologjike në Nikadin
8. Studimi dhe hulumtimi dhe gjurmimi i zonave arkeologjike në Neredime të P. dhe Jezerc
9. Incizimi i Valles së kaçakëve
10. Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Varosh
11. Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Komogllavë
12. Grumbullimi dhe ruajtja dhe selektimi i trashëgimisë së luajtshme në Greme dhe Gaçkë dhe vende të tjera
13. Përcaktimi i sipërfaqeve të mbrojtura për lokacionet e pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore

5.1.7. Shfrytëzimit i tokës

1. Përcaktimi i zonave të Banimit
2. Përcaktimi i zonave Ekonomike
3. Përcaktimi i zonave për infrastrukturës sociale
4. Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore
5. Përcaktimi i zonave për bujqësi intensive
6. Përcaktimi i zonave për irigacion të tokave
7. Përcaktimi i zonave për ripyllëzim në Jezerc, Burrnik dhe Rahavicë, Mirash, Mirosalë, etj.
8. Përcaktimi i zonave për meliorim
9. Përcaktimi i zonave për turizëm malor në Jezerc, Pleshinë, Burrnik, Rahavicë
10. Përcaktimi i zonave për turizëm të gjuetisë (në konsultim me Shoqatën e Gjuetarëve)
11. Përcaktimi i zonave mbrojtëse për rrjetin elektrik të tensionit të lartë
12. Përcaktimi i zonave me interes të veçantë që duhet të trajtohen me Plane Rregulluese të Hollësishme
13. Miratimi i Hartës Zonale të Komunës
14. Miratimi planeve Rregulluese të Hollësishme

5.1.8. Vendbanimet

1. Zhvillimi kompakt hapësinor dhe mbrojtja e tokës bujqësore përmes përcaktimit të kufijve ndërtimor për vendbanimeve rurale
2. Përcaktimi i zonave mbrojtëse për tension të lartë
3. Përcaktimi i kufijve ndërtimor për vendbanime rurale



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025 i Komunës së Ferizajt

4. Përcaktimi i Plane Rregulluese të Hollësishme për vendbanime urbane dhe rurale
5. Trajtimi i vendbanimeve joformale



5.2. Plani i veprimit

5.2.1. Infrastruktura teknike

5.2.1.1. Prioriteti 1. Ngritja e kapaciteteve prodhuese i ujit të pijshëm

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit përgjatë rrugës Shkup – Prishtinë, L=5,000m	I mesëm	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	250,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
2	Zëvendësimi i gypave kryesor nga Kaptimi deri te Fabrika (Prroni i Pukës) Ø 200 AC në PE-100-RC, L=850m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	110,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
3	Zëvendësimi i gypave kryesor nga Kaptimi deri te Fabrika (Prroni i Syles) Ø 200 AC në PE-100-RC, L=1,100m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	130,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
4	Zëvendësimi i gypave kryesor nga Kaptimi deri te Fabrika (Lumi i Vogël) Ø 250 AC në PE-100-RC, L=10,000m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	550,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
	Totali i investimeve					1,040,000 €	

5.2.1.2. Prioriteti 2. Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zëvendësimi i gypave në rrugën Alishefik Spahiu Ø 80 AC në DN 80mm; PE-100-RC, L=300.00m	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	70,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
2	Zëvendësimi i gypave në rrugën Ali Asllani Ø 80 AC në DN 80mm; PE-100-RC, L=200.00m	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	65,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
3	Zëvendësimi i gypave në rrugën Afrim Zeqiri Ø 80 AC në DN 80mm; PE-100-RC, L=200.00m	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	70,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
4	Zëvendësimi i gypave në rrugën Fehmi Lladrovci Ø 80 AC në DN 80mm; PE-100-RC, L=300.00m	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	70,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
5	Zëvendësimi i gypave në rrugën Lidhja e Prizrenit Ø 80 AC në DN 80mm; PE-100-RC, L=270.00m	I lartë	Afatshkurtër	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	70,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
6	Zëvendësimi i gypave nga rezervuari V=5000 m3 deri te Varoshi Ø 300 AC në DN 315mm; PE-100-RC, L=1000m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	170,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
7	Zëvendësimi i gypave në rrugën Afrim Abazi AC 200mm PE- 100-RC, L=(1600-2000)m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	170,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
8	Zëvendësimi i gypave në rrugën Nermin Vlora Ø 200 AC në DN 200mm; PE-100- RC, L=2000m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	150,000 €	Drejtoria për infrastrukturë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
9	Ujësllësi dhe asfaltimi i rrugës në lagjen "Bajram Curri" në fshatin Gaçke	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna	74,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
10	Furnizimi me ujë në fshatrat : Sazli, Papaz dhe Prelez;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna me donator	150,000 €	Drejt. për infrastrukturë
11	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësitn Sojevë, PE-100-RC, L=11500.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	245,120 €	Drejtoria për infrastrukturë
12	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësit për fshatin Dardani, PE-100-RC, L=12000.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	390,700 €	Drejtoria për infrastrukturë
13	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësit për fshatin Prelez i Epërm, PE-100-RC, L=6500.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	245,450 €	Drejtoria për infrastrukturë
14	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësit për fshatin Zllatar, PE-100-RC, L=7500.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	260,500 €	Drejtoria për infrastrukturë
15	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësit për fshatin Jezerc, PE-100-RC, L=3000.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	121,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
16	Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësllësit për fshatin Burnik, PE-100-RC, L=3000.00m	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	121,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
17	Ndërtimi i rezervuarit grumbullues në Talinoc të Muhaxh.	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	1,500,000 €	Drejt. për infrastrukturë
18	Ndërtimi i objektit i cili do të shërbejë për vendosjen e pompaveshtytëse dhe sistemit të klorifikimit	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	90,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
19	Ndërtimi i rezervoarit për shpërndarjen e ujit në Sojevë	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna dhe BE	135,000 €	Drejt. për infrastrukturë
	Totali i investimeve					4,167,770 €	

5.2.1.3. Prioriteti 3. Montimi i ujëmatësve zonal për monitorim të humbjeve

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Montimi i ujëmatësve zonal në hyrje të 45 fshatrave	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK	34,000 €	DI
2	Montimi i ujëmatësve zonal për secilën zonë urbane	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK	13,500 €	DI
3	Përmirsimi i rezervuarve të Vjetërdhe ndërtimi i rezervuarveve të rinj në disa pjesë ku është e nevojshme dhe vendosja e klorinatorëve, si dhe riparimi i tyre	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK	25,000 €	DI
4	Mbrojtja e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore, sipas ligjeve në fuqi	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna	300,000 €	DI
	Totali i investimeve					372,500 €	



5.2.1.4. Prioriteti 4. Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Zëvendësim në pjesën Urbane (Rruga.....) Ø 300mm Beton në DN 400-630mm; PE SN8, L=421m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	160,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
2	Zëvendësim në pjesën Urbane (Rruga.....) Ø 200mm Beton (DN 200-315)mm; PE SN8, L=765m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe KURK "Bifurkacioni	141,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
3	Kanalizimi fekal dhe asfaltimi i rrugës në lagjen e Dragoshve në fshatin Sojevë;	I lartë	Afatmesëm	I Lart	Komuna	263,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
4	Kanalizimi fekal në Lagjen Llojza të Lloshkobares	I lartë	Afatmesëm	I Lart	Komuna	30,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
5	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën jugore DN 400-630mm; PE SN8; L=1995m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	498,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
6	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën jugore DN 1200mm; PE SN8; L=6488m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	2,842,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
7	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore të Muhoc DN400mm; PESN8; L=690m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	80,405 €	Drejtoria për infrastrukturë
8	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Talinoc dhe Zonën Industriale të Qytetit DN 800mm; PESN8; L=940	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	226,059 €	Drejtoria për infrastrukturë
9	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Sazli DN 800mm; PESN8; L=1590m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	381,900 €	Drejtoria për infrastrukturë
10	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Pojat, Softaj dhe Papaz DN=800mm; PESN8; L=151m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	369,510 €	Drejtoria për infrastrukturë
11	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Rahavicë DN (400-800)mm; PESN8; L=3080m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	369,113 €	Drejtoria për infrastrukturë
12	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Mirash dhe Cërnillë DN 800mm; PESN8; L=1994m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	505,970 €	Drejtoria për infrastrukturë
13	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Babush, Surqinë dhe nga Bablaku- Impiant DN 800mm; PESN8; L=3860m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	1,101,131 €	Drejtoria për infrastrukturë



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
14	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZnë pjesën veriore për Prelez të Jerlive DN(315-400)mm; PESN8; L=2370m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	292,862 €	Drejtoria për infrastrukturë
15	Ndërtimi i kolektorëvetë ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Prelez i Muhaxherëve DN315mm; PESN8; L=637m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	73,613 €	Drejtoria për infrastrukturë
16	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën veriore për Kosinë, Slivovë dhe Lloshkobare DN (500-630)mm; PESN8; L=3725m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	631,310 €	Drejtoria për infrastrukturë
17	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës lidhës me ITUZ në pjesën veriore për fshatin Dremjak dhe KoshareDN 630mm; PESN8; L=3080m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	596,521 €	Drejtoria për infrastrukturë
	Ndërtimi i kolektorëve të ri dhe gypave lidhës me ITUZ në pjesën lindore për Dardani, Sojëvë, Zllatar, Mirash dhe Fshati i Vjetër DN 1200mm; PESN8; L=850m	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	Komuna dhe BE	250,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
Totali i investimeve						8,812,394 €	

5.2.1.5. Prioriteti 5. Riparimi dhe ndërtimi i rrjetit të kanalizimit atmosferik

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Kanalizimi atmosferik dhe riasfaltimi i rrugës "Astrit Bytyqi"	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna	72,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
2	Kanalizimi atmosferik dhe riasfaltimi i rrugës "Hasan Prishtina"	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna	50,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
3	Kanalizimi atmosferik, trotuaret dhe riasfaltimi i rrugës "Alishefik Spahiu"	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna	34,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
4	Kanalizimi atmosferik, trotuaret dhe riasfaltimi i rrugës "Zenun Beqa"	I lartë	Afatmesëm	I vogël	Komuna	58,000 €	Drejtoria për infrastrukturë
Totali i investimeve						214,000 €	

5.2.1.6. Prioriteti 6. Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit ekzistues elektrik

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Projekti Bablak 4019, në mes të Lipjanit dhe Ferizajit me 10 km shtrirje dhe 2 nënstacione të reja;	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	KEDS	140,000 €	KEDS



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
2	Projekti 4021 Varoshi, përgjatë rrugës Ferizaj – Shkup me 6.6 km shtrirje dhe SSHnë fshatin Gurëz;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	88,000 €	KEDS
3	Projekti 4001 Gaçka, duke shfrytëzuar trasenë e LP ekzistues për të ndërtuar LP të dyfishtë rreth 6km dhe LP ajror 1.2km SSHnë Greme;	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	KEDS	130,000 €	KEDS
4	Projekti Jezerc 4013, linjë e re rreth 6 km gjatësi dhe një SSHnë fshatin Neredime;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	77,000 €	KEDS
5	Projekti V.Gërvalla dhe Kosovatransi 4014, përgjatë rrugës 'Zahir Neziri', Xhevë Lladrovci, prapa Elkos me rreth 1 km gjatësi me një SSHnë afërsi të Elkosit;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	50,000 €	KEDS
6	Projekti Qyteti 4015, ndërtimi i stabilimentit që do të mundësojë lidhjen unazore në mes të daljeve 10 kV Nikadini dhe Qyteti si dhe rreth 400m kablllo me SSHnë afërsi të Fakultetit të Shkencave;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	30,000 €	KEDS
7	Projekti Betoni 4017, investime në 4 km gjatësi në trasenë ekzistuese me SSHnë Slivovë;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	60,000 €	KEDS
8	Rexhep Bislimi Projekti 4023, Ndërtimi i linjës së re nëntokësore përgjatë rrugëve Latif Hasani dhe Sejdi Sejdiu me 1.5 km gjatësi dheSSH të ri;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	82,000 €	KEDS
9	Kinemaja dhe Ylli: Projekti 4016, ndërtimi i kioskut për të krijuar mundësinë e lidhjes unazore të daljeve Ylli dhe Kinemaja në gjatësi prej 100 m;	I lartë	Afatmesëm	I vogël	KEDS	28,000 €	KEDS
10	Qyteti Projekti-4009, Pas ndërtimit të NS 110/10kV nga KOSTT, KEDS do të investojë në pjesën e vet ku parasheh nxjerrjen e daljeve të reja, kyçjen e zbarrave 10kV të NS-ve mes veti Bibaj, Ferizaj II dhe Ferizaj me 29 km gjatësi të linjës dhe një SSHnë afërsi të VIVA;	I lartë	Afatmesëm	I madh	KEDS	963,000 €	KEDS
11	Projekti Prelez 4012, ndërtimi i linjës së re rreth 7.5 km me SSHnë afërsi të fshatit Prelez;	I lartë	Afatmesëm	I madh	KEDS	224,000 €	KEDS
12	Projekti 4022, rehabilitim i daljes Nikadini dhe Ylli nga Ferizaji III, përmes një SSH të ri;	I lartë	Afatmesëm	I mesëm	KEDS	98,000 €	KEDS
13	Projekti 4025, ndërtimi i linjës ajrore rreth rrugës për Sojevë, me SSHnë fshatin Sojevë;	I lartë	Afatmesëm		KEDS		KEDS



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
14	Projekti 4092, ndërtimi i linjës kabllorike në gjatësi prej 7 km dhe SShqë të krijohet lidhja në mes NS Ferizajt III 35/10kV dhe NS të ri të KOSTT-it;	I mesëm	Afatgjatë	I madh	KEDS	222,000 €	KEDS
15	Projekti 2 Bablak-4088, Përmirësimi i daljes Bablak dhe rritja e rënieve të tensionit do të arsyetoj investimin në daljen e Bablakut;	I mesëm	Afatgjatë		KEDS		KEDS
Totali i investimeve						2,192,000 €	

5.2.1.7. Prioriteti 7. Ndërtimi i rrjetit të ngrohjes qendrore termale

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Përgatitja e projektit zbatues për rrjetin e ri të ngrohjes termale	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna	300,000 €	Dr.për zhvillim ekonomik
2	Ndërtimi i ngrohtores së re	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna	21,428,000 €	Dr.për zhvillim ekonomik
3	Ndërtimi termo-përçuesit 130/75°C	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna	6,093,143 €	Dr.për zhvillim ekonomik
4	Ndërtimi i nënstacioneve termike 130/75°C	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna	1,879,570 €	Dr.për zhvillim ekonomik
Totali i investimeve						29,700,713 €	

5.2.1.8. Prioriteti 8. 100% mbulueshmëri me rrjet telekomunikues dhe përmirësimi i rrjetit kabllor

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Instalimi i kanalizimit kabllor 2+2/ PE 125mm me 124 dalje për zonën 1	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	450,000 €	PTK
2	Instalimi i kanalizimit kabllor (1+1)/PE dhe 2xØ50mm me 183 dalje për zonën 2	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	750,000 €	PTK
3	Instalimi i kanalizimit kabllor PVC (2+2)/1x2Ø50mm me 83 dalje për zonën 3	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	900,000 €	PTK
4	Instalimi i kanalizimit kabllor PE (2+2) Ø125mm+2xØ32+2xØ40mm me 104 dalje për zonën 4	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	600,000 €	PTK
5	Instalimi i kanalizimit kabllor PE (2+2)Ø125mm+2xØ32+2xØ40mm me 124 dalje për zonën 5	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	700,000 €	PTK



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
6	Instalimi i kanalizimit kabllor PVCØ 110mm(2+2)+PEØ125mm(2+2) me 124 dalje për zonën 6	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	700,001 €	PTK
7	Instalimi i kanalizimit kabllor PVC Ø110mm(1+1) dhe PE Ø 125mm(2+2)me 124 dalje për zonën 7	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	700,002 €	PTK
8	Instalimi i kanalizimit kabllor PE Ø125mm(2+2)/200m +1x2Ø50mm me 29 dalje, Babush - Ferizaj	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	120,000 €	PTK
9	Instalimi i kanalizimit kabllor 1xØ50mm me 46 dalje, Babush - Prelez i Muhaxherëve	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	90,000 €	PTK
10	Instalimi i kanalizimit kabllor 1xØ50mm me 53 dalje, Babush - Babush i Muhaxherëve	I lartë	Afatmesëm	I madh	PTK	300,000 €	PTK
	Totali i investimeve					5,310,003 €	



5.2.2. Transporti dhe transporti publik

5.2.2.1. Prioriteti 1. Ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
1	Kompletimi i pjesës jugpërdimore të unazës komunale Dremjak - Gurëz	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna+MI+donator	3,000,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
2	Unazae brendshme urbane	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna+MI+ donat.	5,000,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
3	Rregullimi i nyjellores (udhëkryqit në disnivel) në kryqëzimin e rrugëve Gjilan-Ferizaj	I lartë	Afatmesëm	I madh	Komuna + MI+donator	8,000,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
4	Rregullimi i Udhëkryqit në rrugën Prishtinë - Shkup	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	800,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
5	Zgerimi i rrugës Joe Biden Jr. deri te qasja në autoudhën "Arben Xhaferi"	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	3,000,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
6	Asfaltimi dhe rregullimi i kanalizimit në rrugën Astrit Bytyqi dhe Sef Kosharja- faza dytë	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	338,150 €	Drejt. e Infrastrukturës
7	Asfaltimi i rrugës "Atanas Athanasi" dhe lidhja me nacionalen	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	38,900 €	Drejt. e Infrastrukturës
8	Asfaltimi i rrugës "Milan Shufraj"	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	38,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
9	Asfaltimi i rrugës "Salih Çeku"	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	40,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
10	Asfaltimi i rrugës, Nora Kelmendi, dhe, Metush Krasniqi, lidhjet e ketyre rrugëve	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	35,500 €	Drejt. e Infrastrukturës
11	Asfaltimi i rrugës Kadri Zeka shtresa e dytë	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	29,500 €	Drejt. e Infrastrukturës
12	Asfaltimi i rrugës në fshatin Zaskok te lagja (Mahall)	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	100,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
13	Asfaltimi i rrugës në Koshare	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	177,100 €	Drejt. e Infrastrukturës
14	Asfaltimi i rrugës në lagjen Mustafa- Pleshinë e Posht.	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	149,289 €	Drejt. e Infrastrukturës
15	Asfaltimi i rrugës në lagjen Topojan fshati Greme	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	1,200 €	Drejt. e Infrastrukturës
16	Asfaltimi i rrugës në Lloshkobare	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	180,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
17	Asfaltimi i rrugës në Talinoc të Jerlive- rruga rreth fabrikës së tubave	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	95,400 €	Drejt. e Infrastrukturës
18	Asfaltimi i rrugës në Zllatar	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	122,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
19	Asfaltimi i rrugës Neredime - Balaj dhe rrugicave në fshatin Balaj	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	Komuna	271,000 €	Drejt. e Infrastrukturës
20	Asfaltimi i rrugës përgjate hekurudhes prej rrugës "Driton Islami" deri te rruga "Brahim Ademi"	I lartë	Afatshkurtër	I ulët	MI + Komuna	122,000 €	Drejt. e Infrastrukturës



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

	Përshkrimi i veprimit	Prioriteti	Afati kohor i zbatimit	Implikimi financiar	Aranzhimi për zbatim	Buxheti i përafërt	Organizata përgjegjëse për zbatim
Në zonat e parapara për zgjerim të vendbanimeve do të bëhen projektet konkrete dhe përcaktohen kushte për ofrim të shërbimeve për qytetarët.

Në zonat e trajtuara si zemrat e gjelbërta në kuadër të vendbanimeve mundë të zhvillohen vetë veprimtari bujqësore (produktet pastra pa pesticide dhe ndotës tjerë).

6.1.2.2.4. Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve

Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal si të lira nga cilido lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi për të garantuar mbrojtjen e:

- Zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë.
- Zonave me vlera të veçanta ekologjike.
- Pasurive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion. (duke mos kundërshtuar zhvillimin e vendbanimit).

Jashtë zonës ndërtimore të banimit do të lejohet vetëm këto ndërtesa:

- Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
- Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme – eksploziv etj;
- Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
- Infrastruktura;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar;
- Rekreacion dhe turizëm rural.

Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë kufijve të përcaktuar të vendbanimeve.

Komuna duhet të iniciojë trajtimin e vendbanimeve joformale, duke përfillur parimet nga strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë.

Bazuar në shfrytëzimin e përcaktuar të tokës, ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e ri do të jetë përgjegjësi e pronarëve ose ndërmarrësve.

6.1.2.3. Kushtet për vendosjen e veprimtarive ekonomike

PZHK ka përcaktuar sipërfaqe të mjaftueshme që të përkrahë zhvillimin e biznesit i cili është i bazuar në shfrytëzimin e fuqisë punëtore vendore me kusht nëse vendoset në hapësirat dhe zonat e parapara për këtë shfrytëzim.

Komuna mundë të lejoj edhe ndërrimin e përkohshëm i destinimit të tokës bujqësore për zhvillim ekonomik: shfrytëzim i mineraleve sipërfaqësore, depozitë e mbeturinave, mbeturinat e industrisë së drurit, shfrytëzim të rërës, zhavorrit dhe gurëve me kusht që pas përfundimit të shfrytëzimit apo përfundimit të afatit të përcaktuar për ndërrim të përkohshëm të destinimit, tokën t'a kthej në gjendjen e mëparshme (Krahas kërkesës për dhënien e lejes për ndërtime për shfrytëzim të përkohshëm të tokës bujqësore për destinime të tjera si dhe për ndërtimin e përkohshëm nga e cila vjen deri te dëmtimi përreth i tokës bujqësore, shfrytëzuesi është i detyruar ta paraqet projektin për rikultivim i cili bëhet në pajtim me dokumentacionin teknik për ndërtim, përkatësisht investitori është i obliguar që para fillimit të kryerjes së punëve në tokën bujqësore, të largoj dhe të ruajë shtresën potencialisht pjellore të tokës për nevoja të rikultivimit të tokës).

Komuna do të përkrahë themelimin e inkubatorit të biznesit për ofrimin e hapësirës për zhvillim ekonomik të bizneseve të reja me kushte të shfrytëzimit nga bizneset fillestare.

Komuna do të ofrojë tokë për shkollën profesionale të bujqësisë dhe qendrën informative për bujqësi me infrastrukturën e nevojshme për të. Lokacioni duhet të plotësoj të gjitha kushtet me sa i përket madhësisë së ngastrës, zonës mbrojtëse, orientimin, qasjen në sistemin e transportit publik.

Në zonat e përcaktuara për biznes dhe industri do të lejohet vetëm ndërtimi i përmbajtjeve të pastra për prodhimtari bujqësore dhe industriale, depot, shërbimet dhe përmbajtje tregtare të cilat nuk kanë ndikim negativ në mjedis.

Lokacioni për përmbajtje të pastra të prodhimtarisë dhe shfrytëzim përkatës komercial mund të zhvillohen në kuadër të vendbanimeve vetëm nëse ato nuk shkaktojnë ndikim negativ (emisioni i gazrave, ndotja e ajrit, zhurma, trafiku) në mjedisin që i rrethon.

Zgjerimi i zonës së industrisë dhe biznesit vetëm nëse qëndrueshmëria e zonës është paraprakisht e dëshmuar dhe me interes të përgjithshëm, në rast të urgjencës dhe mungesës së hapësirës së përshtatshme për tu alokuar.

Komuna do të koordinoj hartimin e Hartës Zonale të Komunës me zonim sensitiv, infrastrukturë përkatëse dhe lidhje me rrjetin rajonal të rrugëve bazuar në kriteret në vijim:

1. Qasje të mirë në korridoret rrugore – jo përmes vendbanimeve,
2. Disponueshmëria e tokës me çmim të ulët,
3. Minimizimi i ndikimeve të dëmshme në vendbanim dhe peizazh
4. Potenciali për zhvillim; toka, infrastruktura përkatëse (kanalizimi, uji, rryma, komunikimet, ngrohja).
5. Maksimumi i indeksit të shfrytëzimit të ngastrës nuk duhet të tejkaloj 45% të ngastrës dhe së paku 20% e sipërfaqes duhet të jetë gjelbërim.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Zonat e reja ku mund të zhvillohen disa industri duhet të dëshmojnë furnizim energjetik të vet qëndrueshëm me prodhim të energjisë nga burimet e ripërtërishme nëse ato gjenden në afërsi të potencialit të lartë për energji të ripërtërishme.

Vetëm ndërtimi i akomodimeve të vogla me maksimum 20 shtretër për turistë në fshatra do të jetë i lejuar, nëse ata në tërësi i respektojnë kushtet mjedisore.

Komuna do të lejojë ndërtimin e infrastrukturës që përkrahë atraksionet turistike dhe aktivitetet e rekreacionit të cilat nuk kanë asnjë ndikim negativ në mjedis-shtigjet për bjeshkatar dhe çiklistë, pikat e vizitës etj.

6.1.2.4. Kushtet për vendosjen e veprimtarive publike

Sipërfaqet publike të gjelbëruara në vendbanime dhe në pjesët e përfshira në Planin Zhvillimor Komunal, mund të ndërtohen dhe mirëmbahen vetëm nëse mundësojnë ruajtjen dhe avancimin e vlerave natyrore dhe të krijuara.

Nëse për shkak të vendosjes së veprimtarive publike, dëmtohet sipërfaqja publike e gjelbëruar, ajo duhet të kompensohet sipas kushteve dhe mënyrës së përcaktuar nga komuna.

Për të mbrojtur zonën e infrastrukturës me interes për komunën, një politikë e mençur do të udhëhiqet nga ana e komunës.

Kushtet për vendosjen e objekteve publike për përsone të moshuar, jetim, hendikepuar duhet të plotësojnë kushtet hapësinore, funksionale dhe të lëvizjes së këtyre kategorive së bashku me plotësimin e funksioneve tjera përcjellëse.

Kushtet për zgjerimin e zonave të aktivitetit publik janë që të jenë në përputhje me funksionin e vendbanimeve – qendra kryesore, nënqendra, qendër lokale dhe fshatrat.

Komuna duhet të alokoj hapësirë për shkolla të reja dhe institucione parashkollore me kushtet e sigurimit të brezit mbrojtës të jenë të arritshme nga transporti publik. Ngastrat e alokuara për këtë ndërtim duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Institucionet parashkollore, sipërfaqet standarde/fëmijë;
2. Shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, sipërfaqet standarde/fëmijë;
3. Shkollat e mesme të larta, sipërfaqet standarde/fëmijë;

Komuna mund të alokoj një ngastër të përbashkët për ndërtimin e përmbajtjeve sikur janë: edukimi, kultura, shëndetësia dhe shërbimet sociale, qendra të komunitetit. Kjo posaçërisht është e rëndësishme për nënqendrat dhe qendrat lokale.

Zonat e destinuar për sporte dhe rekreacion duhet të jene të furnizuara me shtigje, infrastrukturë dhe gjelbërim. Në kuadër të këtyre zonave do të lejohet vetëm ndërtimi i objekteve të hapura dhe të mbyllura sportive, hapësira për parkim, restorante të vogla dhe dyqane që shërbejnë pajisje sportive rekreative. Maksimumi i indeksit të zënies së ngastrës guxon të kaloj 10% të sipërfaqes së ngastrës.

6.1.2.5. Kushtet për vendosjen e korridoreve apo traseve, sipërfaqeve komunikuese dhe sistemeve tjera të infrastrukturës

Korridoret rrugore duhet të garantohen në shkallë të përshtatshme në harmoni me funksion të qendrave dhe kërkesave të nivelit të Kosovës dhe regionale.

Gjatë procesit të definimit të zonave të ndërtimit, duhet të dëshmohet se është shmangur kostoja e lartë në masat zhvillimore dhe mirëmbajtje. Ndërtimi duhet ti respektojë rregullativat për një ndërtim të qëndrueshëm – orientimi, kushtet klimatike etj.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Koncepti detaj i mobilitetit (përfshire edhe transportin publik, këmbësor dhe trafikun për çiklist) për komunën e Ferizajt duhet të thellohet në elaborim. Ky koncept duhet të përcillet me plan detaj për zhvillim.

Problemet teknike lidhur me sigurinë e rrugëve (gjerësia e rrugëve, kalimet e rrezikshme, pjerrtësia) duhet të shmangen dhe të lehtësohen me masa të përshtatshme.

Qasje direkte për zhvillim në rrugët kryesore (p.sh. Kategoria 1) me kufizim të shpejtësisë me më shumë se 60 Km/h nuk do të lejohet.

Ministria e Infrastrukturës është përgjegjëse për rrugët kryesore dhe ato regjionale. Kështu që rregulloret dhe standardet teknike janë të dhëna nga Ministria. Në komunën e Ferizajt, rrugët kryesore, rrugët lokale dhe rrugët e tjera duhet të dimensionohen në mënyrë që të mund të lejojnë rrjedhe të komunikacionit të sigurve për të gjitha automjetet në çfarëdo kushte atmosferike. Shtigjet e Komunikacionit duhet të respektojnë rregulloret ekzistuese. Shtigjet duhet të jenë të gjera me së paku 3.0 m'. Aty ku ka probleme janë barrierat fizike mund të paraqiten shtigjet mund të ngushtohen.

Nëse pozita financiare e komunës nuk mund të siguroj zbatimin e rrugëve me hapësira të veçanta për këmbësorë - në zonat e banimit, është e rekomanduar që rruga duhet të përfshij shtigjet për këmbësor.

Rruga për qasje në parcelat për ndërtim duhet të jetë minimum 3.0m' e gjere dhe max. 6.0 m'.

Te gjitha udhëkryqet në nivelin e terrenit duhet të sigurojnë pamje prej të gjitha drejtimeve.

Shtigjet për çiklizëm të një drejtimi, nëse janë të ndara duhet të jene 0,8m' të gjera. Nëse hapësirat për çiklizëm janë të ndara atëherë shtegu i gjelbër duhet të jete min 0,35m'.

Ne zonat për parkim që shërbejnë për transportin publik, shtegu i ndaljeve të autobusëve duhet të jetë së paku 2.0 m' i gjere.

Standardet për parkim janë si në vijim:

1. Shtëpi banimi për një familje(1VP/shtëpi) në ngastër;
2. Banimi kolektiv (1VP/njësi banimi);
3. Banimi familjar (1VP/1 kat në ngastër apo të ngjashëm);
4. Zyrat; 1 VP në 75 m², (12 VP/1000 m²)
5. Dyqane 1 VP në 50 m², (20 VP/1000 m²)
6. Qendër tregtare: 1 VP në 40 m (25 VP/1000 m²);
7. Industri dhe depo: 1 VP / 5 të punësuar;
8. Shërbime 1 VP / 3 të punësuar;
9. Restorante 1 VP /1 tavolinë;
10. Ndërtesa sportive: 1 VP / 20 ulëse;
11. Shkolla dhe jetimore: 1 VP/ klasa dhe grupe të fëmijëve;
12. Shërbimet e shëndetësisë: 1 VP /40 m² (25 VP/1000 m²);

Ne korridorin rrugor të rrugëve kryesore regjionale, është i lejuar ndërtimi i ndërtesave në vijim:

13. Pompa të benzinës me dyqane, restorant dhe përmbajtje shërbyese;
14. Larje dhe shërbime të automjeteve;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

6.1.2.6. Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo-historike

Vlerat e mbrojtura të natyrës mund të përdoren dhe avancohen në mënyrën e cila e mundëson mbrojtjen dhe avancimin e tyre afatgjate, në përputhje me Ligji Nr. 02/L-18 Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në pjesën e mbrojtur të natyrës nuk mund të zhvillohen aktivitete të cilat e rrezikojnë ekuilibrin natyror, llojlojshmërinë biologjike dhe peizazhore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë, vlerat kulturore ose në çfarëdo mënyrë degradojnë cilësitë dhe veçoritë e vlerave të natyrës.

Duhet ndërmarrë masa të veçanta për ruajtjen dhe shfrytëzimin e vlerave të mbrojtura të kulturës dhe të natyrës. Çdo punë për modifikim ose demolim ose ndonjë veprim konservues apo restaurues për mbulesën e jashtme të ndërtesave të përfshira në asamble ose zona konservuese arkitekturale kërkon pëlqim me shkrim nga Institucioni kompetent.

Trashëgimi arkitektural nën mbrojtje shenjëzohet qartë me një shenjë të dukshme. Vendosja e materialeve reklamuese në monumentet arkitekturale, ndërtesat e ansambleve ose brenda hapësirave konservuese arkitekturale bëhet me leje të shkruar nga Institucioni kompetent.

Ndalohet lëvizja apo zhvendosja e pjeshme ose complete e ndonjë pjese të trashëgimisë së mbrojtur arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme apo të përhershme.

Aplikuesi i lejes në zonën arkeologjike nuk mund të marrë lejen për të filluar punën, para se të bëhet një marrëveshje me Institucionin kompetent për të ndërmarrë një studim vlerësues të trashëgimisë arkeologjike. Sasia e kostos që paraqitet nga aplikuesi për këtë qëllim përcaktohet nga një formulë e dhënë në aktin nënligjor.

Gjatë punëve ndërtuese, nëse bëhet ndonjë zbulim arkeologjik zbuluesi ose investitori duhet të informojë Institucionin kompetent menjëherë, por jo më vonë se sa në ditën pasuese nga koha e zbulimit. Institucioni kompetent ka të drejtë që menjëherë të ndalë punët ndërtimore të filluara dhe të ndërmarrë një studim vlerësues dhe shpëtues arkeologjik në vend për një kohë të kufizuar.

Gërmimet arkeologjike mund të bëhen vetëm me lejen e shkruar të Institucionit kompetent. Vendimi lidhur me këtë leje jepet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës.

Institucioni kompetent ndërmerr masat për konservimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së luajtshme nën mbrojtje.

Trashëgimi kulturore shpirtërore në formë të ndryshme të dokumentimit dhe të regjistrimeve mbrohet, ruhet dhe promovohet në pajtim me këtë ligj dhe parimet ndërkombëtare, standardet dhe praktikat gjyqësore.

Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të afektoj vlerat e monumenteve, përveç atyre që shërbejnë ti mbroj ato.

Komuna së bashku me Autoritetin Kosovar të pyjeve dhe do të organizoj pastrimin sanitar të drunjve në zonat pyjore me funksion të mbrojtjes së peizazheve dhe mund ti ofroj ato për prodhimin e briketit Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit si hapësire publike që të mbroj vlerën e peizazhit.

Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse duhet mbroj vlerat historike dhe t'i avancoj ato.

Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse duhet mbroj zonat historike dhe mos të lejoj as një zhvillim në ato zona që e dëmton kontekstin historik.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

6.1.2.7. Mënyra e trajtimit të hedhurinave

Koncepti detaj i Menaxhimit të Mbeturinave për Komunën e Ferizajt dhe nënqendrat duhet të elaborohet më detalisht në fazën e parë dhe të vazhdohet mbulimi i komplet territorit në fazën e dytë menaxhimi i mbeturinave, duke u bazuar në parimet vijuese:

1. Parandalimin ose zvogëlimin i prodhimit të mbeturinave dhe karakteristikave të rrezikshme, duke përfshirë edhe zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të prodhuara më parë, gjatë ciklit të prodhimit duhet jetë pjesë e sistemit të menaxhimit.
2. Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave.
3. Duhet konsideruar riciklimin e mbeturinave.
4. Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimit i vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie etj).
5. Incenerim pa përfitim të energjisë (trajtimi termik).
6. Duhet menaxhuar në atë formë që të bëhet deponimin e mbeturinave në deponi, pa shkaktuar ndikime të dëmshme në mjedis. Për objektet, vendet dhe pajisjet, për të cilat është e nevojshme Leja Ekologjike duhet kërkuar nxjerrjen e Planit për administrimin e mbeturinave:
7. Kompanitë duhet të posedojnë dokumentacionin me shënimet për mbeturinat e prodhuara, shfrytëzuara dhe për mbeturinat që i deponon vet ndërmarrja (llojin, përbërjen dhe sasinë e mbeturinave);
8. Masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin e punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
9. Ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdoren, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar;
10. Zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njerëzve;
11. Përshkrimin e mënyrave që përdoren për magazinim, trajtim dhe deponim të mbeturinave;
12. Çdo çështje tjetër relevante.

Mbeturinat e grumbulluara nëpër pikat e përcaktuara me Planë do të menaxhohen nga kompania publike ose ndonjë kompani tjetër dhe do të drejtohen çdo javë në drejtim të deponisë regjionale.

Komuna duhet të paraqes një politikë për mbledhjen e materialeve të rendit të dytë si dhe për riciklimin e mbeturinave.

Komuna e Ferizajt së bashku me kompaninë publike regjionale për menaxhimin e mbeturinave duhet të organizojnë ndarjen, mbledhjen dhe riciklimin e mbeturinave.

Trajtimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza duhet të konsiderohen me metoda më të qëndrueshme, duke u përqendruar në prodhimin e energjisë ripërtëritëse dhe biomasës në zonat e definuara si zona të mundshme për prodhimin e energjisë ripërtëritëse.

6.1.2.8. Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

Për të penguar ndikimet e dëmshme në mjedis duhet promovuar "Sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit" i cili i obligon autoritetet publike të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punët mes veti për hartimin dhe zbatimin e çdo mase, standardi apo aktiviteti me qëllim të mbrojtjes së mjedisit.

Duhet bërë fuqizimin e zbatimit të ligjeve dhe bëjnë inspektimin e zbatimit të ligjeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm brenda territorit të komunës

së Ferizajt.

Duhet të përgatiten dhe sigurohen informata për qytetarët në lidhje me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin të qëndrueshëm;



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Askujt nuk mund të ju lëshohet leja për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmban masat e mbrojtjes dhe rehabilitimit mjedisor.

Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.

Projektet Zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime (përplasje) në mjedis.

Gjatë dhënies së Lejeve Urbanistike për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

6.1.2.8.1. Mbrojtja e ujit

Me qëllim të mbajtjes në gjendje të rregullt të shtretërve dhe brigjeve, të ujërrjedhave, shtretërve të kanaleve periferike kulluese, shtretërve dhe brigjeve të akumulimeve artificiale, si dhe të digave është e ndaluar:

- Ndërrimi i drejtimit të ujit në lumenj dhe kanal apo të krijimi i pengesave pa të drejtën ujore;
- Nxjerrja, depozitimi i dheut, hedhja e mbeturinave, materialeve të tjera të ngurta dhe të lëngëta në ujërrjedha, akumulime dhe në brigjet e tyre;
- Ndërtimi i objekteve të tjera, të cilat nuk shërbejnë për mbrojtjen nga përmbytjet, në largësi së paku 10 metra nga vija e plotave të larta të ujërrjedhave dhe akumulimeve;
- Kryerja e punimeve, të cilat mund të dëmtojnë shtratin dhe brigjet e ujërrjedhave, liqeneve, shtratin e kanaleve, tuneleve, akumulimeve ose pengimi i rrjedhës së lirë të ujërave;
- Kryerja e punëve në afërsi të ujërrjedhave, akumulimeve, tuneleve, të cilat do të mund të rrezikojnë stabilitetin e objekteve mbrojtëse ose përdorimin e tyre.

Burimet e ujit duhet të mbrohen. Gjatë dhënies së lejeve për planifikim dhe ndërtim është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në mënyrë që uji nëntokësor të mbrohet:

1. Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji;
2. Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit
3. Kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza
4. Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

Ndalohet edhe përdorimi i substancave organike dhe inorganike për plehërimin e tokës dhe për mbrojtjen e bimëve në resurset ujore dhe brigje në largësi prej 15 metrash nga kufiri i bregut të ujit të klasit të parë dhe 5 metra largësi të bregut të ujit të klasit të dytë.

Ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të cilat për shkak të vetive fizike, kimike e biologjike mund të rrezikojnë shëndetin publik, organizmat ujor dhe gjysmë ujor, vështirësojnë rrjedhjen e ujërave, rrezikojnë pajisjet ose instalimet ujore.

Në resurset ujore, ndalohet hedhja e substancave dhe mbeturinave të rrezikshme.

Kur mund të rrezikohen kushtet cilësore apo sasiore në zonën e mbrojtur ujore mund të

ndalohen ose kufizohen aktivitetet e pronarëve apo poseduesve të tokës.

6.1.2.8.2. Mbrojtja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga tejkalimi i nivelit të zhurmës së lejuar është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të automjeteve motorike dhe vendbanimeve.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

Shfrytëzuesi i pajisjeve të cilat prodhojnë zhurmë dhe vibracion, mund të vë në qarkullim ose të përdor pajisjet sipas kushteve të parapara për aplikimin e masave mbrojtëse për zvogëlimin e zhurmës dhe vibracionit, respektivisht të bënë përdorimin e impianteve, pajisjeve, makinave, mjeteve transportuese dhe aparateve të cilat lirojnë zhurmë deri në nivelin e paraparë me ligj të veçantë.

Ndërtesat duhet të jenë të projektuara dhe e ndërtuara në mënyrë që zhurma të cilën e dëgjojnë njerëzit që banojnë në afërsi ose në ndërtesë, të jetë e atij intensiteti që nuk do ta rrezikonte shëndetin e njerëzve dhe të sigurojë qetësi dhe kushte të përshtatshme për pushim dhe punë sipas Ligjit Nr. 2004 / 15 për Ndërtim.

Gjatë kërkesave për mbajtjen e tubimeve publike, organizimit të manifestimeve argëtuese, sportive dhe aktiviteteve tjera në vende publike të hapura ose të mbyllura, për banorët vendorë ose mysafirë, në rastet kur ekzistojnë mundësit e tejkalimit të nivelit të zhurmës së lejuar, njësitë lokale të qeverisjes, me vendim të organeve kompetente, mund të caktojnë një rrugë, një pjesë të rrugës ose pjesë të qytetit, shesh ose lokacion tjetër të përshtatshëm, për qëllime të tilla.

Me rregulloren komunale duhet ndaluar kryerja e punëve, veprimtarive dhe aktiviteteve tjera që me zhurmë pengojnë qetësinë dhe pushimin e njerëzve, në vende të hapura ose të mbyllura nga një orar i caktuar dhe veprimtari të caktuara.

6.1.2.8.3. Mbrojtja e ajrit

Në mënyrë që të bëhet mbrojtja e ajrit është e nevojshme që të gjitha burimet e ndotjes: të palëvizshme, të lëvizshme, burime të vogla të ndotjes ose difuzive të obligohen në ruajtje të cilësisë së ajrit nga ndotjet që mundë shkaktajnë gjatë veprimtarisë që ushtrojnë.

Veprimtaritë që ushtrohet në territorin e Komunës së Ferizajt detyrohen që të:

- Minimizojnë emisionin e ndotësve dhe kundërmimeve; dhe
- Mos tejkalojnë vlerat kufitare të emisionit.

Operatorët e burimeve të ndotjes detyrohen edhe që të:

- Përdorin këto burime vetëm sipas kushteve teknike dhe kushteve të vëna në lejen e integruar ose lejen mjedisore;
- Përgatisin rregullore teknike për funksionim e burimeve të ndotjes;
- Kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të dhënat të dërgohen në Ministri sipas rregullave të parapara me akt të veçantë të cilin e nxjerr MMPH (Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor).
- Përgatisin listën e parametrave teknik, operacional dhe masat tekniko-organizative, për burimet e ndotjes.

6.1.2.8.4. Mbrojtja e biodiversitetit

- Meqenëse Ferizajt është e pasur me lloje të begatshme të bimëve dhe shtazëve këtë begati i mundësojnë pyje dhe peizazhe kodrinore, andaj është e nevojshme të kontrollohet gjuetia dhe shkatërrimi i habitateve të llojeve në rrezik zhdukje në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve bimore dhe shtazore.
- Me qëllim të ruajtjes së disa llojeve shtazore në lumin Sitnica dhe Janjevka dhe rrjedhat e tij është e nevojshme pastrimi nga mbeturinat dhe ujërat e zeza. Në pyje është i nevojshëm rrethim i dhe mbikëqyrje e zonave në të cilat ekzistojnë lloje të rralla për habitatet tona.
- Për mbrojtjen e llojeve bimore është e nevojshme identifikimi i zonave të ndjeshme, ruajtja e disa llojeve mjekësore të cilat janë në rrezik zhdukje nga habitatet tona. Po ashtu është e nevojshme shpallja dhe sensibilizimi i zonave të mbrojtura, peizazheve dhe trungjeve të vjetra të cilat kanë rëndësi shkencore, mjedisore, kulturore, historike, etj.

6.1.2.8.5. Masat për parandalimin e ndikimit negativ social

- Komuna duhet të ofrojë infrastrukturë të nevojshme sociale (edukim, shërbim mjekësor,



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- kulturë, sport) që të shmanget ndikimi negativ social i zhvillimit. Një seri e masave për infrastrukturë duhet të jenë sipas funksionit të vendbanimit (qendra kryesore, nënqendra, qendra lokale).
- Dendësia e vendbanimit duhet të harmonizohet dhe të jetë në pajtim me zhvillimet sociale të vendbanimit.
- Komuna duhet të ballafaqohet me ndërtimet ilegale konform ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale. Për këtë arsye do të krijohet një bazë e të dhënave e cila për çdo ngastër do të përmbajë informata e nevojshme në lidhje me lejen e lëshuar.
- Për ndërtesat e konsideruara si ilegale, sipas ligjit të ri mbi ndërtimet ilegale, komuna do të fillojë procedurën e legalizimit. Për procesin e legalizimit dhe lëshimin e lejeve valide për ndërtesë komuna do të kërkojë taksë.

Për trajtimin cilësorë të ndërtimeve ilegale apo ndërtimeve pa leje bazuar në ligjin aktual me **Nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje** duhet kuptuar definimin e Ndërtimi pa leje sipas këtij ligji i cili i përcakton çdo ndërtim ekzistues i ndërtuar pa leje i cili ka ekzistuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, sipas dëshmive të hartës digjitale ortofoto (ligji i cili zbatohet për ndërtimet pa leje të identifikuar në hartën ortofoto digjitale bazuar në incizimin ajror fotogrametrik në Republikën e Kosovës të datës 30 gusht 2013)

Mirëpo tani është në proces draft ligjin e ri për ndërtimet pa leje i cili bënë ri definim të **“Ndërtimeve pa leje”** – përveç siç parashihet në nenin 13 të këtij ligji, është ndërtim i ndërtuar në tërësi ose pjesërisht deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe që është:

Ndërtuar pa leje ndërtimore apo leje tjetër nga autoriteti qeveritar përgjegjës; Ndërtuar në kundërshtim me lejen ndërtimore, duke përfshirë:

- Ndërtimin e më shumë kateve se që janë lejuar;
- Zgjerimin e gabaritit të ndërtesës përtej lejes; ose
- Ndryshimin e përdorimit/destinimit nga ai për të cilin është dhënë leja;

Ka nisur pa leje para datës së hyrjes në fuqi të këtij Ligji dhe aktualisht është i papërfunduar; ose Ndërhyrje pa leje në ndërtesat me leje; **“Ndërtim i përfunduar ose ndërtim substancialisht i përfunduar”** – është ndërtimi pa leje në të cilin janë kryer punët ndërtimore deri në atë shkallë sa ndërtimi në pjesë të madhe të tij mund të futet në përdorimin e synuar. Që ndërtimi të jetë i përfunduar ose substancialisht i përfunduar duhet të përmbajë së paku elementet e mëposhtme të përfunduara:

- të gjitha elementet e strukturës -konstruksionit;
- të gjitha muret e jashtme dhe kulmin;
- dyert dhe dritaret për të gjitha hapësirat aktualisht të shfrytëzueshme, nëse projekti dhe lloji i ndërtimit përfshin dyer dhe dritare;
- instalimet elektrike të përfunduara për të gjitha hapësirat aktualisht të shfrytëzueshme, nëse projekti dhe lloji i ndërtimit përfshin instalime elektrike;
- instalimet sanitare dhe të hidro-instalimeve të përfunduara për të gjitha hapësirat aktualisht të shfrytëzueshme, nëse projekti dhe lloji i ndërtimit përfshin instalime sanitare dhe hidro-instalime; dhe
- të gjitha sistemet kundër zjarrit, nëse me projekt dhe për llojin e ndërtimit kërkohen sisteme të sigurisë ndaj zjarrit;

“Ndërtim i papërfunduar” – ndërtim pa leje i cili nuk është i përfunduar ose substancialisht i përfunduar; **“Ndërhyrjet pa leje në ndërtesën me leje”** – ndërhyrje pa leje në ndërtesën ekzistuese me leje ose në ndërtesën e regjistruar në Kadastër. Ndërhyrjet përfshijnë: mbindërtimet, zgjerimet, ndërhyrjet në përdhese, kate, kulm apo bodrum, shtesat/aneokset si vertikale ashtu dhe ato horizontale;

Me Nenin 13 të draft ligjit janë definuar ndërtimet për të cilat legalizimi nuk është i domosdoshëm

Ndërtimet e regjistruara në Kadastër konsiderohen të jenë të ligjshme dhe nuk kërkohet trajtim sipas këtij ligji. Megjithatë, nëse ndërtimi pa leje është shtuar pas regjistrimit të ndërtimit origjinal në Kadastër, ndërhyrjet pa leje trajtohen në përputhje



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

me nenin 18. Ndërtimet që janë të përfshira në listën e trashëgimisë kulturore konsiderohen të jenë të ligjshme dhe nuk kërkohet trajtim sipas këtij ligji

Me Nenin 18 të draft ligjit janë definuar trajtimi i ndërhyrjeve pa leje në ndërtesë me leje

Ky nen zbatohet ndaj ndërhyrjeve pa leje në ndërtesë me leje, të ndërtuara deri më datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Sa i përket aspektit legal edhe në rastin e ligjit të tanishëm edhe në rastin e draft ligjit të ri i cili edhe mund të pësoj edhe ndonjë ndryshim deri te aprovimi mund të konstatohet se:

Nëse gjatë cilësdo fazë të procesit shfaqen mangësi të cilat mund të korrigjohen, aplikuesi njoftohet me shkrim lidhur me ato mangësi dhe i jepet një afat i arsyeshëm kohor që t'i korrigjojë dhe/ose përmbushë kërkesat në mënyrë që aplikacioni i legalizimit të mund të vazhdojë.

dhe nëse ndërtimi nuk kualifikohet për legalizim apo nëse aplikuesi nuk i korrigjon mangësitë në aplikacion ose në ndërtim, apo nuk e paguan taksën e kërkuar, organi kompetent nxjerr vendim me shkrim për refuzim të legalizimit dhe e vendos ndërtimin në listën e rrënimit.

Në aspektin legal trajtimi, procedurat dhe komplet sistemi bazohet në ligj dhe vlerësohet nëse objekti legalizohet, ose edhe futet në listën e objekteve për rrënim duke u bazuar në ligjin me **Nr. 04/L-188 për trajtimin e ndërtimeve pa leje** ose kur hyn në fuqi ligji i ri bazuar në ligjin e ri.

Mirëpo sa i përket aspektit të planifikimit duhet merren parasysh edhe aspektet tjera si funksionale, hapësinore por edhe konceptuale dhe në këtë drejtim ndërtimet që duhet trajtuar kujdesshëm janë :

- Ndërtimet para luftës kur nuk kishte plane dhe konsideroheshin sidomos në zonat rurale si legale për kohën.
- Ndërtimet e fazës së rindërtimit të pas luftës
- Ndërtimet në **“Pronë publike”** – pronë në pronësi të Republikës së Kosovës dhe e menaxhuar nga Qeveria e Kosovës ose ndërmarrje publike ose pronë në pronësi dhe nën menaxhim të komunave.
- Ndërtimet në **“Pronë shoqërore”** – pronë e regjistruar në emër të Ndërmarrjes Shoqërore nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.
- Ndërtimet në **“Korridor infrastrukturor”** – tokë për krijimin e infrastrukturës së lidhur me rrugët, transportin publik ose transportimi, lëvizja, transmissioni ose rrjedha e çfarëdo gjëje, duke përfshirë, për shembull ujin, kanalizimin, energjinë dhe informatat ku ndërtimi është i kufizuar ose i ndaluar. Korridori i infrastrukturës mund të përfshijë një hapësirë më të gjerë se vetë infrastruktura për të siguruar një hapësirë neutrale të sigurisë dhe për të mundësuar ndërtimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen sipas nevojës;
- Ndërtimet në **“Tokë bujqësore nën komasacion dhe nën sistem të ujitjes”** – toka bujqësore nën sistem të ujitjes që i është nënshtruar programeve qeveritare të komasacionit

Në të gjitha këto raste mund të konsiderohet legalizimi si opion më i lehtë për dy pikat e para dhe rrënimi për pikat tjera por gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet të merren në konsideratë edhe aspekti funksionale, hapësinore por edhe konceptuale në funksion të zhvillimit dhe e funksionimit normal të komunës.

6.1.3. Masat për zbatimin e planit

6.1.3.1. Detyrimi për hartimin e planit

Në mënyrë që të zbatohet Plani Zhvillimor Komunal, Komuna duhet të përgatis dhe miratojë:

- Hartën Zonale të Komunës;
- Planet Rregulluese të Hollësishme për Zonat Urbane 3,7, 4 dhe 5.
- Planet Rregulluese të Hollësishme për nënqendrat: Prelezi i Muhaxherëve, Softaj, Dardania, Komogllava, Greme, Pleshina e Poshtme, Neredime e Poshtme dhe Koshara.
- Planet Rregulluese të Hollësishme për zonën rekreative Bifurkacioni i Neredimës – Jezerc.
- Planet Rregulluese të Hollësishme për zonat e zhvillimit ekonomik në rrugën M2/25 dhe gjitha zonat tjera të parashikuara me këtë plan.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Prioritet duhet ti jepet zonave ku problemet hapësinore duhet të adresohen urgjentisht. Kjo përfshin zonat ku kërkohet zhvillimi i brendshëm apo ku qyteti rritet në mënyrë të pakontrolluar dhe të paorganizuar dhe ku rigjenerimi i hapësirave publike është nevojë prioritare.
- Planet rregulluese duhet të ofrojnë masa mbrojtëse kundër zjarrit. Këto masa përfshijnë rrjetin për shuarjen e zjarrit në të gjitha pozitat e ndërtesave, qasje të lehtë për kamionët e zjarrfikësve dhe hapësirë për manovrimin e teknologjisë kundër zjarrit sipas rregullave ekzistuese për mbrojtje kundër zjarrit.

6.1.4. Dispozitat lidhur me bashkëpunim

Në mënyrë që të sigurohet zbatimi i Planit komuna sipas procedurave ekzistuese administrative do të ndërtojë bashkëpunim të nevojshëm në mes institucioneve të ndryshme lokale dhe departamenteve, dhe institucioneve në nivelin qendror. Komuna sipas interesit do të ndërtojë marrëveshje bashkëpunimi me komunat fqinje dhe komunat në rajon në mënyrë që të zgjedhin çështjet e përbashkëta të rëndësishme për jetën e banorëve.

Komuna do të bashkëpunojë me institucionet nacionale-institutet zhvillimore dhe kërkimore, që mund të kontribuojnë në procesin e zbatimit të planit. Komuna duhet të themelojë bashkëpunim të mirëfilltë me shoqatat e organizatave civile në mënyrë që të sigurojë procedurë transparente të procesit të planifikimit. Bashkëpunimi me AKP-në—Agjencia Kosovare të Privatizimit—Agjencia do të ketë autoritetin që të administrojë Ndërmarrjet në pronësi Shoqërore dhe Publike që janë regjistruar si të tilla në Kosovë (nëse apo jo ajo Ndërmarrje ka qenë subjekt i Transformimit). Komuna duhet të negociojë më AKP-në për sipërfaqet e tokës për ndërtesat Publike dhe interesat tjera që kanë qenë pjesë e trajtuar dhe destinuar me planë bazuar në ligjet dhe procedurave në fuqi për shkëmbim dhe marrëveshjeve të veçanta.

Zbatimi i Planeve Hapësinore dhe Urbanistike do të jenë të suksesshme vetëm nëse komuna dëshmon zotim për bashkëpunim dhe besim në mes të qytetarëve të saj dhe nevojave të tyre. Fushata mediale do të organizohet në mënyrë që të forcohet njohuria e qytetarëve dhe të rritet mbështetja e tyre për planifikim dhe zbatimin e planeve. Informatat hapësinore në disponim do të vazhdojnë të digjitalizohen dhe centralizohen duke bashkëpunuar me institucionet relevante po ashtu duhet të vazhdojnë të integrohen në një bazë të dhënave GIS. Komuna duhet të vë në dispozicion të dhënat që do të jenë të qasshme për të gjitha drejtoritë e administratës komunale për edhe publikun, në formatin GIS nëpërmjet internetit. Procesi i lëshimit të lejeve për ndërtim, duke rritur bashkëpunimin dhe edhe transparencën për të gjitha grupet me interes.

6.1.5. Dispozitat mbi rendin kronologjik apo etapat e implementimit

Pas miratimit të planit deri në maksimum tre muaj pas miratimit të PZhK-së, Komuna duhet ti rishikojë të gjitha politikat sektoriale në mënyrë që ti harmonizojë ato më dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

Brenda tre muajve pas miratimit final të të dy Planeve Planit Zhvillimor Komunal dhe Planit Zhvillimor Urban, Kuvendi Komunal duhet të miratojë një plan buxhetor shtesë i cili qartë paraqet se si planet e zbatuara do të financohen brenda tri viteve të ardhshme. Ky Plan buxhetorë do të definojë financimin dhe procesin e hartimit të Planeve Rregulluese dhe dokumente shtesë të politikave dhe studimet e nevojshme për zbatimin e planit.

Komponenta fizike e planit që i ka për bazë zonat, vijat dhe korridoret fillon të zbatohet me një herë pas hyrjes në fuqi të planit. Hartimi i buxhetit komunal për vitet e ardhshme duhet bëhet duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal. Të gjitha zhvillimet tjera do të bazohen në planin dinamik dhe prioritetizimet të planit të veprimit: prioritet i lartë(1), prioritet i mesëm (2), dhe prioritet i ultë (3) dhe afatet kohore: Afat shkurtër (1-3 vite), afat mesëm (3-5 vite), dhe në Vazhdimësi (1-10 vite).

6.1.5.1. Elementet dhe udhëzimet për hulumtim të mëtutjeshëm

Plani Zhvillimor Komunal ofron kornizë punuese për studime të mëtutjeshme në zhvillimin e komunës, që lehtëson zbatimin e Planit. Në vazhdim janë dhënë temat e studimit të nevojshëm në mënyrë që të vazhdohet me zbatimin e planit:



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit për zonat që janë nën masa komasacioni ;
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit nëntokësor;
- Hulumtime në funksion të kompletimit të kadastrit të ndotësve të ajrit;
- Thellim i hulumtimeve për zonat tokësore të ndotura dhe ndotësit tjerë;
- Thellim i hulumtimeve për rregullim të regjimit të Ujërave;
- Thellim i hulumtimeve për inventarizim të llojeve organike;
- Thellim i hulumtimeve për zonat me pasuri nëntokësore;
- Thellim i hulumtimeve në saktësimin e hartës së bonitetit të tokës;
- Studimi i pasurive nëntokësore;
- Hulumtime në Plan-konceptin për zhvillimin e turizmit;
- Hulumtime në Plan të Lëvizshmërisë dhe të trafikut;
- Hulumtime në Plan-koncept të zhvillimit ekonomik;
- Vlerësim për prodhim të energjisë alternative duke përfshirë studimin e arsyeshëm për zhvillimet në shkallë të vogël të biomasës, solar dhe energji tjera ripërtëritëse.

6.2. Dispozitat mbi monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal

Bazuar në Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Kuvendi Komunal në baza vjetore shqyrton duhet të shqyrtojë raportin monitorues të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave të deklaruara në Planin zhvillimor Komunal.⁴⁸ Mirëpo, për shkak të rishikimit të buxhet, ky dokument parasheh dy raporteve monitoruese brenda vitit, cilat duhet të jenë të gatshme 15 ditë para datës që është paraparë. Në vijim të përgatitjes së planit të informimit dhe të komunikimit, dhe me qëllim të hartimit të një dokumenti sa më të suksesshëm informimi dhe komunikimi, duhet të potencohen katër faktorë të rëndësishëm:

1. Drejtuesit e komunës dhe drejtoritë e ndryshme komunale, duhet fillimisht vetë të janë të bindur për rëndësinë e informimit dhe të komunikimit në funksion të zbatimit të dokumentit.
2. Drejtuesit e komunës dhe drejtoritë e ndryshme komunale, duhet të pajtohen se informimi dhe komunikimi, duhet planifikuar përmes strategjive për informim dhe komunikim.
3. Drejtuesit e komunës dhe drejtoritë e ndryshme komunale, duhet të parashikojnë buxhet dhe burime të tjera mbi planet dhe strategjitë lidhur me informimin dhe komunikimin.
4. Drejtuesit e komunës dhe drejtoritë e ndryshme komunale, duhet të bëjnë azhurnime periodike të planeve dhe strategjive të informimit dhe komunikimit, pasi që mund të ketë situata të reja në kuptimin e zhvillimeve dhe situata të ndryshme në kuptimin e raporteve me akterët të cilët, informohen dhe me të cilët komunikohet por, edhe klima politike dhe financiare në komunë mund të ndryshojë.

Së paku një herë në vit, 15 ditë pas shqyrtimit të raportit monitorues nga Kuvendi Komunal, personi përgjegjës do të zhvillojë një prezantim publik të raportit monitorues për banorët e Komunës. Për të përgatitur raportet monitoruese, Komuna duhet të themelojë Ekipin Monitorues të Planit Zhvillimor Komunal, duke përcaktuar së paku nga një punonjës nga:

- Drejtoria e Administratës së Përgjithshme
- Drejtoria e Financave
- Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër
- Drejtoria e Infrastrukturës
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm
- Drejtoria e Arsimit
- Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Drejtoria për Pronë, Gjeodezi dhe Kadastër

⁴⁸Republika e Kosovës, Ligji Nr. 04/L-174 Për Planifikimin Hapësinor, Prishtinë, 2013



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Mjedisit
- Përgjegjës për koordinimin e punës të këtyre drejtorive do të caktohet një punëtor nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje e Mjedisit, duke zhvilluar takime punuese së paku katër në vit, ku secila drejtori do të prezantojë sasinë dhe përqindjen e zbatuar të treguesve të monitorimit.

Treguesit e monitorimit të zbatimit të qëllimeve dhe të objektivave hapësinore është parashtruar në ***Shtojcën 2 Ecuritë dhe treguesit e monitorimit.***

Harta Zonale e Komunës, e cila pritet të miratohet së shpejti duhet të përmbajë treguesit e zbatimit, të cilat zbatohen në planin e veprimit, i cili duhet përmbajë edhe veprimet e planifikuara në këtë dokument, duke a plotësuar atë me veprime shtesë. Prandaj edhe treguesit e monitorimit të Hartës Zonale të Komunës duhet të përmbajë treguesit e paraparë në këtë dokument. Zbatimi i harmonizimit të planeve të veprimit dhe treguesve të monitorimit do të sigurojë përgatitjen e vetëm e një raporti monitorues të përbashkët për të dyja dokumentet, që duhet të përgatitet dy herë vit.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

6.3. Dispozitat përfundimtare

6.3.1. Hyrja në fuqi

Ky Plan do të hyn në fuqi 15 ditë pasi që të miratohet nga Kuvendi Komunal.

6.3.2. Validiteti/ vlefshmëria

Ky Plan do të jetë i vlefshëm për 8 vjet.

6.3.3. Vlerësimi

PZHK do të vlerësohen rregullisht, p.sh. një herë në vit.

Gjithashtu do të konsiderohen zhvillimet aktuale dhe të dhënat demografike të tanishme, nevojat për banime dhe zhvillimet ekonomike. Vlerësimet do të përcaktojnë serinë e zbatimit të planeve të veprimit dhe strategjive.



Plani Zhvillimor Komunal 2017 - 2025

i Komunës së Ferizajt

7. Pjesa Hartografike

Pjesa Hartografike e PZHK së përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike për tërë hapësirën e komunës të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në një platformë GIS, i cili paraqet informacione thelbësore për të gjitha planet zhvillimore sektoriale si rrjedhojë e Konceptit të Zhvillimit Hapësinor dhe Prioriteteve Strategjike të Zhvillimit.